

**ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**18**



**PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQIPERISE**



**E N V E R   H O X H A**



'INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE  
PRANE KQ TE PPSH

# ENVER HOXHA

VËLLIMI

18

JANAR 1960 — QERSHOR 1960

**SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1975**

## *PARATHËNIE PËR VËLLIMIN 18*

Në vëllimin e 18-të të Veprave të shokut Enver Hoxha përfshihen shkrime të periudhës janar-qershor 1960. Në këtë vëllim, ndër të tjera, hyjnë: Letër drejtar komiteteve të Partisë për të luftuar disa shfaqje borgjeze e mikroborgjeze në zbatimin e parimit të shpërndarjes sipas punës (6 janar 1960), Fjala në aktivin e Partisë të ushtrisë (7 prill 1960), Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH për disa probleme të zhvillimit të bujqësisë e të blegtorisë (16 prill 1960), Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH për zhvillimin e luftës së klasave dhe për zbatimin drejt të vijës së masave (18 prill 1960), Fjala e mylljes në Plenumin XVI të KQ të PPSH për problemet e përsosjes së organizimit dhe të drejtimit të ndërtimeve në vendin tonë (26 maj 1960), Fjalime gjatë vizitave në rrithin e Peshkopisë e të Burrelit (qershor 1960), diskutime në mbledhje të Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të PPSH, biseda, letra etj. Shumica e dokumenteve botohen për herë të parë.

Materialet e përfshira në këtë vëllim janë një dëshmi tjetër e vazhdimesisë së vijës politike mark-siste-leniniste që ka ndjekur PPSH në të gjithë rrugën e saj revolucionare.

Viti 1960 ishte viti i fundit i pesëvjeçarit të dytë. Për të realizuar me sukses detyrat e rëndësishme të këtij viti dhe të krejt pesëvjeçarit Partia porosiste që të mobilizoheshin të gjitha energjitetë dhe burimet e brendshme, të përsosej më tej organizimi dhe drejtimi i punëve, të rriteshin në një shkallë më të lartë iniciativat revolucionare dhe lufta këmbëngulëse e masave për të përballuar çdo vështirësi e pengesë.

Rëndësi të veçantë në këtë periudhë Partia i kushtonte zhvillimit të miëtejshëm të bujqësisë e sidomos forcimit ekonomiko-organizativ të kooperativave bujqësore.

Në të njëjtën kohë Partia dhe masat punonjëse kishin filluar punën për preqatitjen e projektplanit të pesëvjeçarit të tretë.

Duke vlerësuar drejt situatën e brendshme e të jashtme, mundësitë reale që ekzistonin në gjirin e masave punonjëse si dhe presionet e udhëheqjes revizioniste sovjetike që vinin duke u shtuar, mbi Partinë dhe popullin tonë, KQ i Partisë me shokun Enver Hoxha në krye kërkonte të shfrytëzoheshin të gjitha mundësitë dhe rezervat e brendshme në planifikim, tërhiqte vëmendjen për t'u mbështetur më fort në forcat e veta, dënonite shfaqjet që vëreheshin aty-këtu për të pritur çdo gjë nga jashtë, kërkonte të forcohej puna politike edukative me kuadrot e masat me qëllim që te secili të krijoheshin bindje të shëndosha në forcat, në energjitetë dhe në burimet e brendshme.

Duke punuar për plotësimin e detyrave të vtit të fundit të pesëvjeçarit të dytë dhe për preqatitjen e planit të ardhshëm pesëvjeçar, Partia shikonte me

*shqetësim përhapjen e gjerë që po merrnin teoritë dhe praktikat borgjezo-revizoniste në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera ish-socialiste: Duke qenë kundër këtyre pikëpamjeve dhe praktikave antimarksiste, të cilat i ashpëronin më tej divergjencat dhe mosmarrëveshjet midis PPSH dhe udhëheqjes revizioniste sovjetike, shoku Enver Hoxha me Komitetin Qendror të Partisë parashikonin presione më të mëdha nga ana e udhëheqjes revizioniste sovjetike në të ardhshmen, si rrjedhim, edhe ndeshje më të ashpra me të. Përpara këtyre rreziqeve të mëdha, ata luftonin që Partia të ishte e preqatitur nga çdo pikëpamje për të ruajtur vijën e saj të drejtë e për të siguruar vazhdimësinë e ndërtimit të socializmit.*

*Dokumentet ë botuara në këtë vëllim na japid një pasqyrë të saktë të këtyre qëndrimeve të vendosura e të drejta të Partisë sonë në këtë periudhë.*

*Ndryshe nga PK e BS dhe nga ato parti të tjera që po shkisanin çdo ditë e më tepër në batakun e revizionizmit, PPSH e dendësoi luftën politike e ideologjike kundër revizionizmit modern, në përgjithësi, dhe kundër revizionizmit jugosllav, në veçanti. Krahas luftës klasore kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm si dhe kundër koncepteve e qëndrimeve konservatore, patriarkale, fetare, burokratike etj., PPSH dha orientime të qarta e mori masa konkrete për t'i prerë rrugën depërtimit në Shqipëri të ndikimeve revizioniste, prirjeve borgjeze e mikroborgjeze, që kishin hyrë thellë në jetën e BRSS dhe të mjaft vendeve të tjera ish-socialiste, sidomos shfaqjeve për të zhvatur sa më shumë nga shoqëria, shthurjeve morale në mënyrën e*

jetesës, degjenerimit borgjezo-revizonist të kuadrove, të intelijencës e të rinisë, duke kërkuar të zbatohet sa më drejt parimi socialist i shpërndarjes sipas punës, të ruhej e të forcohej morali socialist. Për këtë qëllim ajo e rriti kujdesin dhe e forcoi punën për edukimin marksist-leninist të komunistëve dhe të të gjithë punonjësve për çelikosjen e unitetit Parti-popull, për zbatimin e drejtë të vijës së masave, për mobilizimin e energjive dhe të burimeve të brendshme të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste, të intelijencës populllore, të rinisë, të grave në luftë kundër vështirësive, kundër çdo gjëje të huaj për politikën dhe ideologjinë proletare, për moralin socialist.

Në të njëjtën kohë iu kushtua një vëmendje e madhe forcimit të fuqisë mbrojtëse të atdheut, rritjes së gatishmërisë luftarakë të popullit, veçanërisht pre-gatitjes së mëtejshme politiko-ushtarake të Ushtrisë Populllore, si edhe mprehjes së vigjilencës së masave.

Për realizimin e këtyre detyrave faktor vendimtar ishte ruajtja dhe forcimi i karakterit proletar të Partisë, udhëheqja e saj revolucionare. Në veprat e këtij vëllimi pasqyrohet qartë kujdesi shumë i madh i shokut Enver Hoxha dhe i gjithë KQ të Partisë për forcimin dhe për gjallërimin e jetës së brendshme të organizative-bazë të Partisë, për rritjen e rolit të tyre udhëheqës, për shtimin e radhëve të Partisë me gjak të ri, me luftëtarë të pararojës në luftën për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e atdheut dhe për ruajtjen e pastërtisë së vijës marksiste-leniniste.

Me këtë luftë të vendosur që zhvillonte si në frontin e brendshëm ashtu edhe në të jashtmin, PPSH

siguronte zhvillimin e pandërprerë të vendit në rrugën e socializmit, jepte një kontribut të rëndësishëm për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, në shkallë ndërkombëtare, njëkohësisht kalitej edhe më tepër, bëhej më e gatshme, më vigjilente dhe më e aftë për të përballuar me guxim betejat e mëdha e të ashpra të vjetëve 60-të, kur revizionistët hruščovianë dhe pasuesit e tyre dolën hapur si përqarësit më të mëdhenj të unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe si armiqtë më të betuar të komunizmit e të popujve.



**VETËM ME NJË LUFTË TË VENDOSUR KUNDËR  
TË GJITIA SHFAQJEVE BORGJEZE  
DHE MIKROBORGJEZE VIHEN NË JETË DREJT  
POROSITË E PARTISË PËR ZBATIMIN  
E PARIMIT SOCIALIST TË SIPIRNDARJES  
SIPAS PUNËS**

*Letër drejtuar komiteteve të Partisë në rrethe*

6 janar 1960

Komiteti Qendror gjithnjë ka theksuar se përmirësimi i mirëqenies materiale dhe ngritja e nivelit kulturor të masave punonjëse është ligji më i lartë që përshkon gjithë veprimtarinë praktike të Partisë dhe të shtetit tonë. Partia ka vlerësuar dhe ka përkrahur gjithnjë përpjekjet e drejta të punonjësve për ngritjen e mirëqenies së tyre. Këtij qëllimi i shërbejnë masat shumë të rëndësishme ekonomike që janë marrë për shpérndarjen dhe rishpérndarjen e të ardhurave kombëtare, për zbatimin e drejtë të parimit socialist të shpérndarjes sipas punës. Në përshtatje me këtë, është përpunuar sistemi i pagave, është përmirësuar normimi i punës, janë vendosur masa nxitëse për novatorët dhe

racionalizatorët e prodhimit, për punonjësit e artit e të kulturës etj. Këto masa kanë ndihmuar në mobilizimin e forcave krijuuese të popullit për të arritur rezultate të mëdha në zbatimin e politikës ekonomike të Partisë.

Marksizëm-leninizmi na mëson se në periudhën e kalimit nga kapitalizmi në socializëm, në ndërgjegjen e njerëzve ruhen akoma mbeturina borgjeze dhe mikroborgjeze, të cilat përbëjnë një nga format e luftës së klasave. Ekzistenza e tyre është e lidhur me mbeturinat që kanë trashëguar punonjësit nga e kaluara jo e largët, me influencën e ideologjisë borgjeze, me ekzistencën, megjithëse në një masë të kufizuar, të pronës private, si dhe me faktin që vendi ynë rrëthohet nga shtete kapitaliste, të cilat bëjnë ç'është e mundur për të mbajtur gjallë te ne mbeturinat e ideologjisë borgjeze. Për këto arsyqe, Komiteti Qendror i PPSH ka porositur vazhdimi i organizatat e Partisë, organet shtetërore dhë të ekonomisë që të forcojnë punën politike dhe edukative me punonjësit, si dhe kontrollin për zbatimin e drejtë dhe me përpikëri të ligjshmërisë socialiste.

Por, Komiteti Qendror i PPSH konstaton se në radhët e punonjësve tanë vihen re disa shfaqje të huaja, për të vënë interesin personal mbi interesin e përgjithshëm, të cilat janë të dëmshme për shtetin dhe popullin si dhe për vetë ndërgjegjen e njerëzve, autorë të këtyre shfaqjeve. Këto kanë gjetur terren të favorshëm në burokratizmin që ekziston akoma në aparatet tona, në nönvlefësimin që i bëhet influencës së ideologjisë borgjeze dhe në mungesën e disiplinës shtetërore e të Partisë në disa raste.

Të metat e mësipërme vërehen në këto drejtime kryesore:

1. Në tendencën për mbajtjen e rezervave që në planifikim, në realizimin e planit të prodhimit në dëm të cilësisë, në falsifikimin e rezultateve të realizimit të planit për të përsituar shpërblime dhe për të shpëtuar nga përgjegjësia e mosrealizimit të tij.

Planifikimi sa më i drejtë i mundësive për shtimin e prodhimit dhe të shërbimeve, zbulimi dhe përfshirja në plan e rezervave të shumta që fshihen në ekonominë popullore, është një detyrë e rëndësishme për çdo punonjës. Krahas me këtë, një kusht i domosdoshëm për mbarëvajtjen e punës është mobilizimi i punonjësve për të realizuar planin në rrugë të drejtë dhe në të gjithë treguesit e tij cilësorë. Këto detyra lidhen ngushtë me shpejtimin e ritmeve të zhvillimit të ekonomisë, me ngritjen e nivelit të jetesës së popullit, me ndërtimin sa më parë të socializmit në vendin tonë.

Me gjithë porositë e vazhdueshme të Partisë, në praktikë janë vërejtur shtrembërimet. Disa drejtues të ekonomisë i planifikojnë treguesit e planit me rezerva, nën mundësitë reale, ndërsa disa të tjerë bëjnë manovrime brenda tremujorëve. Të gjitha këto bëhen me qëllim për të përsituar shpërblime për tejkalim plani, si dhe për të shpëtuar nga përgjegjësia e mosrealizimit të tij. Kështu, ndërmarrja lokale komunale e rrethit të Durrësit, gjatë tremujorit të dytë të vitit 1959, ka marrë 403 000 lekë shpérblim për tejkalim plani. Kjo ndërmarrje realizoi planin e tremujorit të dytë 153 për qind në një kohë kur 5, nga 16 sektorët e saj, nuk e

realizonin planin, ndërsa tejkaloi 3,5 herë planin e lëndës djegëse, që zë një peshë të madhe në vëllimin e prodhimit dhe që ishte planifikuar për tremujorin e dytë shumë më i ulët nga sa ishte realizuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Me këtë gjendje jonormiale është pajtuar si Drejtoria e Përgjithshme e Ekonomisë Komunale, ashtu edhe Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor dhe ai i Partisë në rrethin e Durrësit. Në tremujorin e parë dhe të dytë, mjaft drejtori të arkave të kursimeve dhe të sigurimeve shtetërore shoqërore kanë tejkaluar planin e depozitave të kursimeve nga 180 deri 250 për qind. Si rrjedhim edhe nga planifikimi me rezerva, arkat e kursimeve dhe të sigurimeve shtetërore shoqërore kanë përfituar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 1959 shumën prej 1 milion e 216 mijë lekë shpërblime për tejkalim plani. Këto tejkalime të mëdha, të arritura me lehtësi, nuk kanë tërhequr vëmendjen e organeve financiare, të cilat nuk kanë marrë masat e nevojshme për mënjanimin e tyre.

Në shumë vendime të Partisë është theksuar se plani duhet të realizohet jo vetëm në sasi, por edhe në cilësi, me qëllim që prodhimet të qarkullojnë në kohën e duhur dhe të plotësojnë nevojat dhe shijet e konsumatorëve. Në praktikë, këto detyra janë zbatuar me të meta. Kështu në fabrikën e qelqit në Korçë, plani i tremujorit të parë u realizua 123,6 për qind dhe plani i tremujorit të dytë 122,3 për qind, duke prodhuar me skarcitet mjaft të lartë. Megjithëse në këtë fabrikë gjenden sasi të mëdha prodhimi që për cilësi të dobët nuk shpërndahen, punonjësit e admi-

nistratës të këtij sektori, në rrugë të shtrembër, përfituan një shpërblim prej 250 000 lekësh.

Përpjekja pür të shpëtuar nga përgjegjësia e mosrealizimit të planit, dëshira pér të përfituar shpërblime me çdo rrugë dhc me çdo kusht, i ka nxitur drejtuesit e disa ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike që të falsifikojnë rezultatet e realizimit të planit. Veprime të tilla, që janë bërë me paramendim, formojnë shkelje të rënda ligjore, veprime antishtetërore. Drejtuesit e bashkimit të kooperativave të konsumit në Elbasan kanë bërë falsifikime dhe mashtrime në të dhënrat e realizimit të planit të tremujorit të dytë të këtij viti, duke rritur artificialisht planin e grumbullimit dhe sidomos të drithit. Në këtë mënyrë, duke shtrembëruar realitetin, ata mundën ta paraqitin organizatën e tyre me plan e me zotime të realizuara dhe të marrin flamurin e kuq të Këshillit të Ministrave, së bashku me shpërblimin përkatës. Për këto shkelje të rënda shkaktarët iu dhanë gjyqit dhe komunistët fajtorë u përshtuan nga Partia.

Këto shfaqje kanë prishur ndërgjegjen e mjaft punonjësve, moralin dhe ndershëmërinë e tyre. Disa prej tyre, ndër ta edhe ndonjë komunist, e kanë bërë mashtrimin, matrapazllékun, vetëmburrjen dhe falsifikimin si metodë punc. Falsifikimet në realizimin e planit, mbajtja e rezervave në planifikim, si dhe realizimi i planit vetëm në sasi, në dëm të cilësisë dhe të asortimentit, i kanë sjellë shtetit dëme të mëdha dhe, po të vazhdojnë akoma më tej, mund të pengojnë mobilizimin e të gjitha forcave pér ndërtimin me sukses të socializmit në vendin tonë. Prandaj këto

përbëjnë shkeljet më të rrezikshme dhe më të dëmshme për disiplinën shtetërore dhe si të tilla duhet të demaskohen, të dënohen dhe të merren masa të rënda ndaj shkaktarëve, deri në dhënen e tyre gjyqit.

2. — *Ka shfaqje të huaja në kuptimin dhe në përcaktimin e normave, të cilat, për qëllime përfitimi, tejkalohen shumë në dëm të cilësisë së prodhimit.*

Përcaktimi i drejtë i normave luan një rol me shumë rëndësi për rritjen e prodhimit dhe të shërbimeve, për përmirësimin e cilësisë së tyre, si dhe për zbatimin sa më të drejtë të parimit socialist të shpërblimit sipas punës. Kjo është një çështje e madhe politike, ekonomike dhe shoqërore, në të cilën pjesërisht gjen shprehje kombinimi i interesave të shoqërisë me ato të punonjësve në veçanti.

Por, me gjithë përmirësimet e arritura, në këtë drejtim janë manifestuar tendenca të dëmshme për të përfituar sa më shumë nga shteti në rrugë jo të drejtë, duke i mbajtur normat të ulëta ose duke i tejkaluar ato në një masë të konsiderueshme, në dëmi të cilësisë dhe të asortimentit të prodhimit. Ka tendenca, nga disa punëtorë, për t'i pasur normat të ulëta, që t'i realizojnë dhe t'i tejkalojnë ato me lehtësi, me qëllim që të përfitojnë shpërblime, prandaj ngurrohet përingritjen e tyre. Në Uzinën e Mekanikës Bujqësore në Durrës, gjatë vitiit në vazhdim, normat e punës në repartin e fonderisë, të motoristëve, të kovaçhanës dhe të saldatorëve janë realizuar mesatarisht 159-181 për qind. Punimet e dhëna me akord për montimin e fabrikës së tullave në Tiranë janë kontraktuar pothuajse pa asnje bazë dhe për shuma të

propozuara nga teknikët ose nga specialistët që kanë kryer këto punime. Rezulton se një specialist ka marrë mesatarisht 800-1 000 lekë në ditë dhe punëtorët ndihmës të kategorisë së dytë kanë marrë nga 8 000-9 000 lekë<sup>1</sup> në 15 ditë.

Si rrjedhim, punonjësit e disa degëve dhe të sektorëve të një rëndësie të dorës së dytë për ekonominë popullore, kanë fituar më shumë të ardhura se punonjësit e disa sektorëve kryesorë, gjë që prish raportet në shpërblimin sipas punës. Nga ana tjetër, këto të meta kanë influencuar në cilësinë e prodhimeve dhe të shërbimeve, kanë dëmtuar arkën e shtctit dhe kanë vështirësuar qarkullimin e mallrave. Prandaj është e nevojshme që dobësi të tillë të mënjanohen. Komunistët të jepin shembullin personal në përcaktimin e drejtë të normave dhe me këtë çështje të rëndësishme të merren më tepër organizatat e Partisë dhe drejtuesit e ekonomisë. Komiteti Qendror i Partisë është i bindur se klasa jonë punëtore, që me vetëmohim po punon për të ndërtuar jetën e saj të re, do ta kuuptojë drejt nevojën e mënjanimit të këtyre dobësive, po t'i bëhen të qarta nga organizatat e Partisë humbjet e miëdha që sjell gjendja anormale e realizimit të normave.

3. — *Ka shfaqje të huaja në përfitimin e shpërblimeve për shpikje dhe racionalizime.*

Lëvizja për shpikje dhe racionalizime ka marrë një hov të madh dhe ka dhënë mjaft rezultate në rritjen e prodhimit, në zhvillimin e teknikës, në kursimin

<sup>1</sup> Lekë të vjetër.

cë lëndëve të para dhe të materialeve. Partia e ka vlerësuar dhe do ta vlerësojë vazhdimisht këtë çështje, si një nga format për inkurajimin dhe për zhvillimin e mëtejshëm të forcave krijuese të masave tona punonjëse. Por, në mjaft punonjës, ndër ta dhe kuadro inxhiniero-teknikë, janë manifestuar shfaqje të huaja për të përsituar sa më shumë nga shteti, duke propozuar si shpikje, racionalizime dhe modifikime gjëra që dihen ose që lidhen me detyrat e tyre direkte. Kështu një përgjegjës kantieri në NSHN — «21 Dhjetori» në Tiranë, propozon që, për ndërtesat e banimit në Farkë, për sanatoriumin e ri në Tiranë etj., guri për themelat të mos merret në Linzë, si më parë, por të hapet një gurore në Mullet. Për këtë propozim, i cili nga zyra e shpikjeve dhe e racionalizimeve të Ministrisë së Ndërtimit është konsideruar si «racionallizim», është dhënë shpërblimi prej 17 000 lekësh. Drejtori i NISH-Ushqimores në Elbasan, në vend që të kritikohej rëndë për mosrealizimin e planit dhe për prodhimin e mallrave me cilësi të dobët, që nuk shiten dhe krijojnë mbinormativa, duke blokuar fondet shtetërore, është shpërbllyer me 7 000 lekë sepse propozoi që stokun e rakisë ta kthejë në alkool. Disa herë bëhen propozime për shpikje dhe racionalizime nga persona që janë dërguar posaçorisht për eksperiençë jashtë shtetit.

Kjo tendencë e dëmshme i ka dhënë një kuptim të keq nxitjes së drejtë për shpikje dhe racionalizime. Në këtë mënyrë disa masa teknike dhe organizative që lidhen me detyrat e drejtuesve të ekonomisë dhe të personelit inxhiniero-teknik, janë konsideruar si novatorizma. Para këtyre rasteve organizatat e Partisë

nuk kanë ndërhyrë për të luftuar si duhet për kuptimin e drejtë të nxitjes për shpikje e racionalizime. Kësaj gjendjeje duhet t'i jepet fund. Organet shtetërore, organizatat e Partisë dhe organizatat e bashkimeve profesionale duhet të punojnë për vënien e një rregulli të fortë në vlerësimin e shpikjeve dhe të racionalizimeve, të kritikojnë rëndë ata punonjës që kërkojnë ta përdorin këtë formë në mënyrë të shtrembër përritjen e të ardhurave të tyre.

4. — *Ka shfaqje të huaja në punonjësit e arsimit, të artit dhe të kulturës për të përfituar sa më shumë në dëm të cilësisë së krijimtarisë së tyre.*

Një zhvillim të madh kanë marrë arsimi, arti dhe kultura. Puna krijuese e kuadrove të këtij sektori me të drejtë përkrahet nga Partia, pasi ajo është e lidhur me edukimin komunist të masave të gjera të popullit dhe si e tillë duhet të konsiderohet si një çështje nderi dhe patriotizmi. Por në disa nga këta punonjës janë vërtetuar shfaqje të huaja për të përfituar sa më shumë nga shteti. Mjaft pedagogë, punonjës të dikastereve qendrore, janë marrë me përkthime, me daktiografime, që i kanë shkëputur ata nga kryerja e mirë e detyrës së tyre kryesore. Në disa punonjës të artit dhe të kulturës janë shfaqur tendenca të dëmshme për të përfituar në rrugë jo të drejtë nga profesioni dhe talenti i tyre, duke e bërë profesionin si mjet tregtie dhe matrapazllëku. Për shembull, piktori... ka realizuar rreth 2 milion lekë të ardhura në vit nga punime artistike, DH. P. i dënuar nga gjyqet e popullit, nëpërmjet përkthimeve ka realizuar mesatarisht në muaj rreth 33 500 lekë etj. Të ardhura të mëdha kanë

përfituar në kurriz të shtetit edhe punonjës të tjerë si disa skicografë në universitet, që kanë arritur të marrin mesatarisht rrëth 21 000 lekë në muaj; një përgjegjës dyqani në NTLAI, për punime druri ka marrë rrëth 13 000 lekë në muaj; një fotograf i klubit «Dinamo», rrëth 17 500 lekë në muaj, e kështu disa të tjerë si këta.

Disa pedagogë, disa punonjës të shëndetësisë, disa punonjës të dikastereve etj., kanë synuar të realizojnë sa më shumë të ardhura, duke bërë shumë punë suplementare. Me të drejtë lind pyetja: Ku e gjejnë kohën këta për të kryer detyrat suplementare? Sigurisht në dëm të punës së tyre kryesore.

Në disa punonjës të arsimit, të artit dhe të kulturës manifestohen tendenca për të kryer punime e për të bërë punë suplementare me para në dorë, me shpërblime, bile është bërë e modës për të gjetur shtigje dhe rrugë për të marrë sa më shumë nga shteti.

Dobësitë e mësipërme, jo vetëm që kanë dëmtuar arkën e shtetit, por kanë prishur ndërgjegjen e mjaft punonjësve të këtyre sektorëve të rëndësishëm. Prandaj organet shtetërore dhe organizatat e Partisë duhet t'u presin rrugën këtyre shfaqjeve të huaja për moralin komunist, të forcojnë kontrollin dhe punën edukative me punonjësit e arsimit, të artit dhe të kulturës. Nuk ka dyshim se inteligjenca jonë populllore do t'i dënojë me ashpërsi këto shtrembërime në kuptimin e detyrave të mëdha që i janë vënë për të përpunuuar dhe për të ngritur më lart traditat e shkëlqyera të kulturës së popullit tonë.

*5. — Ka shfaqje të huaja për të përfituar sa më*

shumë duke shpërdoruar pozitën zyrtare dhe duke komprometuar persona të tjerë.

Partia jonë vazhdimisht ka porositur që punonjësit e aparatit administrativ dhe në përgjithësi gjithë punonjësit e vendit tonë, të shërbejnë me ndërgjegje në detyrat e caktuara, të respektojnë ligjet në fuqi dhe të mbajnë marrëdhënie të drejta me vartësit e tyre. Dhe kjo është një nga kërkesat më elementare për çdo qytetar. Në praktikë disa punonjës, duke shkelur ligjet e shtetit, disiplinën shtetërore, e kanë përdorur detyrën që u ka ngarkuar Partia për të siguruar përfitime të padrejta në dëm të interesit të përgjithshëm shtetëror. Drejtori i llixhave të Elbasanit, përvëç lejes së zakonshme, është larguar nga puna pa leje për 44 ditë, nëndrejtori për 57 ditë. Veç kësaj, drejtori, duke qenë i pajtuar në mensë vetëm për vete, ka ngrënë bashkë me gruan dhe fëmijën pa paguar asgjë, dhe persona të tjerë përgjegjës, gjatë orarit zyrtar, kanë punuar kopshjet e tyre personale. Në shkollat 7-vjeçare në Tiranë, disa drejtorë dhe nëndrejtorë që nuk kanë të drejtë të japid mësim me orë suplementare, për të mos nxjerrë emrat e tyre në listat e orëve jashtë orarit, kanë vënë emra të arsimtarëve të tjerë dhe nëpërmjet tyre kanë tërhequr shpërblime që nuk u takonin. Drejtori i ndërmarrjes shtetërore të prodhimeve të material-ndërtimit në Tiranë, për ndërtimin e shtëpisë së tij, ka marrë nga ndërmarrja që drejton, materiale me çmime që zbatohen për ndërmarrjet shtetërore dhe ka pasur përfitime të tjera që vlerësohen në rreth 41 000 lekë.

Në praktikë ka edhe shumë forma të tjera, ku

manifestohen shfaqje të huaja që prishin ndërgjegjen e njerëzve. Kështu, për shembull disa shoferë e kanë bërë zakon të fitojnë para me dallavere në kurriz të popullit dhe të shtetit, disa mjekë ushtrimin e profesionit e kanë përdorur me qëllim fitimi dhe mjaft shitës spekulojnë në kurriz të popullit. Në disa qendra pune, punonjës të ndryshëm dhe sidomos drejtuesit përfitojnë nga ekonomitë ndihmëse duke ngrënë gratis në mensa cse jashtë rregullave. Bëhen favore në vendosjen e fëmijëve në çerdhe dhe në kopshte, në marrjen e pushimeve nga mjekët, në akordimin e bursave, në dërgimin e njerëzve jashtë shtetit e sidomos për të sëmurët, në aprovimin e veprave artistike, të kompozimeve etj.

Komiteti Qendror i PPSH konstaton se të metat e mësipërme kanë influencuar negativisht në ndërgjegjen e njerëzve, kanë dëmtuar disa kuadro drejtues, inxhinierë, teknikë dhe punonjës. Në të njëjtën kohë mjaft punonjës me përgjegjësi dhe me profesione të ndryshme kanë realizuar të ardhura të mëdha jashtë rregullave, kanë krijuar për veten e tyre «një regjim të veçantë jetese», janë të predispozuar për një jetë boshe në kundërshtim me normat e shoqërisë sonë, ushqchen dhe vishen më tepër nga sa i lejon gjendja e tyre ekonomike.

Shkaqet e këtyre dobësive duhen kërkuar në këto drejtime kryesore:

*Së pari*, komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë kanë bërë një punë të pamjaftueshme për edukimin e masave. Nga ana e tyre nuk është mbajtur parasysh që, në periudhën e kalimit nga kapitalizmi në sociali-

zëm, mbeturinat borgjeze dhe mikroborgjeze, nuk zhduken, por manifestohen në aspekte të ndryshme. Puna politike dhe edukative e organizatave-bazë të Partisë, në mjaft raste, nuk është lidhur sa duhet me çështjet që dalin ngajeta, nuk ka shërbyer sa duhet që, duke theksuar anët pozitive të punonjësve në punë, në të njëjtën kohë të luftohen, jo në përgjithësi, por në mënyrë konkrete, duke u nisur nga shembujt e rrëthit, të ndërmarrjes, të sektorit, mbeturinat e së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve dhe shtrembërimet në zbatimin e parimit socialist të shpërndarjes sipas punës. Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë nuk kanë marrë masat e nevojshme për forcimin e mëtejshëm të ndërgjegjes komuniste në punë, me qëllim që të kuptohet nga të gjithë se rruga e ngritjes së mirëqenies materiale të çdo punonjësi është rritja e rendimentit në punë, e kualifikimit, kryerja me sukses, sipas porosive të Partisë, e detyrës kryesore që i është besuar çdo punonjësi në qendrën e tij të punës.

Së dyti, komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë, në mjaft raste, kanë ushtruar një kontroll të dobët ndaj drejtuesve në qendrat e prodhimit dhe në institucionet e tjera shtetërore e shoqërore. Në disa raste, si për shembull në Elbasan, ato jo vetëm që nuk kanë marrë masa për mënjanimin e shfaqjeve të huaja që vërchen në drejtimet që u përmendën më sipër, por i kanë lejuar vetë këto. Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë nuk kanë ushtruar kontroll mbi punën e organizatave të masave e sidomos mbi bashkimet profesionale, të rinisë dhe nuk i kanë aktivizuar mirë këto, me qëllim që t'u bëhet një luftë e vendosur

këtyre shfaqjeve të huaja. Nga ana e tyre, vetë organizatat e masave dhe sidomos bashkimet profesionale kanë bërë një punë të pamjaftueshme edukative me punonjësit për t'u prerë rrugën shfaqjeve të huaja, veçanërisht në drejtim të normave, të shpikje-racionallizimeve dhe të mënjanimit të punës jashtë orarit.

Së treti, dikasteret qendrore dhe sidomos Ministria e Industrisë dhe e Minierave, Ministria e Ndërtimit, Ministria e Bujqësisë, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ekonomisë Komunale, drejtuesit e ndërmarrjeve ekonomike dhe të institucioneve shtetërore, nuk kanë pasur parasysh sa duhet zbatimin e parimit socialist të shpërndarjes sipas punës. Çështjet e rëndësishme, si shtrembërimi i shifrave të planit, lënia e rezervave në planifikim, mënjanimi i prodhimit për prodhim me qëllim përfitimi, nuk janë luftuar me kömbëngulje, bile, në disa raste, janë bërë me dijeninë e tyre. Kjo tregon se kontrolli, jo vetëm në bazë, por edhe nga lart, ka qenë i dobët.

Së katërti, organet e kontrollit dhe sidomos Ministria e Financave dhe Komisioni i Planit të Shtetit, nuk kanë ushtruar kontrollin e duhur në bazë, nuk kanë bërë studime dhe nuk kanë nxjerrë konkluzionet e nevojshme për t'u prerë rrugën këtyre të metave. Të pakta janë kontrolllet e ushtruara dhe masat e marra në vend nga organet financiare të planifikimit. Kjo tregon se këto organe janë burokratizuar dhe nuk e njojin si duhet jetën.

Së pesti, legjislacioni në fuqi ka të meta, ndërsa zbatimi i tij në disa raste bëhet në mënyrë të shtre-

mbër. Për këtë një përgjegjësi e rëndë bie mbi ministritë dhe organet e tjera qendrore, të cilat, duke u nisur nga interesat e ngushta dikasteriale, herë pas here kanë qenë shkaktarë për nxjerrjen e vendimeve të pastudjuara mirë në kompleksin e tyre, që në disa raste kanë influencuar keq në ndërgjegjen e njerëzve. Për këto çështje Qeveria ka marrë udhëzime nga Komiteti Qendror i PPSH dhe ka nxjerrë vendime e urdhëresa të reja. Është e nevojshme që ato t'u bëhen të njoitura mirë të gjithëve, të komentohen dhe të zbatohen rreptësisht.

Gjendja e krijuar nga të metat e mësipërme duhet të marrë fund. Organet shtetërore dhe të Partisë, organizatat-bazë dhe drejtuesit e ekonomisë të nxjerrin konkluzionet e nevojshme dhe të punojnë me këmbëngulje, në të gjitha drejtimet, për të forcuar te punonjësit gjënë më të shtrenjtë, ndërgjegjen komuniste në punë, si dhe për të marrë masat përvendosjen e një regjimi të fortë kursimi në të gjitha aspektet e jetës ekonomike, kulturore dhe shoqërore të popullit tonë. Vetëm me një luftë të vendosur kundër të gjitha shfaqjeve borgjeze dhe mikroborgjeze që manifestohen në ndërgjegjen e njerëzve, mund të vihen në jetë drejt porositë e Partisë përvbatimin e parimit socialist të shpërndarjes sipas punës. Të jetë e qartë se të gjithë ata që shkelin dispozitat ligjore do të ndëshkohen pa mëshirë dhe pa asnje konsideratë të veçantë për çdo person qoftë. Shkelësit dhe shtrembëruesit e ligjeve, përveç masave të tjera ligjore, duhet të vihen përvpara përgjegjësisë dhe të jatin llogari përvpara klasës punëtore përmashtrimet që bëjnë.

Komiteti Qendror i Partisë i konsideron të drejta përpjekjet e vazhdueshme të masave punonjëse për të rritur mirëqenien e tyre në rrugë të drejtë, në saje të rritjes së nivelist arsimor e profesional, të rritjes së rendimentit në punë, që, sikurse dihet, shërbejnë si burime për të shtuar të ardhurat e çdo punonjësi në vendin tonë. Ai ka besim se organizatat e Partisë dhe gjithë punonjësit do ta kuptojnë drejt detyrën që shtron Partia në periudhën e tanishme për të luftuar shfaqjet e huaja në çfarëdo formë që ato të manifestohen dhe do të mobilizohen ashtu si kurdoherë, nën udhëheqjen e Komitetit Qendror të PPSH, për të ecur gjithmonë përpara drejt fitoreve të reja, për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Kjo letër të punohet, brenda muajit shkurt 1960, në të gjitha byrotë e komiteteve të Partisë, në organizatat-bazë të qendrave të punës si dhe në kolegjumet e dikastereve qendrore.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **TE POPULLI SHQIPTAR POPULLI I IRAKUT DIHE POPUJT E TJERË ARABË KANË NJË MIK BESNIK NË KOHË TË MIRA E NË KOHË TË VESHTIRA**

*Nga biseda me drejtorin e Radiodifuzionit të Republikës  
së Irakut dhe kryeredaktori i gazetës «Al Insania»,  
Khadhim al Samavi*

**6 janar 1960**

*Pasi shoku Enver Hoxha përshëndetet me zotin Khadhim al Samavi dhe ky i shpreh falenderimet përmundësinë që iu dha të vizitojë Shqipërinë, fjalën e merr*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Populli shqiptar ka respekt dhe dashuri përmundësinë që populli irakian, sepse ai është një popull luftëtar, paqedashës dhe me një kulturë të lashtë. Kur populli irakian fitoi lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin, me anën e revolucionit të 14 korrikut të vitit 1958, populli shqiptar u gjëzua shumë. Dihet se të dy popujt tanë kanë shumë gjëra të përbashkëta. Ato që ka vuajtur gjatë shekujve populli ynë, i ka vuajtur edhe populli vëlla i Irakut. Të njëjtat ndjenja dhe qëllime i kanë shtyrë të dy popujt tanë gjatë she-

kujve, ato e kanë pasur burimin në luftën kundër pushtuesve të përbashkët.

Fitorja e pavarësisë së popullit trim të Irakut, nën udhëheqjen e Abdyl Kerim Kasemit<sup>1</sup>, hero i popullit irakian, ka qenë një fitorë e madhe jo vetëm për ju, por për të gjithë popujt arabë, si dhe për popullin tonë. Sipas mendimit tonë, fitorja e këtij revolucioni nuk ishte një çështje e lëhtë. Populli i Irakut ka pasur armiq të mëdhenj që ia kishin ngulur kthetrat thellë në trup, prandaj për t'i mundur ata duhej trimëri dhe mençuri.

Realiteti është se revolucioni në Irak u bë me një shpejtësi të madhe po kjo nuk do të thotë se ky revolucion nuk i ka pasur rrënjet në popull. Përkundrazi terreni për fitoren e popullit irakian ishte pregatitur me kohë nga njerëzit tuaj përparimtarë, nga i gjithë populli juaj. Revolucioni irakian është pregatitur gjithashtu gjatë luftërave kundër imperializmit anglez dhe agjentëve të tyre, ndaj të cilëve populli juaj ka luftuar vjete të tëra. Të gjitha këto dëshmojnë se ndjenjat e lirisë, të pavarësisë dhe të sovranitetit kishin hyrë thellë në zemrën e popullit irakian, prandaj ky revolucion u bë me kaq shpejtësi.

Edhe popullit tonë, për të fituar lirinë dhe pavarësinë e tij kombëtare, i është dashur të luftojë me armë në dorë vjete me radhë. Pra edhe fitorja e popu-

<sup>1</sup> Abdyl Kerim Kasemi, udhëheqës i revolucionit të 14 korrikut 1958, drejtoi qeverinë e Republikës së Irakut deri më 8 shkurt 1963, kur, si rezultat i puçit ushtarak, të kurdisur nga imperialistët amerikanë, u vra në përpjekje për mbrojtjen e republikës.

llit tonë është preqatitur prej kohësh, si te ju, në mënyrë luftarake, dhe arriti kulmin me triumfin e Revolucionit Popullor më 29 Nëntor 1944.

Kush nuk e njihte Nuri Saidin, agjentin e vjetër të Inteligens Servis-it, shërbëtorin e kolonelit Laurence, agjent i amerikanëve, kush nuk e njihte dinastinë e Feisalëve, që nuk kishte asnje lidhje me popullin, të sjellë në fuqi nga Laurence për t'i thithur gjakun popullit irakian? Këto gjëra janë të njohura mirë prej të gjithëve. Imperialistët këto i kanë bërë për të shtypur e për të skllavëruar një popull me tradita shumë të lashta dhe revolucionare dhe me një kulturë të madhe, jo vetëm të kohëve të reja, po edhe të epokës para erës së re. E gjithë bota e njeh qytetërimin e lashtë të Kaldesë, Babilonisë së vjetër, të gjithë kanë dëgjuar për Nabukodonosorin, Semiramisin, Hamurabin e kohëve të lashta, si dhe më vonë për halifatin e Bagdatit.

Këto tradita të mëdha të popullit tuaj imperialistët kanë kërkuar t'i marrin nëpër këmbë, ata kanë sjellë në fuqi dinastinë e Feisalëve për të sunduar mbi popullin irakian. Po ky popull me tradita të mëdha dhe kaq të lashta ka luftuar me kohë kundër armiqve të tij dhe më së fundi mundi të bëjë revolucionin e 14 korrikut 1958.

Republika e Irakut po jeton dhe përparon çdo ditë dhe po i reziston me vendosmëri presionit të madh të imperialistëve dhe të gjithë armiqve të tjerë. Kjo vërteton forcën e madhe të popullit irakian që e shkëputi Irakun nga Pakti famëkeq i Bagdatit, nga zinxhirët që e kishin pleksur aq fort atë me otomanët,

persianët, anglezët në kohën e tradhtarit Nuri Said. Por populli irakian u tregua më i fortë nga imperialistët dhe kolonizatorët, gjë që tregon sa i fortë dhe i qëndrueshmëri është revolucionari që u bë në vendin tuaj.

Ne kemi lexuar shumë për luftën heroike të popullit irakian, po njerëzit tanë që kanë vizituar vendin tuaj, dhe që janë të dalë edhe ata nga gjiri i popullit, flasin me respekt për entuziazmin revolucionar që kanë parë në Bagdat, për dashurinë që tregon populli irakian ndaj udhëheqjes së tij përparimtare. Është pikërisht ky entuziazëm dhe kjo lidhje kaq e ngushtë me udhëheqjen e revolucionit tuaj që i ka egërsuar armiqtë e popullit të Irakut, të cilët organizojnë komplotë kundër vendit tuaj. Po të gjitha këto kanë dështuar dhe do të dështojnë. Kështu kanë vepruar edhe armiqtë e popullit tonë të vogël, por gjithmonë kanë dështuar.

Nga ana gjeografike Shqipëria është një vend i rrethuar nga shtete jomiqësore, që e kanë sulmuar dhe e kanë shkelur vazhdimisht në të kaluarën. Po ngjarjet e së kaluarës nuk e kanë përkultur popullin shqiptar. Ne e fituam lirinë dhe, sido që rreth e rrotull kemi armiq, po ecim drejt në rrugën e përparimit dhe të bollëkut, në rrugën e socializmit. Intrigat dhe komplotet e panumërtë të armiqve tanë janë bërë si gjatë kohës së luftës, ashtu edhe pas Çlirimtës së Shqipërisë, por të gjitha ato janë likuiduar, sepse tani kohët kanë ndryshuar shumë. Faktori i rëndësishëm i ecjes sonë përpara është se populli dhe pushteti i tij popullor janë një e të pandarë dhe mbrojnë me vendosmëri të drejtat e tyre. Edhe Republika e Irakut qëndron në këm-

bë, sepse populli ka besim te qeveria e tij që punon në interes të popullit. Pastaj duhet ditur se në luftën e tij për liri dhe për pavarësi kombëtare populli i Irakut nuk është i vetëm. Prandaj imperialistët dhe të gjithë armiqtë e popullit dhe të Republikës së Irakut nuk mund të bëjnë si të duan me ju dhe çdo përpjekje e tyre për t'ju penguar në rrugën që po ndiqni, do të dështojë.

Ne jemi të bindur se Iraku është i fortë dhe po forcohet dita-ditës. Ç'e bëri që të dështonte puçin e Mosulit? Sigurisht forca e madhe e popullit dhe e qeverisë së tij. Armiqtë e revolucionit e gjetën vendin. Ata u orvatën edhe kundër jetës së udhëheqësít të popullit tuaj Abdyl Kerim Kasemit, i cili duhet mbrojtur dhe duhet ruajtur, sepse armiqtë shohin se atë populli e do shumë, sepse ai është i lidhur me popullin dhe po e çon drejt mirëqenies, prandaj edhe përpiken ta likuidojnë.

Disa nga shokët tanë vizituan vendin tuaj pasi ishte bërë komploti i Mosulit. Ata panë popullin të armatosur dhe plot zjarr që ishte gati të mbronte fitoret e revolucionit. Sot është përvjetori i ushtrisë suaj, unë ju uroj për këtë fcastë të shënuar të popullit vëlla irakian. Ne shqiptarët, sikurse edhe populli juaj, e duam shumë ushtrinë, sepse ajo mbron interesat dhe pavarësinë e popullit. Rreziqe ekzistojnë akoma në botë, prandaj ushtritë ne duhet t'i mbajmë të forta, sepse ato janë ushtri të popullit, vetëm për mbrojtjen e interesave të popujve të tyre dhe nuk drejtohen kundër askujt.

Edhe shtete të tjera rrotull nesh kanë ushtri, po

morali i tyre nuk është i lartë si morali i ushtrive të vendeve tona. Të forta hiqeshin ushtritë e Hitlerit dhe të Musolinit që pushtuan vendin tonë, po ushtria jonë, e dalë nga populli, me armët që u rrëmbeu pushtuese i shkatërrroi ata. Mund të ketë tanksa e aeroplanë ushtria e shahut të Iranit, po ai nuk përpinqet për interesat e popullit, ndaj rrënjet e tij janë mbi ujë. Populli i Iranit sheh dita-ditës se kush është shahu që rron në kurriz të popullit duke u dhënë imperialistëve koncesionet e vajgurit dhe duke u shitur atyre gjithçka për hesap të vet.

Armiqtë rrotull Irakut mund të kenë armë, po armë ka edhe Republika e Irakut e, veg atyre, ajo ka edhe armën më të lavdishme, njeriun, që di përsë lufton, kurse iraniani e di që, po të shkojë në luftë, gjaku i derdhur prej tij do të kthehet në xhevahirë për shahun dhe familjen e tij mbretërore. Ata janë grabitqarë, sepse me grabitje rrojnë. Ata kërkojnë të mohojnë të drejtat e Irakut në Shat el Arab<sup>1</sup> dhe bëjnë zhurmë të madhe për ta frikësuar popullin irakian. Ne jemi të bindur se populli juaj nuk trembet nga këto frikësime, sepse kërkon të drejtën e tij.

Po ta shikosh këtë çështje nga ana historike, si Tigri, ashtu edhe Eufrati kanë qenë pronë e Irakut. Këta lumenj kanë ujitur prej shekujsh fushat e Irakut. Dihet nga historia e vjetër se kanalizimet dhe ujitja që në vendet e tjera kanë qenë akoma shumë primitive, te ju ishin ngritur në art. Ato bënë që tokat

---

<sup>1</sup> Delta që krijohet pasi bashkohen lumenjtë Tigër dhe Eufrat, pjesë territoriale e Irakut.

e vendit tuaj të kthehen në fusha pjellore të dëgjuarë për prodhimin e tyre të lartë. Dhe tani Irani i harron këto dhe kërkon të dëmtojë Irakun. Por të gjitha këto veprime të nxitura nga intrigat e imperialistëve, të gjitha këto presione kundër vendit tuaj do të dështojnë patjetër, ato nuk pinë ujë në shtete si Iraku ose si Shqipëria.

Ne, me sa kemi mundësi, nëpërmjet shtypit dhe radios, ndjekim me kujdes të madh të gjitha vendimet e qeverisë suaj për përmirësimin e jetës së popullit irakian, si dhe për çështje të tjera politike.

Ne kemi ndjekur çështjen e reformës agrare në Irak. Kjo natyrisht ka një rëndësi të madhe për popullin, sidomos për fshatarësinë e vendit tuaj.

Në Shqipëri fshatarësia ka luajtur një rol shumë të madh, ajo ka qenë mbështetja kryesore e Luftës Nacionalçlirimtare, ajo përbënte pjesën dërrmuese të popullit tonë. Çështja e lirisë dhe e pavarësisë së vendit tonë ishte e lidhur me çështjen e tokës. Fashistët italianë e gjermanë sulmuan për ta pushtuar vendin tonë. Fshatarësia jonë ashtu si gjithë populli, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë, luftoi për çlirimin e vendit, për realizimin e ëndrrës së saj për liri dhe për tokë. Prandaj, kur flasim për pavarësinë dhe luftën për liri, flasim edhe për tokën dhe kur flasim për tokën duhet që kjo t'u jepet atyre që e punojnë, të shkojë në interes të popullit. Kush bën reformën agrare ai ndihmon me siguri për forcimin e pavarësisë së vendit të tij. Prandaj reformat që janë duke u bërë në Irak na gjëzojnë jashtëzakonisht shumë, pse ne, si thashë përpara, e duam popullin tuaj,

pavarësisht se jemi larg. Kur i thua ndonjë shqiptari se ky është nga Iraku, nga Bagdati, ai e ndjen se nuk është i huaj për të.

Populli ynë është patriot, ai ka luftuar për lirinë e atdheut dhe është gati përsëri të hidhet në zjarrin e luftës po të jetë nevoja. Ai e ndjek me besnikëri Partinë tonë, se ajo e udhëheq drejt, se ajo i dha fshatarit tokë, bagëti, të drejta të rrojë e të punojë i lirë, të ketë shkolla për fëmijët e të mira të tjera.

Përpara në vendin tonë kishte feudalë e bejlerë që popullin e rripnin, kurse tani populli çdo gjë që prodhon e ka për vete, prandaj ka të ushqehet më mirë, të vishet dhc të plotësojë më mirë të gjitha nevojat e tij, të jetë i lirë dhe të punojë për lumturinë e vendit të vet.

Prandaj edhe ju që keni fituar lirinë dhe pavarësinë e vendit tuaj, ju duam sinqerisht dhe dëshirojmë që lidhjet midis dy vendeve tona të konkretizohen sa më shumë. Largësia gjeografike midis popujve tani nuk luan ndonjë rol. Në kohën e sotme janë zbuluar gjithë këto mjete të mrekullueshme ndërlidhjeje, njëra nga të cilat është edhe radioja që drejtoni ju, të cilat do të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në afrimin e të dy popujve tanë. Këto mjete ne duhet t'i përdorim në mënyrë të tillë, që popujt tanë të lidhen akoma më shumë me njëri-tjetrin.

Ju e vizituat Shqipërinë, patë se të gjitha ato që janë ndërtuar në vendin tonë janë të reja, janë të periudhës pas Çlirimt. Fabrikat, minierat, hekurudhat, shumë nga qytetet tona, kanalizimet dhe veprat bonifikuase në fusha etj. të gjitha janë të reja dhe janë

ndërtuar brenda 10-15 vjetëve. Do të ishte e pamundur që populli ynë të ndërtonte të gjitha këto vepra brenda një kohe kaq të shkurtër. Po ne i ngritëm këto vepra sepse kemi një popull të mrekullueshëm, liridashës dhe punëtor, kemi një popull që është i lidhur si mishi me koskën me udhëheqjen e tij.

Në vendin tonë në vjetët e parë kanë ardhur specialistë sovjetikë për të mësuar njerëzit tanë në punë edhe në shkollat që hapëm. Po tani në veprat tona kudo punojnë dhe drejtojnë kuadrot tanë sikurse mund ta keni parë edhe vetë. Kur ne iu drejtuam për të na ndihmuar me kuadro specialistë, vetë Stalini na ka thënë se ishte gati të na ndihmonte, siç na ndihmoi, por njëkohësisht ai këshilloi që ne të pregatitnim kua-drot tanë.

Iraku është një vend i pasur me naftë dhe me fusha shumë pjellore. Ne kemi bindjen se brenda një kohe të shkurtër ai do të bëhet një vend i pasur i Lindjes së Mesme. Faktorët kryesorë për këtë janë pasuritë e tij të mëdha natyrore, populli i tij dhe qeveria popullore.

Ne urojmë që Iraku të zhvillohet në rrugën e begatisë dhe të bëhet shembull i vëllazërimit të popujve arabë. Vetëm armiqjtë e popujve arabë nuk e duan këtë vëllazërim dhe këtë bashkim të arabëve. Ne mendojmë se regjimi popullor dhe përparimet e shpejta që do të bëhen në Irak janë garancia më e madhe e këtij vëlla-zërimi. Ne u duam të mirën të gjithë popujve arabë dhe shpresojmë se të gjithë ata do të shikojnë te ju se ç'mund të bëjë një popull që ka në duar pushtetin.

Ne kemi bindjen se politika që ndjekin vendet so-

cialiste do të triumfojë dhe paqja do të sigurohet. Mendojmë se do të ndodhë kështu jo në saje të zemërgjerësisë së imperialistëve amerikanë ose anglezë, po në saje të politikës së drejtë dhe të forcës së madhe të vendeve socialiste dhe të të gjithë popujve të tjerrë paqedashës, në mes të të cilëve edhe populli irakian, që fitoi lirinë dhe pavarësinë kombëtare dhe tani po përparon dhe i bën imperialistët të zembrapën.

Sa herë do të na kishin sulmuar deri tani ne, shqiptarëve, imperialistët, sa herë do t'ju kishin sulmuar edhe ju, ashtu sikurse bënë në Jordani! Po imperialistët nuk kanë mundur të na bëjnë dot gjë. Kjo tregon forcën e popujve tanë, unitetin e popujve tanë rrëth qeverive të tyre.

Ne dëshirojmë që me Republikën e Irakut të bëjmë shkëmbime vizitash me njerëz, sidomos me grupe, të cilët i presim të vijnë në vendin tonë si në shtëpinë e tyre dhe jo vetëm zyrtarisht, po ashtu si e ka zakon populli ynë që e pret mikun me zemër të hapur në shtëpi, me atë që ka, që bisedon me të dhe i tregon dashurinë e tij mikut. Pra, në dëshirojmë të kemi lidhje të tilla, lidhje popullore, lidhje miqësore që unë besoj se do t'i krijojmë.

Pavarësisht se vendi ynë është i vogël dhe ekonomikisht akoma jo në nivelin e duhur, po miqtë siç janë miqtë e ardhur nga gjiri i popullit vëlla irakian, ne i presim si njerëz të dashur dhe bisedojmë me ta pa diplomaci. Ne nuk bëjmë diplomaci me njëri-tjetrin se të dy palët kemi qenë të shtypur dhe dimë ç'ka qenë varfëria, dimë ç'është miqësia dhe sinqueriteti, kurse

nga ana tjetër dimë çfarë fshihen nën buzëqeshjen dhe në politikën e imperialistëve.

Popujt tanë kanë nevojë për zemër të pastër. Nuk ka gjë më të madhe se dashuria e singertë për njëri-tjetrin. Një dashuri të tillë ushqejmë ne për popullin tuaj.

Kur të keni rastin të takoheni, unë do t'ju lutesha t'i transmetoni udhëheqësit të dashur të popullit tuaj, urimet më të përzemërtë të popullit tonë, të udhëheqjes së tij, të shokut Mehmet Shehu dhe timin personal dhe ta siguroni atë dhe popullin vëlla të Irakut se te populli shqiptar ata, ashtu sikurse gjithë popujt arabë, kanë një mik besnik përjetë, në kohë të mira dhe në kohë të këqija. Në kohë të këqija ata do të kenë kurdoherë afër popullin tonë, po as ju as ne nuk dëshirojmë që të vijnë kurrë të tilla kohë, po këtë e thashë se, si thotë populli ynë, «miku njihet në kohë të këqija». Populli ynë ka edhe një tjetër fjalë të urtë: «kur ka shporta fiq të gjithë të bëhen miq». Po ne jemi miq të vërtetë atëherë kur shporta nuk ka fiq, domethënë jemi miq të kohëve të vështira dhe në rreziqe ne jemi bashkë ashtu sikurse edhe në kohë të mira. Ne besojmë se këtej e tutje do të ketë vetëm të mira si për popullin irakian ashtu edhe për popullin shqiptar. Por edhe armikun ne nuk e harrojmë.

**ZOTI KHADHIM AL SAMAVI:** Kjo është një bisedë, ashtu sikurse tha shkëlqesia e tij, Enver Hoxha, jodiplomatike, po që buron nga një zemër te tjetra. E vërteta është se kjo bisedë e rëndësishme do të ketë një jehonë të thellë historike në popullin irakian dhe në gjithë popujt arabë.

*Pastaj miku irakian, pasi tregoi për përshtypjet shumë të mira që kishte nga vizita nëpër vendin tonë dhe për dashurinë e respektin që gjëzojnë RP e Shqipërisë, populli shqiptar, Qeveria e RP të Shqipërisë dhe personalisht shoku Enver Hoxha te populli dhe te qeveria revolucionare e Irakut, i drejtoi shokut Enver Hoxha një sërë pyetjes.*

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të marrë me stenogram që gjendet në AQP*

## **POPULLI IRAKIAN BËRI COPË E THËRRIME MASKËN E IMPERIALISTËVE PËR TË NDËRHYRE NE PUNËT E BRENDIIME TË VENDEVE ARABE**

*Intervistë dhënë zotit Khadhim al Samavi, drejtor i Radiodifuzionit të Republikës së Irakut dhe kryeredaktor i gazetës «Al Insania»*

**6 janar 1960**

**PYETJE:** Ju e dini se Iraku i çliruar është sot një pikëmbështetje për çlirimin dhe sovranitetin e popujve arabë dhe të Lindjes së Mesme dhe se revolucioni i 14 korrikut konsiderohet si një kthesë shumë e rëndësishme jo vetëm në historinë e Irakut por edhe në politikën internacionaliste dhe taktikën e saj në Lindjen e Mesme. Cili është opinioni i shkëlqesisë suaj për këtë revolucion të madh?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ngjarjet historike që ndodhën në Irak më 14 korrik 1958 kanë pasur një jehonë shumë të madhe në gjithë botën. Ato u përshëndetën me një entuziazëm të madh dhe me një përkrahje të zjarrtë edhe nga populli shqiptar, i cili ka ushqyer dhe vazhdon të ushqejë një dashuri të singertë për

popullin heroik dhe liridashës të Irakut, ashtu sikurse ushqen për gjithë popujt arabë.

Revolucioni i 14 korrikut në Irak ka hyrë në historinë e përpjekjeve heroike të popullit irakian si një ngjarje me një rëndësi të madhe kombëtare dhe ndër-kombëtare. Më 14 korrik populli i Irakut i udhëhequr nga biri i tij, Abdyl Kerim Kasem, përmbysi nga fuqia me heroizëm dhe me guxim të madh, klikën e urryer të Nuri Saidit, vegël e ndyrë e imperialistëve për nënshtimin e Irakut dhe të vendeve të tjera arabe. Duke bërë këtë, populli i Irakut, zhduku jo vetëm pen-gesën kryesore në rrugën për çlirimin e tij kombëtar, për lirinë dhe progresin shoqëror, por dha një kontribut të rëndësishëm në luftën nacionalçlirimtare që bëjnë popujt arabë për çlirimin e tyre nga zgjedha imperialiste.

Revolucioni i 14 korrikut i dha një goditje të rëndë imperializmit në një zonë shumë të rëndësishme për të, tronditi nga themellet Paktin famëkeq të Bagdatit dhe i detyroi organizatorët e tij që jo vetëm t'i ndërrojnë emrin, por të mos guxojnë më t'i vënë emrin e ndonjë kryeqyteti tjetër të kësaj zone, duke pasur frikë se mos e pësojnë edhe gjetkë një fat të tillë. Revolucioni i popullit irakian bëri copë e thërrime maskën e imperialistëve për të ndërhyrë në punët e brendshme të vendeve arabe me anën e të ashtuquajturave doktrina. Ky revolucion tregoi se populli i Irakut, ashtu sikurse gjithë popujt e tjerë arabë, hedhin poshtë me përbuzje politikën imperialiste të «bosllë-kut» në këtë zonë, se koha e sundimit të tyre me anën e klikave të shitura po perëndon dhe se ata duan të

jetojnë të lirë në atdheun e tyre, t'i përdorin pasuritë e tokës dhe të nëntokës së tyre për të shpëtuar nga mizerja, për të ngritur mirëqenien e tyre materiale dhe kulturore.

Për të gjitha këto arsyet rëndësia e revolucionit të 14 korrikut i kalon kufijtë e tij nacionalë. Ky revolucion i dha një hov të ri të fuqishëm lëvizjes nacionalçlirimtare të popujve arabë duke e ngritur këtë në një shkallë të re. Duke krijuar Republikën e Irakut, revolucioni i 14 korrikut krijoi edhe një bazë të rëndësishme dhe besnike te e cila popujt arabë mund të mbështeten dhe lëvizja e tyre nacionalçlirimtare ka një përkrahës të sigurtë dhe me të vërtetë të sinqertë.

**PYETJE:** Iraku qysh nga çlirimi i tij po përballon komplotet imperialiste që kanë për qëllim ta kthejnë mbrapa, por politika e vendosur e udhëheqësit Abdyl Kerim Kasem dhe përkrahja që i japid kësaj politike të gjitha forcat popullore bënë të dështojnë këto komplotë. Ju e dini gjithashtu se komploti i fundit kishte për qëllim vrasjen e vetë udhëheqësit tonë dhe se populli irakian me në krye udhëheqësin e tij besnik, Abdyl Kerim Kasem, është i vendosur ta vazhdojë luftën e tij deri në fund. Dëshironi të thoni diçka përluftën e popullit irakian dhe veçoritë e tij gjatë revolucioneve të shumta kundër imperializmit?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Është e kuplueshme se fuqitë imperialiste, me në krye imperialistët amerikanë, brejtën hekurin me dhëmbë nga dëshpërimi për disfatën e rëndë që pësuan nga fitorja e revolucionit në Irák. Ata nuk e kanë pranuar dhe nuk duan ta pranojnë këtë fitore, megjithëse me fjalë e me deklara-

rata të bujshme hiqen sikur janë për lirinë dhe për pavarësinë e popullit irakian dhe të të gjithë popujve arabë. Populli i Irakut, ashtu sikurse gjithë popujt e botës, e di fare mirë pse zbarkuan ata në Liban dhe në Jordani menjëherë pas ngjarjeve të 14 korrikut. Ai e di gjithashtu shumë mirë se ata u tërroqën nga këto vende jo sepse deshën, por sepse dështuan në planet e tyre, sepse fituan urrejtjen e gjithë popujve të botës, të cilët më në fund i detyruan të tërhiqen me turp, duke marrë me vete urrejtjen dhe përbuzjen e rëndë nga i gjithë opinioni publik botëror. Por komplotet e prekatitura prej tyre pas këtij revolucioni, ngjarjet e shëmtuara, të provokuara prej tyre në Mosul e gjetkë, tregojnë se ata jo vetëm s'kanë hequr dorë nga planet për përmbysjen e regjimit demokratik në Irak, por punojnë me të gjitha mijetet që ta kthejnë gjendjen e krijuar prapa dhe të vendosin këtu veglat e tyre të urryera aq shumë nga populli i Irakut. Komploti i shëmtuar dhe aq kriminal kundër jetës së udhëheqësit të popullit irakian, të cilin ai e do dhe e çmon aq shumë, është një tjetër akt i poshtër i imperialistëve dhe i veglave të tyre kundër popullit irakian, kundër udhëheqësve të tij, për zhdukjen e fitoreve të revolucionit të 14 korrikut, për vendosjen përsëri të monarkisë në Irak.

Populli shqiptar shprehu atëherë, ashtu sikurse i gjithë populli i Irakut, zemërimin e tij të thellë për këtë krim të shëmtuar dhe mori pjesë me gjithë zemër në hidhërimin e thellë që ai ndjeu. Populli ynë dhe udhëheqësit e tij u gjëzuan shumë që shkëlqesia e tij Abdyl Kerim Kasem shpëtoi nga rreziku dhe gjzon

tashti shëndet të plotë për të mirën e popullit dhe të atdheut të tij.

Ne të gjithë e kemi të qartë se komplotet dhe atentatet janë metodat e preferuara të gjithë atyre që kanë dështuar në politikën e tyre, që në këtë politikë nuk udhëhiqen nga principe, por nga qëllime të errëta prej gangsterësh dhe aventurierësh.

Dështimi i turpshëm i gjithë këtyre komplateve, sigurisht i kushtohet në radhë të parë popullit të lavdishëm irakian, dashurisë së tij të flaktë për atdhe, vendosmërisë së tij për të mbrojtur fitoret e arritura në revolucion dhe për ta çuar përpara këtë revolucion.

Populli i Irakut është një popull me tradita të shkëlqyera patriotike dhe revolucionare. Lufta e tij e vendosur kundër imperializmit, në periudha të ndryshme të historisë së tij, heroizmi i treguar prej tij në këto luftëra, besimi i tij i pathyeshëm në fitore, durimi i tij i madh, tregojnë virthitet e larta të një populli patriot, liridashës dhe luftëtar i papërkulur për demokracinë dhe përparimin shoqëror. Populli shqiptar i çmon shumë këto virthye të larta të popullit trim dhe patriot irakian, çmon shumë luftën e tij të përgjakshme për çlirim kundër imperializmit dhe klikave në shërbim të tij dhe i konsideron këto si një kontribut të çmuar për fitoren e kauzës së popujve arabë, për miqësinë dhe për bashkëpunimin midis gjithë popujve, për paqen dhe për sigurimin në botë.

**PYETJE:** Të gjitha komplotet e organizuara brenda vendit kanë dështuar dhe udhëheqësi Abdyl Kerim Kasem deklroi se ne jemi një komb paqedashës, nuk duam të sulmojmë njeri dhe nuk pranojmë që të na

sulmojë njeri. Kohët e fundit Irani ka përqëndruar trupat e tij në kufirin tonë, megjithëse ne nuk kemi dërguar asnjë ushtar në kufi. A nuk na përkrahni ju në këtë qëndrim paqësor dhe a nuk jeni dakord se të ndezësh flakën e luftës në Lindjen e Mesme do të thotë të ndezësh një luftë të tretë botërore në rast se imperialistët nuk tërhiqen?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Populli shqiptar dhe Qeveria e tij çmojnë shumë politikën e urtë paqësore që ndjek qeveria c Irakut me në krye shkëlqesinë e tij, zotin Abdyl Kerim Kasem. Kjo politikë që mbështetet në parimet e mosndërhyrjes në punët e brendshme të popujve të tjerë, por që në të njëjtën kohë nuk lejon që të tjerë t'i ndërhyjnë në punët e tij, është një politikë që jo vetëm i shërben mbrojtjes së lirisë, pavarësisë dhe interesave kombëtare të popullit të vet, por njëkohësisht i shërben afrimit dhe miqësisë midis vendeve fqinje, midis gjithë popujve arabë. Ajo i shërben në këtë mënyrë uljes së tensionit në këtë zonë, paqes dhe sigurimit në të gjithë botën.

Tani, popujt e botës, po e kuptojnë gjithnjë e më shumë se ashpërsimi i marrëdhënieve midis vendeve të ndryshme, u shërben vetëm e vetëm atyre qarqeve që kërkojnë ta mbajnë të ngritur tensionin në marrëdhënicë ndërkombëtare, duke shpresuar se në këtë mënyrë do të mundin të vazhdojnë garën e çmendur të armatimeve dhe të nxjerrin prej saj fitime të jash-tëzakonshme. Krijimi i gjendjes së nderë në zona të ndryshme të botës mbështetet, sigurisht në politikën e tyre të falimentuar të «luftërave të vogla», të «luftërave të kufizuara». Kuptohet se luftënxitësit këto

luftëra të vogla kërkojnë pastaj t'i kthejnë në luftëra të mëdha, në një konflikt të përgjithshëm botëror. Por në kushtet e sotme ndërkombëtare, kur ekzistojnë forca kolosale që luftojnë për ndalimin e një lufte të re, kur në krye të këtij misioni të lartë humanitar, qëndrojnë Bashkimi Sovjetik, Kina e madhe, vendet e tjera socialiste, gjithë popujt e tjerë liridashës, këto plane djallëzore do të dështojnë me turp.

**PYETJE:** Ne e gjejmë se midis popullit shqiptar dhe popujve arabë ka shumë lidhje historike të thella dhe shumë nga historianët tanë kanë vizituar vendin tuaj dhc kanë shkruar mbi të. Sot këto lidhje janë bërë edhe më të thella në rrugën e luftës sonë të përbashkët për demokracinë, për forcimin e paqes dhe për përkrahjen e popujve të çliruar në luftën e tyre për mbrojtjen e fitoreve të arritura. A do të dëshironcë shkëlqesia juaj t'i drejtonte disa fjalë popullit irakian?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Populli shqiptar dhc popujt arabë kanë pasur në të kaluarën një fat të përbashkët. Për shekuj me radhë, ata u shtypën dhe u shfrytëzuan në mënyrë të egër nga pushtuesit otomanë. Gjatë kësaj periudhe populli ynë e bashkoi luftën e tij me atë të popujve arabë për çlirimin nga zgjedha otomane. Kështu shumë patriotë shqiptarë dhe bij të shquar të këtij populli kanë gjetur strehë në shumë vende arabe dhe janë përkrahur nga popujt e këtyre vendeve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre patriotike, letrare ose kulturore. Po ashtu shumë njerëz të shquar nga vendet arabe kanë vizituar vendin tonë dhe u krijuan kështu lidhje të ngushta në fusha të ndryshme.

Sikurse dihet, pas shkatërrimit të perandorisë turke si popujt arabë, ashtu edhe ne, megjithëse më 1912 fituam pavarësinë, ramë përsëri nën një shfrytëzim tjeter, në atë të suqive të mëdha imperialiste.

Vetëm më 29 Nëntor 1944, populli shqiptar në saje të Luftës Nacionalçlirimtare, i grumbulluar në një front unik dhe i udhëhequr nga Partia Komuniste e Shqipërisë (tani Partia e Punës), fitoi lirinë dhe pavarësinë e vërtetë dhe po ndërton me sukses socializmin.

Para disa kohësh ne festuam me fitore të shkëlqyera 15-vjetorin e Çlirimit kombëtar dhe shoqëror. Po të marrim parasysh prapambetjen jashtëzakonisht të madhe që trashëguam nga e kaluara, kur vendi ynë nuk trashëgoi asnjë industri, kur bujqësia ishte pothuaj në gjendje primitive dhe afro 85 për qind e popullsisë ishte analfabete, sukseset e arritura gjatë kësaj periudhe të shkurtër nga populli ynë janë me të vërtetë madhështore. Është ngritur një industri e fuqishme dhe moderne që prodhon 22 herë më shumë se më 1938. Ne prodhojmë tani për fryshtë të popullsisë naftë, energji elektrike, qymyrguri etj. më shumë se Turqia, Italia, Greqia dhe Jugosllavia. Shqipëria e vogël prodhon 3 herë më shumë krom se Turqia dhe 14 herë më shumë se Jugosllavia. Bujqësia jonë është pajisur tani me mjete të fuqishme mekanike dhe po zhvillohet gjithnjë e më shumë drejt socializimit të saj të plotë. Fshatarësia punonjëse shpëtoi një herë e përgjithmonë nga mjerimi dhe nga varfëria dhe po bën një jetë të lumtur. Në lëmin e arsimit e të kulturës është bërë një revolucion i vërtetë, analfabetizmi është zhdukur dhe

janë preqatitur me mijëra kuadro të lartë e të mesëm për nevojat e vendit.

Këto suksese kolosale, të pashebullta në historinë e popullit shqiptar, që në regjime të tjera do të duheshin shekuj, u arritën në kushte shumë të vështira, në kushte të ndërhyrjes së vazhdueshme armiqësore nga ana e imperialistëve, që organizonin komplotë e sabotazhe, futnin spiunë e diversantë për të përmbysur pushtetin e popullit e për të penguar ndërtimin socialist të vendit. Këto suksese janë arritur në kushte kur vendi ynë është i rrethuar nga fqinjë që mbajnë një qëndrim armiqësor, janë arritur, siç është bërë zakon të thuhet te nc, duke mbajtur në një dorë kazmën e në tjetrën pushkën.

Si u arritën gjithë këto rezultate në kushte kaq të vështira? Në radhë të parë kjo i detyrohet popullit tonë heroik, vendosmërisë së tij për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e atdheut dhe për të ndërtuar një jetë të begatshme e të kulturuar nën udhëheqjen e Partisë. Një rol të ndjeshëm për këto fitore ka luajtur gjithashtu ndihma e Bashkimit Sovjetik.

Në saje të këtyre kushteve që janë krijuar në RP të Shqipërisë, në saje të politikës paqësore dhe të bashkëpunimit miqësor që ndjek qeveria shqiptare, në saje të kësaj politike që ndjek edhe qeveria e Irakut, të luftës së përbashkët për demokraci e paqe, marrëdhëniet midis dy vendeve tona janë forcuar dhe do të forcohen gjithnjë e më shumë. Ne jemi për zgjerimin gjithnjë e më tepër të marrëdhënieve midis dy vendeve tona.

Populli shqiptar ndjek me simpati të madhe luftën

heroike që bën populli i Irakut për forcimin e pavarësisë së atdheut të tij, për ndërtimin e ekonomisë dhe të kulturës. Në këtë rrugë, sigurisht, ai ka vështirësi të mëdha, të jashtme dhe të brendshme. Në miqësi me popujt e kampit socialist që janë miq besnikë të popujeve arabë, dhe me të gjitha vendet e tjera që i duan të mirën popullit irakian, ai do t'i kapërcejë me siguri këto vështirësi dhe do të arrijë fitoret e dëshiruara. Ne i urojmë nga zemra popullit trim dhe patriot irakian suksese gjithnjë më të mëdha në këtë rrugë plot vështirësi, por të lavdishme!

**PYETJE:** Shkëlqesia e tij, çlirimtari ynë i madh, udhëheqësi Abdyl Kerim Kasem, respekton shumë udhëheqësit që kanë dalë nga gjiri i popullit dhe që i kanë kushtuar atij jetën e tyre dhe çdo gjë që kanë më të shtrenjtë. Ne jemi një shtet mik për të gjithë popujt e botës dhe udhëheqësit e tyre që ushqejnë ndjenja të pastra ndaj nesh. Shkëlqesia e tij udhëheqësi Abdyl Kerim Kasem është bir i një zdrukthëtari, që ka dalë nga gjiri i popullit, ka drejtar popullin drejt lirisë dhe drejt zhdukjes së regjimit monarkik dhe ka krijuar Republikën e Irakut, ashtu sikundër ju e keni udhëhequr popullin shqiptar dhe e shpëtuat nga regjimet e kalbura të së kaluarës. Dhe këtu po gjej gjëra të përbashkëta midis jush dhe udhëheqësit tonë. Cilat janë mendimet e shkëlqesisë suaj në lidhje me luftën për forcimin e paqes në botë, sidomos në zonën e Lindjes së Mesme?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Vendet tona janë vende të vogla që kanë vënë të gjitha përpjekjet për forcimin e fitoreve të arritura dhe për zhvillimin e eko-

nomisë dhe të kulturës, prandaj ato kanë nevojë për paqen.

Në saje të përpjekjeve fisnike të vendeve socialiste dhe të të gjithë popujve që luftojnë për paqen këto kohët e fundit vihet re një farë ulje në tensionin ndërkontebtar. Por problemet e mbetur pezull akoma nuk janë zgjidhur. Ne mendojmë se problemi më i rëndësishëm për çështjen e paqes në ditët tona është ai i çarmatimit. Propozimi për një çarmatim të plotë dhe të përgjithshëm është propozimi që e zgjidh problemin në mënyrën më të drejtë duke krijuar kushtet e favorshme për zgjidhjen edhe të problemeve të tjera që kanë mbetur pezull në Evropë, në Azi e në vende të tjera. Si pasojë e këtyre përpjekjeve dhe e uljes së tensionit, edhe në Lindjen e Afërmë e të Mesme, gjendja është më e mirë se përpara. Por kjo zonë vazhdon të mbetet gjithnjë nën shenjën e intrigave dhe të komplateve të fuqive imperialiste. Ato s'duan të pajtohen me ndryshimin e ngjarjeve në këtë zonë, kërkojnë të mbajnë gjithnjë shfrytëzimin e pasurive të mëdha që zotërojnë këto vende dhe si pasojë ato punojnë për realizimin e planeve të tyre. Nga sa duket ato kërkojnë t'i përcajnë vendet arabe, kërkojnë t'i gënjejnë këto me parullat se gjoja nuk ekziston më rreziku imperialist dhe se duhet mbrojtur nga i ashtuquajturi rrezik komunist. Ato punojnë që të armiqësojnë këto vende me vendet socialiste dhe pastaj, sikurse dihet, pasi t'i përcajnë e t'i lënë pa mbrojtës, t'i sundojnë kollaj.

Kjo politikë sigurisht është e rrezikshme për paqen dhe për sigurimin e vendeve arabe si dhe për sigurimin

në përgjithësi. Vendet arabe kanë nevojë për paqe e qetësi që të forcojnë indipendencën kombëtare, të zhvillojnë demokracinë dhe progresin shoqëror. Duke marrë parasysh se armiku i betuar i popujve arabë ka qenë dhe mbetet imperializmi me në krye atë amerikan, popujt arabë kanë nevojë për bashkimin në një front unik të të gjitha forcave antiimperialiste, për forcimin e solidaritetit arab, për zhvillimin e luftës nacionalçlirimtare. Kështu do të forcohet pavarësia politike dhe ekonomike e tyre dhe do t'u bëhet ballë me sukses ndërhyrjeve të vazhdueshme e intrigave të shumta të imperialistëve për nënshtimin e tyre. Në këtë mënyrë do t'u priten duart imperialistëve dhe do të jepet një kontribut i rëndësishëm për forcimin e paqes dhe për sigurimin në këtë zonë. Në këtë rrugë, sigurisht, hasen vështirësi të mëdha, por ne jemi të bindur se popujt arabë do të dinë t'i kapërcejnë edhe këto me vendosmëri dhe do të arrijnë fitoren e dëshiruar.

*ZOTI KHADHIM AL SAMAVI:* Unë ju falenderoj veçanërisht ju që më dhatë rastin të realizoja një nga ëndrrat e mia për t'ju takuar. Ju falenderoj gjithashtu që me këtë takim ju më falët një pjesë të kohës suaj shumë të shtrenjtë.

Deklarata që më dhatë është shumë e rëndësishme, ajo do ta ngrejë shumë moralin e popullit irakian dhe udhëheqësi ynë, Abdyl Kerim Kasem, do t'ju jetë shumë mirënlohës për ndjenjat që shprehët për popullin tonë...

*SHOKU ENVER HOXHA:* Edhe unë jam shumë i gjuar për këtë takim që pata me ju dhe do t'u raportoj edhe shokëve të mi për këtë, për sfjalët e mira

që ju shprehët këtu për popullin tonë, fjalë që dalin nga zemra, për miqësinë që ju ushqeni për popullin shqiptar, për dashurinë që ushqen zoti Abdyl Kerim Kasemi për popullin tonë si dhe për të ardhshmen e ndritur që e pret popullin vëlla irakian.

Popullin irakian ne e kemi mik, po ata bij të tij që kanë pasur rastin të vizitojnë Shqipërinë bëhen miq të flaktë të vendit tonë. Prandaj edhe ju do t'ju konsiderojmë si një nga miqtë irakianë më të afërt të Shqipërisë. Ne e dimë se ju keni punë, po dëshiroj t'u them shokëve tanë shqiptarë, me të cilët keni bashkë-punuar këto ditë të qëndrimit tuaj në Shqipëri, që t'ju mbajnë «rob» edhe disa ditë akoma. Ju duhet të dini se miqtë ne nuk i lëshojmë lehtë të largohen.

Dëshirojmë që vizita juaj të mos jetë e para dhe e fundit dhe jo vetëm për takime të tilla, po edhe për të kaluar pushimet në vendin tonë. Kur të keni kohë të pushoni, urdhëroni në vendin tonë, dhe ne, ashtu siç thotë populli ynë, do t'ju presim me ato që kemi. Ne e dimë që në Irak ka plot vende të bucura, ku ju mund t'i kaloni shumë mirë pushimet, po neve na vjen mirë që të vini edhe te ne të pushoni pas një pune të gjatë që do të bëni. Në këtë mënyrë ju do të keni rastin të takoheni dhe të bisedoni lirisht, pa «teklif», me popullin tonë.

*Botohet për herë të parë si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **MBI INISIATIVËN E KOOPERATIVISTËVE TË DALLUAR TË RRETHIT TË GJIROKASTRËS PËR RRITJEN E PJESEMARRJES NË PUNË**

**15 janar 1960**

Komiteti Qendror i PPSH mori njoftim mbi iniciativën që kanë marrë disa kooperativistë të dalluar të rrethit të Gjirokastrës, të cilët u kanë bërë thirrje gjithë anëtarëve të kooperativave bujqësore të vendit tonë që të ndjekin shembullin e tyre për të bërë mbi 300 ditë-punë në vit në ekonominë e përbashkët të kooperativës.

Komiteti Qendror i Partisë i përgëzon nxehësisht kooperativistët e dalluar të rrethit të Gjirokastrës dhe e mbështet plotësisht iniciativën e re, si dhe thirrjen e tyre drejtuar gjithë anëtarëve të kooperativave bujqësore të vendit.

Iniciativa e kooperativistëve të dalluar të Gjirokastrës, për të bërë më shumë se 300 ditë-punë në vit, ka rëndësi shumë të madhe për forcimin e kooperativave bujqësore, sepse ajo do të ndihmojë të rritet ndërgjegjja e anëtarëve në punë, të forcohet disiplina në punë, të zhvillohen në një shkallë më të lartë iniciativat krijuese të masave punonjëse në fshat, të

shtohen të ardhurat e kooperativës dhe të anëtarëve, të ngrihet niveli i përgjithshëm i jetesës në fshat.

Plenumi i Komitetit Qendror, që u mbajt në dhjetor të vitit të kaluar, vërejti se bujqësia janë ka arritur suksese të rëndësishme, siç janë përfundimi para afatit i kolektivizimit të bujqësisë dhe rritja e prodhimit bujqësor e blegtoral. Por Plenumi, në bazë të një analize të thellë që i bëri sektorit të bujqësisë, vërejti se ka mjaft të meta në drejtim të forcimit organizativ dhe ekonomik të kooperativave bujqësore për hapjen e tokave të reja, në rritjen e rendimenteve, në mobilizimin e përgjithshëm të masave punonjëse të fshatit etj. Për të gjitha këto, Plenumi ka vënë detyra konkrete para Partisë dhe gjithë punonjësve të bujqësisë. Detyrat për vitin 1960 janë shumë të mëdha, por plotësish të realizueshme. Përhapja e gjerë e inisiativës për të bërë më se 300 ditë-punë në vit, do t'i shërbejë më së miri realizimit të detyrave që dalin para punonjësve të bujqësisë për realizimin e planit të vitit 1960.

Komiteti Qendror i Partisë porositi të gjitha komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve të marrin masa që këtë thirrje të kooperativistëve të dalluar të rrethit të Gjirokastrës ta shtrojnë në mbledhje të përgjithshme të kooperativave bujqësore, me qëllim që inisiativa për të kryer mbi 300 ditë-punë të gjejë përkrahje të gjerë dhe të përfshijë kooperativat e gjithë Republikës. Komiteti Qendror i Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë të marrë masa për ta popullarizuar gjerësish në të rinjtë dhe në të rejat kooperativiste këtë inisiativë, me qëllim që rinia janë,

si kurdoherë, të jetë e para për t'iu përgjigjur kësaj thirrjeje patriotike të kooperativistëve të dalluar të rrethit të Gjirokastrës. Organet e shtypit dhe të radios të popullarizojnë gjerësisht këtë iniciativë dhe pjesëmarrësit në këtë lëvizje patriotike. Të popullarizohen prej tyre sistematikisht rezultatet e arritura në këtë drejtim.

Komiteti Qendror i PPSH shpreh bindjen se me punën që do të bëjnë në këtë drejtim organizatat e Partisë në rrethe dhe në kooperativat bujqësore, kjo iniciativë e madhe patriotike do të gjejë përkrahje të gjerë nga të gjithë kooperativistët e vendit tonë.

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit».  
Nr. 14 (3543), 17 janar 1960*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë  
nga gazeta «Zëri i popullit».  
Nr. 14 (3543), 17 janar 1960*

**PARTIA JONE DO TË JETË KURDOHERE  
VIGJILENTE NË MBROJTJE TË MARKSIZËM-  
-LENINIZMIT, TË INTERESAVE TË POPULLIT  
E TË ATDHEUT**

*Nga biseda në takimin me delegacionin e Partisë Komuniste të Indonezisë, të kryesuar nga D. N. Aidit,  
Sekretar i Përgjithshëm i kësaj partie*

**20 janar 1960**

*Pasi bëhen përshëndetjet e para të zakonshme, dhe  
pasi shoku Aidit flet shkurtimisht mbi përshtypjet  
nga vendi ynë, fjalën e merr*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në emër të Komitetit Qendror të Partisë sonë ju falenderojmë edhe një herë nga zemra për ardhjen tuaj në Shqipëri, e cila është një ngjarje e rëndësishme për Partinë tonë sepse forcon kontaktet dhe vëllazërimin në mes Partisë dhe popullit tonë me Partinë Komuniste dhe popullin vëlla indonezian!

Ne jemi të bindur se vizita juaj në Shqipëri, kontaktet që morët me punonjësit dhe me kuadrot tanë do ta forcojnë akoma më shumë punën e Partisë dhe të popullit tonë për ndërtimin e socializmit. Të gjithë

ata që ju panë dhe u takuan me ju gjatë vizitave që bëtë nëpër vendin tonë ndiejnë një dashuri dhe respekt të madh për partinë tuaj heroike.

Koha e qëndrimit tuaj në Shqipëri është e shkurtër, po pak a shumë ju morët një farë përshtypje mbi vendin tonë, gjë që ndihmon shumë për forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të ngushta miqësore midis dy partive tona.

Sikurse e patë, në Shqipëri ka edhe suksese, ka edhe të meta e vështirësi. Sigurisht vendi ynë akoma nuk është i përparuar dhe i begatshëm në atë shkallë që janë mjaft vende të tjera. Ne jemi akoma shumë prapa, por, në krahasim me të kaluarën, gjatë 15 vjetëve jete të lirë e të pavarur, në vendin tonë janë bërë ndryshime të mëdha, të cilat u detyrohen luftës dhe heroizmit të popullit tonë, heroizmit dhe vijës së drejtë të Partisë sonë dhe ndihmës së kampit socialist.

Populli dhe vendi ynë në të kaluarën kanë vuajtur nën thundrën e pushtuesve të huaj, të cilët e kishin lënë nga çdo pikëpamje shumë prapa ekonominë dhe kulturën e vendit tonë, sidomos që populli ynë, në çdo etapë të historisë së tij, ka luftuar me armë në dorë për lirinë, për pavarësinë, për një jetë më të mirë, për arsimin dhe për kulturën e tij. Këto tradita patriotike e luftarake të popullit tonë bënë që ai gjatë Lustës Nacionalçlirimtare t'i përgjigjej thirrjes së Partisë dhe të mobilizohej në rrugën që i tregonte ajo për të fituar të drejtat e tij, për të cilat kishte luftuar gjatë shekujve.

Përpara çlirimit vendi ynë ishte nën sundimin e regjimit të egër antidekomkratik të çifligarëve dhe të borgjezisë reaksionare, e cila sapo kishte nisur të hidh-

te hapat e parë. Në prag të Luftës Nacionalçlirimtare Shqipëria ishte një vend agrar gjysmëfeudal, me një bujqësi krejtësisht të prapambetur, e cila zhvillohej e shfrytëzohej në mënyrë feudale.

Fshatarët nga pikëpamja ekonomike ishin në mjerim, sëmundje nga të katër anët, nuk kishte shkolla, dhe, në fund të periudhës së regjimit feudal të Zogut, mbreti filloi t'u jepte edhe koncesione në toka italianëve, të cilët përpara pushtimit kishin filluar të blenin çifliket e bejlerëve me qëllim që të kolonizonin Shqipërinë.

Për industrinë mund të themi se gati nuk ekzistonte fare. Te ne kishte vetëm disa punishte dhe një artizanat jo shumë të zhvilluar. Populli shqiptar rronte në mjerim dhe për plotësimin e nevojave të tij shumë të pakta silleshin nga tregjet e jashtme, si i thonë, që nga peri e deri te gjilpëra.

Disa vjet përpara pushtimit fashist, shfrytëzuesit italianë, në bazë të koncesioneve kapitulluese që u bëri Zogu, kishin filluar të hapnin disa puse të naftës dhe të shfrytëzonin në mënyrë barbare burimet tonë. Zhvillim tjetër industrial nuk kishte, me përjashtim të disa fabrikave të vogla të duhanit pa rëndësi, disa punishte lëkurësh, makaronash, vaji, një fabrikë çimente. Me fillimin e pushtimit filloi të zhvillohej pak a shumë një borgjezi tregtarë, e cila kishte nisur qysh gjatë regjimit të Zogut t'u jepte koncesione italianeve në të gjitha fushat dhe të merrte edhe ajo një pjesë të vogël në zhvillimin e tregtisë. Kjo borgjezi filloi të merrte rrugën e fajdeve, të blente disa toka të bejlerëve. Ajo nuk u interesua të investonte aspak kapitale në sektorin e industrisë, u lidh pak a shumë me firmat

kapitaliste italiane, pra, mund të themi, u bë si një ndërmjetëse për disa fitime në çështje tregtare.

Kështu, në të kaluarën vendi ynë ishte në një nivel shumë të ulët përsa i përket zhvillimit ekonomik. Po urrejtja popullore, lufta kundër regjimit feudal të Zogut dhe preqitjes së pushtimit nga ana e tij, ishte kurdoherë në ngritje. Burgjet e mbretërisë atëherë ishin plot me bij të popullit që qenë ngritur kundër shtypjes e shfrytëzimit.

Klasa jonë punëtore në atë kohë ishte e vogël, po lufta dhe niveli i saj politik filluan të rritheshin kur në Shqipëri nisën të përhapeshin idetë komuniste dhe të formoheshin grupet tonë para komuniste, të cilat luftuan për demaskimin e regjimit të Zogut dhe për përhapjen e ideve marksiste në masat.

Grupet komuniste, megjithëse në mjaft çështje nuk kishin pikëpamje plotësisht të drejta marksiste-leniniste, bënë një punë fillestare shumë të mirë. Ato preqitën, përpara formimit të Partisë, rezistencën e popullit kundër regjimit të Zogut dhe, me pushtimin e vendit, i aktivizuan forcat patriotike në luftën kundër pushtuesit. Kështu, lufta e popullit tonë që filloi praktikisht qysh më 7 prill 1939, shkoi vazhdimisht duke u ngritur dhe mori një formë të ashpër, të organizuar dhe të papërkulur, kur u formua Partia jonë në nëntor 1941.

Formimi i Partisë sonë u bë, natyrisht, me përpjekje kundër pushtuesve dhe kuislingëve, pse populli dhe komunistët kishin hyrë në luftë kundër tyre, duke bërë atentate dhe duke organizuar veprimitarinë antifashiste ilegale. Në të njëjtën kohë Partia jonë luftoi pa mëshirë dhe me konsekuençë kundër troc-

kistëve dhe clementëve oportunistë, të cilët kishin infiltruar në grupet e ndryshme komuniste.

Formimi i Partisë ishte një sukses i madh për popullin tonë. Ai shënoi fitoren mbi të gjitha fraksionet antimarksiste që ekzistonin në atë kohë në lëvizjen komuniste në Shqipëri. Menjëherë pas themiclimit të Partisë detyra më e ngutshme që i vunë vetes komunistët shqiptarë ishte organizimi dhe kalitja e Partisë, mbrojtja e parimeve të marksizëm-léninizmit, uniteti politik dhe organizativ i radhëve të saj. Ata që goditnin këtë unitet flakeshin jashtë radhëve të Partisë.

Partia që me themelimin e saj vuri si detyrë kryesore luftën kundër pushtuesve. Komunistët e parë që themeluan Partinë dhe që zbatuan vijën e saj e kishin të qartë se Partia do të rritej dhe do të kalitej në rrugën marksiste-leniniste, vetëm në luftë duke mobilizuar masat e gjera popullore e duke i udhëhequr ato drejt kryengritjes së armatosur për çlirimin e vendit.

Në zbatimin e kësaj vije Partia jonë ka pasur suksese të mëdha, po ajo ka bërë edhe shumë sakrifica, sepse ishte në radhët e para të luftës kundër pushtuesve dhe tradhtarëve të vendit. Në kushtet e pushtimit të plotë të vendit dhe të terrorit të egër fashist, Partia jonë ndërmori aksionet më të guximshme me armë dhe me propagandë dhe doli me sukses. Mbështetjen për heroizmin e saj Partia e gjeti te populli ynë i cili ka luftuar me trimëri gjithë jetën. Trimëria është një nga cilësitë e larta të popullit tonë, ashtu sikurse është kjo cilësi edhe te çdo popull tjetër, dhe populli ynë e ka zakon që t'i nderojë e t'i dojë shumë njerëzit që sheh se nuk u trembet

syri dhe janë të sakrificës e luftojnë për qëllimet e larta të çlirimtës së atdheut.

Aksionet e guximshme që bëri ia shtuan autoritetin Partisë sonë. Duhet pasur parasysh se komunistët shqiptarë ishin të rinj, njerëz të thjeshtë të popullit, pra njerëz që populli nuk i kishte njohur, kurse, nga ana tjetër, mjaft kuqislingë kishin një farë të kaluare, disa kishin marrë pjesë edhe në lëvizjet patriotike të kohëve të mëparshme, po ishin degjeneruar dhe më në fund u bashkuan me pushtuesit. Natyrisht ata bënë demagogji edhe në politikë për të penguar Luftën Nacionallçlirimtare të popullit tonë.

Pushtuesit në shumë raste i shfrytëzuan këto situata, po Partia jonë me guximin dhe me trimërinë e komunistëve shqiptarë, jo vetëm fitoi autoritet në popull, po i tregoi atij qartë dhe tradhtinë e elementëve kuqislingë. Ajo jo vetëm vuri në dukje me propagandë se këta njerëz ishin demagogë, po dhe në bashkëpunim me pushtuesit, gjë që provonte në fakt se ata nuk donin çlirimin e Shqipërisë.

Vendimtare ka qenë lufta e armatosur e popullit tonë të udhihequr nga Partia. Natyrisht Partia e kishte të qartë se luftë do ta zhvillonte me popullin, prandaj popullin duhet ta bënte të ndërgjegjshëm për misionin e tij, ta mobilizonte dhe sidomos ta organizonte politikisht dhe ushtarakisht. Gjendja qe e favorshme dhe Partia kishte bindje të plotë se populli ishte i gatshëm të hidhej në luftë kundër pushtuesve dhe tradhtarëve. Nëpërmjet luftës dhe aksioneve të armatosura e të guximshme Partia kishte edhe një plan për preqatitjen politike dhe për organizimin e popullit.

Partia, duke punuar për forcimin e pozitave të saj politike e ushtarake, në momentet më të përshtatshme organizoi çetat partizane dhe Frontin Nacionalçlirimtar. Ajo kishte për qëllim të bashkonte politikisht të gjithë popullin tonë në këtë organizatë të madhe antifashiste, kundër pushtuesve e tradhtarëve dhe në këtë organizatë, të udhëhcqur nga Partia, të merrte pjesë i gjithë populli, pa marrë parasysh pikëpamjet politike të njerëzve, besimet fetare etj., mjafton të ishin kundër pushtuesve dhe të kishin dëshirë për të luftuar kundër tyre.

Duhet thënë se në vendin tonë gjatë regjimit të Zogut nuk kishte asnjë parti politike. Zogu ishte një feudal dinak, prapanik dhe diktator i egër që sundonte me anë të xhandarmërisë, nëpërmjet bajraktarëve dhe kryetarëve të fiseve dhe nuk lejonte asnje zhvillim politik ose kulturor të konkretizuar nëpër parti të ndryshme. Ai nuk kishte asnje parti të vetën, po kishte rrëth vetes një klikë të degjeneruar.

Kështu, kur u krijuua Partia jonë ishte e vëtmja parti në Shqipëri. Partia, me Frontin Nacionalçlirimtar që organizoi, kishte për qëllim që në të të përfshi heshin masat e gjera të popullit. Në mbledhjen e parë për krijimin e këtij fronti, Partia stoi edhe përfaqësuesit e grupeve të ndryshme që nuk përfaqësonin parti po grupe njerëzish dhe që pak a shumë kishin influencë dhe njiheshin si kryetarë dhe si njerëz të shquar të kësaj ose asaj krahine, apo të këtyre apo atyre grupe njerëzish.

Në mbledhjen e parë që u zhvillua afër Tiranës, në Pezë, fshat i një zone që e kishin çliruar partizanët, u ftua për shembull edhe një ish-oficer i Zogut, i cili

hiqej si përfaqësuesi i tij. U ftuan edhe elementë të tillë nationalistë të lëkundshëm që nuk e kishin përcaktuar plotësisht qëndrimin e tyre, që kishin edhe prirje reaksionare, por që me qëndrimet e tyre në ato kohë tregonin disa kontradikta me pushtuesit dhe me kuislingët.

Nga ana tjeter, kjo mbledhje me rëndësi të madhe për Lëvizjen Nacionalçlirimtare të popullit tonë ka pasur rëndësi edhe për hedhjen e bazave të pushtetit tonë popullor. Që nga ajo datë u krijuan këshillat nacionalçlirimtare që do transformoheshin gjatë dhe pas luftës në organë të pushtetit tonë aktual. Partia jonë i pati të qarta qysh në fillim dhe i zbatoi, mund të themi pa gabime, parimet marksiste-leniniste të ndërtimit të Partisë, të luftës partizane, sipas teorisë së Marksit, Engelsit, Leninit dhe të Stalinit, të shkatërrimit të pushtetit të pushtuesve dhe të kuislingëve dhe të krijimit të pushtetit popullor.

Në këtë mbledhje programi i Partisë sonë për bashkimin luftarak të popullit dhe për ngritjen e këshillave nacionalçlirimtare u pranua edhe nga përfaqësuesit e grupeve të tjera dhe u vendos vazhdimi i luftës kundër pushtuesve e u muar vendim për aksione të menjëherëshme, të cilat u zbatuan nga Partia, nga nationalistët e ndershëm dhe nga populli, kurse përfaqësuesit e grupeve reaksionare u mënjanuan dhe nuk morën pjesë.

Partia më vonë bëri thirrje të njëpasnjëshme, zhvilloi mbledhje pas mbledhjesh me përfaqësues të këtyre grupeve dhe bëri të gjitha përpjekjet për t'i sjellë në rrugë. Por më në fund ata u bashkuan për-

fundimisht me pushtuesit dhe Partia u gjend ballë për ballë në luftë me ta.

Vija politike dhe organizative e Partisë, vija e luftës pa kompromis kundër pushtuesve e tradhtarëve gjeti aprovim dhe mbështetje të plotë në masat e gjera të popullit. Çështja më me rëndësi në atë kohë për Luftën Nacionalçlirimtare ishte çështja e fshatarësisë. Duhej të fitohej fshatarësia, sepse ajo përbënte pjesën dërrmuese të popullit dhe ishte një forcë e madhe revolucionare. Prandaj Partia me politikën e saj të drejtlë, punoi dhe bëri që ta fitonte fshatarësinë.

Në luftë e sipër u demaskua e gjithë demagogjia e bejlerëve, e latifondistëve etj. Fshatarësia u bashkua me ne, për shkak të çështjes së madhe të çlirimit për të cilën kishte luftuar gjithë jetën, për arsyet e trimërisë së komunistëve, për arsyet e bindjes që krijoj se Partia do t'i jepte tokën pas çlirimit, si edhe të masave imediate që mori Partia gjatë luftës, që fshatarësia të priste marrëdhëniet ekonomike dhe feudale me të gjithë agallarët dhe bejlerët, shërbëtorë të pushtuesit, për të mos u dhënë asgjë më atyre si deri atëherë, po kështu edhe qeverisë fashiste e tradhtarëve të mos u paguante asnjë lloj detyrimi e tatimi, por t'u përgjigjej me armë kërkeseve të tyre. Njëkohësisht Partia dhe çetat partizanc morën direktivën për të shkuar deri në plumb ata që grabitnin dhc që kërcënonin fshatarët dhe masa të tilla u morën.

Kështu, fshatarësia pa se kishte një udhëheqje të saj, pa se Partia mbronte interesat e popullit dhe të fshatarësisë. Prandaj fshatarësia u bë burimi dhe forca kryesore e armatosur e Luftës Nacionalçlirimtare, mbë-

shtetja më e shëndoshë e klasës punëtore, e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Kjo shpjegon se si Lufta Nacionalçlirimtare mori një zjarr kaq të madh në vendin tonë dhe partizanët shqiptarë patën përkrahjen kaq masive të fshatarësisë së Shqipërisë.

Terror i madh u bë nga ana e pushtuesve kundër popullit. Krahina të tëra u dogjën, një numër fshatash u rrafshuan fare, po lufta e popullit forcohej vazhdimiشت dhe çetat u kthyen gradualisht në batalione, brigada e divizione dhe kur Shqipëria u çirua plotësisht ne kishim në këmbë mbi 70 000 partizanë.

### Për luftën kundër revizionizmit modern

Partisë sonë iu desh të zhvillonte një aktivitet të madh politik e luftarak jo vetëm kundër pushtuesve dhe tradhtarëve, por edhe kundër intrigave të imperialisë amerikano-anglezë dhe trockistëve jugosllavë. Me veprimtarinë armiqësore të revizionistëve jugosllavë Partia jonë u ndesh qysh në fillim, që nga koha e luftës e gjersa këta renegatë u demaskuan, pa folur këtu për periudhën pas vitit 1948. Gjatë gjithë periudhës së luftës, natyrisht, trockistët jugosllavë punuan në mënyrë shumë të maskuar. Ne kishim kundërshtime me ta në punë, por nuk ishim në gjendje të gjykonim qysh atëherë se ata ishin revizionistë, trockistë dhe armiq të komunizmit dhe të vendit tonë.

Qysh në kohën e krijimit të Partisë sonë dhë të fillimit të Luftës Nacionalçlirimtare qëllimi i udhëhe-

qësve trockistë të ish-Partisë Komuniste Jugosllave ishte që Partia jonë të bëhej një bisht i saj, që lufta e Partisë sonë të drejtohej nga Partia Komuniste Jugosllave dhe, me çlirimin, Shqipëria të lidhej ngush-të me Jugosllavinë, gjersa të arrihej që ajo të bëhej një republikë e shtatë jugosllave.

Eshtë shumë interesant zhvillimi gjatë gjithë kohës i veprimtarisë së tyre shoviniste e armiqësore ndaj nesh. Ata u përpoqën që Lufta Nacionalçirimitare e popullit tonë të mos merrte një drejtim si ai që mori. Në çështjen e krijimit dhe të forcimit të ushtrisë sonë, ata luftonin që ushtria jonë të mos zhvillohej në for-macione të mëdha, ata u përpoqën vazhdimisht që Luftën tonë Nacionalçirimitare ta futnin nën komandën e tyre të plotë dhe direkte.

Sic u duk edhe më vonë me marrëdhëniet që kishte me anglezët, udhëheqja revizioniste jugosllave u përpoq të krijonte një shtab të madh ballkanik nën komandën e jugosllavëve. Përfaqësues të Titos erdhën në Shqipëri, shkuan edhe në Greqi për këtë qëllim, po nuk ia arriten dot te ne, kurse Partia Komuniste e Greqisë në atë kohë, e tradhtuar nga udhëheqja e saj, u fut, për hesap të vet, nën drejtimin e Shtabit aleat të Mesdheut.

Kur Shqipëria ishte pothuaj duke u çliruar, udhë-heqësit e ish-PK të Jugosllavisë u përpoqën që në radhët e ushtrisë dhe të Frontit tonë Nacionalçirimitar të futnin tradhtarët shqiptarë me të cilët ne i kishim larë hesapet prej kohësh. Duke vazhduar rrugën e tyre armiqësore ndaj Partisë dhe vendit tonë, në pragun e çlirimt të Shqipërisë ata i paraqitën zyrtarisht KQ të

Partisë sonë pikëpamjet e tyre se gjoja lufta jonë kishte gabime në vijë dhe prapa krahëve organizuan edhe një komplot<sup>1</sup>. Faktet provonin se lufta dhe vija e Partisë ishte e drejtë, ajo vijë kishte bërë të mundur që të çlirohet e gjithë Shqipëria, të konsolidohej Partia në rrugën marksiste-leniniste, të krijohej një Ushtri e fuqishme Nacionalçlirimtare, e cila luftoi heroikisht ditë dhe natë për çlirimin e atdheut, krijoit në të katër anët e vendit, që gjatë luftës, pushtetin popullor, kë-shillat nacionalçlirimtare, në fshatra dhe në qytete, mobilizoi gjithë popullin në rrugën e luftës, në rrugën e Partisë, kaliti lidhjet e dashurisë dhe të miqësisë së popullit tonë me Bashkimin Sovjetik dhe me popujt e vendeve të tjera që qenë ngritur në luftë kundër fashizmit.

Udhëheqësit jugosllavë, jo vetëm sulmuani vijën e Partisë sonë si një vijë gjoja jo e drejtë, por me disa nga anëtarët e KQ të Partisë sonë, organizuan, siç thashë, edhe një komplot për të rrëzuar udhëheqësit e shëndoshë të Partisë sonë. Qëllimi ishte që të zbatonin pjesën tjetër të programit të tyre, për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Mirëpo ata nuk patën sukses në këtë ndërmarrje.

Ata e zhvilluan gjithashtu veprimtarinë e tyre trockiste, antimarksiste dhe antishqiptare edhe pas

<sup>1</sup> Është fjalë për Plenumin II të KQ të PKSH, në nëntor 1944, ku u ftua të merrte pjesë si përfaqësues i një partie motër edhe i dërguari i udhëheqjes jugosllave, Velimir Stojniçi. Ky, duke pasur përkrahjen e komplotistëve në gjirin e KQ të PKSH, ndërhyri brutalisht në punët tona të brendshme, duke shkelur të gjitha rregullat e marrëdhënieve midis partive komuniste.

çlirim. Duhet pasur parasysh fakti se ne jemi përpjekur për të pasur marrëdhënie shumë të mira dhe të afërtë me ish-Partinë Komuniste të Jugosllavisë, sepse kishim besim të plotë te ajo si te çdo parti tjetër marksiste. Kur u çlirua Shqipëria, ne dërguam 9 brigada të ushtrisë sonë, të cilat morën pjesë në luftën për çlirimin e Kosovës, të Malit të Zi, të Dibrës së Madhe, të Sanxhakut, të Bosnjës etj. së bashku me reparte të UNÇ Jugosllave. Gjatë këtyre luftimeve kundër ushtrive gjermane na u vranë qindra partizanë shqiptarë.

Përveç këtyre, në saje të lidhjeve të ngushta, që ne i kishim me singjeritet, jugosllavët vinin gjoja për të na ndihmuar për zhvillimin ekonomik të vendit, por qëllimi i tyre i vërtetë ishte gllabërimi i Shqipërisë.

Qëllimi kryesor i tyre ishte të hidhnin në dorë në radhë të parë Partinë nëpërmjet tradhtarit Koçi Xoxe që ishte sekretar organizativ i Partisë dhe ministër i punëve të brendshme, njeri i jugosllavëve. Tendencia e udhëheqjes jugosllave dhe e grupit tradhtar të Koçi Xoxes ishte që Partia jonë të ndërronte parimet dhe metodat e punës, domethënë që Partia jonë të transformohet në një parti trockiste. Përveç kësaj, ata luftonin të hidhnin në duar kyçet e ekonomisë sonë.

Dihet se vendi ynë doli i shkatërruar nga lufta, po populli, i udhëhequr nga Partia, me mundësitë që kishte, me mobilizim e entuziazëm të paparë ndërtoi brenda dy vjetëve shtëpitë dhe fshatrat e djegura, urat, rrugët dhc çdo gjë tjetër që shkatërruan armiqjtë push-tues. Në këtë vepër një rol të madh ka luajtur rinia me vrullin dhe me entuziazmin e saj.

Udhëheqësit revizionistë jugosllavë u përpoqën me të gjitha mënyrat që ekonominë e Shqipërisë ta kishin nën drejtimin e tyre, qoftë nga ana organizative ashtu edhe përsa u përket zhvillimit dhe drejtimit politik të saj. Ata u përpoqën të mos kishim lidhje me Bashkimin Sovjetik dhe në këtë drejtim zhvilluan një aktivitet të madh.

Qëllimi tjetër i tyre ishte të likuidonin ushtrinë tonë, duke likuiduar në radhë të parë të gjithë kuadrot kryesorë dhe besnikë, të Partisë dhe në vend të tyre të vinin elementët dhe agjentët e vet.

Gjatë gjithë këtij procesi antimarksist e antishqiptar ata kanë pasur përpjekje të ashpra me Partinë tonë. Kështu nuk mundën t'i realizonin dot qëllimet e tyre.

Sidomos çështja e Partisë ata i preokuponte shumë. Me anën e tradhtarit Koçi Xoxe ata u përpoqën të vinin Partinë nën kontrollin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ministri ynë i Brendshëm, natyrisht, kishte lidhje me Ministrinë e Brendshme të Jugosllavisë. Kur u likuidua kjo punë armiqësore, në Ministrinë tonë të Brendshme u gjendën dosje të preqatitura për qindra kuadro kryesorë të Partisë sonë, dhe ishin preqatitur gjithashtu plane për të hedhur udhëheqësit në gjyq. Të gjitha këto gjëra të kurdisura nga revizionistët jugosllavë vërtetohen me fakte se janë organizuar nga UDB-ja jugosllave që atëherë quhej OZNA.

Kjo punë armiqësore vazhdoi gati gjer në vitin 1948. Ata mendonin se kishte ardhur koha që të realizonin edhe bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë nëpërmjet këtij grupei tradhtar. Kjo çështje u lidh atëherë edhe me planin jugosllav për krijimin e një

federate ballkanike. Por, kjo situatë u shemb dhe filluan përpjekje të ashpra në mes të Partisë sonë dhe të partisë së tyre edhe përpara se të na vinin letrat e Stalinit drejtuar KQ të ish-PK të Jugosllavisë.

Ata nuk u mjaftuan me këto veprime po shfrytëzuan edhe provokacione të jashtme. Në nëntor 1946 ndodhi provokacioni ndërkombetar i Korfuzit, anjet angleze hynë në ujërat tona e u përplasën në mina. Ju kaluat afër Sarandës dhe e merrni 'me mend se sa afër portit ndodhi ky provokacion. Anjet angleze s'kishin ç'të kërkonin atje. Ky ishte një plan i kombinuar midis jugosllavëve dhe anglezëve.

Në këto rrethana revisionistët jugosllavë, duke parë së po precipitohej situata dhe veprimitaria e tyre do të demaskohej, krijuan legjendën se gjoja Shqipëria ishte në rrezik, se grekët dhe anglezët do të na sulmonin, prandaj propozuan të dërgonin 4 divizionë jugosllave «për të mbrojtur» Shqipërinë. Partia jonë e kishte të qartë se prapa këtij propozimi fshihej synimi për pushtimin e Shqipërisë nga forcat e armatosura të Jugosllavisë, ndaj, pasi u këshillua me Stalinin, i cili na njoftoi se asnë rrezik nuk kishte përvendin tonë nga Greqia, ne vendosëm përfundimisht të mos pranonim me asnë mënyrë divizonet jugosllave në vendin tonë dhe ia dërguam lajmin Titos. Pas këtyre ngjarjeve u demaskua veprimitaria e trockistëve jugosllavë botërisht nga Byroja Informativë.

Këto janë në vija të përgjithshme çështjet që deshëm t'ju vinim në dijeni përsa u përket marrëdhënieve të Partisë sonë me revisionistët jugosllavë. Për këto çështje ka një praktikë të tërë, ka fakte dhe

dokumente të njohura, shkrime dhe letra të Titos e gjëra të tjera. Qëllimi i Titos ishte të hidhte në dorë Partinë tonë, ta kthente atë nga një parti marksiste-leniniste në një parti oportuniste. Por Partia jonë i përballoi me sukses të madh të gjitha këto orvatje, e likuidoi këtë situatë dhe, nga gjithë kjo luftë e tmerrshme kundër trockistëve jugosllavë dhe tradhtarëve shqiptarë, ajo doli më e kalitur.

Gjatë periudhës së «miqësisë» që ne kemi pasur me revisionistët jugosllavë, sidomos gjatë periudhës 1945-1948, kemi humbur tre vjet të vlefshëm për ndërtimin e socializmit. Prandaj zhvillimi i vërtetë i vendit tonë mund të thuhet se ka filluar nga 1949.

Revisionistët jugosllavë e grabitën vendin tonë të varfër e të mjeruar në çdo gjë që mund të grabitej, deri në gjërat antike. Ne kishim konfiskuar pas Çlirimt pasurinë e tregtarëve në mallra; revisionistët jugosllavë, nën pretekstin se jemi «miq», rrëmbyen të gjitha stofat, sende ushqimore e çdo gjë tjetër, në një kohë kur populli ynë ishte i zhveshur, i zbathur e i uritur. Naftën tonë, në vend që të na ndihmonin për ta zhvilluar, ata na e sabotuan; sabotonin puset tona të naftës që punëtorët tanë mezi i kishin vënë në shfrytëzim.

Ata u përpoqën, gjithashlu, që në vendin tonë të mos zhvillohej bujqësia, sidomos drithërat, duke na thënë se na jasin ata bukë, gjë që nuk na e dhanë kurrë. Qëllimi i tyre ishte të na mbanin në varfëri ekonomike për të realizuar të gjitha planet.

Prandaj ne mund të themi se vetëm nga viti 1949 dhe 1950 filluam në shkallë të gjerë nga puna për

ndërtimin e socializmit në vendin tonë dhe kjo u bë në saje të heroizmit të Partisë sonë dhe të ndihmës së Bashkimit Sovjetik, i cili me interesimin e drejtëpërdrejtë të Stalinit na ka përkrahur për mëkëmbjen e ekonomisë sonë. Megjithëse në vendin tonë nuk erdhi asnje ushtar sovjetik, Bashkimin Sovjetik ne e konsiderojmë si faktorin e jashtëm që na ndihmoi të çlrohem, sepse ishte Ushtria Sovjetike që mposhti e shkatërrroi forcat e egra hitleriane.

Bashkimi Sovjetik, Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, shoku Stalin na kanë ndihmuar dhe janë interesuar në ato kohë të vështira për vendin tonë. Kur u likuidua puna armiqësore e titistëve jugosllavë, Partia dhë populli ynë thanë me të drejtë se Bashkimi Sovjetik dhe Stalini ishin faktori i jashtëm kryesor që e ndihmuam përsëri popullin tonë, sepse me të vërtetë kaluam periudha jashtëzakonisht të rënda, po ato u kapërcyen në saje të faktorëve që përmenda.

Përveç luftës së ashpër e të pandërprerë që na është dashur të bëjmë kundër revizionistëve jugosllavë, Partia e populli ynë janë ndeshur edhe me synimet gllabëruese të imperialistëve anglezë e amerikanë, të cilët organizuan komplotë kundër vendit tonë. Ne kemi kapur dokumente me të cilat vërtetohet organizimi i këtyre komploteve nëpërmjet misioneve si Militari Lizon (M.L.), UNRRA etj. Mirëpo të gjitha këto komplotë e plane djallëzore dështuan sepse Partia dhe populli ynë i demaskuan me forcë dhe qëndruan të pathyer përpara manovrave dhe synimeve të armiqve, imperialistëve apo revizionistëve.

Por sidoqoftë armiqtë tanë rrëth e rrötull kanë

vazhduar dhe po vazhdojnë të bëjnë një punë intensive armiqësore kundër Shqipërisë. Pas demaskimit nga ana e Byrosë Informative, revisionistët jugosllavë e vazhduan më me egërsi e më me brutalitet luftën e tyre kundër Republikës sonë Popullore, kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, kampit socialist dhe marksizëm-leninizmit. Këtë e dëshmon krejt veprimitaria e tyre nga viti 1948 e këtej.

Revisionistët jugosllavë kanë qenë, janë dhë do të jenë gjithë jetën e tyre armiq të komunizmit, të marksizëm-leninizmit dhe të kampit tonë. Sikurse është në dijeni shoku Aidit dhe të gjithë shokët indonezianë, revisionistët jugosllavë e kanë vërtetuar armiqësinë e tyre kundër komunizmit, kundër lëvizjes punëtore ndërkombëtare. Ne jemi në dijeni për qëndrimin marksist-leninist që ka mbajtur Partia Komuniste e Indonezisë kundër revisionistëve jugosllavë dhe kundër intrigave të përfaqësuesve jugosllavë në Indonezi.

Sidoqoftë përpara historisë së lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare është fakt se Partia jonë bëri përqapje për t'i sjellë në rrugë të drejtë, megjithëse e dinte q'ishin këta renegatë. Edhe pasi iu dha dorë nga ana e partive tona, revisionistët jugosllavë e treguan me vepra se ishin një agjenturë e imperializmit dhe këtë e provuan shumë mirë me ngjarjet e Hungarisë dhe në Kongresin e tyre të 7-të, ku intensifikuan në teori dhe në praktikë politikën e tyre armiqësore kundër kampit socialist dhe lëvizjes punëtore ndërkombëtare.

Por për Partinë tonë, në bazë të atyre që ju thashë, ishte e qartë tradhtia e udhëheqjes jugosllave. Ata i

bënë shumë të këqija Partisë sonë. Këto nuk mund të ishin gabime të rastit, po veprime të paramenduara të armiqve të komunizmit. Mund të kuptohen bërja e disa gabimeve ose e padrejtësive nga disa elementë, po në rastin konkret këto nuk mund të ishin të tillë. Ato ishin fund e krye shprehje e një vije të vendosur nga elementët trockistë dhe revisionistë siç ishin revisionistët jugosllavë.

Kjo nuk ishte një punë armiqüsore që u zhvillua pas vitit 1948 nga ana e udhëheqjes jugosllave, po ishte një vijë e kristalizuar të Titoja dhe të gjithë shokët e tij shumë kohë përpara. Ata për një kohë mundën të kalonin të maskuar brenda lëvizjes punëtore ndërkombëtare. Por çështja e Shqipërisë vërlletoi që këto veprime të tyre ishin të paramenduara me kohë dhe të vendosura nga një grup trockistësh.

Pas 1948-s ata u demaskuan dhe vazhduan veprimtarinë e tyre kundër partive dhe vendeve tonë. Në Shqipëri ata nuk i realizuan dot qëllimet e tyre, po më pas ata nuk i realizuan dot qëllimet as në vendet e tjera, si për shembull në Hungari, në Bullgari etj. Pas 1948-s ata u treguan veçanërisht aktivë në kohën e ngjarjeve të kundërrevolucionit në Hungari.

Kundërrevolucioni në Hungari, ku ata morën pjesë aktivisht, ishte organizuar prej tyre. Një gjë të tillë ata u orvatën ta bën edhe te ne. Ne themi se revisionistët jugosllavë ishin organizatorë në këtë kundërrevolucion, sepse këtë ata e treguan jo vetëm me mbrojtjen e gjatë që i bënë Nagit, po edhe se kundërrevolucionin e quajtën revolucion.

Përpëra ngjarjeve të Hungarisë ata organizuan

edhe në Shqipëri një grup tradhtarësh për të krijuar edhe te ne një kundërrevolucion. Dy anëtarë të KQ të Partisë sonë, ish-anëtarë të Byrosë Politike<sup>1</sup> ishin agjentë të revizionistëve jugosllavë. Një vit e gjysmë më parë se të ndodhnin ngjarjet në Hungari ata u orvatën të bënин sulme kundër Partisë sonë për likuidimin e udhëheqjes së saj. Po KQ i Partisë sonë u tregua vigjilent, i demaskoi dhe më pas u provua se ata ishin agjentë jugosllavë.

Të gjitha lidhjet këta agjentë i mbanin me ambasadën jugosllave dhe kishin në plan që në Kongresin III të Partisë sonë të sillnin në krye elementë të kalbur, të rrëzonin kështu udhëheqjen ekzistuese të Partisë dhe të merrnin fuqinë në dorë. Këtë revizionistët jugosllavë tentuan ta bënin në Konferencën e Partisë të Tiranës. Dissa elementë antiparti, agjentë të maskuar jugosllavë, të lidhur me ambasadën jugosllave në Tiranë, në Konferencën e Tiranës u ngritën dhe goditën vijën dhe udhëheqjen e Partisë. Po Konferencia e Partisë i dërrmoi dhe i përjashtoi nga Partia dhe ata deklaruan lidhjet me ambasadën jugosllave si dhe qëllimet e tyre.

Në Beograd, po në këtë kohë, zëvendësministri i Punëve të Jashtme deklaronte haptazi se në Shqipëri do të ndodhin së shpejti ngjarje me rëndësi. Po ata u gabuan, gjëra të tillë nuk mund të ndodhnin te ne.

Ata filluan të organizonin pastaj kriminelët shqiptarë të arratisur pas luftës që i kanë grumbulluar në

---

<sup>1</sup> Është fjala për Bedri Spahiun e Tuk Jakovën.

Kosovë e në Metohi për t'i pasur rezervë e t'i hedhin, kur të jetë për ta rasti i volitshëm, kundër vendit tonë. Po Partia dhe Qeveria jonë i kishin marrë me kohë të gjitha masat, si në kufi, ashtu edhe brenda-përbrenda vendit, kundër agjentëve jugosllavë. Kështu, kur plasi kundërrevolucioni në Hungari, të gjithë anëtarët e Partisë, oficerët e liruar dhe mbarë populli i thanë Partisë se jemi gati për të përballuar çdo rrezik.

Kështu revizionistët jugosllavë nuk kishin plane vetëm për Hungarinë, po edhe për Shqipërinë e kudo ku do të gjenin dobësi. Po ata nuk gjetën dhe nuk do të gjejnë kurrë të çara, megjithëse kanë vazhduar dhe vazhdojnë veprimtarinë e tyre subversive dhe të spiunazhit kundër vendeve tona dhe sidomos kundër Shqipërisë.

Ata futin në kufirin tonë grupe diversantësh, të cilët ne i kapim. Ata propagandojnë kundër Partisë, pushtetit tonë dhe udhëheqjes, bëjnë një punë të madhe kundër vendit tonë në popullsinë shqiptare në Jugosllavi, që është një Shqipëri e dytë se ka rreth një milion banorë. Tani me popullsinë shqiptare në Jugosllavi bëhet një punë shfarosëse, duke dërguar një pjesë në Turqi, një pjesë tjeter të madhe duke e shpërndarë në gjithë territorin jugosllav dhe çdo ditë përpiken të organizojnë reaksionin shqiptar për ta pasur kundër nesh.

Por Partia dhe Qeveria jonë kanë deklaruar zyrtarisht dhe i kanë paralajmëruar revizionistët jugosllavë se të tilla veprime do të kthehen kundër tyre. Ata janë shumë dinakë, përpiken të përfitojnë nga këto situata të bashkekzistencës, përpiken të përfitojnë nga bashk-

ekzistenca në mes të shteteve dhe të infiltrohen në kampin tonë të socializmit si «kali i Trojës». Për këtë ata mbështeten në faktin se gjoja në politikën e jashtme paskan disa qëndrime të njëllojta me ne! Po është e ditur se në këto situata është e vështirë për ata të dalin fare hapur e të mbajnë pozita të tjera, ndryshe do të cilësoheshin njësoj si Adenauri.

Përsa u përket anës ideologjike dhe politike, në fakt, në praktikë ata vazhdojnë një punë armiqësore kundër Partisë sonë e kampit të socializmit. Ata kanë propozuar të futen në Këshillin e Ndihmës Ekonomike Reciproke, me paturpësinë më të madhe kanë kërkuar të vijnë aty si vëzhgues permanent, domethënë si spiunë, që të na shohin ç'bëjmë ne dhe si e kemi ekonominë. Qeveria jonë dha mendimin e saj që në asnjë mënyrë dhe në asnjë kohë përfaqësuesit revisionistë jugosllavë të mos pranohen.

Kjo është rruga marksiste-leniniste që ka ndjekur Partia jonë për t'i demaskuar këta armiq të komunizmit dhe për të mos i lënë të futen në kampin tonë.

Partia jonë do të jetë kurdoherë vigjilente, do të mbrojë vijën e saj, popullin, atdheun dhe interesat e kampit socialist, do të ndjekë rrugën marksiste-leniniste dhe do të forcojë radhët në mes të të gjitha partive tona, sepse kjo është rruga shpëtimtare për të gjithë ne, se forca jonë qëndron në unitetin e partive komuniste dhe punëtore të vendeve të demokracisë populllore dhe të partive motra në të gjitha vendet e tjera, ndaj ne kemi luftuar dhe do të luftojmë me të gjitha forcat që ky unitet të mos çahet.

## Disa fjalë mbi zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit tonë

Tani, i dashur shoku Aidit, dua t'ju njoh shkurtimisht me politikën që ka ndjekur Partia jonë për zhvillimin ekonomik e kulturor të RP të Shqipërisë.

Partia jonë përcaktoi vijën e zhvillimit ekonomik, në radhë të parë të industrisë, asaj të minierave, të industrisë së lehtë, të industrisë ushqimore, si dhe të zhvillimit të bujqësisë e njëkohësisht edhe të arsimit, të kulturës dhe të ngritjes së kuadrit, po pa harruar në asnje rast forcimin e ushtrisë sonë dhe modernizimin e saj të vazhdueshëm. Bile Partia çështjen e ushtrisë e pati në kujdes në radhë të parë, sepse Ushtria jonë Popullore, e krijuar nga Partia në zjarrin e luftës dhe e udhëhequr me zotësi prej saj bëri të çlirohet atdheu dhe populli shqiptar. Forcimit të ushtrisë dhe mbrojtjes së atdheut, Partia jonë u ka kushtuar kujdesin kryesor dhe mendojmë se nuk ka bërë keq, pasi vendi ynë ka kaluar rreziqe të mëdha edhe pas Çlirimt. .

Unë ju fola më lart si për intrigat djallëzore të revisionistëve jugosllavë ashtu edhe për komplotet që kanë thurur imperialistët anglo-amerikanë kundër lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë. Këta faktorë na detyruan ne që, krahas të tjerave, të pregatitnim e të aftësonim vazhdimisht nga ana politike e ushtarake kuadrot e ushtrisë sonë. Kështu tani gati të gjithë kuadrot tanë ushtarake i kemi me shkolla të larta ushtarake. Ne po vazhdojmë t'i edukojmë kuadrot

e ushtrisë me idealet e larta të Partisë, të jenë të qartë politikisht e të ngritur ideologjikisht, të thjeshtë e të dashur me ushtarët e me popullin, vigjilentë e të gatshëm për të përballuar çdo situatë të rëndë që mund të na imponohet. Oficerët tanë kanë dalë nga Lufta Nacionalçlirimtare, shumicën e tyre i kemi anëtarë të Partisë, me përjashtim të oficerëve të rinj në moshë që kanë qenë pionierë gjatë luftës.

Edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme kemi kuadro nga më të vjetrit dhe më besnikët e Partisë. Të tërë kanë bërë Luftën Nacionalçlirimtare.

Për zhvillimin e sektorit të industrisë dhe të minierave, si në çdo sektor tjeter, kemi pasur ndihmën e Bashkimit Sovjetik e të kampit socialist. Duhet ditur se për këta sektore ne nuk kishim asnjë kuadër, asnjë inxhinier nafte, kurse tani në ekonomi kemi me qindra, kështu edhe industria jonë e naftës është duke u zhvilluar vazhdimesht.

Për sektorin e naftës ne kemi preqatitur specia-listët tanë dhe i kemi zgjeruar vazhdimesht shpimet dhe kërkimet. Perspektivat e naftës sonë janë shumë të mira. Zona të gjera nafte shtrihen në Veri dhe në Jug, po aktualisht ne tani shfrytëzojmë vetëm dy-tri zona.

Nafta ka pasur dhe ka një rëndësi shumë të madhe për ne. Ajo jo vetëm mjafton për të plotësuar nevojat tona, po edhe për eksport. Një pjesë të madhe ne e përpunojmë në vend sepse kemi ngritur dy rafineri e në perspektivë do të ngremë edhe të tjera, në mënyrë që të eksportojmë më shumë naftë të rafinuar.

Në të ardhshmen mendojmë që në shumë sektorë të zbatojmë ngrohjen me gaz, sepse edhe gaz kemi dhe jemi duke kërkuar edhe në fusha të tjera. Po deri tani me gaz ne mendojmë të furnizojmë fabrikën e plehrave azotike që do të fillojmë të ngremë në vjetët e ardhshëm.

Ne kemi edhe krom, që është një pasuri e madhe për vendin tonë. Tani jemi duke ngritur një fabrikë për pasurimin e këtij minerali, kështu në të ardhshmen do të kemi të ardhura më të mëdha prej tij.

Gjatë vjetëve të pesëvjeçarit të tretë do të ngremë edhe një uzinë të madhe të ferro-kromit, e cila do të punojë me energji elektrike. Tani jemi duke ndërtuar për nevojat e industrisë edhe dy hidrocentrale të reja.

Në zonat e kromit ne kemi edhe mineral bakri. Për bakrin kemi ngritur një fabrikë për pasurimin e tij, e cila do të vihet në shfrytëzim muajt e ardhshëm. Tani kemi një industri metalurgjike të bakrit, po do të ndërtojmë një kombinat të madh për përpunimin e bakrit dhe të plehrave fosfatike.

Vendi ynë ka gjithashtu edhe hekur e nikeli. Tani këto i eksportojmë si minerale. Nikeli ynë është shumë i mirë, kështu edhe hekuri, por në pesëvjeçarët e ardhshëm kemi vendosur që të ndërtojmë metalurgjinë e hekur-nikelit. Kjo degë e industrisë do të kërkojë shumë energji elektrike, prandaj do të ndërtojmë edhe një hidrocentral tjetër më të madh në Veri, me të cilin në vendin tonë do të bëhen 5 hidrocentrale.

Te ne ka gjithashtu edhe qymyrguri, po jo të kualitetit të mirë. Vjetët e ardhshëm ne do të ngremë

fabrikën e brikitimit dhe do të përpinqemi që këtë qymyr që kemi ta kokëzojmë për ngrohje.

Parashikohet të ketë në vendin tonë edhe minerale të tjera. Për zbulimin e vendburimeve të reja po punojnë grupe specialistësh, zbulimet gjeologjike në vendin tonë janë të reja dhe vetëm tani po zbulohen pasuritë e nëntokës së vendit tonë.

Ne kemi pasur dhe kemi akoma vështirësi për kuadro. Po pas Çlirimt kemi preqatitur me qindra kuadro të lartë. Prandaj industria jonë e minierave ka një perspektivë shumë të madhe dhe aktualisht ajo është shumë rentabël, po Partia dhe Qeveria përpiken që ta zhvillojnë akoma më tepër, të ulin më shumë koston e prodhimit dhe ekonomia popullore të ketë fitime më të mëdha. Industria e lehtë te ne para çlirimt thuajse nuk ka ekzistuar kurse tani mund të themi se kemi një industri moderne që drejtobet nga kuadrot tanë.

Ju vizituat kombinatin tonë të tekstileve. Shumica e punëtorëve që janë tani atje kanë qenë dikur analabetë, sidomos gratë dhe vajzat nuk dinin as të shkruanin as të këndonin, bile shumica e tyre kanë qenë të myllura brenda katër mureve të shtëpisë. Por ato erdhën dhe e ndërtuan vetë kombinatin me duart e tyre, atje u hapën kurse dhe shkolla ku gratë dhe vajzat mësuan profesionin. Ne në këtë kombinat nuk kishim asnjë inxhinier tonin, kurse tani kemi 45-46 inxhinierë, përvç qindra kuadrove të mesëm. Tani kombinati e ka tejkaluar kapacitetin e parashikuar në projekt dhe prodhon shumë artikuj të mirë, sidomos disa lloje që kërkohen mjaft edhe jashtë. Kombinati ynë

është bërë një shkollë e madhe për punëtorin tonë dhe ne do të kemi lehtësi të mëdha në të ardhshmen kur do të ndërtojmë një tjetër kombinat tekstili, në Berat<sup>1</sup>. Kombinati i Tiranës ka ndihmuar dhe për zhvillimin e Fabrikës së Tisazhit në Shkodër dhe ka bërë që aktualisht për çdo frymë në Shqipëri të sigurohen 16 ml.

Ne kemi një uzinë mekanike që është ngritur në vjetët e parë pas Çlirimit. Më vonë kjo uzinë u zgjerua në saje të ndihmës që na kanë dhënë Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore. Në këtë ndërma-rreje ne kemi një bërthamë të mirë të klasës punëtore dhe një bazë të shëndoshë për zgjerimin e mëtejshëm të industrisë sonë mekanike. Drejtimi aktual dhe perspektiv i kësaj dege të industrisë është për prodhimin e pjesëve të këmbimit të automjeteve e të traktorëve, prandaj në të ardhshmen ne do ta zgjerojmë edhe më tepër këtë degë sa të arrijmë që të mos importojmë më pjesë këmbimi nga jashtë.

<sup>1</sup> Një pjesë e veprave të reja të industrisë që përmenden në këtë bisedë u vendos të ngriheshin gjatë planit të tretë pesëvjeçar (1961-1965). Por për shkak të politikës antimarksiste dhe antishqiptare të revizionistëve hrushovianë e të pasuesve të tyre, të cilët organizuan blokadën e përgjithshme kundër Shqipërisë socialiste dhe anuluan arbitrarisht të gjitha marrëveshjet e përfunduara, Qeveria e RPSH, në gjendjen e re të krijuar, vendosi shtyrjen e afatit të ndërtimit të këtyre veprave. Më pas, këto vepra u ngriten në saje të punës vetëmohuese të masave tona punonjëse dhe të ndihmës internacionliste të RP të Kinës.

Uzina të tjera të vogla mekanike ne kemi gati në të gjitha qytetet, kemi edhe uzina diçka më të mëdha për riparimin kapital të traktorëve dhe të automobilave dhe të tjerat jemi duke i plotësuar e duke i zhvilluar. Në të gjitha këto uzina janë pregetitur kuadro të rinj shqiptarë.

Tani ne kemi fabrikë sheqeri, këpucësh, që në perspektivë do t'i zgjerojmë, kemi një sërë fabrikash për përpunimin e frutave, një fabrikë për konservimin e peshkut, jemi duke ndërtuar në Tiranë një kombinat ushqimor, për prodhimin e birrës, të lëngjeve të frutave etj., kemi dy fabrika dhe në të ardhshmen do të ndërtojmë edhe një fabrikë tjetër të madhe çimentoje, një tjetër kombinat druri, kemi gjithashtu në plan zhvillimin e mëtejshëm të kapacitetit industrial dhe të minierave. Perspektiva është e tillë që në vendin tonë të arrijmë të ngremë industrinë e nevojshme për të rritur mirëqenien e popullit tonë dhe për shfrytëzimin e burimeve tona të brendshme.

Përsa i përket zhvillimit industrial dhe realizimit të planeve në industri mund të themi se kemi suksese. Ne para një muaji bëmë analizën e realizimit të planit të vitit të kaluar dhe të 4 vjetëve të pesëvjeçarit të dytë dhe rezulton se gjatë 4 vjetëve prodhimi industrial yni është tejkaluar dhe i gjithë plani i pesëvjeçarit të dytë, jo vetëm do të realizohet, po edhe do të tejkalohet. Ky është fryti i punës së klasës sonë punëtore të re, i entuziazmit, i disiplinës dhe i edukimit të saj në rrugën e drejtë të Partisë.

Kjo nuk do të thotë se ne nuk kemi të meta në punën tonë në industri. Te ne ka raste që bëhen lëshi-

me, raste të thyerjes së disiplinës, humbje kohe në prodhim, moshfrytëzim si duhet të materialeve dhe të kohës së punës e të makinerisë. Por, kuptohet se këto janë vështirësi të rritjes. Partia dhe klasa punëtore luftojnë me këto të meta dhe vazhdimisht ka përmirësimë në këtë drejtim.

Por në përgjithësi ne mendojmë se Partia e zhvillon drejt industrinë e minierave dhe industrinë e lehtë, me temp të shpejtë, gjë që ka ndihmuar shumë në përmirësimin e nivelit të jetesës së popullit tonë dhe në forcimin e klasës punëtore e të Partisë.

Edhe bujqësia jonë është futur në rrugën e modernizimit, sidomos që bujqësia jonë është akoma prapa, por në krahasim me të kaluarën ajo ka përparuar shumë. Në radhë të parë në kolektivizimin e bujqësisë te ne janë arritur suksese të mëdha. Kjo punë është zgjidhur në rrugën marksiste, pa u shpejtuar, pa sforço, ka ecur përpara gradualisht dhe duke e bindur fshatarësinë dhe jo vetëm fshatarësinë e varfër, por edhe të mesmen.

Këto suksese kanë influencuar përritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore, përzgjerimin e tokave të punueshme, gati dy herë në krahasim me të kaluarën, janë hapur toka të reja dhe fshatarësia jonë po përqafon çdo ditë e më shumë metodat e reja agroteknike.

Partia jonë ka ndjekur një politikë të drejtë në drejtim të ndihmës përfshatarësinë. Përpara se të fillonte në shkallë të gjërë kolektivizimi, në kuadrin e mundësive që kishte shteti ynë, fshatarëve u ka dhënë ndihmë në kredi përkafshë pune, përfshirë të

zgjedhura dhe për ndërtime bujqësore. Kjo ishte ndihma konkrete materiale, ndërsa me propagandë vazhdohej të flitej për kolektivizimin.

Përveç kësaj, shteti ynë studjoi dhe filloi të marrë masa për bonifikimin e tokave, gjë që ishte detyrë e parë dhë me rëndësi për zhvillimin e bujqësisë së vendit. Me gjithë varférinë e popullit dhe të shtetit tonë kjo punë shumë e rëndë dhe e kushtueshme u ndërmuar nga Partia dhe Qeveria.

Partia lëshoi parullën për tharjen e moçaleve dhe të kënetave. Kjo parullë i vajti në zemër fshatarësë, prandaj me dhjetëra mijëra fshatarë, të rinj e të reja, u futën nëpër moçale, në vendet malarike në mes të mushkonjave, pa bukë, zbathur e pa çizme, pa ekskavatorë e mjete të tjera, dhe punonin natë e ditë, e luftonin edhe kundër sabotatorëve, agjentëve amerikanë dhe jugosllavë.

Kështu u tha këneta e Maliqit, nga e cila u përfituan disa mijëra hektarë toka shumë pjellore. Regjimi feudal i Zogut 15 vjet u përpoq për ta tharë këtë kënetë, po asgjë nuk bëri dot. Projekti ynë i parë parashikonte që një pjesë e fushës së Maliqit të mbannte akoma ujë dhe kështu ndodhi, meqenëse inxhinierët janë atëherë nuk kishin shumë eksperiencë, prandaj tani do të fillojnë të bëhen punime të tjera në mënyrë që të thahet gati plotësisht e gjithë fusha. Në fushën e Maliqit ne mbjellim tani panxhar shekeri që arrijmë të marrim gjer në 225 kv për ha, prandaj atje kemi ndërtuar edhe fabrikën e shequerit dhe tokën e bonifikuar e kemi organizuar në ndërmarrje bujqësore shtetërore.

Nga ana e Lushnjës dhe e Fierit ku kaluat ka fi-

lluar dhe do të vazhdojë puna për tharjen e kënetës së Tërbufit dhe të moçalishteve të tjera. Kështu do të fitojmë mijëra hektarë toka të tjera. Atje përpëra asgjë nuk bëhej, kurse tani mbillet misër, pambuk, grurë, janë hapur kanale të mëdha me ekskavatorë.

Tani po punohet për bonifikimin e gati të gjitha fushave të Shqipërisë, në Jug e në Veri, në Lushnjë, në Fier, në Krujë, në Shkodër. Të gjitha fushat, që kur del nga aerodromi e derisa shkon në Shkodër, kemi në plan për t'i tharë, për t'i sistemuar e për t'i shpyllëzuar.

Kështu krahas me propagandën për kolektivizim, shteti ndërmori punime të mëdha në bujqësi. Ato dhanë mundësi për shtimin e fondit të tokave, ku shteti ka krijuar ndërmarrje bujqësore, dhe punimet për kullimin e tokave ndihmuani njëkohësisht për përmirësimin e tokave të fshatarëve. Pastaj filluan të bëjmë edhe kanale ujitëse, shumë të nevojshme për vendin tonë, sepse te ne në verë bën vapë e madhe dhe thatësirë. Në vitin 1965 parashikojmë që 40 për qind të tokave t'i kemi nën ujë. Pjesën më të madhe të tokave në mbarim të pesëvjeçarit të tretë do ta kemi të pajisur me kanale kulluese e ujitëse. Gjatë kësaj kohe, ne do të kemi përfunduar edhe dy fabrikat për prodhimin e plehrave kimike. Gjithashtu parashikojmë të kemi deri atëherë rrëth 10 000 traktorë me 15 kuaj fuqi.

Kështu vija e Partisë sonë në bujqësi në pesëvjeçarin e ardhshëm është për zgjerimin e tokave të kulluara e të ujitura, për shtimin e mekanizimit dhe për zgjidhjen e problemit të sigurimit të plehrave kimike.

Problemin e kolektivizimit ne e kemi zgjidhur. Në

pranverën që vjen kolektivizimi do të përfundojë krejtësisht në të gjitha fushat, po edhe tani si Republikë kemi arritur të kolektivizojmë 83 për qind të tokës së punueshme të fshatarësisë. Detyra e Partisë sonë tani është forcimi organizativ dhe teknik i kooperativave bujqësore. Në këtë çështje ne kemi disa vështirësi. Vullneti dhe dëshira për të ccur përpara janë të mëdha. Në kooperativat ne kemi organizata partie, të Frontit, të rinisë, të gruas etj., po vështirësinë më të madhe aty e kemi në problemin e kuadrit, sidomos të kuadrove të lartë teknikë, si dhe të kuadrove të mesëm e drejtues. Drejtuesit e kooperativave bujqësore luajnë një rol të madh për mbarëvajtjen e punës. Aktualisht ata kanë një eksperiencë praktike, po për ta kemi ngritur edhe shkolla ku kualifikohen kryetarët e kooperativave, kuadrot e financës dhe brigadierët. Po kuptohet se problemi i kuadrove nuk zgjidhet dot me një vit ose dy. Rëndësi të madhe i kemi vënë forcimit të Institutit të Lartë Bujqësor, kemi krijuar edhe shkolla të mesme bujqësore për sigurimin e kuadrove të mesëm bujqësorë. Në krahasim me të kaluarën, ne kemi bërë disa hapa përpara për plotësimin e problemit të kuadrit, po jemi akoma larg zgjidhjes së kësaj detyre të rëndësishme.

Tani kenë i filluar gjithashtu nga puna për bashkimin e disa kooperativave bujqësore. Po edhe në këtë drejtim ne ecim me kujdes që të mos bëjmë kooperativa shumë të mëdha pa u krijuar plotësisht kushtet e pa pasur kuadro drejtues dhe teknikë. Kjo çështje do të ecë gradualisht me rritjen e nivelit të punës e të gjendjes në kooperativat ekzistuese, me sigurimin e me

kualifikimin e kuadrove drejtues e teknikë në bujqësi, me zgjerimin e mekanizmit etj.

Eshtë fakt që rendimentet e kulturave bujqësore te ne tani janë rritur në krahasim me të kaluarën. Kulturat tona kryesore janë drithërat — misri, gruri, thekra etj. Si kultura industriale kemi pambukun, panxharin, duhanin.

Por, në krahasim me vendet e tjera socialiste, në kushtet aktuale pa plehra kimike, rendimentet tona janë shumë të ulëta. Në përgjithësi misri te ne arrin 13-14 kv për ha, megjithëse ka edhe ekonomi që marrin edhe 30-35 kv për ha pa pleh kimik. Ka pastaj edhe parcela eksperimentale ku janë marrë më shumë. Për shembull shoku Mehmet në parcelën ku kryente punën prodhuese ka marrë 85 kv për ha misër dhe 1 200-1 300 kv për ha silazh. Gruri te ne arrin 12-13 kv për ha po ka ekonomi që marrin 30 e deri në 45 kv për ha.

Direktiva e Kongresit III të Partisë dhe lufta jonë eshtë që ta bëjmë bukën në vend, po fakti eshtë se këtë detyrë të Kongresit ne nuk do ta plotësojmë dot gjatë këtij pesëvjeçari.

Përsa i përket çështjes së pambukut ne i plotësojmë nevojat tona. Në planin e ri pesëvjeçar parashikohet që ta zgjerojmë sipërfaqen e mbjellë me pambuk për të plotësuar nevojat e kombinatit tjetër që do të ndërtojmë. Kultura e pambukut eshtë e re në vendin tonë, ajo ka hyrë pothuaj pas Çlirimt, prandaj në fillim rendimentet kanë qenë shumë të ulëta, po tani kemi arritur të marrim mesatarisht 7-8 kv për ha, sido që ka rajone që marrin rendimente më të mira dhe

ka që arrijnë deri në 30 kv për ha. Kur të kemi plehra kimike, ne do të arrijmë një mesatare shumë më të mirë se kjo e tanishmja në rendimentin e pambukut.

Duhani është një nga prodhimet tona me leverdi të madhe. Vend i ynë ka eksperiencë për zhvillimin e kësaj kulture dhe deri tani ne kemi siguruar mjast të ardhura me të, sidomos në fushën e eksportit. Për këtë kulturë kemi një sërë fabrikash për përpunimin e duhanit, një nga të cilat ju e patë kur vizituat Shkodrën. Atje ka punëtorë të mirë, entuziastë, po të tilla fabrika kemi edhe në Durrës, në Gjirokastër dhe në Elbasan.

Oriz prodrojmë pak në krahasin me kulturat e tjera dhe marrim 25-30 kv për ha. Ne mbjellim edhe fasule që populli i ha shumë. Këto i mbjellim si bimë shoqëruese me misrin, po tani kemi filluar t'i mbjellim edhe si kulturë të veçantë.

Përveç këtyre kemi edhe një blegtori të zhvilluar nga ana numerike. Populli ynë ka pasur dhe ka tradita në blegtori, prandaj i do shumë bagëtitë, po është fakt se, me gjithëkëtë, ai nuk ua bënte mirë shërbimet. Prandaj në këtë sektor me kujdesin e madh të Partisë dhe të Qeverisë po bëhet një revolucion i tërë. Ne kemi një numër të konsiderueshëm delesh, dhish, lopësh, derrash etj., por nga pikëpamja e rendimenteve del se ne marrim shumë pak prodhime prej tyre. Nga çdo dele, për shembull, marrim mesatarisht 1,2 kg lesh, — 45 kg qumësht kurse nga dhitë — 65 kg e nga lopët — 600 kg qumësht. Kjo vjen në radhë të parë nga degjenerimi i racës së vendit, sidomos nga

ushqimi i pamjaftueshëm që u sigurohet, si dhe ngaqë nuk u sigurohen kushte të mira strehimi.

Partia dhe Qeveria kanë marrë masa dhe propagojnë që të luftohet për përmirësimin e të gjitha këtyre drejtimeve, në radhë të parë, për shtimin e ushqimit të blegtorisë. Tani po bëhet një luftë e madhe nga ana e Partisë dhe e pushtetit që fshatarët ta kuptojnë dhe të bëjnë një kthesë rrënjosore për sigurimin e ushqimit të blegtorisë, dhe kemi rezultate në këtë drejtim.

Për këtë duhet të luftojmë edhe kundër disa mentaliteteve, si për shembulli për çështjen e misrit si kulturë e dytë (foragjere) që fshatarët me zor të madh e përdorin për silazh, sepse në të kaluarën ata aq kanë vuajtur për bukë saqë edhe sot të vesh në shtëpitë e fshatarëve, para se të fillojnë të hanë do të shikosh se ata i bëjnë nder bukës, e puthin atë etj. Kurse tani ne i themi që këtë misër ta futë në tokë për silazh.

Përveç kësaj kemi marrë masa dhe po punojmë intensivisht për përmirësimin e racave të bagëtisë. Dy-tre vjetët e fundit ka filluar një punë e mirë për ndërzimin artificial me raca të mira të vendeve të tjera. Kjo punë na ka dalë me sukses dhe po vazhdon. Me këto masa mendojmë se gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm do të përmirësojmë shumë racën e bagëtive.

Për vendin tonë ka qenë dhe është problem i madh edhe çështja e pyllëzimeve, sepse pyjet u shkaterruan sidomos gjatë luftës, prandaj Komiteti Qendror ka marrë një vendim të veçantë për këtë sektor dhe tani po punohet në fshatarësi dhe në popull që të zgjidhim problemet mirë edhe në këtë sektor.

Pasuri e madhe është për vendin tonë frutikultura. Shumë pemë frutore mund të rriten fare mirë te ne. Prandaj Partia dhe Qeveria vjetët e kaluar e sidomos në pesëvjeçarin e ardhshëm punojnë që të zhvillohet në një shkallë akoma më të gjerë frutikultura, si për nevojat e brendshme ashtu edhe për ek-sportimin e agrumeve, të rrushit, të pjeshkëve, të mollëve etj. Në planin e ardhshëm parashikojmë të ndërtojmë fabrika për të prodhuar verëra, lëngje frutash etj.

Masat që janë marrë kanë bërë që situata ekonomike e vendit tonë dhe mirëqenia materiale e kulturore e popullit të ngrihen vazhdimisht. Tani populli ynë është më i veshur dhe ushqehet më mirë se përpara, janë ndërtuar më shumë shtëpi banimi dhe shkolla janë hapur nga të katër anët e vendit. Rëndësi të madhe i kemi vënë arsimit në fshat. Shkolla fillore ka gati në të gjitha fshatrat dhe 7-vjeçaret janë përhapur shumë. Në këto shkolla ne kemi futur në program pjesë që kanë të bëjnë me bujqësinë për t'i lidhur më mirë të rinjtë fshatarë me jetën e fshatit. Shkolla të mesme kemi të paktën nga dy nëpër qytete, përveç shkollave profesionale që edhe këto janë shtuar shumë. Duhet të drejtojmë të rinjtë dhe të rejat e fshatit që të mbarojnë sa më shumë shkollat e mesme bujqësore.

Në të njëjtën kohë është zgjeruar shumë rrjeti i kinemave dhe i teatrove, nga të cilat përpara nuk ka pasur fare. Është krijuar Teatri i Operës dhe i Baletit etj. Përpara, vajzat, në disa krahina, po edhe nëpër qytete, nuk dilnin fare për punë po rrinin mbyllur

në shtëpi, kurse tani nuk ekziston fanatizëm në këtë drejtim.

Por, natyrisht, nuk mund të themi se në vendin tonë është krijuar «parajsa», kemi akoma të meta dhe dobësi në punë, kemi pika të dobëta si në furnizimin e popullit, në çështjet e bujqësisë që nuk po na ecën si duhet, në drejtim të strehimit të punonjësve etj.

Po populli ynë është i lidhur shumë ngushtë me Partinë, ai e ka kuptuar si duhet vijën e saj të drejtë, i shikon përpjekjet e saj të mëdha nëpërmjet realizimeve konkrete të tanishme, e shikon me besim të ardhshmen dhe është i bindur e i sigurtë se nën udhëheqjen e Partisë ai do t'i realizojë planet dhe do ta përmirësojë më tej jetesën. Ky besim i popullit ka shumë rëndësi, ai është një kapital shumë i madh për Partinë.

### Mbi përbërjen dhe shtrirjen e Partisë

Suksesi dhe fitorja më e madhe e popullit tonë është fakti që ai ka Partinë e tij marksiste-leniniste, të fortë nga pikëpamja ideologjike, politike dhe organizative. Në Partinë tonë ka një unitet të çeliktë, luftohet në kohë e me ashpërsi çdo sëmundje që mund të lindë, me qëllim që kurrë të mos zërë vend ideologjia e huaj armiqësore e revisioniste në Partinë tonë.

Partia jonë është mësuar të mbrojë me vendosmëri parimet e marksizëm-leninizmit dhe mund të themi se nuk ka bërë dhe nuk do të bëjë lëshime në mbrojtjen e këtyre parimeve.

Aktualisht Partia jonë numëron afër 52 000 vetë. Në tetor 1959 kishte 48 000 anëtarë dhe afër 4 000 kandidatë për anëtarë partie. Partia jonë bën përpjekje që kandidatët të mos kalojnë shumë kohë si stazhierë po të edukohen brenda kohës së parashikuar nga Statuti dhe të bëhen të aftë për të kryer detyrat e anëtarit të Partisë.

74,1 për qind e anëtarëve të Partisë në vitin 1952 qenë me origjinë nga shtresat e varfëra, prej të cilëve 11,5 për qind punëtorë. Kjo tregon sa e vogël ka qenë klasa punëtore në vendin tonë në të kaluarën. Nga shtresat e mesme në përbërjen sociale të Partisë qenë 22,02 për qind dhe nga të pasurat 3,3 për qind e efektivit të përgjithshëm. Duhet pasur parasysh se këta të fundit kanë bërë të tërë Luftën Nacionalçlirimtare, që nga fillimi e deri në fund.

Kurse gjendja aktuale shoqërore në Parti është ndryshe. Punëtorët tani zënë 25,5 për qind të efektivit të përgjithshëm, fshatarët 27,9 për qind, nga të cilët 21,4 për qind anëtarë të kooperativave bujqësore, në-punës 41 për qind, anëtarë të kooperativave të artizanatit 2,4 për qind dhe të ndryshëm 1,6 për qind. Duke parë këto ndryshime mendojmë se gjendja shoqërore e Partisë sonë është përmirësuar.

Partinë e kemi të shtrirë në këtë mënyrë: 28 organizata partie rrëthesh, të cilat varen direkt nga Komiteti Qendror e që përfshijnë 3 423 organizata-bazë.

Në sektorët ekonomikë ne kemi 439 organizata-bazë, në bujqësinë socialiste — 1 384, në ato të administratës, të arsimit e të kulturës — 669 e këshiu edhe në sektorë të tjera.

Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe i kandidatëve të Partisë në terren më 1959, 60,6 për qind e tyre punojnë në prodhim dhe 36,1 për qind në administratë, 0,7 për qind janë studentë dhe nxënës në shkolla, 0,9 për qind janë invalidë të luftës dhe 1,7 për qind gra shtëpiake.

Punëtorë e nëpunës në të gjithë Republikën kemi gjithsejt 186 000, anëtarë të organizatës së Bashkimeve Profesionale rrëth 136 000, nga të cilët mbi 100 000 janë punëtorë.

Në të gjithë Republikën kemi 4 064 organizata rinnie, efektivi i përgjithshëm i të cilave arrin në 180 402 veta. Organizata e BRPSH është një nga levat kryesore të Partisë. Ne kemi një organizatë rinnie shumë të shëndoshë dhe patriote, të lidhur ngushtë me Partinë dhe që lufton, nën udhëheqjen e Partisë, për edukimin e pandërprerë të anëtarëve të saj me normat e moralit komunist.

Arsimi marksist-leninist dhe shtetëror i komunisteve më 1 Janar 1959 ishte i tillë: Nga i gjithë efektivi i Partisë kanë kryer shkolla dhe kurse partie 11 057 veta ose 21 për qind e efektivit, 45 për qind ndiqnin format e arsimit të Partisë.

Partia në kongreset dhe në plenumet e Komitetit Qendror u ka vënë rëndësi të madhe çështjeve ideologjike. Gati të gjithë sekretarët e parë të komiteteve të Partisë në rrethe, shumica e sekretarëve të dytë dhe shumë punonjës të aparatit të KQ të Partisë kanë mbaruar Shkollën e Lartë të Partisë. Brenda disa vjetëve ne mendojmë që të gjithë kuadrot e aparatit të KQ të Partisë dhe një numër i madh instruktorësh partie në

komitetet e Partisë në rrethe të kenë mbaruar Shkollën «V. I. Lenin» të Partisë sonë. Përveç eksperiencës që kanë në drejtimin praktik të çështjeve, shokët që kanë mbaruar shkolla partie kanë marrë detyrë që të mbarojnë edhe shkolla të larta ekonomike, kurse kryetarëve të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve u kemi rekomanduar të mbarojnë institutet e larta ekonomike dhe kurse teorike të Partisë. Kështu punon Partia jonë në drejtim të krijimit të një udhëheqjeje jo vetëm të vëndosur për çështjen e Partisë, po edhe të ngritur nga ana teorike dhe profesionale.

Në Shkollën tonë të Partisë «V. I. Lenin» kanë mbaruar 336 veta, ndërsa tani vazhdojnë 230 të tjera. Në kursin njëvjeçar të Shkollës së Partisë kanë mbaruar 936 dhe vazhdojnë 138. Kurset 2 dhe 4-vjeçare me korrespondencë i kanë mbaruar 335 komunistë dhe i ndjekin 400 të tjera.

Në arsimin e Partisë marrin pjesë rreth 30 000 veta, nga të cilët 60 për qind janë komunistë dhe 40 për qind pa parti. Format e edukimit marksist-leninist janë shkollat politike, rrethet e studimit të lëvizjes punëtore ndërkombëtare, të historisë së Partisë Komuniste të BS, të ekonomisë politike e konkrete, si të organizimit të kooperativave bujqësore, të ndërmarrjeve industriale etj.

Përsa i përket arsimit shtetëror, ne në Parti kemi disa analfabetë. Ata janë pleq, gjithsejt 145 veta, po njerëz që kanë luftuar. Dinë shkrim e këndim rreth 9 200 veta, me fillore rreth 21 000 veta, me 7-vjeçare rreth 12 000 veta, me shkolla të mesme profesionale

rreth 800, me të mesme të përgjithshme rreth 3 000 veta dhe me arsim të lartë 1 200 veta.

Sikurse e shikoni nga ana e kulturës ne jemi akoma prapa, por në këtë drejtim po bëjmë përpjekje të mëdha dhe komunistët veçanërisht kanë vullnet të madh për të mësuar. Tani janë krijuar kushte të tillë që ata mund të mësojnë dhe në fakt po mësojnë dhe në shembullin e tyre po mëson i gjithë populli shqiptar. Kështu sot te ne në çdo 6 veta një mëson.

Ngritja e kuadrove të tillë besnikë të Partisë bën që të forcohet çdo ditë e më shumë gjendja ekonomike dhe politike e vendit tonë. Situata politike aktuale në RP të Shqipërisë është shumë e fortë dhe e shëndoshë. Te ne për çdo problem që na preokupon mobilizohet gjithë Partia e populli dhe luftojmë me vendosmëri për të mos lejuar në radhët tona asnje sëmundje politike ose ideologjike.

Më falni se ju lodhëm, shoku Aidit, por sigurisht në një bisedë s'mund të thuhen dot të gjitha e ju mund të keni nevojë për ndonjë sqarim. Këtu është edhe shoku Mehmet, janë edhe shokë të tjera të Byrosë Politike e të Qeverisë, ndaj në rast se ju dëshironi të sqaroheni për disa gjëra të tjera ne jemi gati t'jua plotësojmë dëshirën, se duam të dimë për njëri-tjetrin sa më shumë, të mirat edhe dobësitë, me qëllim që të ndihmojmë njëri-tjetrin. Prandaj po të keni nevojë për pyetje dhe sqarime ne jemi gati t'jua japim.

Me këtë rast ju urojmë të rroni sa malet e Shqipërisë dhe të udhëhiqni kurdoherë drejt KQ të Partisë së lavdishme Komuniste të Indonezisë!

Përsa i përket projektdeklaratës ne mendojmë se është një dokument me rëndësi që do t'i gjëzojë shumë komunistët dhe popullin shqiptar. Tani, po të jemi dakord, ne mund ta shtypim definitivisht dhe propozojmë që nesër të caktojmë një orë për nënshkrimin zyrtar të saj.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të marrë me stenogram që gjendet në AQP*

# **NE DO TË MOBILIZOJMË TË GJITHA ENERGJITË DHE BURIMET E BRENDSHIME PËR ZHILLIMIN E MËTEJSIËM TË BUJQËSISE SOCIALISTE**

*Nga fjala në mbledhjen e Moskës të përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore të vendeve socialiste të Europës për çështjet e zhvillimit të bujqësisë*

**2 shkurt 1960**

Të dashur shokë,

Gjatë 15 vjetëve të ekzistencës së pushtetit populor në Shqipëri, populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë së tij të Punës, ka punuar me të gjitha energjitet për zhvillimin e bujqësisë në rrugën socialiste.

Më lejoni t'ju paraqit shkurtimisht gjendjen e bujqësisë së vendit tonë dhe perspektivat e zhvillimit të saj si dhe problemet që na dalin përpëra në zhvillimin e bujqësisë.

Siq dihet, para luftës Shqipëria ishte vendi më i prapambetur në Evropë, një vend agrar, gjysmëfeudal. Lufta Nacionalçlirimtare, që nga fillimi i vitit 1939 dhe deri në fund të vitit 1944, solli shkatërrime të

rënda në bujqësinë tonë. Ne nuk trashëguam nga e kaluara pothuajse asnë traktor, asnë makinë bujqësore; shumica e pyjeve, një pjesë e madhe e pemëve frutore dhe më shumë se një e treta e blegtorisë u shkatërruan nga lufta.

Menjëherë pas Çlirimtë dë vendosjes së pushtetit popullor në vendin tonë, Partia dhe Qeveria morën nasa serioze për rimëkëmbjen e bujqësisë së shkatërruar nga lufta. Reforma agrare që ne bëmë gjatë periudhës 1945-1946, i dha tokën fshatarit dhe përmbysi marrëdhëniet feudale në prodhim që ekzistonin më parë në fshatin tonë. Me gjithë vështirësitë ekonomike kolosale që ne kishim atëherë, shteti u kujdes në mënyrë të posaçme për t'i ardhur në ndihmë fshatarësise me të gjitha mjitet e mundshme: me kredi, me farëra të zgjedhura, me kafshë race etj. Qysh në vitin 1946 u ngritën të parat kooperativa bujqësore në vendin tonë.

Duhet thënë se në periudhën e parë, pas Çlirimtë, neve na është dashur të kapërcenim vështirësi kolosale të krijuara nga shkatërrimet e lustës dhe nga armiqtë e Partisë e të pushtetit tonë popullor, të brendshëm e të jashtëm, dhe këto vështirësi e penguan shumë në atë periudhë zhvillimin e ekonomisë sonë popullore e veçanërisht bujqësinë.

Partia dhe Qeveria jonë e kanë pasur kurdoherë të qartë se e vëtmja rrugë e drejtë për ndërtimin e socializmit në fshat, është rruga leniniste e kooperimit të ekonomive bujqësore, në bazë të parimit leninist të bindjes dhe të vullnetit të lirë të fshatarit. Partia jonë punoi shumë për t'i bindur fshatarët që të viheshin në rrugën e kolektivizmit. Vërtet ne ngritëm kooperativat

e para bujqësore që në vitin 1946, por deri në vitin 1956 kemi ecur me hapa shumë të matur dhe kështu ia arritëm plotësisht qëllimit: të bindim fshatarësinë për epërsinë e ekonomisë kolektive mbi atë individuale. Pas Kongresit III të Partisë, që u mbajt në maj të vitit 1956, filloi në masë kolktivizimi i bujqësisë. Detyrën që caktoi Kongresi në lidhje me kolktivizimin e bujqësisë, ne e realizuam qysh në vitin 1959, dome-thënë një vit para afatit. Sot rrëth tre të katërtat e numrit të fshatrave të Republikës, ose më tepër se 70 për qind e ekonomive fshatare me më tepër se 82 pér qind të sipërfaqeve të mbjella, janë futur në kooperativat bujqësore, e vetmja formë e kooperimit të fshatarësisë në vendin tonë. Kështu, ne mund të themi se kolktivizimi i bujqësisë në Shqipëri, në përgjithësi ka marrë fund, pasi ato ekonomi që akoma nuk janë kolktivizuar, janë në vende malore dhe ne mendojmë që ato të mbeten, pér një kohë, ashtu siç janë, sepse nuk kanë bazën materiale.

Ndërsa në vitin 1938 sipërfaqja nën kulturë në Shqipëri ishte 327 mijë ha, duke përfshirë këtu edhe 35 mijë ha mbjellje të dyta, në vitin 1960 ajo është rrëth 611 mijë ha, duke përfshirë këtu edhe mbi 100 mijë ha mbjellje të dyta. Kjo është 87 pér qind më shumë se në vitin 1938. Në vitin 1959 vëllimi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor ishte 106 pér qind më i madh se në vitin 1938, kurse në vitin 1960 plani parashikon që të jetë 33 pér qind më i madh se në vitin 1959 osc 173 pér qind më i madh se në vitin 1938. Në vitin 1959 prodhimi i drithërave të bukës arriti në 203 pér qind, në krahasim me vitin 1938, prodhimi i

duhanit u rrit 6 herë, i pambukut — 131 herë, i përimeve — 3 herë etj. Megjithëse më tepër se një e tre-ta e blegtorisë u asgjësua nga lufta, sot numri i kërëve të të gjitha llojeve të bagëtive është më i madh se ai i para luftës, dhe vëllimi i përgjithshëm i prodhimit blegtoral ka një peshë specifike prej rreth 30 për qind kundrejt vëllimit të përgjithshëm bujqësor të Republikës. Gjithashtu, ne kemi pasur disa suksese edhe në zhvillimin e frutikulturës ku vendin kryesor e zënë ullinjtë, që prodrojnë rreth 50 për qind të sasisë së yndyrnave që konsumohen në vendin tonë.

Në periudhën 1950-1959, të ardhurat reale të fshatarësisë janë rritur rreth 50 për qind.

Këto suksese, siç shihet, nuk janë të vogla. Ne, natyrisht, nuk kënaqemi me kaq dhe do të punojmë me të gjitha forcat që të arrijmë suksese edhe më të mëdha. Këto suksese janë arritur në saje të punës vetëmohuase të fshatarësisë sonë punonjëse. Por, shokë, neve na është dashur të kapërcejjmë vështirësi shumë të mëdha në punën tonë dhe një pjesë e madhe e këtyre vështirësive ekzistojnë edhe sot.

Në vitin 1950 ne kishim vetëm 55 agronomë të lartë, ose 1 agronom për çdo 7 800 ha tokë, kurse sot kemi 285 agronomë ose 1 agronom të lartë për çdo 1 900 ha tokë të mbjellë. Në vitin 1950 ne kishim 1 veteriner ose zooteknik të lartë për çdo 96 mijë kërë gjedhe dhe bagëti të holla, ndërsa sot kemi 1 për çdo 22 mijë kërë. Siç e shihni, problemi i kuadrit është problem shumë i madh te ne, por ne kemi marrë dhe do të marrim masa për ta zgjidhur këtë, se zgjidhja e tij varet vetëm nga ne.

Ne sot kemi rrëth 4 000 traktorë të kthyer në 15 kuaj fuqi. Por kjo fuqi motorike tërheqëse është krijuar në këta vjetët e fundit, sepse deri në vitin 1955 na është dashur që si fuqi tërheqëse të përdornim pothuajse vetëm qetë. Mjafton të themi se në vitin 1950 ne kishim vetëm 359 traktorë të kthyer në 15 kuaj fuqi. Por ndërsa në vitin 1938 ne kishim rrëth 98 000 pendë qé, që përbënин një fuqi tërheqëse afërsisht të barabartë me 108 500 kuaj fuqi dhe që shërbenin për të punuar vetëm 300 mijë ha tokë, në vitin 1960 ne kemi rrëth 4 000 traktorë të kthyer në 15 kuaj fuqi dhe 72 000 pendë qé dhe kjo fuqi tërheqëse duhet të punojë 611 mijë ha tokë. Po t'i llogaritim edhe pendët e qeve në kuaj fuqi, del se për çdo njësi tërheqëse prej 15 kuajsh fuqi në vitin 1938 kishim 45 ha, kurse në vitin 1960 na takon të kemi 66 ha. Siç e shihni, fuqia tërheqëse në raport me sipërsaqen e tokës së punuar sot është shumë më e vogël se në vitin 1938. Nga këto shifra mund të kuptojmë se ç'pengesë e madhe është bërë për ne mungesa e fuqisë tërheqëse në bujqësi dhe se ç'përpjekje kolosale bën fshatarësia jonë për të realizuar planin e bujqësisë për të arritur që në vitin 1960 sipërsaqja nën kulturë të jetë 87 për qind më tepër se në vitin 1938 dhe vëllimi i përgjithshëm bujqësor — 173 për qind më tepër.

Sot në kooperativat tonë bujqësore çdo krahu pune i takon mesatarisht 1,3 ha. tokë e mbjellë, por ka edhe rrethe të tëra ku për çdo krahu pune ka edhe 4-6 ha. Duhet theksuar se me procesin e zhvillimit të shpejtë të industrisë, një pjesë e mirë e fuqisë punëtore do të largohet nga fshati për në qytet. Ky proces

ka kohë që ka filluar dhe do të vazhdojë. Këtej kuptohet rëndësia e dorës së parë që ka zgjerimi në shkallë të gjerë i mëkanizimit të bujqësisë së sonë. Bujqësia jonë ka kushtë që të jetë një bujqësi intensive, ku të merren 2 prodhime brenda një viti bujqësor. Por kjo kërkon, përveç të tjerave, edhe zëvendësimin e punës së qeve nga traktori në tokat e rrëfshta dhe kodrinore, kudo ku mund të punojë traktori.

Dihet se përdorimi i plehrave kimike në shkallë të gjerë, është kusht i domosdoshëm për një bujqësi intensive, për rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore. Si vend me fuqi ekonomike të vogël, ne nuk kemi mundur që të sigurojmë për bujqësinë tonë as sasinë minimale në plëhra kimike. Sasia më e madhe e plehrave kimike që ne kemi importuar deri sot ka qenë në vitin 1958 31 mijë tonë, sasi kjo afersisht e pamjaf-tueshme as për kulturat industriale, pa bërë fjalë këtu për përdorimin e plehut kimik për grurin, për misrin, për ullirin etj.

Vendi ynë ka klimë mesdhetare. Por kjo klimë ka anë pozitive dhe negative. Te ne mund të rritet gruri, misri, duhani, pambuku, panxhari i sheqerit, ulliri, agrumet, vreshtat etj. Ne kemi një temperaturë mesatare vjetore prej rrëth  $17^{\circ}\text{C}$ . Klima jonë lejon të merren dy prodhime në vit, të ketë ushqim të gjelbër për blektorinë edhe gjatë dimrit, domatet mund të piqen rrëth 20 ditë më herët se në Bullgari dhe te ne mund të gjesh rrush të freskët edhe në fund të nëntorit e domate më vonë se në çdo vend tjetër të demokracisë populllore. Kjo është ana pozitive e klimës sonë.

Por karakteristika kryesore e kësaj klime është

shpörndarja jo e barabartë e rreshjeve. Te ne bie mesatarisht 1 400 mm shi dhe ka zonë ku bie edhe gjër në 2 000 mm shi në vit. Por kjo sasi rreshjesh e godet bujqësinë tonë në fazat më kritike, gjatë pranverës dhe vjeshtës, tamam në kohën kur bëhen mbjelljet. Në këtë mënyrë, mbjelljet e pranverës vazhdojnë shumë gjatë; si rrjedhim bimët e pranverës piqen shumë vonë në vjeshtë dhe mbjelljet e vjeshtës pengohen jashtëzakonisht shumë. Veç kësaj, si rregull, me të mbaruar shirat në pranverë, fillon menjëherë thatësira dhe vazhdon edhe dy, tre dhe deri katër muaj pa rënë asnjë pikë shi. Si rrjedhim i shirave të vonshme të pranverës dhe të mungesës së fuqisë tërheqëse, mbjellja e misrit te ne vazhdon 70-80 ditë, e pambukut — 50-60 ditë dhe e duhanit — 30-40 ditë, korrijet e të lashtave vazhdojnë 60-70 ditë dhe mbjelljet e vjeshtës zgjaten deri nga mesi i dhjetorit. Kjo është ana negative e klimës sonë.

Ujërat e shumta që formohen në zonat malore nga dëbora dhe nga shiu rrjedhin e grumbullohen në fushat bregdetare që janë hambari ynë. Prandaj një nga problemet më të mëdha të bujqësisë sonë ka qenë dhe është kullimi i tokave, sikurse edhe problemi i sigurimit të ujit përvaditje në kohën e thatë të verës. Për këtë qëllim shteti ka bërë investime të mëdha në bujqësi. Ne kemi investuar disa miliard lekë deri sot dhe do të investojmë edhe më shumë në të ardhshmen përkullimin dhe përujiten e tokave. Vetëm gërmime dhei përhapjen e kanaleve kulluese kryesore, deri në vitin 1959, janë kryer në masën rreth 34 milion  $m^3$ . Por shumica e kësaj pune, është bërë pa asnjë mehani-

zim, me krahë, nga ana e fshatarësisë. Mjafton të themi se në vitin 1956 ne kishim më pak se 30 ekskavatorë dhe vetëm nga fundi i vitit 1958 mundëm të importonim nga Bashkimi Sovjetik mbi 100 ekskavatorë të tjerë. Por edhe sot mekanizimi i këtyre punimeve nuk është i plotë dhe ne kemi qenë të detyruar që të aprovonim ligjin, me anën e të cilit fshatarësia detyrohet të bëjë me krahët e saj 25 për qind të gërmimeve të dheut në veprat e mëdha të bonifikimit, pa llogaritur këtu kanalizimet e vogla, që ajo i bën krejtësisht vetë, pjesëmarrjen e saj në pyllëzimet etj.

Si rezultat i punës në bonifikimet, deri sot ne kemi përmirësuar 65 mijë ha toka dhe kemi përfituar edhe 17 mijë ha. toka të reja. Ndërsa në vitin 1938 kishte vetëm rrëth 29 000 ha toka nën ujë, në vitin 1960 do të ujiten 135 000 ha ose 27 pér qind e sipërfaqes së mbjellë.

Prodhimi i drithërave të bukës në vitin 1959 ka qenë 2 herë më i madh se në vitin 1938, por megjithatë ne asnjëherë nuk i kemi plotësuar nevojat për bukë me prodhimin e vendit dhe na është dashur të importojmë vazhdimesht 40-50 mijë tonë drithëra buke çdo vit, pa mundur të krijojmë ndonjë rezervë shtetërore për bukën dhe duke e përdorur bukën me shumë kursime. NB-të punojnë me rentabilitet dhe japin rrëth 18 pér qind të të gjithë sasisë së drithërave të bukës që grumbullon shteti. Në qoftë se në vitin 1938 shteti grumbullonte 10 pér qind të prodhimit të drithërave të fshatarësisë, në vitin 1960 ne do të grumbullojmë 24 pér qind të prodhimit të drithërave të bukës të fshatarësisë dhe, megjithatë, na duhet të

importojmë dhjetëra mijëra tonë grurë për të përballuar nevojat. Kurse rritja e produkteve blegtoreale nuk i përgjigjet rritjes së populsisë.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria kanë hartuar shifrat kryesore të planit të tretë pesëvjeçar të zhvillimit të bujqësisë për periudhën 1961-1965.

Në vitin 1965, sipërfaqet nën kulturë do të arrijnë në 740 mijë ha, duke përfshirë këtu edhe 140 mijë ha mbjellje të dyta, ose 41 për qind më shumë se në vitin 1959. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor në vitin 1965 do të jetë 80 për qind më i madh se në vitin 1959. Në vitin 1965 prodhimi i drithërave të bukës do të jetë 53 për qind më shumë se në vitin 1959, duke arritur në 16 kv për ha rendimenti i grurit dhe në 18 kv për ha rendimenti i misrit. Gjithashtu, në vitin 1965, prodhimi i pambukut do të jetë 78 për qind, prodhimi i duhanit — 52 për qind dhe prodhimi i panxharit të sheqerit — 65 për qind më shumë se në vitin 1959. Gjithsejt kulturat drunore në vitin 1965 do të arrijnë në më shumë se 80 mijë ha, nga të cilat 17 mijë ha vreshta, 32 mijë ha pemë frutore, 25 mijë ha ullishta, mbi 3 mijë ha agrume etj. Prodhimi i mishit në pesëvjeçarin e tretë do të rritet rrëth 57 për qind dhe prodhimi i qumshtit rrëth 72 për qind.

Të ardhurat reale të fshatarësise në pesëvjeçarin e tretë parashikohet të rriten 28 për qind.

Këto janë, shokë, shkurtimisht, rezultatet e punës sonë në bujqësi, perspektiva e afërt e zhvillimit të bujqësisë sonë dhe vështirësitë tona objektive kryesore. Sukseset që kemi arritur deri sot në zhvillimin e bujqësisë e kanë përmirësuar gjendjen materiale të masave

punonjëse në krahasim me të kaluarën dhe kanë ndihmuar për zhvillimin e të gjithë ekonomisë populllore.

Asnjëherë Partia dhe Qeveria janë nuk janë përkultur dhe nuk janë zmbrapsur përpëra vështirësive, qofshin këto subjektive apo objektive, të cilat kanë penguar zhvillimin e ekonomisë populllore të vendit tonë. Ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet, siç kemi bërë në mënyrë konskuente deri sot, do të mobili zojmë të gjitha energjitet tona dhe burimet tona të brendshme për të realizuar me sukses planin e zhvillimit të bujqësisë sonë, për të kapërcyer të gjitha vështirësitë subjektive. Por ne e ndiejmë për detyrë që të shtrojmë këtu sot përpëra jush disa kërkesa të rëndësishme, plotësimi i të cilave ka rëndësi jetike për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë e të ekonomisë sonë populllore dhe për ngritjen e nivelit të jetesës së mësave tona punonjëse.

Së pari, *mbi mekanizimin e bujqësisë sonë*. Sikurse thamë më lart, ne kemi shumë më pak fuqi tërheqëse sot sesa kishim në vitin 1938, në raport me sipërsaqet e mbjella. Karakteristikat negative të klimës sonë të mirë kërkojnë mekanizimin maksimal të bujqësisë, në mënyrë që të shkurtohen afatet e mbjelljeve të pranverës dhe të vjeshtës, si dhe afatet e korrijeve. Veç kësaj, duhet theksuar se struktura e tokës sonë është shumë e rëndë. Për të kuptuar këtë, mjafton të përmendim se asnjë traktor DT-54 nuk punon me plugun e tij të fabrikës prej 5 veshësh. Një traktor DT-54 te ne, në plugimet e para punon zakonisht me plugun me 3 dhe e shumta me 4 veshë, kurse plugun me 5 veshë mund ta tërheqë vetëm traktori S-80, i cili, në kushtet

e Bashkimit Sovjetik, tërheq 2 plugje të tilla. Ne detyrohem i përdorim traktoret edhe në tokat kodrinore ku, në vend të traktorit DT-54, përdoret vetëm traktori S-80 dhe S-100 dhe ky vetëm me plugun me 1 vesh; ky traktor lart shkon bosh e vetëm kur zbrët poshtë plugon.

Për ta bërë bujqësinë tonë intensive, ne duhet të arrijmë të bëjmë plugime të thella, për bimët prashitëse — deri në 40 cm dhe për të lashtat — deri në 35 cm. Zgjerimi i sipërsaqeve të reja te ne do të bëhet kryesisht nga shpyllëzimet dhe kjo kërkon traktorë të rëndë. Toka jonë sot për sot nuk është e sistemuar, ka shumë gjerdhe, ledhe, hendeqe të panevojshme, të cilat e ulin rendimentin e punës së traktorit dhe likuidimi i të cilave kërkon fuqi tërheqëse suplementare. Përveç shtimit të numrit të traktorëve, neve na duhet të shtojmë importin e veglave të këmbimit për mekanikën bujqësore, sepse deri sot traktoret tanë kanë punuar vetëm me gjysmën e normës së veglave të këmbimit që përdoren në Bashkinin Sovjetik dhe, njëkohësisht, të forcojnë bazën e remontit të mekanikës bujqësore.

Siq thamë, sot ne kemi rrëth 4 000 traktorë të kthyer në 15 kuaj fuqi. Në bazë të përllogaritjeve tona, duke u bazuar në kushtet konkrete të vendit, del se, për ta arritur mekanizimin e plotë të punimeve të gjithë sipërsaqes ku mund të punojë traktori, do të duhet që ne të kemi rrëth 12 000 traktorë të kthyer në 15 kuaj fuqi bashkë me aggregatet dhe me makinat e tjera përkatëse të punimeve bujqësore.

Për të arritur këtë shkallë të domosdoshme të me-

kanizimit të bujqësisë, na duhet të importojmë në periudhën 1960-1965 rreth 8 000<sup>1</sup> traktorë të kthyer në 15 kuaj fuqi bashkë me aggregatet dhe me makinat e tjera përkatëse bujqësore, si dhe me pajisjet për krijimin e bazës së remontit të makinerisë bujqësore e me sasinë e nevojshme të veglave të këmbimit. Kjo është nevoja jonë për mekanizimin e bujqësisë.

Së dyti, *mbi sigurimin e sasisë së nevojshme të plehrave kimike*. Për rritjen e rendimenteve të prodhimeve bujqësore në pesëvjeçarin e tretë është e nevojshme që ne të importojmë një sasi minimale plehrash kimike. Për këtë ne duhet të importojmë gjatë këtyre gjashtë vjetëve rreth 350 mijë tonë pleh kimik, që vlerësohet në rreth 95 milion rubla. Do të ishte mirë që Komiteti Qendror dhe qeveria e Bashkimit Sovjetik si dhe Komiteti Qendror dhe qeveria e Çekoslovakisë të avancojnë dërgimin e pajisjeve për ndërtimin në Shqipëri të fabrikës së plehrave azotike nga Bashkimi Sovjetik dhe të plehrave fosfatike nga republika çekoslovakake<sup>2</sup>, në mënyrë që këto objekte të mbarojnë së ndërtuar brenda vitit 1964.

Së treti, *mbi eksportin e produkteve bujqësore të Shqipërisë*. Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria janë duke e rishqyrtuar planin e tretë pesëvjeçar për t'i dhënë një drejtim më të mirë bujqësisë sonë, për të zhvilluar në radhë të parë ato kultura që janë të

<sup>1</sup> Pas bllokadës që krijuan revizionistët sovjetikë dhe pasuesit e tyre, që nga viti 1960, kjo shifër nuk u arrit plotësisht.

<sup>2</sup> Shpejtimi i ndërtimit të këtyre dy veprave u sabotua nga ana e revizionistëve sovjetikë e çekoslovakë. Ato u ndërtuan nga populli ynë me ndihmën e Republikës Popullore të Kinës.

leverdisshme si për vendin tonë, ashtu edhe për vendet e kampit socialist. Në kemi mundësi të prodhojmë dhe të eksportojmë duhan, perime të hershme dhe të vona, fruta të freskëta si pjeshkë etj., agrume, ullinj. Në pesëvjeçarin e ardhshëm ne mendojmë që frutikulturën dhe vreshtat t'i zhvillojmë pa prekur tokat e bukës, ndërsa zgjerimi i agrumeve dhe i perimeve kërkon shkurtimin e tokave të bukës dhe kjo shkakton një deficit në fondin e drithërave të bukës. Në vitin 1965, për shembull, ne mund të eksportonim rreth 50 mijë tonë perime të freskëta, rreth 8 mijë tonë fruta të freskëta etj. Po të realizohet plani i mbjelljeve të agrumeve, pas 7-8 vjetësh ne mund të eksportonim mbi 25 mijë tonë agrume në vit etj.

Në lidhje me këtë dalin dy probleme: problemi i transportit të perimeve dhe të frutave të freskëta dhe problemi i sigurimit të fidaneve të agrumeve me cilësi të lartë nga vendet e Perëndimit. Prandaj ne do t'u propozonim vendeve që kanë interes të importojnë perime dhe fruta të freskëta nga Shqipëria, të diskutojnë me ne posaçërisht, të përllogaritim mundësitë dhe nevojat dhe të lidhim kontrata me afat të gjatë në interesin e të dy palëve. Ne jemi për koordinimin e bujqësisë midis vendeve socialiste.

Shokë, ne jemi të porositur nga Komiteti Qendror i Partisë sonë që, me këtë rast, të deklarojmë se edhe në të ardhshmen do të vëmë të gjitha forcat për ta çuar Shqipërinë përpëra edhe në lëmin e bujqësisë sociale, që po lulëzon gjithnjë e më shumë në rrugën e mësimeve të marksizëm-leninizmit.

Në zhvillimin e Shqipërisë, vendet fqinje, sidomos vendet e Lindjes së Afërme dhe të Afrikës së Veriut, shohin forcën e socializmit, shohin se çfarë mund të bëjë socializmi për të mirën e popujve. Populli dhe Partia janë janë të vendosur deri në fund të derdhin të gjitha energjitetë e tyre për ta mbajtur lart flamurin e socializmit edhe në këtë drejtim.

*Botohet për herë të parë si-  
pas originalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## EDUKIMI I FËMIJËVE — DETYRË E TË GJITHËVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

16 shkurt 1960

Komiteti i Partisë duhet të ketë iniciativë dhe të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që janë krijuar për edukimin e pionierëve. Sot, nuk kemi kudo shtëpi pionieri dhe shtëpi kulture. Prandaj në shkolla, për shembull, të shfrytëzohet sa të jetë e mundur edhe ndonjë dhomë. Atje ku nuk ka shtëpi pionieri, organizata e rinisë të ketë kujdes shumë të madh për fëmijët, në mënyrë që ata të mos mbeten rrugëve.

Edukimi i fëmijëve është detyrë e të gjithëve, prandaj të gjithë duhet të kujdesemi për ta. Për edukimin dhe për veshmbathjen e tyre kujdesin kryesor duhet ta tregojë nëna, për këtë është e domosdoshme që organizata e gruas t'i mësojë ato që t'i mbajnë fëmijët të pastër dhe të veshur mirë. Natyrisht, për fë-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim relacioni i paraqitur nga aparati i KQ «Mbi mirërritjen dhc edukimin e fëmijëve».

mijët ka detyra edhe babai, por, sado i kulturuar që të jetë ky, nuk mund të interesohet sa nëna. Një kujdes të veçantë duhet të tregojë organizata e gruas edhe për konsultoret e grave, të cilat, bashkë me institucionet e tjera kryesore, të ndihmojnë për mirërritjen dhe për edukimin e fëmijëve.

Propozimet që u bënë lidhur me pagesën e çerdheve dhe kuotën e ushqimit, të studjohen mirë dhe t'i paraqiten Byrosë Politike për shqyrtim. Lidhur me çerdhet duhet të kemi një kuptim më të drejtë. Te ne nuk mund të ketë çerdhe për të gjithë fëmijët. Ne kemi bërë e do të bëjmë edhe në të ardhshmen çerdhe dhe kopshte për fëmijët, por, në kushtet e sotme, nuk kemi mundësi që çdo ndërmarrje të ketë çerdhen e saj. Kjo nuk është arritur akoma në vende më të zhvilluar nga pikëpamja ekonomike. Prandaj të sqarohen ato qendra pune që kërkojnë çerdhe, se aktualisht nuk mund të plotësohen kërkesat e tyre. Është e vërtetë që gratë, për të hyrë në punë, kërkojnë që shteti më parë t'u sigurojë fëmijët në çerdhe, por, në gjendjen që jemi, ato duhet të kuptojnë drejt vështirësitë që po kalojmë, prandaj duhet të bëjnë edhe vetë përpjekje. Ndërsa, ndërmarrjet që kanë në plan ngritjen e çerdhes dhe nuk interesohen, të detyrohen t'i çelin.

Përsa u përket mensave në shkolla, kjo të shikohet me prindërit dhe me Ministrinë e Arsimit. Atje ku ka mundësi, le të çelen mensa. Ne mund të vëmë në dispozicion dhomën, tavolinat si dhe mësuesin që do të kujdeset, ndërsa ushqimin ta sigurojnë vetë prindërit, në mënyrë që fëmijët të mos rrinë rrugëve.

Në përfundim, theksoj që organizata e rinisë dhe

shkolla të interesohen më shumë për pionierët dhe fatosat. Të shikohet si mund të përmirësohet më tepër puna e udhëheqësve të pionierëve, e shtabeve të tyre dhe të rritet më shumë interesimi i arsimtarëve për edukimin jashtëshkollor në përgjithësi. Në vendimin që do të dalë nga kjo mbledhje të pasqyrohen edhe disa detyra për organizatat-bazë të Partisë të shkollave, të cilat të vënë si duhet në lëvizje të gjitha levat për edukimin e fëmijëve, sidomos organizatën e rinisë, që është ngarkuar nga Partia të merrct drejtpërdrejt me organizatën e pionierit.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## MË SHUMË INTERESIM PËR PRANIMET NË PARTI

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH*

16 shkurt 1960

Ju duhet t'i keni mirë parasysh çështjet që ngrihen në këtë raport, sidomos pranimin e elementeve të rinj në Parti<sup>1</sup>. Në kushtet e rrethit tuaj, ku shumica e popullsisë përbëhet nga fshatarë, një rëndësi të veçantë duhet t'i kushton shtimit të radhëve të Partisë me njerëzit më të mirë të fshatit. Ju i keni të gjitha mundësitë që, pa lënë pas dore pranimin e punëtorëve atje ku ka të tillë, të sillni në Parti gjak të ri nga fshati, sidomos në ato fshatra ku ka pak komunistë ose ku terreni ka shumë nevojë. Natyrisht, zgjedhja e elementit duhet bërë me kujdes. Dhe të tillë ka në Përmet, djem e vajza, që janë rritur gjatë vjetëve të

---

<sup>1</sup> I drejtohet sekretarit të parë të KP të Rrethit të Përmetit, që ishte i pranishëm në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH, ku shqyrtohet raporti i paraqitur nga aparati i Komitetit Qendror mbi disa çështje organizative të Partisë në këtë rreth

pushtetit popullor. Prandaj mos u qëndroni shabllon orientimeve të dhëna, në mënyrë që Partia të forcohet, sidomos atje ku influenca dhe roli i saj udhëheqës nuk janë në lartësinë e duhur.

Në rrëthin tuaj ka anëtarë partie që janë përjashtuar për faje të ndryshme, por që s'janë armiq, prandaj të gjeni forma të përshtatshme punc, në mënyrë që t'i mbani afër Partisë. Ka prej tyre që kanë dhënë prova me fakte se janë përmirësuar. Në këto raste, çështja mund të shikohet dhe ata që meritojnë, të pranohen përsëri në Parti. Natyrisht nuk është fjala për komunistë të përjashtuar për shkaqe politike dhe për biografi jo të pastër, por për ata që mund të janë përjashtuar, për shembull, se nuk kanë hyrë në kooperativën bujqësore kur ajo është ngritur në fshatin e tyre, ose nuk kanë shkuar në punë atje ku u është bërë thirrje etj., e që në fakt janë elementë të mirë. Këtë çështje mund ta shqyrtoni sidomos në ato krahina ku keni pak komunistë dhe që të përjashtuarit nga Partia njihen si elementë të mirë. Mendoj se edhe shokët e tjerë të Sekretariatit janë dakord që për këtë çështje të mos tregoheni shumë sektarë.

Sikundër e ka theksuar edhe herë të tjera Byroja Politike, ju duhet t'i vini rëndësi të madhe gjallërimit të jetës së organizatës-bazë, rritjes së rolit pararojë të komunistëve. Në mënyrë të veçantë të kujdeseni për edukimin marksist-leninist dhe politik të komunistëve. Kjo është nga detyrat e dorës së parë. Shokët që kanë bërë edhe Shkollën e Partisë është e domosdoshme ta kuptojnë mirë e të veprojnë me seriozitet për ngritjen e nivelit ideologjik të komunistëve dhe në përgjithësi

për edukimin politik të masave. Përmeti është një rrëth kufitar, populli ka qenë i lidhur me Luftën Nacionalçlirimtare, por në ndonjë fshat ka pasur edhe influencë të bejlerëve dhe të armiqve. Prandaj, përvëç punës ideo-politike frontale që zhvillohet me masat, duhet zhvilluar edhe një punë e dendur, e diferencuar me njërejt, sipas kushteve konkrete të terrenit.

Unë këto pak fjalë kisha për të thënë. Rezultatet që janë arritur në rrëthin e Përmetit janë meritë e punës së Partisë dhe e udhëheqjes së saj në rrëth, prandaj edhe më mirë të punoni në të ardhshmen.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verballi i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

# **SA MË MIRE TË PUNOJNË E TË MËSOJNË GRATË, AQ MË SHPEJT DO TË LULEZOJË SHQIPERIA**

*Fjala në takimin me një grup grash të dalluara  
të vendit tonë me rastin e 50-vjetorit të  
Ditës Ndërkombëtare të Gruas*

**9 mars 1960**

Të gjitha shoqet që ishin mbrëmë në mbledhjen solemne kushtuar 50-vjetorit të 8 Marsit, Ditës së solidaritetit ndërkombëtar të grave, sigurisht nuk ndodhen në këtë takim. Këtu ndodhet vetëm një pjesë e tyre, por që përfaqëson më së miri masat e grave të të gjithë vendit tonë. Duke përsituar nga ky rast, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, unë dua t'ju përrshëndes nga zemra edhe njëherë ju dhe nëpërmjet jush të gjitha gratë e Shqipërisë, me rastin e 8 Marsit, festës suaj të madhe, festës ndërkombëtare të gruas! Këtë ditë nuk e festoni vetëm ju, mëma dhe motra shqiptare, por e festojnë të gjitha gratë e botës, si një datë që ka një rëndësi të madhe në luftën që bëjnë ato kudo në botë për të drejtat e tyre dhe për mbrojtjen e paqes.

Kjo ka një rëndësi të madhe, sepse gratë gjatë shekujve kanë punuar, janë robtuar, siç thotë populli, dhe kanë luftuar, por asnjëherë ato nuk kanë mundur të siguronin të drejtat që u takonin si të gjithë njerëzve, nuk kanë mundur të siguronin ato të drejta që gjëzonin edhe burrat. Por të tilla ishin rrethanat, burri sundonte mbi gruan nga pikëpamja ekonomike, shoqërore e kulturore. Fër t'ia arritur kësaj, klasat shëtypëse kishin si armë edhe fënë. Duhet kupluar mirë se seja ishte jo vetëm opium për të vënë në gjumë popullin, por ajo kishte krijuar për gruan një situatë shumë të vështirë. Feudalëve dhe kapitalistëve u vinte për mbarë ta përdornin atë për të shtypur popujt, veçanërisht gruan.

Vendi ynë i kapërcju vështirësitë e para dhe më hapa të sigurtë e të guximshëm tanë po ecën në rrugën e ndërtimit të socializmit, që do të thotë një jetë më e mirë, kulturë më e lartë për të gjithë njerëzit dhe të drejta të barabarta midis burrit dhe gruas.

Në të kaluarën, gratë e vendit tonë kanë qenë luftëtare, trime dhe të guximshme, ato kanë luftuar vazhdimesh për t'u çliruar nga shfrytëzimi dhe nga robëria e huaj. Fërpjekjet e popullit tonë në të kaluarën për t'u çliruar nga të huajt nuk mund të kuptohen pa kontributin e madh edhe të grave të vendit tonë, ndonëse burrat janë përpjekur ta marrin mbi vete tërë lavdinë për këtë të kaluar. Ndihma e madhe e grave duhet llogaritur në gjithë bilancin e luftës së popullit tonë për liri e pavarësi, në bilancin e luftës së bërrë që në kohët më të lashta dhe më vonë nga Çerçiz Topulli, Themistokli Gërmjeni, Mihal Grameno dhe shumë patriotë të tjera.

Në të kaluarën, dhe veçanërisht gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, kanë luftuar heroikisht edhe gratë. Me këtë nuk dua të përmend këtu vetëm gratë heroike partizane që morën armët dhe dolën në mal duke u vënë kështu në pararojë të çështjes së çlirimit të atdheut; një kontribut të madh dhanë gratë edhe në prapavija, duke qëndruar me vendosmëri, duke ruajtur bazat, komunistët, partizanët dhe duke ndihmuar me ushqime, veshmbathje etj. Kështu, pra, ndihma egrave të Shqipërisë për çlirimin e atdheut ka qenë e madhe.

Luftha jonë Nacionalçlirimtare, e preqatitur nga Partia, u mbështet në traditat e larta patriotike të popullit tonë, tradita jo vetëm luftarake, por edhe tradita të mëdha përpjekjesh për mësim e për dituri. Të parët tanë, gjyshërit dhe gjyshet tona, mëmat dhe ballarët tanë, nuk kanë qenë aq të paditur dhe të pakulturuar sa mund të mendojnë disa. Ata kanë qenë njerëz me virtute dhe me cilësi të larta morale. Natyrisht, ata nuk kishin bërë shumë shkollë, por kishin një zgjuarsi të madhe të fituar nga jeta, se luftërat, përpjekjet dhe mundimet ua kishin imprehur mendjen. Të tilla kanë qenë gratë e vendit tonë, në mes të masës së gjerë të të cilave ka pasur edhe gra të kulturuara. Natyrisht, ato ishin të pakta, por edhe burrat e ditur atëherë ishin shumë të paktë.

Megjithëse zhvillimi i kulturës në vendin tonë ishte penguar shumë nga regjimet feudoborgjeze, nga gjiri i popullit tonë kanë dalë njerëz të shquar të artit e të kulturës, poetë, filozofë, historianë, inxhinierë dhe aktorë të mëdhenj, që shumë herë kanë qenë autoritete edhe në vende të tjera të botës.

Përhapja e diturisë në vendin tonë u pengua sepse regjimet feudale u përpoqën ta mbanin popullin në errësirë, për ta shtypur e për ta shfrytëzuar më shumë e më lehtë. Por me gjithë kushtet e vështira të asaj kohe, edhe Shqipëria ka pasur zhvillimin e saj kultural. Nga gjiri i popullit tonë kanë dalë njerëz përparimtarë, që kanë luftuar jo vetëm me armë në dorë, por edhe me penë, dhe kanë kontribuar shumë për të arritur ditët që jetojmë ne sot. Midis tyre ka pasur edhe shumë gra që punuan për hapjen e shkollave shqipe, ku mësuan djemtë dhe vajzat e popullit për t'u bërë patriotë dhe edukatorë të brezave të ardhshëm dhe për të përhapur edhe në masat e grave të vendit tonë shkrimin dhe këndimin, kulturën dhe arsimin, si arma e parë që do t'i hapte femrës shqiptare rrugën e kulturës dhe të shkencës.

Këto gra, së bashku me burrat, ne duhet t'i konsiderojmë si pionieret e kulturës sonë. Sigurisht, tani është shumë më lehtë të bëhesh mësuese, është shumë më lehtë të mbushen shkollat me vajza. Le të mos shkojmë shumë larg, 25-30 vjet më parë një punë e tillë ishte shumë e vështirë, sepse sundonin prapambetja, fanatizmi dhe gjithfarë paragjykimesh. Mësueset që kanë punuar atëherë në shkolla dhe kanë mësuar gratë dhe vajzat e Shqipërisë, kanë një meritë shumë të madhe, sepse kanë luftuar kundër errësirës, paragjykimeve dhe fesë; ato kanë vuajtur shumë në ato kohë për të kryer këtë detyrë të shenjtë ndaj popullit. Nga shkollat ku kanë punuar ato, kanë dalë mjaft gra të përparuara. Efekti i punës së tyre është ndier në Shqipëri, pavarësisht se Zogu, bejlerët dhe agallarët

përpiqeshin të pengonin ngritjen kulturore, jo vetëm të grave, por edhe të burrave. Përpjekja e mësueseve të vjetra për të përhapur arsimin në vajzat e vendit tonë, është një vepër e lavdishme. Partia dhe populli ynë nuk do t'ua harrojnë kurrë kontributin e dhënë për të mirën e atdheut e të popullit.

Ka akoma fakte nga historia e vendit tonë që nuk janë studjuar me hollësi, për të vënë në dukje si duhet veprën e pionierëve e të pioniereve që punuan dhe luftuan për lirinë dhe pavarësinë e atdheut dhe për zhvillimin e kulturës e të arsimit në vendin tonë. Me kohë këto çështje do të studjohen dhe secila do të marrë vendin që meriton. Me plot të drejtë Presidiumi i Ku-vendit Popullor dekoroi tani disa nga këto pioniere, arsimtare e patriote të vjetra dhe pjesëmarrëse të Luftës Nacionalçlirimtare, përveç shumë patriotave të tjera të dekoruara më parë.

Në saje të luftës heroike që bëri populli ynë, i udhëhequr nga Partia e Punës, kohët ndryshuan. Për të gjithë është e qartë, mëma dhe motra të dashura, se Shqipëria nuk mund të çlirohet, se ne do të rronim në robëri të rëndë, po të mos ishte Partia. Pa Partinë jeta e popullit tonë nuk mund të përmirësohet vazhdimesht dhe nuk mund të ndërtohet socializmi dhe komunizmi. Pa ekzistencën dhe udhëheqjen e saj, sot nuk mund të kishte një Shqipëri që të respektohej nga të gjithë popujt e botës. Shqipëria nuk është më plaçkë tregu për imperialistët. Ajo ka sot miq popujt e kampit socialist si dhe të gjithë popujt e tjerë përparimtarë të botës. Të gjitha këto popullit tonë ia siguroi vetëm Partia.

Prandaj me të drejtë populli shqiptar e do me gjithë zemër dhe do ta dojë në shekuj Partinë e tij. Ai punon që ajo të jetë një parti marksiste-leniniste, e papërkulur përpara armiqve të popullit, përpara armiqve të marksizëm-leninizmit, një parti që mbron dhe do të mbrojë përjetë lirinë dhe pavarësinë e popullit të vet. Partia është shumë e shtrenjtë për burrat dhe për gratë e vendit tonë, për të rinxjtë dhe për të rejet, për gjithë popullin tonë. Në saje të udhëheqjes së saj të drcjtë, të mobilizimit të masave punonjëse dhc faktit që ajo ditit t'i japë hov të madh lëvizjes së gjerë të emancipimit të gruas, brenda 15 vjetëve Shqipëria jonç e re ka ndryshuar shumë.

Duhet kuptuar nga të gjithë se sukseset që ka arritur vendi ynë i detyrohen jo vetëm punës së palodhur të burrave, por edhe punës heroike të grave tona. Këto ditë, duke lexuar në gazetë një artikull kushtuar mësueses së vjetër Urani Rumbo, mësova se ajo me të drcjtë thoshte që «zogu nuk mund të fluturojë me një krah». Kështu edhe vendi ynë nuk mund të përparojë pa i kushtuar kujdes dhe rëndësi të madhe edhc përparimit të grave. Mësucsja e zgjuar shqiptare ka folur drejt për këtë çështje. Në të vërtetë Partia jonë i ka dhënë rëndësi shumë të madhe zhvillimit dhe përparimit të gruas; qëllimi i saj është që gratë e vendit tonë të ngrihen në një nivel me burrat. Dihet që tani gratë në verdin tonë i gëzojnë të gjitha të drejtat, por Partia kërkon që ato të inkurajohen në të gjithë sektorët e jetës, që të bëhen po aq të afta dhe të zonjat sa edhe burrat. Ky është një qëllim i madh i Partisë sonë. Po në ç'mënyrë do t'i arrihet këtij qëllimi?

Kjo do të arrihet, në radhë të parë, me pjesëmarrjen e gjerë të grave në ndërtimin e socializmit, në punët e arsimit e të kulturës etj. Arsimi dhe kultura kanë për qëllim t'i zhvillojnë njerëzit, t'ua bëjnë jetën më të bukur. Pojeta zbukurohet e bëhet më e begatshme kryesisht me punë. Duke punuar zhvillohen aftësitë e njeriut, mjeshtëria dhe zotësia e duarve, zhvillohet edhe intelctti i tij. Me punë krijohet bollëku. Prandaj kryesorja është që gratë të marrin pjesë gjerrësisht në të gjitha punët e vendit tonë, jo vetëm në administratë, por edhe në prodhim, pasi është e dobishme për shoqërinë, krijohet një gjendje tjetër në psikologjinë e njeriut, krijohet gjëzimi dhe lumturia.

Grave një gjë e tillë nuk u lejohej para çlirimt. Kjo nuk do të thotë se më parë gruaja në vendin tonë nuk ka punuar, ajo më parë ka punuar, kryesisht në shtëpi, kurse tani janë hapur të gjitha dyert që gratë e Shqipërisë të punojnë kudo. Dhe me të vërtetë tani shumë gra punojnë në bujqësi, në industri, në administratë, në arsim, në shëndetësi etj.

Partia e di se shumica e grave në vendin tonë punojnë shumë mirë, ndonëse bëjnë një punë të dysfishtë, sepse pas punës, ato punojnë mjaft edhe në shtëpi. Në qoftë se burrat te ne nuk janë mësuar akoma të ndihmojnë gratë në punët e shtëpisë, ata duhet të kenë, të paktën, më shumë respekt për to. Çdo burrë duhet të mendojë se gruaja e tij, pasi punon në fabrikë, në zyrë ose në arë, kthehet në shtëpi bën bukë e gjellë, kujdeset përfëmijët, lan rrobat, fshin e rregullon shtëpinë etj. Burri, duke i vlerësuar kështu sakrificat që bën gruaja, do të ketë më shumë respekt për të e do

të luftojë për të zhdukur pikëpamjet e vjetra se gruaja ka lindur vetëm për të punuar, dhe do ta ndihmojë atë konkretisht.

Për gruan ne duhet të kemi respektin më të madh, sepse ajo përtërin jetën. Ne kërkojmë që punonjësit të kenë kujdes të madh për ruajtjen e makinave, të kenë kujdes për tokën, sepse ato na sigurojnë të mirat materiale, me të cilat plotësojmë nevojat tona të përditshme. Por në qoftë se duhet të kemi një herë respekt dhe kujdes për to, për gruan kujdesi dhe respekti duhet të jetë njëqind herë më i madh, sepse ajo lind fëmijët, sepse pa të nuk ka jetë.

Te ne nëna respektohet kudo. Partia jonë i dënon ata pak njerëz që sillen keq me nënrat dhe gratë e tyre. Nëna është nënë, ajo të ka bërë kokën, ajo mund të ketë dhe disa huqe, mund të jetë edhe ca e sertë, por duhet ta durosh. Në rast se nëna nuk shkon mirë me gruan tënde, ti duhet ta sqaresh me urtësi. Ti duhet të punosh, të punosh veçanërisht me gruan që është e re dhe të sigurosh harmoni në familje. Si burrat, ashtu edhe nënrat, gratë dhe gjithë shoqëria jonë duhet të luftojnë për një familje të shëndoshë socialiste plot harmoni. Po të shihet kështu çështja, do të ndryshojë krejtësisht edhe psikologjia në familje. Në këtë drejtim, veçanërisht burri duhet të hedhë poshtë mbeturinat e së kaluarës, duhet të ndryshojë qëndrimin ndaj gruas.

Tani, mëma dhe motra të dashura, janë hapur të gjitha dyert për gratë, janë krijuar mundësítë që ato të marrin pjesë në shkallë të gjerë në ndërtimin e vendit, për të mirën e tyre, të familjes së tyre dhe për të mirën e gjithë popullit shqiptar. Sigurisht, ne kemi

akoma vështirësi. Kjo do të thotë se te ne nuk janë krijuar akoma të gjitha kushtet e duhura për nënët që punojnë, por çdo vit ju shihni se ato po përmirësohen vazhdimesht dhe po bëjnë të mundur që një numër gjithnjë e më i madh grash të punojnë.

Gratë kanë besim në të ardhshmen dhe e dinë se gradualisht gjithçka do të përmirësohet. Ato kanë besim të plotë se do të kenë shtëpi më të mira e më të gjera, do të kenë më shumë kopshte e çerdhe përfëmijët e tyre, do të kenë edhe ushqim e veshmbathje më shumë. Ato kanë besim të plotë, se janë vetë luftëtare të socializmit dhe i njojin mirë sukseset e mëdha të arritura jo lehtë në vendin tonë gjatë këtyre 15 vjetëve. Ngritja e ekonomisë sonë u bë me vështirësi, duke marrë parasysh sidomos bazën nga jemi nisur ne, që nuk trashëguam asgjë nga e kaluara. Prandaj, gratë tona e kuptojnë se çdo gjë nuk mund të jetë e përsosur, nuk mund të arrihet menjëherë dhe pa përpjekje e mobilizim të madh në punë.

Megjithatë, janë të gjitha mundësitë që në të ardhshmen të bëjmë hapa akoma më të mëdhenj e më të shpejtë përpara, sepse tani ekonomia jonë ka hedhur baza të shëndosha. Këtë bindje e kanë të gjithë dhe kjo ka bazë reale.

Kjo kërkon që edhe gruaja të marrë pjesë gjerësisht në këtë luftë të madhe, që është akoma më e vështirë se Lufta Nacionalçlirimtare. Në këtë luftë të re do të dalin shumë njerëz të shquar ashtu siç dolën gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Por ata që morën pjesë në luftë nuk duhet të flenë mbi dafinat e saj, të kënaqen vetëm me luftën që bënë, dhe të mendojnë se

duhet të gjëzojnë vëtëm të drejta në shoqërinë tonë socialiste, pa kryer edhe detyrat aktuale. Dekoratat që kemi marrë për luftën që bëmë, sigurisht, kanë një vlerë shumë të madhe. Njerëzit që kanë luftuar për lirinë e Shqipërisë populli i respekton, i nderon, por Partia na mëson të jemi konsekuentë, që gjithë jetën forcat tona mendore e fizike t'i vëmë në shërbim të popullit; edhe tani në luftën e re për ndërtimin e socializmit, luftëtarët e vjetër të janë në ballë, ashtu sikurse ishin edhe në Luftën Nacionalçirimitare. Prandaj njerëzit e luftës duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet që të mos mbeten prapa nga koha. Shumë nga luftëtarët e rinj për ndërtimin e socializmit mund të mos kenë marrë pjesë në luftë, sepse disa kanë qenë fëmijë, disa s'patën kurajën e nevojshme, të tjerë s'patën perspektivën e qartë e të tjera, por sot punojnë me të gjitha forcat për lulëzimin e Shqipërisë socialiste. Le të marrim si shembull Budo Isufin, i cili nuk ka marrë pjesë në Luftën Nacionalçirimitare; sot ai është një nga traktoristët më të lavdishëm të vendit tonë, që punon për llogari të vitit 1964, duke realizuar kështu çdo vit dy plane vjetore. Me traktorin e tij, heroi Budo Isufi, ka bërë deri tani 8 000 hektarë dhe është zotuar të punojë me të, pa revizionim të përgjithshëm, 12 mijë hektarë, duke i siguruar shtetit kështu kursime të mëdha. Sot, sipas shembullit të tij, po punojnë me qindra traktoristë të tjerë të vendit tonë. Pra, a nuk është ky me plot të drejtë një hero i luftës së madhe të ndërtimit të socializmit, ashtu siç janë edhe heroinat Sadie Rexhepi, Vita Ikonomi e shumë e shumë të tjera që respektohen nga populli ynë aq

sa respektohen edhe trimat e Luftës sonë Nacionalçlirimtare?

Nëna dhe motra, në përpjekjet tuaja për të ecur përpara Partia do t'ju mbështetë, ashtu sikurse ju ka mbështetur deri tani. Por edhe ju duhet të tregohëni të forta përpara vështirësive, të mos u bëni lëshime atyre që, në një mënyrë ose në një tjetër, shkelin vijën e Partisë. Dhe gjëra të tilla ka. Për shembull, në fshat gruaja çshtë një forcë e madhe dhe është konstatuar se atje gratë punojnë shumë mirë. Ka në malësi koooperativa bujqësore që mbahen vetëm me punën e grave, sepse burrat për shkak se kooperativat janë të vogla dhe malore, shkojnë e punojnë në ndërmarrjet shtetërore. Mirëpo ka edhe njerëz të Partisë me imbeturina të së kaluarës, që, duke menduar se vetëm burrat janë në gjendje të drejtojnë, nuk zbatojnë si duhet direktivat e Partisë në lidhje me ngritjen e njerëzve të aftë në përgjegjësi, e sidomos të gruas. Në këto kooperativa bujqësore ka skuadra plot me gra të afta dhe megjithëkëtë në krye të tyre vënë nga një burri. Ky akull duhet thyer dhe ka filluar të thyhet. Por në rast se disa njerëz me koncepte të vjetra, qofshin këta edhe anëtarë partie, por të paformuar, nuk i inkurajojnë gratë, ato nuk do të mund t'i vënë të tëra energjitet e tyre të mëdha në shërbim të popullit. Prandaj në këtë drejtim duhet që të luftojnë edhe vetë gratë.

Më ka rënë rasti të shoh dhe të dëgjoj që në mjaft kooperativa bujqësore, ku gratë punojnë shumë mirë, i kanë ngritur si brigadiere, anëtarë të kryesive ose në vende të tjera me përgjegjësi. Por ka kryetarë kooperativash që nuk kanë besim në aftësitë drejtuese të

gruas, që mundohën të ngjallin te ato mosbesim dhe bille t'i dekurajojnë, duke u përsëritur shumë herë shprehje të tilla si: «do ta bëni këtë punë?», «shikoni se keni përgjegjësi!» etj.

Sikur në këto kooperativa të futeshin në Parti 3-4 gra nga më të mirat, sikur në kryesinë e kooperativës bujqësore dhe në këshillin e fshatit të zgjidheshin më shumë gra, ato me siguri do t'i mobilizonin të gjitha gratë e fshatit, do t'i inkurajonin ato në punë, do t'i impononin organizatës-bazë e kryesisë mendimet e tyre të drejta dhe do t'i detyronin të zbatonin drejt vijën e Partisë. Kështu do të gjejnë vendin të gjithë ata njerëz me parti ose pa parti që nuk e kuptojnë ose nuk duan ta kuptojnë vijën e Partisë lidhur me forcën e madhe të grave. Ndaj komunistëve që nuk duan të kuptojnë vijën e Partisë lidhur me gruan, organizata-bazë të mbajë qëndrim, sepse Partia nuk mund të lejojë që gratë apo burrat, kur punojnë me heroizëm, të mos marrin vendin që meritojnë. Ata që punojnë mirë duhet të zënë vendin e merituar.

Por në këtë çështje nuk mjafton vetëm lufta që do të bëjë Partia. Këtë luftë duhet ta mbështetni edhe ju, mëma dhe motra, sepse në këtë rrugë hasen plot vështirësi, qofshin ato subjektive apo objektive.

Tregohet se si një udhëheqës i një kryengritjeje fshatare u thye në luftën kundër feudalëve dhe i lodhur e i dëshpëruar u shtri përtokë. Ai vuri re aty afër një milingonë që kishte marrë gjahun e saj të rëndë dhe përpiquej ta ngjiste në të përpjetë, por, pasi arrinte në një farë vendi, rrokullisej; ajo me këmbëngulje e vazhdoi këtë përpjekje të dëshpëruar disa herë me radhë.

Më së fundi, e kaloi të përpjetën bashkë me barrën. Udhëheqësi fshatar, i frymëzuar nga shembulli i milingonës së vogël, mori guxim dhe me të gjitha forcat që kishte sulmoi mbi kështjellën e feudalit dhe e mori atë. Me këtë dua të them të mos tërhiqemi përpara vështirësive, po të luftojmë me këmbëngulje, ashtu siç na mëson Partia, derisa t'ia arrijmë qëllimit.

Në këtë drejtëm juve ju ndihmon shumë edhe vendimi i fundit i Komitetit Qendror të Partisë për punën me gruan. Vija e Partisë për punën me gruan është përpunuar që në fillim, por vendimi i fundit mbi këtë çështje është një tjetër armë që do t'i ndihmojë gratë e vendit tonë të bëhen luftëtare më aktive për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Ky vendim i shërben gjithashtu Partisë sonë që t'i japë një hov akoma më të madh punës me gruan. Prandaj çdo grua në vendin tonë ta ketë parasysh këtë vendim të Partisë dhe të luftojë me vendosmëri përzbatimin e tij..

Një punë e madhe duhet të bëhet për forcimin e organizatës suaj. Kjo do të thotë që veprimitaria e saj të arrijë deri në skajin më të largët të vendit tonë, deri në vatrën e çdo shtëpie. Ne kemi nevojë për organizatën e gruas edhe për shumë vjet, derisa gruaja shqiptare të ketë arritur atë nivel ideologjik, kulturor dhe arsimor që e kërkon ndërtimi i shoqërisë socialiste dhe që e dëshiron Partia. Organizata e gruas le të shërbejë pëngritjen politike të grave dhe për nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në punë.

Aktiviteti i Bashkimit të Grave të Shqipërisë është një shembull i qartë për shumë organizata të grave të

vendeve që porsa kanë fituar lirinë e pavarësinë e tyre kombëtare, ai është një shembull i mirë veçanërisht për gratë e vendeve koloniale e gjysmëkoloniale, si dhe për vende të tjera. Shembulli i organizatës suaj u shërben edhe vendeve më të përparuara, pasi edhe ato kanë nevojë për një punë sistematike politike dhe të organizuar mirë me gratë. Rrobat, thotë një fjalë e vjetër, nuk e bëjnë priftin. Që të jetë prift ai duhet të dijë edhe të psallë. Mjaft gra në Perëndim mund të vishen më bukur, por botëkuptimi i tyre politik është shumë i ngushtë.

Gratë heroike të vendit tonë duhet të bëjnë përpjekje të mëdha që të arrijnë akoma më shumë suksese edhe përsa i përket arsimit. Duke filluar që pas Çlirimt, qindra e mijëra gra dhe vajza kanë mbaruar shkolla dhe kurse, por pjesëmarrja e femrave në shkolla nuk është akoma në atë nivel që e kërkon Partia, megjithëse është bërë një revolucion i tërë në këtë drejtim.

Një punë e madhe është zhvilluar në vendin tonë kundër analfabetizmit dhe në këtë çështje janë arritur suksese të mëdha. Por mjaft gra, që kryen me sukses kurset kundër analfabetizmit, ngaqë nuk bënë përpjekje të mëtejshme, tanjani janë kthyer në gjysmanalfabete. Ato duhet të bëjnë përpjekje për të mësuar dhe kanë mundësi të ecin akoma përpara. Partia u rekomandon mëmave që vajzat e tyre, të cilat kanë kryer shkollën fillore, t'i dërgojnë të mbarojnë 7-vjeçaren, ndërsa ato që kanë kryer shkollën 7-vjeçare t'i dërgojnë të mbarojnë shkollat e mesme ose teknikumet që të mos mbeten pa kulturë ose pa profesion. Shumë kanë

vuajtur mëmat dhe motrat tona, që ishin pa kulturë dhe pa arsim. Prandaj ato le të mendojnë tani më mirë për të ardhshmen e fëmijëve të tyre, sidomos për vajzat, sepse në kohën e tanishme nuk mund të ecet pa dituri, pa shkencë. Sot është epoka e shkencës dhe e atomit.

Imperialistët përpinqen që energjinë atomike ta përdorin për luftë, për asgjësimin e njerëzimit e për shkatërrimin e vlerave materiale e kulturore, që me aq mundim i ka krijuar njerëzimi gjatë shekujve. Kurse energjia atomike mund të përdoret për të mirën e njerëzimit, në të gjithë sektorët e jetës së shoqërisë, për të prodhuar më shumë të mira materiale për njerëzit, për të zhdukur sëmundjet, për të zbuluar të fshehtat e kozmosit dhe jo për të prodhuar bomba për zhdukjen e njerëzve.

Ne duhet të luftojmë me të gjitha forcat tona për mbrojtjen e paqes dhe askush të mos mendojë se mjaf-ton për këtë çështje vetëm fakti që ne jemi një vend i demokracisë popullore. Është e vërtetë se ne jemi një vend socialist, dhe politika e vendit tonë është politikë paqësore, por kjo nuk është e mjaftueshme. Në këtë çështje kaq fisniqe për gjithë njerëzimin, ku një rol të madh luajnë edhe gratë, ne duhet të vëmë të gjitha forcat tona. Gratë e vendit tonë mund të bëjnë shumë për të demaskuar të gjithë ata që përkrahin luftën dhe përpinqen të futin njerëzimin në një luftë të re.

Për të mbrojtur çështjen e paqes, duhet të pregatitemi kundër luftës. Për këtë duhet të punojmë me të gjitha mundësitë që të jemi kurdoherë e në çdo drejtim më të fortë nga armiqjtë e paqes. Por që të jemi

më të fortë duhet të punojmë për të forcuar pozitat politike e ekonomike të vendit tonë. Propaganda jonë për paqen do të bëjë efektin e saj kur të gjithë burrat dhe gratë e vendit tonë, kudo që janë, të punojnë me të gjitha forcat dhe të jasin maksimumin e rendimentit të tyre në punë, që te ne të krijohet bollëku, populli të furnizohet gjithnjë e më shumë dhe të jetojë më mirë. Kjo është ndihma konkrete efektive për forcimin e paqes, kundër luftës.

Nga ana tjetër, ne duhet të tregohemi shumë vigjilëntë kundrejt çdo pune armiqësore, kundër të gjithë atyre që nuk na e duan të mirën. Të tillë ka brenda, por sidomos jashtë vendit tonë. Edhe brenda vendit ka aty-këtu njerëz që, me gjithëse me gjuhë të vogël, nxjerrin helm nga goja; por ata nuk kanë asnje sukses, në saje të punës së madhe që bën Partia, vija e së cilës përqafohet plotësisht nga populli. Forca jonë dhe vija e drejtë e Partisë kanë bërë që edhe njerëz të cilët më parë mbanin qëndrim armiqësor, tani janë bërë realistë. Ata shohin ç'po ndodh në vendin tonë dhe arsyetojnë se komunistët nuk kanë rrugë të gabuar, se komunistët kanë bërë shumë gjëra të mira dhe të mëdha për popullin. Ju e dini ose keni dëgjuar se njerëz të tillë hiqeshin si shumë të ditur e të zotë, që mund të bënin çdo gjë dhe mendonin se vetëm ata mund ta drejtonin Shqipërinë. Por sot ata e shohin se nuk kanë qenë gjë veçse një zero. 20 vjet qëndruan në fuqi këta njerëz dhe nuk bënë gjë tjetër veçse mbajtën afër xhandarët, shtypën pcpullin dhe e ropën atë me fajde, e detyruan fshatarin të punonte për ta, ndërsa vetë dridhnin zinxhirin.

Ka pasur dhe ka në vendin tonë edhe njerëz që dje lëkundeshin, por sot duan të jetojnë dhe që e kuptojnë se asnjë fitim nuk kanë pasur nga regjimet e kaluara, ndërsa sot ai që është i ndershëm dhe punon ndershmërisht, ka mundësi jo vetëm të punojë dhe të jetojë mirë, por të marrë edhe përgjegjësi, në rast se e meriton. Njerëz të tillë sot janë afruar shumë me pushtetin tonë.

Pra, politika e drejtë e Partisë e ka forcuar gjendjen e brendshme të vendit tonë, ajo sot është e çeliktë, sepse i çeliktë është uniteti i Partisë me popullin.

Por ne kemi edhe armiq të jashtëm, kundër veprimtarisë së të cilëve Partia dhe populli ynë duhet të jenë shumë vigjilentë, sepse vetëm kështu veprimitaria e tyre do të dështojë me turp, ashtu si ka dështuar deri më sot. Prandaj lufta për paqen të jetë një luftë e përditshme dhe në të gjitha drejtimet.

Vendi ynë ka perspektiva të shkëlqyera zhvillimi. Ju i jetoni vetë ndryshimet e mëdha dhe përmirësimet që po bëhen dita-ditës në Shqipëri. Jeta e popullit tonë ka ndryshuar shumë në krahasim me periudhën paraçlirimit. Populli tani jeton, vishet dhe ushqehet më mirë se më parë. Por niveli i jetesës te ne është akoma i ulët, prandaj duhet të luftojmë me të gjitha forcat që ta ngremë atë vazhdimisht. Këtë qëllim kanë planet tona ekonomike. Planet e ardhshme që po përpunon Partia do ta përmirësojnë më shumë jetën e popullit. Industria do të zgjerohet akoma më shumë gjatë planit të tretë pesëvjeçar dhe bujqësia do të bëjë një hap të madh përpara.

Industria është dhe do të jetë dega udhëheqëse e

ekonomisë sonë popullore. Në pesëvjeçarin e tretë Shqipëria do të ecë me hapa më të shpejtë në rrugën e shndërrimit nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar dhe vendi ynë do të futet kështu në radhën e vendeve të përparuara industriale. Për këtë qëllim do të zhvillohet akoma më shumë industria, sidomos ajo e minierave, e hekurit, e nikelit, e bakrit, e ferro-kromit, e naftës etj., të cilat do të janë baza e industrisë sonë të rëndë që do t'i sjellë ekonomisë sonë popullore të ardhura të mëdha.

Masa të rëndësishme do të marrë Partia për zhvilimin e mëtejshëm të bujqësisë. Kolektivizimin e bujqësisë ne po e përfundojmë. Kjo ka një rëndësi shumë të madhe për fshatarësinë, e cila e ka kuptuar se kolektivizimi është rruga më e mirë për përmirësimin e jetesës në fshat; në këtë drejtim ka mjaft përparime. Por duhet luftuar edhe më shumë për forcimin ekonomik e organizativ të kooperativave bujqësore, ku një rol më të madh duhet të luajnë gratë.

Një kujdes i madh duhet t'i kushtohet zbatimit të statutit të kooperativave bujqësore dhe urdhëresave e vendimeve të Qeverisë, sepse ato janë në interes të fshatarësë, por të mos lihet mënjanë edhe interes personal i kooperativistëve. Komunistët në fshat nuk duhet ta harrojnë këtë çështje, por edhe të kenë parasysh që interesi personal i çdo kooperativisti t'i nënshtronhet interesit të përgjithshëm. Ekipet e dërguara në fshat kanë treguar se në disa kooperativa nuk respektohet plotësia statuti i tyre dhe se te disa fshatarë ekziston ndjenja e pronës private, gjë që shfaqet edhe te mbivlerësimi i oborrit kooperativist. Mirëpo

në kooperativën bujqësore, kryesorja është prona e grupit. Po të punohet si duhet dhe sa duhet, çdo kooperativist do të ketë të ardhura shumë më të mëdha nga puna në kooperativë sesa nga oborri kooperativist. Gratë kooperativiste mund të kontribuojnë shumë për ta rdryshuar këtë gjendje, sepse ato kanë guxim e janë nga më punëtoret. Këtë nuk jua them për t'ju bërë qejfin, por është fakt që gratë dallohen për kujdesin, dhëmshurinë, ndershmërinë në punë e në jetë. Prandaj Partia të mbështetet të gratë, se ato janë një forcë e madhe.

Në të ardhshmen Partia do të punojë që kooperativave bujqësore t'u jepet më shumë ndihmë me traktorë, me plehra, me farëra të zgjedhura etj., me qëllim që të rriten më shumë rendimentet e kulturave bujqësore, d.m.th. të kemi më tepër për të ngrënë dhe për t'u veshur, të kemi më shumë shtëpi të reja, ashtu siç e dëshiron zemra juaj. Qëllimet e Partisë ne do t'i arrijmë patjetër.

Popujt e Azisë dhe të Afrikës kanë jetuar shekuj me radhë nën sundimin imperialist dhe kolonialist, që u ka pirë gjakun. Prandaj atyre në asnjë mënyrë nuk mund t'u hiqet mendimi se armiku kryesor i tyre është imperializmi aq sa mund t'i hiqet popullit tonë nga koka mendimi se armiku ynë më i madh ishte feudalizmi dhe tani është imperializmi.

Shumë vende të Azisë dhe të Afrikës kanë fituar tani lirinë dhe pavarësinë. Udhëheqja e këtyre vendeve ka burra shteti që në politikën e tyre nuk mund të mos kenë parasysh mendimin dhe vullnetin e masave të gjera të popullit që nuk është më ai i 100 vjetëve më

parë. Ato janë të vendosura kundër imperializmit dhe kolonializmit. Ato e dinë se çdo ndihmë nga ana e shteteve imperialiste, jepet vetëm me kushte të caktuara politike dhe ushtarake, sepse kapitalistët fajdexhinj nuk mund të veprojnë ndryshe. Le të marrim shembull ngajeta. Keni dëgjuar ju ndonjëherë për fajdexhi zemërbardhë? Kjo nuk mund të ndodhë. Fajdexhi nuk mund ta ndryshojë kurrë karakterin e tij. Kështu është edhe me imperializmin. Imperialistët kreditë i japin vetëm me kushte politike, ushtarake. Kjo do të thotë që në qoftë se imperializmi i jep dikujt kredi, ai duhet të lidhet me të me traktat lufte, dhe ndihma që ai merr qëndron vetëm në armë dhe në disa sende ushqimore ose veshmbathjeje, mallra të mbeturat që duan t'i shesin për të bërë tregti. Fajdexhi përpinqet të marrë sa më shumë fajde nga huaja që jep. Edhe imperialistët amerikanë kreditë e tyre i japin me përqindje të larta, 6,7 dhe 8 për qind.

Imperialistët nuk kanë asnje interes të ngrihet dhe të zhvillohet industria në vendet e porsaqiruara, pasi qëllimi i tyre është t'u shesin këtyre vendeve produktet e tyre industriale. Imperialistët gjithashtu nuk duan të zhvillohet bujqësia e vendeve të porsaqiruara ose e vendeve të tjera të varura, sepse duan që ato të shërbejnë si tregje për produktet e tyre bujqësore.

Vendi ynë është kundër luftënxitësve imperialistë, kundër revisionistëve modernë, të cilët janë armiq të betuar të komunizmit, të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Sado maska që të vënë, sado përpjekje që të bëjnë për të mbuluar

fytyrën e tyre prej revizionisti, ata nuk mund ta fshehin natyrën armiqësore kundër komunizmit.

Partia jonë ka qëndruar dhe do të qëndrojë e papërkulur kundrejt armiqve të marksizëm-leninizmit. Kjo është në interesin e Shqipërisë dhe të gjithë kampit të socializmit, prandaj duhet të jemi kurdoherë vigjilëtë ndaj dredhive dhe qëllimeve të revizionistëve, sepse këto qëllime nuk kanë ndryshuar. Vetëm taktika e tyre mund të ndryshojë. Por Partia jonë marksiste-leniniste nuk gjenjet nga këto taktika, sepse ajo ka një eksperiencë të madhe në luftën kundër armiqve të komunizmit dhe di ta luftojë e ta demaskojë veprimtarinë armiqësore të revizionistëve, në çfarëdo ngjyrë që të paraqitet ajo.

Pra, mëma dhe motra të dashura, punoni me besim të madh se një e ardhshme shumë më e mirë e pret vendin tonë; shtërngoni radhët rreth Partisë dhe luftoni me besim të madh në rrugën që ju tregon ajo, në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë, ju uroj juve, dhe nëpërmjet jush të gjitha grave të Shqipërisë, suksese të mëdha në punë dhe pjesëmarrje sa më të madhe në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së vendit tonë. Uroj që pjesëmarrja juaj në ndërtimin e socializmit të jetë akoma më e gjallë, gjithnjë më e madhe, në interes të ngritjes së mëtejshme të nivelit material dhe kulturor të popullit tonë. Ju uroj që të ecni në punë kurdoherë krah për krah me baballarët, me burrat dhe me vëllezërit tuaj. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë, edhe një herë ju këshilloj që të tregoni kujdesin më të madh për rritjen e fëmijëve, që

janë shpresa e së ardhshmes së vendit tonë. Sa më mirë të rriten dhe të edukohen fëmijët tanë me dashuri për popullin, për atdheun, për Partinë, për socializmin e me dashuri për punë e arsim, aq më shpejt do të lulëzojë dhe do të zbukurohet Shqipëria.

Të rrojë Partia jonë e lavdishme e Punës!

Rrofshin gratë punonjëse të vendit tonë dhe Organizata e Bashkimit të Grave të Shqipërisë!

*Botuar për herë të parë në  
gazeten «Zëri i popullit».  
Nr. 60 (3589), 11 mars 1960*

*Botohet sipas originalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

# TE EKONOMIZOJMË E TE SHFRYTEZOJMË MË MIRE MATERIALIN E IMPORTIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

23 mars 1960

Dëshiroj të them dy fjalë para se të fillojmë diskutimet. Ky material që i është paraqitur Byrosë Politike të hidhëron dhe të revolton. Nga raporti del se shumë shokë ministra kanë një përgjegjësi të madhe morale dhe materiale për shpërdorimin e pasurisë sonë, por nuk përjashtohet që, në këtë drejtim, nëpër administrat e ndërmarrjeve tona të ketë edhe sabotime. Çështja nuk është e thjeshtë, sepse kemi të bëjmë me materiale të konsiderueshme, me shkeljen e vijës së Partisë, të direktivave të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi mënjanimin e çrrregullimeve në importin e makinerive, të pajisjeve, të materialeve dhe të mallrave të konsumit, për vendosjen e një discipline të fortë në përcaktimin e nevojave për import, në ardhjen, në shpërndarjen dhe në përdorimin e artikujve të importit.

dhe të Qeverisë, prandaj duhet ta studjojmë mirë këtë çështje dhe të marrim masat e nevojshme, me qëllim që të mos përsëriten më dobësitë ekzistuese, të cilat kanë pasur dhe do të kenë pasoja në planin tonë. Në qoftë se nuk do të luftojmë me forcë kundër këtyre dobësive, do të vihem para vështirësive më të mëdha edhe për t'u paguar miqve kreditë që na kanë ndihmuar për zhvillimin e ekonomisë.

Nuk është puna të diskutojmë për këtë ose atë send, sepse këtu nuk është e gjithë gama e tyre. Kryesorja është të kuptohet pse është kjo gjendje, cilat janë shkaqet, ku qëndrojnë përgjegjësitet. Nuk është hera e parë që ne i shtrojmë këto probleme. Çështjen e importit, uljen e kuotave, pakësimin e devizës ne i diskutojmë pothuaj në çdo mbledhje, por fakti është se udhëzimet e Partisë në këtë fushë janë shkelur, është mashtruar Komiteti Qendror, Byroja Politike dhe Qeveria nën maskën se «këto ose ato sende janë të nevojshme, se pa to nuk mund të bëhet, se pa to nuk realizohet prodhimi» etj. Mua më duket se këtu përgjegjësia kryesore është e ministrave, të cilët duhet të japin llogari për këtë gjendje shumë të rëndë.

*Pasi u zhvilluan pyetje e diskutime, të cilat vazhduan gjithë ditën, në përfundim të kësaj pike të rendit të ditës, shoku Enver Hoxha tha:*

Të gjithë e dimë se bilancin e import-eksportit ne e bëjmë me kreditë. Eksporti ynë është ulur, sepse planet tona ekonomike nuk realizohen, por kjo është një çështje e veçantë, për të cilën sot nuk flasim dot. Në këtë mbledhje theksin e vëmë në problemet e importit. Fakti është se shumë makina dhe fabrika lihen

pa u shfrytëzuar. Ne kërkojmë kredi për naftën, por duhet të kemi parasysh se 20 për qind e kësaj kredie janë të panevojshme, janë të tepërtë. Kjo ngjet se bëhen specifikime pa menduar mirë, si rrjedhim shokët e naftës kanë gjendje hekura ose tuba për të cilat s'kanë nevojë. Në qoftë se këto kanë ardhur për naftën, atëherë nuk duhet të ndodhë që të shiten në pazar. Kur vjen nga Vlora, gjer në qafë të Koshovicës sheh tri puse, tri sonda që janë lënë atje dhe nuk përdoren. Mund të gabohem për këtë gjë, por e kam fjalën që duhet të jemi jashtëzakonisht të rreptë në përdorimin e kredive të dhëna, ndryshe do të vijë koha që do të ndodhemi ngushtë. Prandaj kreditë e dhëna nga vendet miq t'i harxhojmë drejt dhe mirë, të mos mendohet që «tani kredi kemi sigruar, prandaj të sjellim këtu mjete e makineri pa s'ka gjë se nuk i shfrytëzojmë». Këto gjëra ngjasin kur njeriu ka boll, ndërsa ne s'kemi shumë, megjithëkëtë ka mjaft makineri të sjella nga jashtë, që janë lënë pa u shfrytëzuar. Kjo nuk është e drejtë jo vetëm për ne që jemi një vend i varfër, por edhe për vende të tjera.

Të marrim çështjen e bujqësisë. Për këtë sektor na janë dhënë shumë kredi, por ne nuk duhet të nisemi nga mendimi i gabuar që të sjellim aq makineri sa t'i bëjmë stivë. Përkundrazi, kredinë ta harxhojmë me vend, të sjellim aq makineri sa kemi nevojë, shumë pjesë këmbimi të marrim masa që t'i prodhojmë vetë. Ndonjëri mund të thotë se prodhimi në vend i mjeteve të këmbimit na koston më shtrenjtë sesa kur sjellim nga jashtë, por harrohet se kur të prodhohen në seri, atëherë do të jenë më të lira. Kështu zgjidhim edhe një çështje

tjetër: sistemohen në punë edhe njerëz të tjerë, që sot, për arsyе të ndryshme, janë forcë e lirë. Ministria e Komunikacionit ka marrë masa të mira, pjesët e këmbimit ka filluar t'i sigurojë në vend. Kështu duhet të veprojë edhe Ministria e Bujqësisë, e cila përqindjen më të madhe të pjesëve të këmbimit duhet ta sigurojë vetë, në mënyrë që kredia e kërkuar të përdoret për të sjellë traktorë që ne nuk i prodhojmë dot.

Edhe hartimi i planit të importit të makinave të reja tok me pjesët e këmbimit kërkon një kujdes të veçantë. Makineritë e reja kanë afat të caktuar se kur kanë nevojë për pjesë këmbimi. Pse duhet, për shembull, që një fabrike të re t'i caktohen edhe tri torno pas? Ne mund t'u themi miqve që kur bëjmë porosinë se këtë fabrikë e duam pa ato tri torno. Ose, pse për drejtorinë e fabrikës së çimentos të ndërtohet një «pallat» i tërë, duke ngrënë kështu kreditinë e ndonjë fabrike tjetër? Këto kanë rëndësi të madhe për ekonominë tonë. Ndoshta shokët ministra ishin të papregatitur për të folur rrëth tyre, sepse diskutimet që u zhvilluan këtu nuk qenë në lartësinë e duhur, ose nuk u kanë dhënë rëndësinë e duhur këtyre çështjeve.

Miqtë tanë na japid kredi jo për sadaka. Ata kryejnë kështu një detyrë internasionaliste, që edhe ne të ndërtojmë socializmin, pra kemi ideale të përbashkëta. Por shteti ynë nuk do të falimentojë, ne duhet të kemi parasysh që borxhet miqve t'ua paguajmë.

Jam dakord të forcohet Ministria e Tregtisë dhe këto çështje që diskutojmë të shikohen mirë. Mendoj që Byroja Politike të vendosë për të krijuar një fond rezervë në klering, i cili të përdoret në momente të

caktuara, kur mund të na dalin probleme. Ky fond të përdoret nga Qeveria me autorizim të Byrosë Politike. Kuotat e importit jo të na i diktojnë dikasteret, por t'ua caktojmë ne si Byro Politike e Qeveri. Në këtë mënyrë, dikasteret do të veprojnë me ekonomi në kreditë e caktuara dhe në klering. Ato do të shfrytëzojnë si duhet kleringun dhe kreditinë e caktuar. Kur caktohen kuotat e importit nuk duhet të tërheqë kërraba dikasteriale por interes i përgjithshëm, prandaj nevojat e një ministrie duhen parë të lidhura me ato të vendit dhe çdo ministër, kur vete para Qeverisë ose Byrosë Politike, të jetë në rolin e një udhëheqësi të shtetit e të Partisë.

Forcimi i ndërgjegjes socialiste të njerëzve përbën një detyrë të madhe e të vazhdueshme për Partinë. Lidhur me këtë, unë dua të them një çështje, që duhet kuptuar mirë. Po ta analizojmë thellë problemin që diskutojmë sot, duhet të pranojmë se faji nuk është vetëm i ministrave, por edhe i komiteteve të Partisë e i organizatave-bazë. Partia nuk e ka kuptuar si duhet se gjatë këtyre 15 vjetëve që po luftojmë për ndërtimin e socializmit, krahas luftëtarëve të rinj që dalin në punë e sipër dhe ecin përrpara, ka edhe disa që mbeten prapa. Ne duhet të çmojmë njerëzit që luftojnë sot për ndërtimin e socializmit ashtu siç kemi vlerësuar Luftën Nacionalçlirimtare. Por kjo gjë nuk bëhet si duhet. Të marrim një çështje, atë të karakteristikave të kuadrit. Shpeshherë në këto karakteristika paraqitet vetëm ana politike duke thënë se «ai ka luftuar, ka këto dekorata» etj., ndërsa kur vjen çështja për punën konkrete që kryen, thuhet vetëm një fjalë. A është e drejtë kjo?

Jo, shokë, nuk është e drejtë. Ka njerëz që kanë luftuar, janë plagosur, kanë dhënë gjak për çështjen e popullit, (këto Partia duhet t'i shikojë sepse kanë të bëjnë me meritat e kaluara të kuadrit), por duhet parë edhe puna e tanishme e secilit. Kur u bë konferenca e Partisë në Vlorë, ai që dha raportin e mandateve tha se ata që marrin pjesë në konferencë mbajnë kaq dekorata të luftës, kurse heroi i punës socialiste u harrua fare. Kjo nuk është e drejtë. Stabiliteti i Partisë dhe i Qeverisë është një gjë e mirë, por ky duhet të jetë një stabilitet i fortë marksist-leninist. Në qoftë se i shikojmë çështjet në mënyrë marksiste, atëherë kur bëhen karakteristikat e kuadrit ose dikush ngrihet në përgjegjësi, nuk duhet parë vetëm ana politike, por edhe puna e tij e sotme. Pas disa vjetësh ne do të plakemi dhe ata që do të vijnë nuk do t'i kenë këto karakteristika. Unë mendoj se kjo është çështje serioze, prandaj duhet korriguar në të ardhshmen.

Në raportin që na është paraqitur thuhet se ministritë nuk janë kujdesur për çështjen e kuadrit. Shikoni kombinatin e tekstit të «Stalin» dhe uzinën «Enver», të cilat kanë vjete që realizojnë planin. Kjo ndodh pse këto ndërmarrje kanë kuadro të kualifikuar, prandaj në qoftë se dikasteret duan të zhdukin të metat në punë, është e domosdoshme të punojnë për kualifikimin e njerëzve.

Mendoj që, me të dalë nga kjo mbledhje, ministrat të krijojnë menjëherë ekipe për të stabilizuar listat e mallrave të importit, të cilat mund të ndahen në tri kolona: makinat që do të mbahen për të shfrytëzuar vetë, kur do të shfrytëzohen dhe makina që nuk nevo-

jiten. Këtyre të fundit t'u gjendet vendi. Pas kësaj, Qeveria, të krijojë një komision të rreptë dhe pastaj shoku Mehmet e di vetë se si duhet të veprojë më tej. Brenda tre muajve, t'i paraqitet një informacion Byrosë Politike. Të gjitha makineritë e tepërtë, duhet të llogariten si devizë importi duke shkurtuar kuotën që i është dhënë dikastereve. Nuk jam i mendimit që për këtë çështje të organizohen aktive nationale, por të merrin masa konkrete, siç u bisedua këtu. Mund t'u dërgohet një letër edhe organizatavc të Partisë, ku të thuhet se këto janë dobësi të mëdha, për të cilat kemi faje si ne, ashtu dhe shokët në bazë. Prandaj, kur në ndërmarrje bëhet plani për këto çështje, të dëgjohet edhe zëri i Partisë, kështu do të rritet edhe përgjegjësia e komunistëve, e organizatave-bazë.

Një çështje me rëndësi të veçantë është ajo që ngriti shoku Hysni që organet e financës dhe të bankës të ushtrojnë kontroll, gjë që më duket se nuk bëhet si duhet. Kreditë kalojnë nëpërmjet Bankës së Shtetit, atëherë del pyetja: pse ajo nuk ushtron kontroll? Kontrolli i Bankës duhet të jetë i rreptë dhe herë pas here ajo t'i paraqitë Qeverisë informacion mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë. Edhe Ministria e Financave duhet të jetë më e gjallë dhe më aktive në këtë drejtim.

Ju, shokë ministra, duhet t'ia lehtësoni punën Qeverisë dhe Byrosë Politike dhe jo të na futni në kërkessat tuaja të fryra duke na larguar nga disa probleme kapitale. Këtë ta kuptioni mirë dhe të ndihmoni si duhet Qeverinë, shokun Mehmet dhe zëvendëskryeministrat.

Disa çështje të organizimit të punës në Ministrinë e Ndërtimit dhe në portet, mendoj se duhet të shikohen nga ana e Qeverisë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

# LIDHJA E TEORISË ME PRAKTIKEN — DETYRE ME RËNDËSI E SHKOLLES SONË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

23-24 mars 1960

Edhe unë desha të shfaq disa mendime për problemin që po shqyrtojmë sot. Propozimet që u bënë këtu nga ana e shokëve mund t'i shikojë edhe një herë Ministria e Arsimit.

Unë mendoj se për këtë çështje ne duhet të nisemi vërtet nga studimi i eksperiencës së vendeve të tjera, por në radhë të parë të mbështetemi në kushtet tonë konkrete, prandaj nuk mund të themi se duhet të zbatojmë çdo gjë që shohim te të tjerët. Kështu, për shembull, për çështjen e politeknizimit të shkollës, mendoj se ne akoma nuk i kemi kushtet, pasi nuk kemi

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim studimi «Mbi perspektivat e zhvillimit të arsimit dhe mundësítë për riorganizimin e sistemit arsimor».

një industri të zhvilluar. Prandaj, sot për sot, ne duhet të marrim masa për përmirësimin e brendisë së punës mësimore-ekzaktive dhe për forcimin e lidhjes së shkollës me ndërtimin socialist të vendit.

Realizimi i këtyre detyrave ndoshta do të kërkonte që të studjohet nëse shkolla jonë mund të bëhet ose jo 12-vjeçare. Ky mendim lind për disa arsyen. Përveç argumenteve që u sollën këtu, duhet mbajtur parasysh kujdesi për ruajtjen e shëndetit të rinisë. Në një shkollë të mesme 12-vjeçare, kuptohet se nxënësit do të ngarkohen më pak. Lidhur me këtë, mendoj që të mos vendosim sot, sepse është e nevojshme që problemi të diskutohet nga kuadrot e Partisë, nga arsimtarët dhe nga populli në bazë. Veç kësaj, përpala se Byroja Politike të marrë vendim për këtë çështje, duhet të na bëhen më të qarta mundësitet tekniqe që kemi. Të na tregohet, për shembull, si do të organizohet puna praktike me klasat e ndryshme këtu në Tiranë, si do të sigurohet kuadri i nevojshëm, çështja e programeve, e teksteve, e arsimit 7 apo 8-vjeçar të detyruar, sigurimi i kontingjenteve për kategoritë e ndryshme të shkollave etj. Të gjitha këto kërkojnë një studim paraprak e pastaj të vendosim. Arsyen tjetër janë dobësitet e trashëguara edhe nga e kaluara e vetë shkollës sonë si dhe nga niveli akoma i ulët i kuadrit arsimor që punon në shkolla.

Me këtë sy mendoj se duhen parë edhe programet e shkollës sonë për forcimin e punës së saj sidomos në tri drejtime: E para në drejtim të forcimit dhe të ngritjes së nivelit teorik; e dyta, në lidhjen e teorisë me praktikën; e treta, në futjen e elementeve të

arsimit politeknik, për një njojje më të mirë me jetën, për pajisjen e nxënësve me shprehitë më të domosdoshme për punën. Këtij qëllimi do t'i shërbente, për shembull, dërgimi i nxënësve në industri ose në bujqësi, për të hapur toka të reja, për t'u njojur me jetën.

Për forcimin e programeve mësimore është e nevojshme që, duke hequr prej tyre gjërat e tepërtat, të forcohen më shumë shkencat e natyrës, matematika etj. Natyrisht, programeve të ardhshme të mos u bëhen krasitje atje ku nuk duhet. Anën teorike në fizikë, në kimi dhe në lëndët e tjera të shkencave ekzakte duhet ta ruajmë dhe të bëjmë kujdes për forcimin e lëndëve teknike dhe të shkencave të natyrës. Për këtë është e domosdoshme që të forcohet lidhja e punës teorike me praktikën, pra të forcojmë laboratorët, sepse nxënësit, përpara se të venë në praktikë, duhet të zhvillojnë punë laboratorike, me qëllim që lënda teorike të bëhet e konkretizuar dhe e kuptueshme për ta. Uzinat ose hidrocentralet, ndërmarrjet mekanike ose SMT-të duhet të konsiderohen si laboratorë në një shkallë më të gjerë. Kjo do të ishte një plus për punën laboratorike dhe për të edukuar rininë me dashuri për shkencën, për teknikën, për punën.

Mendoj se të ne nuk ka ardhur akoma koha që nxënësve të shkollës së mesme t'u japim një profesion, por qëllimi kryesor i kësaj shkolle të jetë preqitja e duhur për të vazhduar shkollën e lartë.

Duke bërë këtë reformë na vihet detyrë që, krahas shkollës së mesme të përgjithshme, të forcojmë edhe shkollat teknike dhe shkollat e ulëta profesionale.

Synimi ynë kryesor, duke bërë këtë reformë, është të forcojmë në shkolla edukatën e punës, në mënyrë që nxënësit, kur të dalin nga shkolla, të dinë të bëjnë disa punë, për shembull një copë mur etj., pra atyre t'u zërë dora për të kryer qoftë edhe disa shërbime që ka nevojë familja. Rritja e dashurisë së rinisë ndaj punës është një domosdoshmëri për shkollën tonë. Kjo nuk është një parullë teorike dhe propagandistike, por një veprimtari e gjerë praktike, që nxënësit ta duan punën që nga fillorja, 7-vjeçarja e deri në shkollën e lartë. Realizimi i kësaj detyre kërkon edhe sigurimin e kuadrit të nevojshëm të shkollës. Një organizim i tillë mund të bëhet pas dy-tre vjetësh, sepse kjo kërkon disa pre-gatitje.

Vendet e tjera që e kanë bërë këtë reformë më përpara janë nisur nga nevojat e tyre, sepse shumicën e nxënësve e dërgojnë në prodhim, që, kur të imbarojë nxënësi shkollën e mesme, të mos harxhojë edhe 2 vjet të tjera kohë për të mësuar zanatin, por brenda dy muajve të jetë në gjendje të fillojë nga puna.

Ne, për kushtet e zhvillimit ekonomik të vendit, sot për sot, kemi nevojë për kuadro të lartë dhe teknikë, të cilët duhet t'i pregetitim nëpërmjet shkollave të larta dhe shkollave teknike profesionale, prandaj çështja që ngriti shoku Mehmet se shumica e nxënësve të gjimnazeve të destinoohen kryesisht për universitet, është e drejtë. Në gjimnaze, me gjithë riorganizimin, pregetitja teorike e nxënësve mbetet kryesorja.

Këto sugjerime mendoj t'ua themi shokëve të arsimit, të cilët t'i studjojnë dhe të na i japin për shqyrtim në një mbledhje tjeter.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

**TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR  
MBLEDHJES SË KOMITETIT EKZEKUTIV  
TË FBRD**

**25 mars 1960**

**KOMITETIT EKZEKUTIV TË FBRD**

*Konakri — Guine*

Në emër të popullit shqiptar, të rinisë së vendit tonë si dhe në emrin tim personal, u uroj gjithë pjesë-marrësve të mbledhjes së Komitetit Ekzekutiv të FBRD suksese në punë për zhvillimin e bashkëpunimit midis organizatave të rinisë në luftën për çarmatimin e përgjithshëm dhe për mbrojtjen e për sigurimin e paqes në botë.

Federata Botërore e Rinisë Demokratike, duke shprehur ndjenjat dhe interesat jetike të rinisë të të gjitha vendeve, ka luajtur dhe luan një rol të madh në forcimin e bashkëpunimit midis organizatave të rinisë, në forcimin e solidaritetit midis rinisë së vendeve të ndryshme; ajo ka dhënë një kontribut të madh në çështjen e forcimit të paqes dhe të bashkëpunimit të vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore.

Rinia e vendit tonë, e cila rritet e lirë dhe e lumtur në Republikën Popullore të Shqipërisë si anëtare aktive e organizatës së madhe të FBRD, si gjithnjë edhe në të ardhshmen, do të luftojë me të gjitha forcat për forcimin e radhëve të Federatës Botërore të Rinisë Demokratike për çarmatin e përgjithshëm dhe të plotë, për evitimin e luftërave agresive, për jetën e lumtur dhe të begatshme të rinisë dhe të të gjithë popujve të rruzullit tokësor.

Rinia dhe populli i vendit tonë kanë ndjekur me simpati dhe me respekt luftën dhe përpjekjet e popujve e të rinisë së Afrikës për çlirimin nacional, për forcimin e sovranitetit dhe të unitetit të të gjitha vendeve të Afrikës. Popujt dhe rinia e vendeve të Afrikës do të kenë te populli dhe te rinia shqiptare një mik dhe aleat besnik.

Duke ju uruar suksese në punë, shpreh bindjen se mbledhja juaj dhe organizatat e rinisë të të gjitha vendeve do të ndihmojnë edhe më shumë për uljen e mëtejshme të tensionit ndërkontëtar, që brezi i ri, lulet e pranverës, të rriten dhe të rrojnë të lumtur, në miqësi dhe në paqe.

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
gazeten «Zëri i popullit».  
Nr. 72 (3601), 25 mars 1960*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## **ROLI UDHEHEQËS DHE DREJTUES I PARTISE DUHET TË NDIHET KUDO**

*Fjala e mbajtur në aktivin e Partisë të ushtrisë*

**7 prill 1960**

Të dashur shokë,

Jam shumë i gjëzuar që asistova në këtë aktiv të ushtrisë, sado që jo në të gjitha seancat e tij.

Qëllimi i këtij aktivit ishte për të diskutuar se si punon Partia në ushtri, si punojnë organizatat-bazë të Partisë. Unë mendoj se është kapur mirë kjo çështje. Me këtë dua të them se është bërë mirë që është organizuar ky aktiv dhe një punë e tillë mendoj se duhet të zhvillohet çdo vit. Kështu do të shkëmbitet eksperiencia e fituar gjatë vittit, do të bëhet kritika e punës dhe do të mobilizohet Partia për realizimin e detyrave të mëtejshme.

Puna e Partisë ka rëndësi të madhe. Në rast se Partia është kudo e mobilizuar, i kuption mirë detyrat, është në lartësinë e saj, atëherë çdo gjë do të shkojë mirë. Përparimet që janë bërë në ushtri tregojnë se

Partia këtu është në pozita luftarake, të forta dhe të drejta ideologjike. Për këto suksese Komiteti Qendror ju përgëzon.

Roli udhëheqës dhe drejues i Partisë duhet të ndihet kudo. Mbledhja e organizatës-bazë, roli i byrosë së organizatës-bazë dhe i sekretarit nuk duhet të kuptohen thjesht, por në gjerësinë dhe në rëndësinë e tyre.

Ju e dini se shumica e kuadrove tanë në ushtri janë komunistë dhe anëtarë të Bashkimit të Rinisë. Një përqindje fare e vogël janë të paorganizuar, por edhe këta janë patriotë. Pra të gjithë duhet të kuptojnë që në rast se organizata-bazë e Partisë, jo vetëm në mbledhje, por dhe jashtë saj, tregohet luftarake, influenca e saj do të rritet.

Komunisti, në çdo funksion që ka në ushtri, me vullnet të madh mëson vazhdimisht dhe zbaton si duhet rregulloret. Me njerëz të tillë plot vullnet organizata-bazë e Partisë bëhet me të vërtetë një organizatë luftarake. Mbledhjet e organizatës-bazë duhet të shërbjnë për t'i kalitur dhe për t'i armatosur komunistët, për të zhdukur të metat dhe gabimet që vërtetohen në punën e tyre. Mësimet, këshillat dhe direktivat e organizatës-bazë ata duhet të dinë t'i futin në mendjen dhe në zemrën e gjithë ushtrisë në mënyrë të organizuar dhe pareshtur.

Sekretari i organizatës-bazë mund të mos jetë njeri me post komandues, ai mund të jetë edhe një ushtar i thjeshtë, ose me gradë të ulët, por ai ka një rol të madh dhe këtë duhet ta kuptojnë mirë të gjithë ata komandantë që kanë grada dhe poste më të larta. Kjo nuk do të thotë se sekretari është medoemos ose vet-

vetiu më i zoti në dituri nga komandanti dhe duhet t'i shesë mend orë e çast komandantit, kjo nuk do të thotë se ai duhet të komandojë komandantin. Le të marrim një shembull të thjeshtë: një komandant është i zoti, por është gjaknxchtë dhe disa herë kalon në arrogancë e bën gabime, nuk e ka kuptuar akoma ku qëndron kufiri i kërkesës së llogarisë dhe e kapërcen atë. Në këtë rast i bie barra sekretarit të organizatës-bazë që t'i vijë në ndihmë këtij komandanti, t'i tregojë gabimin dhe rrugën e drejtë që duhet të ndjekë, ta korrigjojë për këtë të metë.

Natyrisht edhe sekretari duhet të ketë takt sepse në qoftë se ai i vete komandantit zjarr për zjarr, në kohën kur këtij i ka hipur në majë të hundës, çështja nuk zgjidhet, prandaj sekretari duhet të gjejë kohën e duhur, të mendojë formën dhe mënyrën si t'ia vëré në dukje gabimin. Komandanti që ka një post të rëndësishëm, sigurisht, është njeri i mirë, ai është komunist dhe mund të jetë më i sprovuar si komunist. Por komandanti duhet ta dëgjojë sekretarin e organizatës-bazë, sepse në atë detyrë të rëndësishme e ka vënë Partia, pavarësisht se ka gradë më të ulët. Në rast se sekretari nuk mund ta bindë komandantin menjëherë, ai duhet të rikthehet te komandanti, të gjejë përsëri mënyrën se si ta bindë me arsyé komandantin, t'ia shtrojë edhe në organizatën-bazë.

Sekretari i organizatës-bazë të Partisë duhet të jetë vazhdimesht në kontakt me gjithë Partinë dhe me njerezit pa parti. Këtë gjë ju shokë duhet ta praktikoni. Ushtari që bën një gabim, ose ai ushtar ndaj të cilit është bërë një gabim, nuk mund të vejë aq lirisht te

komandanti i togës së tij, i batalionit ose i brigadës, por atij duhet t'i hapet rruga të vejë lirisht te sekretari i Partisë, sepse ai është sekretar partie dhe përpëra Partisë ushtari e hap zemrën. Sekretari duhet t'i krijojë një ambient të ngrohtë ushtarit që i vete për të qarë një hall, në mënyrë që ky ta ndiejë veten sikur shkon te njeriu më i afërt që do t'ia zgjidhë atë. Sekretari, pasi e gjykon çështjen, i jep mendimin e tij nëse mund të zgjidhet apo jo dhe po të ketë gabim, pasi e sqaron ku e ka gabimin, e këshillon si duhet të veprojë. Por në rast se sekretari e shikon që me të vërtetë fajtor mund të jetë komandanti, atëherë bisedon me komandantin dhe ky duhet ta kuptojë që sekretari i organizatës-bazë, duke qenë në kontakt të ngushtë me shokët e Partisë në repart dhe me të gjithë ushtarët, i çon atij zërin, ndjenjat, pikëpamjet e ushtarëve, pakënaqësitë, lodhjet, mërzitjet, gjëzimet e tyre etj. Sekretari i organizatës-bazë duhet të ndjekë çdo gjë që ndodh në repartin e tij deri në fund. Kur ai i shikon mirë gjërat, çdo gjë mund të shkojë mirë. Kushdo që ka bërë gabim mund të ndreqet dhe të korrigohet. Njerëz jemi dhe mund të gabojmë, por në qoftë se sekretari e njeh njeriun nga afër, sjelljet, jetën e tij, atëherë do të dijë t'i japë edhe ilaçin. E kush mund ta ndihmojë atë që gabon më mirë se kushdo? Sigurisht ata që janë në kontakt të vazhdueshëm me të: shokët, Partia, gjithë komunistët, organizata-bazë e Partisë, sekretari i Partisë. Prandaj duhet të kuptohet dhe të kihet parasysh roli i madh që luan organizata-bazë dhe sekretari i organizatës-bazë.

Nuk i bie aspak prestigji një oficeri, kur ulet kë-

mbëkryq me sekretarin e organizatës-bazë, flet me të lirisht, duke pasur respekt reciprok ndaj njëri-tjetrit, pavarësisht se ky është me gradë më të ulët. Ata duhet të flasin midis tyre me zemër të hapur, me dashuri të sinqeritë për njëri-tjetrin, me qëllim që punët të shkojnë mbarë, gabimi të ndreqet dhe ushtria të forcohet.

Për zbatimin mirë të urdhraleve, të vendimeve, të rregulloreve, për çështjet e mësimit, komanda, po ta kuptojë si duhet rëndësinë e organizatës-bazë, përparrë se të marrë një vendim, duhet të marrë edhe mendimin e byrosë, të sekretarit dhe të organizatës-bazë, sepse kjo sjell eksperiencën dhe mendimet e ushtarëve, sjell konkretisht situatën e vërtetë të repartit, ajo e di nëse kjo çështje do të zbatohet lehtë apo me vështirësi dhe do t'i thotë se si do t'u merren krahët këtyre vështirësive. Kjo ka rëndësi të madhe.

Në qoftë se ne nuk dëgjojmë zërin e Partisë, që do të thotë zërin e masës së komunistëve dhe të ushtarëve, atëherë urdhri, vendimi, edukimi bëhen në mënyrë burokratike. Një gjë e tillë nuk duhet të ngjasë, por që të mos ngjasë duhet që Partia të gjitha organizmat e saj t'i futë si duhet në ushtri, në zemrën e njerëzve.

Këto gjëra ju i dini dhe unë nuk po ju them ndonjë gjë të re, ju i zbatoni këto, por ka dhe të meta në këtë drejtim. Prandaj Partia në radhë të parë duhet të luajë rolin e saj në reparte dhe çdo gjë të zgjidhet në frymë partie. Partia duhet të jetë mësuesja më e mirë, e përditshme për ne. Ç'do të thotë kjo? Mund të ketë dhe ka njerëz të mësuar, dhe jo vetëm në ushtri, që mendojnë se dinë gjithçka, janë kryelartë dhe nuk

përfillin forcën dhe diturinë e kolektivit. Pikërisht «filozofë» dhe «intelektualë» të tillë që u pëlqen të lëvdohen i mburr borgjezia, por jo Partia. Qëllimi i njerëzve të ditur është që ta transformojnë botën dhe që ta bësh këtë borgjezia nuk të mburr dhe nuk të vë dekorata; vetëm Partia dhe populli të vlerësojnë në këtë drejtim. Të marrim çështjen tuaj. Ju jeni njerëz të kulturuar. Ne me të drejtë mburremi me ushtrinë tonë, sepse ajo është një ushtri moderne, jo vetëm nga pikëpamja se ka kuadro që kanë përvetësuar shkencën ushtarake moderne, por se ajo është e ngritur politikisht, ideologjikisht dhe i kupton ashtu si duhet detyrat e saj dhe i zbaton në jetë. Mund të ketë njerëz që kanë shumë njoburi, por nuk luftojnë që atë t'ua japid edhe të tjerëve.

Çfarë do të transformojnë njerëzit e ditur në ushtri? Ata duhet të transformojnë në radhë të parë njeriun, të transformojnë ushtarët, domethënë të punojnë në atë mënyrë që, duke filluar që nga ushtari i thjeshtë dhe deri te oficeri më i lartë, këta të bëhen njerëz me të vërtetë të denjë të epokës sonë socialiste. Është lehtë të transformosh një arë jopjellore në arë pjellore, por është shumë vështirë të transformosh një njeri me paragjykime dhe me mbeturina, që, me gjithë dëshirën e tij, e ka zor të mësojë dhe t'i zhdukë ato. Ta bësh këtë njeri të zhdukë mbeturinat e tij, të punojë me zell të madh pér të mësuar, ta bësh njeri të zot që këtë zotësi ta vërë në shërbim të popullit, të atdheut, të ekonomisë, të ushtrisë, kjo është një punë shumë më e vështirë, por e mundshme.

Prandaj në ushtri ngrihet detyra e madhe që ju

t'u mësoni njerëzve artin modern ushtarak. Kjo nuk është një gjë e thjeshtë, por është një shkencë, për zotërimin e së cilës duhet punuar seriozisht. Qëllimi kryesor i kësaj shkencë është që ne të jemi të gatshëm për të mbrojtur popullin dhe atdheun tonë socialist nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm dhe t'i sigurojmë popullit dhe Partisë qetësinë që ata të ecin nga suksesi në sukses.

Në duart tuaja, shokë oficerë, kalojnë me dhjetëra mijëra njerëz, të cilët nuk qëndrojnë vazhdimisht në ushtri, por, pasi kryejnë këtë shërbim të shenjtë, kalojnë në jetën civile. Unë nuk them që ju duhet t'i pregatitni ata si bujq të mirë ose si inxhinierë. Këto kompetenca ju nuk i keni, por ju keni disa mundësi e detyra të tjera.

Në radhë të parë ju duhet të punoni për edukimin politik dhe ideologjik të të gjithë këtyre njerëzve, që ata në ushtri të ngrihen më shumë, të bëhen më të ndërgjegjshëm, t'u hapen horizonte më të gjera, që, kur të shkojnë në jetën civile, të jenë më të armatosur politikisht, më të qartë ideologjisht dhe të vendosur për një qëllim të lartë në jetë.

Komiteti Qendror i Partisë sonë mendon se për ta kryer këtë detyrë ju keni mundësi shumë më të mëdha se në sektorët e jetës civile, sepse në ushtri kemi organizata të forta, se në ushtri janë nga kuadrot më të vjetër dhe të sprovuar të Partisë, që në përgjithësi kanë një ngritje politike dhe marksiste të mirë. Lufta e përditshme për të zbatuar në jetë direktivat e Komitetit Qendror të Partisë, ju ka armatosur me ideo- logjinë marksiste-leniniste, me ideologjinë e pavdek-

shme të Partisë sonë. Pra ju e keni këtë mundësi, ju i keni të gjitha mjetet teknike që me dhjetëra mijëra ushtarë t'i edukoni politikisht dhe ideologjikisht.

Por ju duhet të keni parasysh edhe një gjë tjetër. Tani ushtria jonë është e armatosur dhe do të armatoset vazhdimisht me teknikë akoma më të komplikuar, prandaj detyra juaj është që ushtari të mos mësojë vetëm atë mjet që ka në dorë. Unë nuk ju këshilloj që të lini programet tuaja dhe të zgjeroheni si vaji në lakra, por të keni parasysh që ushtarët që marrin taninë dorë këtë teknikë, të mësojnë si duhet teknikën dhe përdorimin e mjeteve që disponojnë, në mënyrë që ata, kur të mbarojnë shërbimin ushtarëk, të mundin fare lehtë të shkojnë në atë profesion ose në një tjetër në jetën civile dhe brenda një kohe fare të shkurtër të ambientohen dhe të bëhen specialistë të kategorisë së pestë, të gjashtë bile dhe të kategorisë së shtatë. Këtë mundësi ju e keni dhe duhet të punoni në këtë drejtim.

Duke u mësuar ushtarëve, nën oficerëve dhe oficerëve teknikën moderne, ju do të keni parasysh të mos i kufizoni mësimet tuaja vetëm në anën thjesht teknike, por t'u mësoni sidomos parimin ku mbështetet përpunimi dhe përdorimi i kësaj teknike. Në këtë mënyrë me një rrugë ju keni bërë dy punë. Kështu ushtari do të dijë mirë jo vetëm teknikën speciale që ju i keni dhënë, por njëkohësisht do të mund të përdorë dhe shumë mjete të tjera të njëlllojta ose të kombinuara. Ju duhet të insistoni shumë në këtë drejtim, sepse kështu do t'i bëni një shërbim të madh ekonomisë sonë popullore, industrisë sonë.

Ne kemi flotën tonë, por kalojnë vjetët dhe numri i madh i ushtarëve që kryejnë tanë shërbimin në të do të zëvendësohet me ushtarë të tjera. Po të punohet si thamë, këta ushtarë do të bëhen teknikë të mbaruar dhe do të dalin nesër udhëheqës të mirë të flotës sonë tregtare dhe të peshkimit. Pra detyrat që ju vihen përpara janë komplekse; nga njëra anë ju duhet, në radhë të parë, t'u mësoni ushtarëve përdorimin e mjetave luftarake moderne që ju ka dhënë Partia e populli, dhe, nga ana tjetër, t'i bëni ata të aftë që, kur të mbarojnë shërbimin ushtarak, të bëhen mekanikë, teknikë dhe punëtorë të mbaruar.

Një tjetër çështje me rëndësi të madhe që ju e dini shumë mirë. Ushtarët vijnë nga të gjitha anët e vendit tonë, prandaj ju vetë duhet të keni kontakt të vazhdueshëm me terrenin, nuk duhet të jeni të shkëputur ngajeta e vendit tonë. Ushtria jonë nuk është diçka e mbyllur në vetvete, ajo duhet të ketë kontakte të gjalla me terrenin. Ushtari që vjen këtu, vjen me dëshirë në ushtri, se e di që do të kryejë një detyrë shumë të lartë patriotike. Veç kësaj, duke jetuar për disa vjet, ai shikon se ushtria është një shkollë e madhe, por njëkohësisht ai e ka mendjen edhe në fshat te ara, te kooperativa, te rendimenti etj. se është fshatar. Prandaj në rast se nuk e mbajmë në korrent ushtarin se si zhvillohet e përparon jeta në fshat dhe në të gjitha fushat, atëherë do të bëjmë gabim. Kjo kërkon që ju të mbani konkretisht kontakte të ngushta me terrenin. Atëherë edhe referatet politike, edhe bisedat me ushtarët e me nënoficerët do ta keni më lehtë t'i bëni konkrete, t'i lidhni me jetën,

me përparimin e vendit tonë, me luftën që bën populli ynë për ndërtimin e socializmit.

Çështjes së edukimit marksist-leninist duhet t'i vëmë një rëndësi të madhe, sepse ajo na jep mundësi të zhvillojmë punën tonë, të ecim me siguri përpara, të zbulojmë gabimet dhe të metat tona të brendshme. Marksizëm-leninizmin ne duhet ta përvetësojmë, domethënë ta bluajmë si duhet, atëherë njerëzit do të mund të ndreçin më shpejt gabimet e tyre dhe do të përparojnë.

Partinë duhet ta preokupojë çështja e njerëzve. Natyra e njeriut është e komplikuar. Të gjithë e dimë se njërit i mbetet hatëri për një çështje, një tjetër mendon pse shoku i tij u gradua dhe unë jo, ose pse u gradua ai më parë nga unë, pse ai më shikon jo me sy të mirë dhe shumë gjëra të tjera. Ka njerëz që u rezistojnë këtyre shfaqjeve dhe i luftojnë, por ka edhe të tjerë që nuk janë të kalitur si duhet dhe qimen e bëjnë tra me mendjen e tyre dhe nga pozita krejtësisht të qarta kalojnë në pozita të errëta e pastaj në gabime më të rënda. Këta njerëz, në qoftë se nuk edukohen, mund të shkojnë edhe më larg, prandaj duhet t'i kuptojmë dhe t'i ndihmojmë. Po kush mund t'i kuptojë më mirë ata se njerëzit e Partisë, domethënë ata njerëz që luftojnë dhe edukohen vazhdimisht me teorinë marksiste-leniniste?

Prandaj masat disiplinore që ju merrni duhet t'ju bëjnë të mendoheni, nuk është e drejtë të mbetet kjo në disa raste e vetmja formë e edukimit të njerëzve. Ai që e jep një masë të tillë është e domosdoshme ta kuptojë si duhet shpirtin e njeriut, rrugën që duhet

ndjekur për ta ndrequr atë që ka gabuar. Është fare lehtë që komandanti të japë fletarresti, por asgjë nuk do të fitojë. Ka njerëz që, po t'i qortosh me fjalë, në fillim mund të mos e pranojnë këshillën, por ata prapëseprapë do të mendohen dhe do t'i vënë gishtin kokës.

Çështja e edukimit ka rëndësi të madhe, prandaj ju duhet të hiqni dorë nga dënimet. Kjo nuk do të thotë që masat ndëshkimore nuk duhet të ekzistojnë fare. Ato duhet të ekzistojnë, ashtu siç ekzistojnë edhe në Parti që nga më të thjeshtat e deri te masa më e rëndë, përjashtimi nga Partia. Vetëm se ato nuk duhet të jepen orë e çast. Prandaj komandantët të jenë të matur. Mund të jetë gjaknxehtë ushtari i thjeshtë, por komandanti duhet të jetë i matur dhe të mos rrëmbehet, sepse është më i regjur, ka më tepër eksperiencë, ka edukatë më të madhe, është më i vjetër në Parti, kurse ushtari mund të mos jetë dhe në Parti, ai është i ri, me shumë më pak eksperiencë nga komandanti, prandaj fare lehtë mund të bëjë edhe një gabim. Komandanti të mos nxitohet, ta gjykojë gabimin me gjakftohtësi. Komandanti duhet t'i përdorë drejt kompetencat, t'i përdorë ato në frymë partie.

Ju duhet të keni durim me njerëzit. Kjo nuk do të thotë që të ulet disiplina në ushtri. Disiplina në ushtri duhet të mbahet e fortë, por ajo të jetë një disiplinë e ndërgjegjshme. Partia në ushtri është në gjendje të vendosë një disiplinë të fortë dhe të ndërgjegjshme, gjë që do të ndihmojë shumë për kufizimin e masave disiplinore.

Një çështje tjeter është se, duke përvetësuar teo-

rinë marksiste-leniniste, ne duhet të pastrojmë në radhë të parë veten tonë. Ne duhet ta rishikojmë veten vazhdimisht, se është e vështirë të zhduken menjëherë mbeturinat mikroborgjeze, sidomos të elementët me prejardhje borgjeze e mikroborgjeze. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë pastrim në veten tonë nuk mundet ta kërkojmë këtë nga të tjerët.

Ka komunistë që bëjnë gabime dhe jo vetëm gabime politike, por edhe gabime morale, shoqërore etj. Komunisti që nuk është në pozita partie, kur Partia kërkon që anëtarët e saj të flasin dhe të punojnë për forcimin e familjes, për respektimin e normave morale në shoqëri etj., kuptohet se e ka vështirë ta zbatojë vetë vijën e Partisë.

Ka komunistë intelektualë, megjithëse të rrallë, që, kur fitojnë dituri, mendojnë se pa ata nuk ecën përpara shoqëria, veten e vlerësojnë si njerëz të zotë që kanë mbaruar një ose dy akademi dhe u rritet mendja. Intelektualë të tillë që nuk pranojnë mendimin e të tjerëve, që mbivlerësojnë veten, izolohen nga masa, duan t'i imponohen masës dhe kështu bien në gabime të rënda. Prandaj, shokë, në këto raste duhet kudhra e Partisë.

Tendencat e izolimit dhe mendjemadhësia që manifestohen te disa intelektualë, Partia duhet t'i luftojë, pse këto i shtyjnë ata të dalin mbi klasat, ta harrojnë luftën e klasave dhe të bien në oportunizëm.

Partia i mëson dhe i edukon njerëzit jo për ta pasur diturinë si një stoli, por për ta shfrytëzuar atë si një armë për të transformuar natyrën, shoqërinë, konkretisht te ne për të transformuar Shqipërinë nga

një vend i prapambetur agrar në një vend të përparruar industrial, për të kaluar nga socializmi në komunizëm. Të gjitha dituritë dhe mjetet që na kanë dhënë Partia dhe populli, duhet t'i përdorim për të transformuar jetën e popullit tonë, ta bëjmë atë më të mirë e më të lumtur. Për të arritur këto qëllime kaq fisnike roli i Partisë eshtë vendimtar.

Partia jonë i ka kuptuar këto gjëra dhe i zbaton në jetë. Në ushtritë borgjeze nuk mund të ndodhë kurrë që një gjeneral të rri, të krahas me një kapter, sikundër po rrini ju këtu dhe as që mund të lejohet që kapteri të ngrihet dhe të kritikojë eprorët e tij, sepse ato janë ushtri antipopullore. Borgjezia nuk dëshiron që në ushtri të bëhet politikë se e di çfarë do t'i ngjasë. Praktikisht unë dëgjova diskutimin e shokut të xhenios që më pëlqeu ashtu si edhe shumë nga diskutimet e tjera. Ai vuri mirë në dukje sukseset dhe të metat në punë. Unë jam i sigurtë se ai nuk dinte më tepër, se po të dinte do t'i kishte lëshuar të tëra këtu dhe nuk do të bënte keq. Po këtë gjë ai duhet ta bëjë edhe në organizatën-bazë.

Por duhet të kihet parasysh se kjo demokraci në Parti dhe në ushtri nuk duhet të marrë nëpër këmbë disiplinën proletare dhe ushtarake. Disiplina është respekti duhet të jenë të bazuara në ndjenja të shëndoshë. Këtë do ta bëjë me njerëzit Partia. Po të zhvillohet një frymë e shëndoshë kudo, ne do të kemi akoma më pak të meta dhe sukseset do të jenë të mëdha.

Prandaj e theksoj edhe një herë se rëndësi të madhe duhet t'i kushtojmë marksizëm-leninizmit. Që keni vështirësi për këtë nuk ka dyshim. Unë jam intelektual,

kam bërë shkollë, prandaj kam edhe praktikën e të lexuarit, megjithëkëtë unë po ju them se, pas Çlirimit, sado që kisha lexuar shumë, përpiqështë t'i kuptoja sa më mirë librat marksistë. T'ju them të drejtënkishte libra që nuk i kuptoja menjëherë, por përfunksionin që më kishte ngarkuar Partia më duhej të bëja përpjekje, të mësoja së bashku me të gjithë shokët e Byrosë Politike, se ato mësimet ishin vendimtare përfatë e Partisë dhe të popullit tonë. Vendimet që ka marrë Komiteti Qendror në bazë të këtyre mësimeve të marksizëm-leninizmit përdrejtimin e shqetësit dhe të ekonomisë sonë, kanë qenë të drejta, pa gabime parimore. Prandaj mund të themi se në saje të punës kolegiale të Komitetit Qendror dhe të Byrosë Politike, ne kemi marrë vendime pa gabime parimore që t'i shkaktonin dëme Partisë, popullit ose ekonomisë. Kjo na bëri ne që në luftën e përditshme, librat marksistë-leninistë që nuk i kuptionim në fillim, t'i kuptionim mirë më vonë.

Për t'u prepatitur nga ana ideologjike e kulturore, nuk do të thotë që ne të mësojmë çdo libër marksist-leninist, çdo libër shkencor. Kjo nuk do të ishte e mundur. Dituria është e pafund, prandaj njeriu nuk mund t'i dijë të gjitha. Mund të mendojë se i di të gjitha vetëm ndonjë intelektual i sëmurë nga megalomania. Por Partia di çdo gjë, sepse njëri di një gjë, tjetri diçka tjetër dhe të gjithë të grumbulluar përfshi një qëllim të vetëm përbëjnë një forcë kompakte kolosale që kuption, zgjidh drejt çdo problem dhe korr fitore. Kështu e kuptioni ne forcën e madhe të Partisë.

Kur çliruam atdheun, borgjezia na qante hallin se si do të drejtonim, sepse ne nuk ishim as financiarë,

nuk dinim të drejtonim shtetin, ekonominë, ushtrinë dhe priste me padurim që të dështonim. E vërteta është që ne atëherë nuk i dinim këto dhe kishim përpara shumë vështirësi dhe shumë probleme për të zgjidhur, po ne kishim besim të madh te Partia se me Partinë në krye do të fitonim. Dhe ja, shokë, tani se ç'po bëhet në Shqipëri. Po të krahasojmë gjendjen e mjeruar në të cilën e la vendin ajo borgjezi injorante që kritikonte Partinë tonë, me sukseset kolosale që ka arritur deri tani populli nën drejtimin e Partisë, del se sa e madhe është forca e kolektivit, sa e drejtë është vija e Partisë sonë dhe përpjekjet e shumanshmë të saj që dhanë këto rezultate. Ne Partinë e kemi të fortë, monolite. Unitet të çeliktë ka Partia jonë, sepse ajo është një Parti revolucionare e tipit marksist-leninist.

Kisha edhe një çështje tjeter, çështjen e edukimit tuaj të përgjithshëm, shokë oficerë të ushtrisë sonë. Përveç edukimit tuaj special ju nuk duhet të neglizhoni edhe për ngritjen tuaj kulturore. Oficerët tanë duhet të jenë njerëz të kulturuar. Me këtë nuk duhet të kuptojmë që të jemi enciklopedikë, por të dimë si zhvillohetjeta, si zhvillohet shkenca, si zhvillohet politika e përgjithshme ndërkontaktore. Të gjitha këto mësohen në shkolla, po mësohen edhe jashtë shkollës.

Ai që mëson në shkolla duhet të mësojë jo për notë, por për të zhvilluar intelektin e tij. Çështja e notës nuk ka rëndësi të madhe. Njëri mund të marrë rastësisht një notë pesë<sup>1</sup> dhe disa herë, pa bërë përpjekje të mëdha,

---

<sup>1</sup> Në sistemin e mëparshëm të vlerësimit, nota pesë kon siderohet nota më e mirë.

por Partia dhe shteti do ta shohin në jetë, ku ai person duhet të zbatojë diturinë që ka marrë dhe jo pesën. Një njeriu të përciptë pas një ose dy vjetësh do t'i dalë boja dhe atëherë do të duket se ai nuk e ka marrë si duhet diturinë. Kurse do të ketë të tjerë që mund të kenë marrë edhe notën katër, por kanë bërë përpjekje të mëdha për të mësuar thelbin e çështjes, e kanë përtypur në jetë teorinë, prandaj ata do të shkëlqejnë në jetë. Pra çështja nuk është të luftohet për notën, por për diturinë.

Por dituria fitohet edhe jashtë shkollës, duke lejuar. Është e vërtetë se të tërë punojmë, lodhemi, kush më shumë e kush më pak, por, mendoj unë, çështja e ushqimit me dituri jashtë shkollës, jashtë punës duhet të bëhet një jetë e dytë për kuadrot tanë udhëheqës, për të zgjeruar diturinë. Po të veproni kështu sistematikisht do të shikoni se kjo do t'ju vlejë shumë në jetën dhe në punën tuaj personale, sepse jeta juaj nuk është e izoluar, ju jeni aktivistë dhe njerëz që merreni me politikë. Kur dilni jashtë, në familje, ose merrni kontakt me popullin, ju jeni nga agjigatorët më të kualifikuar të Partisë. Me masat nuk do të flasësh për armët moderne as për nëndetëset, por për ato halle që i preku pojnë ose për ato probleme të kohës që duan shpjegime. Dhe këto sqarime më mirë se kushdo do t'ia japid popullit kuadrot e Partisë, kuadrot e ushtrisë dhe të shtetit, te të cilët populli ka besim të madh. Kjo kërkon që këtë besim që ka populli për ne të mos e errësojmë, prandaj të mësojmë, kudo që jemi, në punë ose jashtë punës, se Partia dhe populli presin shumë nga ne.

Dua të theksoj pak edhe punën për forcimin e

vigjilencës, për të ruajtur pastërtinë e Partisë nga orvatjet e armiqve. Pavarësisht nga përmirësimi i gjendjes ndërkombejtare, të mos harrojmë se imperializmi ekziston, ai është i armatosur dhe akoma i fortë. Qëllimet e tij janë ato që kanë qenë. Të përfitojmë nga dobësitë dhe nga taktika e imperializmit që po e sheh se tanika dështuar taktika e luftës së ftohtë dhe ta shfrytëzojmë këtë në shërbim të paqes.

Me gjithë këtë nuk duhet menduar në asnje mënyrë se rreziku i luftës është zhdukur, prandaj ta forcojmë vigjilencën dhe unitetin e Partisë. Po të dobësohet Partia, atëherë mund të punojë fare mirë armiku. Qëllimi kryesor i armikut për të realizuar planet e tij është të godasë forcën kryesore dhe vendimtare të një shteti socialist, partinë marksiste-leniniste, pastaj pozitat e tjera ai i merr me lehtësi. Pra goditja kryesore e imperializmit dhe e shërbëtorëve të tij besnikë, revisionistëve, drejtohet kundër të gjitha partive marksiste-leniniste, kudo që këto janë, dua të them jo vetëm kundër partive të vendeve socialiste, por dhe kundër partive marksiste-leniniste të vendeve ku sundon kapitali, qofshin në Azi, në Afrikë, në Amerikën Latine, apo në çdo vend tjetër të botës. Lufta e armikut kundër partive marksiste-leniniste bëhet e shumanshme, me shtyp, me radio etj., por edhe me anë të agjenturës së organizuar të borgjezisë ndërkombejtare, revizionizmit. Revizionizmi është sot rreziku kryesor. I rrezikshëm veçanërisht për Partinë tonë dhe për të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste është revizionizmi jugosllav.

Partia jonë, së bashku me të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste, janë të vendosura t'i bëjnë një luftë

të vazhdueshme, deri në likuidimin e plotë revizionizmit. Tani revizionizmi jugosllav me të vërtetë është diskredituar, ai ka ngrënë grushte, por ai nuk i ka hedhur armët. Ashtu sikurse imperializmi edhe agjentura e tij ideologjike, revizionizmi, nuk i hedhin lehtë armët. Ata përdorin taktika të shumëllojta. Kur situata shkon duke u zbutur, atëherë ata mundohen të përdorin tjetër taktkë, përpiken të infiltrojnë me qetësi në vendet socialiste, t'i kalbin ato nga brenda dhe në kohë të përshtatshme për ta, qoftë me evolucion, qoftë në situata të acaruara, po të arrijnë t'i krijojnë, t'i përmbysin partitë marksiste-leniniste dhe pushtetin e demokracisë popullore.

Prandaj në momente të zbutjes së situatës ndërkombëtare Partia jonë duhet të jetë po aq vigjilente ndaj revizionistëve sa edhe në periudhat e acaruara.

*Pasi foli për orvatjet e kota që bëjnë revizionistët jugosllavë kundër partive marksiste-leniniste dhe vendeve socialiste, shoku Enver Hoxha, vazhdoi:* Ne nuk do të pushojmë asnjëherë luftën ideologjike kundër revizionistëve. Marksizëm-leninizmi duhet mbrojtur se ai është burimi i të gjitha sukseseve tonë, është ideologja e Partisë sonë. Pa këtë ideologji, po shkele parimet e marksizëm-leninizmit, nuk ka parti. Partia ështëjeta e popullit prandaj atë duhet ta mbrojmë dhe parimet kurrë të mos i shkelim.

Ne jemi të gatshëm të kemi marrëdhënie të mira dhe normale me Greqinë, të ndërtojmë së bashku piramidat e prishura, të bëjmë tregti me përfitim reciprok etj., por nuk lejojmë të na futen grupe ushtarësh të

huaj që të na vrasin njerëzit tanë. Dhe po të futen të tjerët në truallin tonë të shenjtë ne nuk do të qëndrojmë duarkryq.

Në mbrojtjen e parimeve asnje parti e vërtetë marksiste-leniniste nuk duhet të bëjë lëshime. Përsa i përket Partisë sonë, ajo do të jetë e vendosur në këtë çështje sepse kjo është një çështje jetike për të. Vija e Partisë sonë ndaj revizionizmit dhe veçanërisht ndaj atij jugosllav është lufta e papajtueshme ideologjike sepse revizionizmi është armiku kryesor i marksizëm-leninizmit, i socializmit dhe i vendit tonë. Ne jemi përmiqësi me popullin vëlla jugosllav, jemi përmarrëdhënie normale shtetërcre dhe tregtare me Jugosllavinë, sipas parimeve të mirënlohura të përfitimit reciprok dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit. Sepse ne veprojmë kështu dhe nuk bëjmë lëshime në parimet, revisionistët jugosllavë na kanë halë në sy. Por, Partia jonë qëndron në pozita të forta luftarake, ka mbajtur dhe mban qëndrim të drejtë, prandaj gjëzon simpatinë e të gjitha partive marksiste-leniniste.

Qëndrimet e drejta të Partisë sonë kanë bërë që gjendja politike e brendshme dhe e jashtme e vendit tonë të jetë e fortë, uniteti i popullit rrëth Partisë të jetë i shëndoshë, të ketë suksese në realizimin e planit, në industri dhe në bujqësi, në arsim e në kulturë. Vështirësi dhe të meta ka te ne, po ato janë vështirësi dhe të meta të rritjes. Sigurisht sa kohë kalon aq edhe më tepër eksperiencë grumbullojmë, kjo nënkupton që edhe gabime duhet të bëhen më pak, po që të bëhen më pak gabime duhet të forcojmë më shumë punën tonë

të drejtimit, të organizimit, të kontrollit, pse ajo akoma nuk është në lartësinë e duhur.

Njëkohësisht te ne duhet të bëhen përpjekje akoma më të mëdha për ngritjen dhe për edukimin e kuadrove në të gjithë sektorët. Në industri ne kemi arritur suksese të mëdha, sepse kemi një klasë punëtore të re, heroike që e ka filluar mirë punën, kemi gjithashtu kuadro të tillë që e çojnë prodhimin përpara dhe realizojnë planin.

Kështu ndodh në përgjithësi, por, po ta shohësh punën në detaje, del se ne kemi edhe boshllëqe në realizimin e detyrave.

Por, sidomos, në bujqësi kemi akoma shumë për të bërë. Megjithëse bujqësia jonë ka ecur shumë përpara, atje ne kemi vështirësi të mëdha në shumë drejtime. Kolektivizimi i bujqësisë në përgjithësi u krye. Ky është një sukses shumë i madh, por tani duhet të luftojmë që të arrijmë suksese të tjera të mëdha, sidomos në rritjen e ndërgjegjes socialiste në punë të fshatarit tonë, domethënë në likuidimin në një shkallë më të gjerë të mbeturinave mikroborgjeze, të mentalitetit dhe të pikëpamjeve të vjetra, qoftë në mënyrën e jetesës, qoftë në botëkuptimin fetar, qoftë në çështjen e zbatimit të metodave të reja agroteknike etj.

Pra ne duhet të bëjmë një luftë të madhe në fshat që të arrijmë rezultate akoma më të mëdha, sepse ato që kemi bërë nuk janë të mjaftueshme. Për këtë qëllim në radhë të parë duhet që të forcohet shumë Partia në fshat, të ngremë nivelin ideologjik e kulturor të anëtarëve të Partisë mbi nivelin e fshatarit të thjeshtë, pse ka anëtarë partie, niveli i të cilëve është gati sa i

fshatarit pa parti. Në fshat ka pasur disa komunistë që kanë shkelur statutin, duke mbajtur 7-10 dynym tokë si oborr kooperativist, në vend të tre dynymëve që lejon statuti i kooperativave bujqësore, kanë mbajtur bagëti më shumë ctj. Atëherë çfarë shembull jep kryetari i kooperativës ose sekretari i organizatës-bazë të Partisë në fshat përpara fshatarëve? Sigurisht një shembull i tillë është i keq, sepse ka lënë shteg që dhe të tjerët të bëjnë si ai. Kjo është një çështje me rëndësi.

Organizimi i drejtimit, organizimi i punës, organizimi i llogarisë në kooperativë dhe shfrytëzimi si duhet i të gjitha mundësive që kanë dhënë shteti dhe Partia janë faktorë me rëndësi për forcimin e kooperativave tona bujqësore. Fshatarët duhet të zbatojnë me kujdes agroteknikën. Ata duhet të sigurojnë farë të zgjedhur për mbjelljet, ta punojnë mirë tokën dhe t'i hedhin asaj sasitë e nevojshme të plehut.

Sivjet kushtet jo të favorshme atmosferike nuk na kanë lejuar akoma t'i futemi punimit të tokave, po shkon koha, afatet po ngushtohen. Të tilla janë kushtet klimatike të vendit tonë. Në këto kushte na duhet që për një kohë shumë të shkurtër t'i punojmë dhe t'i mbjellim tokat, ndryshe nuk do të na lënë shirat ose porsa të pushojnë këto do të na dëmtojë thatësira. Ka dhe plot probleme të tjera në fshat.

Shikoni, pra, që kemi një punë të madhe dhe të vështirë për të bërë në fshat, por ne do ta kapërcejmë me sukses këtë situatë. Bonifikime kemi bërë e po bëjmë, dhe në të ardhshmen do të bonifikojmë të gjitha fushat e vendit tonë e do të shtojmë më shumë mekanizmin e bujqësisë.

Ne duhet të punojmë akoma më mirë është të ngjallim te punonjësit dashurinë për punën. Ne kemi suksese në këtë drejtim, por këto suksese në fshat, sidomos në bujqësi, janë të pamjaftueshme. Në industri ka norma, ka rregulla, ka disiplinë, por në fshat ekzistojnë akoma shfaqje të dembelizmit, mosvlerësim të kohës, kënaqje me pak, te disa kooperativistë ekziston mentaliteti që të shikojë më parë oborrin kooperativist dhe jo burimin kryesor të të ardhurave të tij, tokën e përbashkët të kooperativës. Duhet të luftojmë që, në radhë të parë, punonjësi të shikojë interesin e përgjithshëm, domethënë fshatari në vend që të punojë 150 ditë në vit të punojë 350 ditë dhe në vend të prodhojë 10 kv misër për ha të prodhojë mesatarisht 20 kv e më shumë. Në vend që fshatari i Kavajës, i Lushnjës etj. të marrë një prodhim në vit nga toka, të marrë dy prodhime, sidomos atje ku klasa punëtore i ka bërë bonifikimin tokave, të mbjellë edhe grurë, edhe misër.

Partia duhet të luftojë shumë në këtë drejtim, sepse vetëm puna në kooperativën bujqësore mund të shtojë prodhimet dhe kjo nuk është një gjë e lehtë, po edhe çështje e pakapërcyeshme nuk është. Tani është përqafuar në masë nga shumë kooperativa bujqësore të vendit parulla për të bërë 300 ditë-punë në vit, po Partia duhet ta mbajë parasysh këtë çështje dhe ta çojë deri në fund, që këto të jenë me të vërtetë 300 ditë-punë efektive në vit. Ndodh që u thuhet kooperativistëve të mbjellin ullinj, pemë të ndryshme, vreshta etj. dhe ata i mbjellin ato, por nuk tregojnë kujdes të madh, nuk i hapin gropat si duhet, nuk i vendosin fidanet sipas kërkjesave të agroteknikës. Ditë-punë ata

marrin po kur bëhet në fund llogaria sa fidane janë zënë, rezultati është shumë i vogël. Kooperativisti nuk mendon sa dëm i bën kështu vetes, se kjo çështje ka të bëjë me të ardhshmen e tij. Duke mos gjykuar thellë ai shikon vetëm të tanishmen. Në qoftë se ai, dhe të gjithë të tjerët si ai, bëjnë 300 ditë-punë të tilla në vit jo të frytshme, prodhimi sigurisht do të mbetet në vend, paga ditore do të jetë natyrisht shumë e ulët.

Procesin e shpërnguljes nga fshati Partia duhet ta luftojë. Ju keni vëllezërit, motrat, kushérinjtë, shokët që punojnë në fshat. Fshatari nuk e shikon interesin e madh që ka nga toka, e cila, po ta punosh si duhet, mund të të japë shumë. Po fshatari bën llogari të thjeshta. Tani, gjykon ai, marr kaq e aq në vit, unë këto mund t'i marr në qytet në disa muaj dhe kërcet e ikën. Tani kemi marrë disa masa, për ta penguar këtë fenomen të përkohshëm. Ne duhet të punojmë që në fshat të kemi përparime akoma më të mëdha. Mundësi në të ardhshmen do të kemi shumë, por duhet të punojmë më tepër.

Ju, shokë të ushtrisë, nuk duhet të jeni të shkëputur nga problemet e vendit, duhet të jeni mirë në korrent, të lidhur me organizatat e Partisë të terrenit. Kërkoni nga Partia dhe nga udhëheqja që t'ju mbajnë në korrent për këto situata, në mënyrë që të jepni edhe ju kontributin tuaj në këto çështje kaq të rëndësishme. Fakti është se ushtria ka dhënë një kontribut të madh, si në zhvillimin e industrisë, ashtu edhe në atë të bujqësisë dhe në ngritjen politike të masave punonjëse të fshatit. Nga gjithë këta mijëra ushtarë që kanë kryer shërbimin ushtarak, shumica janë kthyer në bujqësi

dhe kanë ndihmuar në përparimin e fshatit, kanë ngjallur frymën e dashurisë për bujqësinë, kanë përqafuar metodat dhe stilin e ri, kanë punuar për rritjen e ndërgjegjes së fshatarëve në punë.

Prandaj edhe ju, shokë oficerë, keni një përgjegjësi dhe një rol të madh në edukimin e ushtarit që ai të bëhet jo vetëm një mbrojtës i vendosur i atdheut, por edhe ndërtues i shkëlqyer i atdheut tonë socialist.

Ne kemi besim të madh në forcat e popullit tonë heroik, në vijën e drejtë të Partisë sonë, në mobilizimin e plotë të gjitha forcave të Partisë dhe të masave dhe me siguri do t'i realizojmë me sukses të gjitha detyrat e mëdha që na vihen përrpara.

Gjithashtu besimi i Komitetit Qendoror të Partisë sonë është i madh ndaj ushtrisë, ndaj kuadrove të saj për punën e tyre në edukimin e Ushtrisë Popullore.

Ne, shokë, fare pak gjëra dinim atëherë kur krijuam ushtrinë, po me aq sa dinim luftuam. Tani është një gëzim i madh kur shohim shokët tanë të luftës dhe të rinjtë që kanë mbaruar akademi, që janë të zotë të drejtojnë ushtrinë tonë në fryshtë e marksizëm-lenismit dhe me një dashuri të madhe për atdheun, për Partinë dhe për popullin.

Koha punon për ne, të dashur shokë, dhe nuk ka forcë në botë që ta kthejë prapa rrugën e zhvillimit dhe të përparimit të shoqërisë.

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendoror të Partisë*

## **T'U VIHET FRE SHFAQJEVE LIBERALE PËR TA SJELLË ÇDO GJË NGA IMPORTI**

*Letër komiteteve të Partisë në rrethe*

**13 prill 1960**

Komiteti Qendror i PPSH i ka porositur vazhdimisht organet shtetërore dhe të ekonomisë, komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë që të përdorin me kursim të madh materialet e importit, të organizojnë sa më mirë shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe të pajisjeve, të sjellin mallra konsumi në përputhje me kërkesat dhe me nivelin ekonomik të popullsisë. Nga kuadrot drejtues të ekonomisë, nga të gjithë komunistët dhe punonjësit, duhet të tregohet kujdes i madh në përcaktimin e nevojave, për të importuar sendet më të domosdoshme për ekonominë popullore. Duhet të luftohen me këmbëngulje shfaqjet e huaja për të sjell çdo gjë nga importi dhe për të bërë përpjekje të organizuara për zëvendësimin e pjesshëm, por të vazhdueshëm, të mallrave të importit me prodhime të vendit.

Këto çështje të rëndësishme kanë filluar të tërheqin më tepër vëmendjen e organeve shtetërore të ekono-

misë dhe të Partisë. Nuk janë të pakta rastet e inisiativave të mira për shkurtimin e materialeve dhe të makinerive nga importi. Por në këtë drejtim vërehen të meta serioze, mënjanimi i të cilave është detyrë për gjithë Partinë, për të gjithë kuadrot dhe punonjësit.

Komiteti Qendror i PPSH, pasi analizoi punën që bëhet për importimin e makinerive, të pajisjeve, të materialeve dhe të mallrave të konsumit të gjërë, si dhe të përdorimit të tyre, konstaton se në këtë drejtim vërehen të meta serioze:

1. — Në disa kuadro drejtues të ekonomisë ka tendencia të dëmshme antishtetërore për të sjellë nga importi artikuj të panevojshëm për ekominë tonë e të kushtueshëm, përdorimi i të cilëve në disa raste nuk dihet. Kështu në Ndërmarrjen e Bonifikimit, në Ndërmarrjen Shtetërore të Riparimit të Makinerive të Rënda të Ndërtimit, në Ndërmarrjen Shtetërore Hidro-Elektro, në Ndërmarrjen Shtetërore të Hekurudhave në Durrës, në Termocentralin e Tiranës, në Ndërmarrjen Shtetërore Rruja-Ura, në uzinën «Enver», në Kinostudion «Shqipëria e re» në Tiranë, në bazat grosiste të dikastereve të ndërtimit dhe të bujqësisë, në kombinatin e naftës «Stalin», në ndërmarrjen shtetërore të ndërtimit «Perlët Rexhepi», në Ndërmarrjen Industriale Shtetërore Ushqimore në Vlorë dhe në mjaft ndërmarrje të tjera ndodhen makineri dhe pajisje krejt të reja, ose në gjendje pune, të importuara prej kohësh, si traktorë, buldozerë, ekskavatorë, draga, gurthyese, plugje, motorë e elektromotorë, pompa e të tjera që nuk vihen në shfrytëzim, pasi nuk nevojiten, nuk dihet përdorimi i tyre, ose janë sjellë para kohe.

2. — Disa kuadro të dikastereve dhe të ndërmarrjeve janë të prirur për të sjellë makineri, pajisje dhe mallra luksoze, të parakohshme për nevojat e ekonomisë dhe të popullit. Ministria e Bujqësisë importon makina me motor për të mjetë lopët gjatë kullotjes në fushë, në një kohë kur i nevojiten shumë sende ose makineri të tjera më të ngutshme për nevojat e bujqësisë e të blegtorisë dhe me muaj të tërë këto makina dhe motorë po qëndrojnë në arka pranë ndërmarrjeve bujqësore. Kombinati i naftës «Stalin» ka importuar autobuzë luksozë të tipit turistik, shumë të kushtueshëm, në vend që të sillte autobuzë më të lirë dhe më të thjeshtë, por komodë, që mund të plotësonin më mirë nevojat e punonjësve. Ministria e tregtisë importon tipa të kushtueshëm frigoriferësh, makina për larjen e rrobave dhe mallra të tjera, të cilat janë kthyer në mallra mbinormativë në rrjetin e tregtisë.

3. — Shumë serioze është pakujdesia që tregohet për makinat e vjetra, të cilat mund të puncjnë akoma, por në të njëjtën kohë porositen të importohen makina të reja. Lihen pa shfrytëzuar makineri të vjetra, pa llogaritur dëmin që i sillet ekonomisë duke vepruar në këtë mënyrë. Kështu disa ndërmarrje të komunikacionit nxorën jashtë përdorimit mjافت automjete që ishin në gjendje pune, me qëllim që të ulnin planin e transportit. Në Ndërmarrjen Industriale Shtetërore të Tullave dhe në Ndërmarrjen Shtetërore të Riparimit të Makinerive të Rënda të Ndërtimit në Durrës, si dhe në disa ndërmarrje të tjera ekonomike, ka makineri dhe pajisje të vjetra, por në gjendje pune, të cilat nuk përdoren dhe shpeshherë lihen poshtë e lart pa asnjë

kujdes, ndërsa drejtuesit e ndërmarrjeve pa kurrfarë përgjegjësie bëjnë kërkesa të reja për makineri të këtij lloji.

4. — Në planifikimin e importit nuk mbahet para-sysh sa duhet gjendja aktuale e mallrave, si dhe mallrat e kontraktuara, por që vijnë me vonesë, për të nxjerrë kështu nevojat reale për zhvillimin e ekonomisë. Gjithashtu nuk u vihet fre tendencave liberale për të kërkuar çdo gjë nga importi. Si rrjedhim, në mjaft ndërmarrje dhe organizata ekonomike, janë krijuar mbinormativa në materiale e në mallra të importit dhe qështë më keq, nga këto mallra ka shumë pajisje e makineri që nuk vihen në shfrytëzim për mungesë të fronteve të punës. Të tilla raste vërtetohen në ndërmarrjen industriale shtetërore të prodhimeve farmaceutike, më uzinën «Partizani», në ndërmarrjen shtetërore të artikujve farmaceutikë dhe sanitare, në kombinatin e tekstileve «Stalin», në Tiranë, në ndërmarrjen tregtare të shpérndarjes së veglave automobilistike dhe të karburantit, në ndërmarrjen shtetërore të shpérndarjes së mallrave të importit, në bazën tregtare të kooperativave të konsumit, në magazinën qendrore të grumbullimit, në portin e Durrësit etj.

5. — Në porositjen e mallrave të importit bëhen mjaft gabime. Mungesa e studimit të mirë të nevojavc ka bërë që dikasteret qendrore, sidomos Ministria e Ndërtimit, e Bujqësisë, e Industrisë, si dhe ndërmarrjet e tyre, të sjellin nga importi makineri dhe pajisje të tipave që nuk duhen, jokomplete dhe me difekte. Në këtë drejtim ka pasur të meta edhe në punën e organeve të tregtisë së jashtme. Porosi të gabuara për ma-

kineri dhe për materiale importi kanë bërë kombinat i naftës «Stalin», Ministria e Industrisë, e Minierave dhe dikastere e ndërmarrje të ndryshme. Ndërmarrja shtetërore e importit ka sjellë nga jashtë aparate distilimi, frigoriferë, stofa dhe materiale të tjera me difekte, të cilave u ka kaluar koha, ose janë porositur gabim. Më e keqja në këto çështje kaq të rëndësishme është fakti se kundrejt shkaktarëve të këtyre gabimeve kaq të rënda, nuk është mbajtur qëndrimi i duhur nga organet shtetërore dhe nga organizatat-bazë përkatëse të Partisë.

6. — Planifikimi dhe vënia në shfrytëzim e objekteve industriale ka raste që bëhet me të meta, pajisjet nuk vijnë në kohën e duhur, lihen përjashta në shi, prishen dhe dëmtohen. Gjithashtu bëhen gabime në zgjedhjen e makinerive dhe të pajisjeve, duke sjellë tipa makinerish shumë të komplikuara që nuk u dihet teknika e përdorimit dhe shpesh nuk kombinohen me makineritë dhe pajisjet ekzistuese, kështu që nuk i përshtaten procesit të prodhimit.

Veçanërisht, pak vëmendje tregohet për objektet e vogla dhe sidomos për rikonstruksionet. Kështu ka ndodhur që rikonstruksioni i fabrikave të vajit në Tiranë, në Ndroq, në Krujë, në Peqin dhe në Dhërmi të mos bëhet në afat, pasi planifikimi i ndërtimit të tyre nuk është studjuar mirë. Shumë keq ka punuar Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit të Durrësit, i cili pothuajse nuk ka treguar asnjë interesim për ndërtimin e fabrikës së niseshtesë në Shqipëri, makineritë e së cilës ishin shpërndarë andej-këtej, duke u lënë në mëshirën e fatit. Organet qendrore dhe

sidomos ato të ministrive të Industrisë, të Minierave dhe të Gjeologjisë, kanë bërë gabime në zgjedhjen e tipave të makinerive, duke lejuar kështu që në disa raste rikonstrukzionet të mos shërbejnë sa duhet për ngritjen e treguesve tekniko-ekonomikë.

7. — Në importimin e pjesëve të këmbimit ka çrregullime që rëndojnë ekonominë me shpenzime të panevojshme dhe, në të njëjtën kohë, krijojnë vështirësi në funksionimin dhe në mirëmbajtjen e makinerisë. Nuk janë të pakta rastet që sillen nga jashtë pjesë këmbimi mbi nevojat dhe bëhen përpjekje të pakta për zëvendësimin e tyre me prodhime të vendit. Në bazat grosiste të dikastereve në Durrës, në Uzinën e Mekanikës Bujqësore, në ndërmarrjet shtetërore të gjeologjisë, në Ndërmarrjen Shtetërore të Transportit Automobilistik në Tiranë etj., janë krijuar stoqe pjesësh këmbimi, në shumë raste të papërshtatshme. Nga ana tjetër, ka tendenca të dëmshme për të sjellë tipa të shumtë automjetesh, traktorësh dhe makinerish, të cilët shtojnë nevojat për pjesë këmbimi, krijojnë stoqe pjesësh këmbimi ngaqë zëvendësohen tipat me njëri-tjetrin dhe vështirësohen kështu mirëmbajtja e tyre.

8. — Qarkullimi i mallrave të importit bëhet me ngadalësi të madhe, mungon organizimi dhe kontrolli mbi punën e organeve shpërndarëse dhe të transportit. Ka raste të shumta që nga organet e tregtisë së jashtme të shkelen afatet e caktuara në planin e shtetit dhe në kontratë për importimin e mallrave. Nga ana e tyre është bërë zakon që nga njëri vit në tjetrin të krijojen deficite në sigurimin dhe në sjelljen e mallrave, duke vënë në vështirësi realizimin e planit në disa ndër-

marrje dhe duke i sjellë dëme ekonomisë populllore. Ka shumë raste që makineritë, pajisjet dhe materialet, për pakujdesi të organeve të tregtisë, të bazave grosiste të dikastereve, të portit, të hekurudhës dhe të vetë porositësve, qëndrojnë me muaj dhe vjete të tëra nëpër depo dhe nëpër fusha, para se të arrijnë në destinacionin e caktuar. Në këtë mënyrë, përveç dëmtimit që pësojnë këto mallra, pengohet vënia e tyre në shfrytëzim dhe bllokohen fonde të mëdha në sferën e qarkullimit. Në shumë raste, mallrat e importuara shpërndahen në mënyrë mekanike, pa përgjegjësi dhe me destinacion të gabuar nga organet e tregtisë, nga dikasteret porositëse dhe nga organet e transportit.

9. — Janë importuar mallra pa qenë në plan. Këto raste vërtetojnë shkeljen e disiplinës së planit, dhe tregojnë dobësitë e kontrollit shtetëror dhe të organizatave-bazë të Partisë e të dikastereve mbi punën e importit.

\*  
\* \* \*

Të metat e mësipërme janë të palejueshme, sepse ato i sjellin dëme të rënda ekonomisë populllore, bllokojnë fondet valutore dhe pengojnë shfrytëzimin e tyre të mirë. Nga ana tjetër, ato ndikojnë negativisht në edukimin e ndërgjegjes socialiste te punonjësit dhe nuk i mobilizojnë sa duhet ata në luftën e madhe që duhet të bëhet për shkurtimin e importimeve të panevojshme.

Shkaqet e këtyre të metave duhen kërkuar në këto drejtime:

a) Në dikasteret e organet qendrore, në disa drejtues të ndërmarrjeve ekonomike e të institucioneve shtetërore dhe sidomos në Ministrinë e Ndërtimit, në Ministrinë e Industrisë, në Ministrinë e Minierave dhe të Gjeologjisë, në Ministrinë e Bujqësisë etj., ka tendencia për të importuar sa më shumë makineri, pajisje dhe materiale, në disa raste për të krijuar rezerva mbi rezerva, pa marrë parasysh mundësitë ekonomike të vendit. tonë, pa marrë masat e duhura që këto makineri të vihen sa më shpejt në shfrytëzim. Njëkohësisht është nënvleftësuar përdorimi i makinerive të vjetra, të cilat janë akoma në gjendje pune. Në këtë mënyrë, kuadrot drejtues nuk punojnë sa duhet me llogari, tërhiqen nga interesat dikasteriale dhe nuk mbajnë parasysh se sa rëndë e dëmtojnë ekonominë populllore me veprime të tilla.

b) Në punën e planifikimit të importit ka të meta, të cilat u lënë shteg çrrregullimeve. Kuadrot e Komisionit të Planit të Shtetit, nuk janë thelluar sa duhet në planifikimin e importit, i njojin pak gjendjen konkrete dhe nevojat që kanë ndërmarrjet, si rrjedhim ata nuk kanë qenë në gjendje t'u pritnin rrugën kërkesave të fryra dhe pa vend. Kjo të lë të kuptosh se Kontrolli i Komisionit të Planit të Shtetit, ku drejton shoku Koço Theodhosi mbi kërkesat e dikastereve qendrore, vazhdon të mos jetë në nivelin që kërkohet.

c) Në punën e organeve të tregtisë së jashtme që drejtohet nga shoku Kiço Ngjela, ka burokratizëm, nuk ndihet si duhet përgjegjësia e madhe që kanë për t'i bërë drejt porositë e artikujve të importit dhe për t'i sjellë ato në kohë, sipas nevojave që ka ekonomia populllore. Ato vazhdojnë të punojnë dobët për shkurti-

min e importimeve të panevojshme dhe për t'i prerë rrugën importimit të artikujve të tipave të vjetër me difekte, të dëmtuar etj.

ç) Organet e kontrollit, sidomos ato të Ministrisë së Financave dhe të Bankës së Shtetit kanë bërë një punë krejtësisht të pamjaftueshme, bile pothuajse nuk janë marrë fare me këtë çështje shumë të rëndësishme ekonomike.

d) Komitetet dhe organizatat e Partisë, veçanërisht organizatat-bazë të Partisë në dikasteret qendrore, janë marrë shumë pak me shkurtimin e importimeve të panevojshme, me edukimin e komunistëve dhe të punonjësve me ndërgjegjen socialiste për t'i parë të gjitha çështjet në prizmin shtetëror, në interesin e përgjithshëm të shoqërisë. Nga ana e tyre është ushtruar një kontroll i përciptë dhe mjaft i dobët ndaj drejtuesve të ekonomisë, nuk janë vënë ata përpara përgjegjësisë së Partisë, në një kohë që me veprimet e tyre të pastudjuara mirë dëmtojnë ekonominë popullore.

Problemet e kursimit të valutës, të shkurtimit të importit dhe të përdorimit racional të makinerive e të materialeve që sillen nga jashtë, komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë nuk po i bëjnë probleme të të gjithë punonjësve. S'ka dyshim se me një punë më të kujdeshshme, duke aktivizuar punonjësit në këto probleme shumë të rëndësishme ekonomike e duke rritur ndjenjën e përgjegjësisë së njerëzve ndaj detyrës, do të mënjanoheshin shumë nga këto të meta.



Komiteti Qendror i PPSH ka porositur Qeverinë e dikasteret qendrore që të marrin masa të shpejta për t'i dhënë fund gjendjes së rëndë që është krijuar në importin e makinerive, të pajisjeve, të materialeve, të pjesëve të kömbimit dhe të mallrave të konsumit. Organet shtetërore dhe të Partisë, organizatat-bazë të Partisë dhe drejtuesit e ekonomisë duhet të nxjerrin kcnkluzionet e nevojshme që të punojnë me kömbëngulje, në të gjitha drejtimet, për të forcuar ndërgjegjen e punonjësve dhe për të shtuar kontrollin mbi ta, me qëllim që nevojat e ekonomisë sonë popullorë për import të studjohen dhe të përcaktohen sa më drejt. Të shfrytëzohen me çdo kusht e në kohën e duhur makinër, pajisjet, si dhe materialet e tjera, të organizohet më mirë shpërndarja e tyre me qëllim që të shkurtohen sa më shumë fondet e importit, për t'i përdorur ato sa më mirë, pasi kjo është një nga rrugët kryesore për përmirësimin e bilancit të pagesave të shtetit tonë.

Vetëm me një luftë të vendosur dhe të organizuar mirë kundër të gjitha të metave në këtë drejtim mund të vihen drejt në jetë porositë e Partisë që importimi i mallrave nga jashtë të shërbejë me sukses për ndërtimin me ritme të shpejta të socializmit në vendin tonë.

Komiteti Qendror i PPSH thekson se në këtë çështje të rëndësishme nuk duhet bërë asnjë lëshim. Së pari, të metat e vërtetuara të ndreqen pa humbur kohë, dhe së dyti, veprime të tillë të mos përsëriten më, për-

ndryshe ndaj shkaktarëve do të merren masa të rënda, bile edhe penale. Çdo person, çdo institut dhe çdo instancë duhet të përgjigjet për çrregullimet që do të vërtctohen këtej e tutje dhe në këto raste duhet të vihet dorë menjëherë nga organet e shtetit dhe të Partisë.

Komiteti Qendror i PPSH ka besim se organet shtetërore dhe të Partisë do t'i trajtojnë seriozisht këto detyra dhe në të ardhshmen do ta kenë vazhdimisht parasysh këtë problem kaq të rëndësishëm ekonomik.

Kjo letër të punohet sa më shpejt në byrotë e komiteteve të Partisë, në organizatat-bazë të ndërmarrjeve dhe të institucioneve shtetërore, si dhe në kolegjumet e dikastereve qendrore.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

# KUSH ECËN NË RRUGËN E PARTISË, AI DUHET TË LUFTOJË E TË FITOJË EDHE KUNDER VËSHTIRESHIVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

16 prill 1960

Raporti që na është paraqitur bazohet në vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror dhe përbën një pasqyrë të qartë se si është realizuar plani i viti 1959 dhe cilat janë detyrat e viti 1960. Por diskutimet që u zhvilluan në këtë mbledhje duhet të rrihnin më tepër në mosrealizimin e detyrave të caktuara, sepse kjo anë e çështjes ka një rëndësi të madhe.

Sic dihet, detyrat e planit në sektorin e bujqësisë nuk janë realizuar. Unë jam i mendimit se kjo situatë e ka burimin jo në mungesën e bazës ushqimore, sic

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u analizua zbatimi i vendimit të Plenumit të KQ të PPSH «Mbi zhvillimin dhe përmirësimin e dhenve-dhe «Mbi masat për shtimin me një ritëm më të shpejtë të prodhimit të qumshtit dhe të mishit».

thotë Maqoja, i cili i shikon çështjet në mënyrë shumë subjektive, por sepse nuk janë bërë të gjitha përpjekjet. Këtu kanë faj organet e Partisë e të pushtetit, por sidomos Ministria e Bujqësisë. Mundet që detyrat të mos realizoheshin qind për qind, por në qoftë se do të bëhen përpjekje më shumë, realizimi i planit do të ishte më i mirë. Natyrisht, brenda një viti nuk do të bëhej kthesa rrënjosore, por përparimet do të ishin më të mëdha, do të sigurohej realizimi i planit për vitin 1960, ose do të arrihej në përqindjen më të madhe të realizimit të tij.

Sekretarët e komiteteve të Partisë që janë thirrur në këtë mbledhje nuk vunë në dyshim vendimin e Plenumit të Komitetit Qendror. Kjo tregon se ata kanë besim në realizimin e tij. Kjo është pozitive dhe me siguri do të sjellë një mobilizim të ri e më të madh në punën e Partisë dhe të fshatarësisë. Ndryshe e shtron çështjen Maqoja, i cili ka dyshim në vendimin e marrë nga Plenumi dhe kërkon që të ndryshojmë planin, sepse, sipas tij, «është bërë i gabuar». Unë dua të them se ky plan nuk është bërë nga zyra, por është diskutuar në bazë, në rrëth, në Byronë Politike dhe pastaj u shtrua edhe në Plenum. Pra plani ka një bazë, bile një bazë të fortë. Atë nuk e kanë hartuar vetëm specialistët e bujqësisë, por e gjithë Partia. Shoku Maqo ka pasur një rezervë. Në qoftë se ai nuk ishte dakord, me këtë plan, pse nuk e tha me kohë? Përkundrazi, në fund ai ka thënë se detyrën do ta realizojmë. Prandaj ky është një faj i rëndë për Magon. Unë e kam thirrur atë dhe i kam thënë se nuk të lejoj të shkelësh vendimin e Plenumit të Komitetit

Qendror, po në qoftë se ti e shikon se ky vendim është i gabuar, atëherë paraqitja Byrosë Politike që ta shikojë, të bëjmë autokritikë dhe më në fund, t'i themi Plenumit që ta ndryshojë planin. Por të dalë sot Maqoja me fryshtë që «detyrat e planit janë të parealizueshme», ky është gabim i madh. Kjo fryshtë ka vazhduar edhe pas bisedës që ai ka zhvilluar me mua dhe me shokun Mehmet dhe kjo e rëndon atë akoma më shumë me faj.

Pikëpamje të tilla ka edhe në specialistë të Ministrisë së Bujqësisë, të cilët thonë se për të shtuar prodhimin e qumshtit e të mishit duhet kaq ose aq koncentrat. Sipas tyre t'u japim bukë vetëm lopëve e të mos mendojmë për njerëzit. Kjo është në kundërshtim me vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror. Unë jam dakord të caktohet norma ushqimore, por duhet më parë të caktohen treguesit e tjerë dhe jo të nisemi nga dëshira që t'i japim kaq misër pulës, ndërsa njerëzit të mbeten me gojë thatë. Këto çështje duhen studjuar. Mund të ketë shumë të tjera që meritojnë studim, si, për shembull, mbajtja e lopëve të këqija, të cilat nuk prodhojnë qumësht, çështja e zogjve, çështja e bagëtisë së imët në fusha etj. Këto probleme të shikohen së bashku me planin pesëvjeçar dhe pasi të studjohen, po të lindë nevoja, i bëjmë edhe ndonjë korrigjim vendimit të Plenumit të Komitetit Qendror. Ne mund të bëjmë korrigjime, po këto duhet të bëhen në rrugë të drejtë dhe në fryshtë të drejtë.

Për këto të meta unë bëj fajtor kryesor Maqon, i cili edhe në këtë mbledhje të Byrosë Politike nuk bëri asnje farë autokritike. Çfarë jemi ne këtu, mos

vallë nuk i kuptojmë këto çështje dhe i kupton vetëm ai? Po më duket se të gjitha vërejtjet që i kanë bërë Maqos shokët e Byrosë Politike, i kanë hyrë nga një vesh dhe i kanë dalë nga veshi tjetër. Unë them se ai duhet të ndryshojë rrugë, sepse Ministria e Bujqësisë nuk mund të ecë në kundërshtim me Byronë Politike dhe Komitetin Qendror. Këtu nuk është çështja e personit, po e interesit të madh të Partisë. Kush ecën në rrugën e Partisë, ai duhet të luftojë e të fitojë edhe kundër vështirësive. Kur lufton si duhet dhe megjithë-këtë një detyrë nuk realizohet, atëherë mund të shtrohet çështja për ta parë nëse është ose jo e drejtë. Po jo të lexohen libra e të lihen mënjanë vendimet e Komitetit Qendror, të mos luftohet për zbatimin e tyre, siç bën Maço Como.

Është e vërtetë që specialistët tanë të bujqësisë janë njerëz të mirë, sepse, po t'u jepet atyre si duhet direktiva e Partisë, ata bëhen copë për zbatimin e saj. Mirëpo një gjë e tillë nuk është bërë drejt nga Maqoja, i cili me pesimizmin e tij ka çmobilizuar edhe të tjerë. Asnjeli nuk i ndalon shokët në qendër e në bazë që të thonë mendimin e tyre për vendimet e Komitetit Qendror. Kjo duhet bërë medoemos, po jo se kështu më mbushet mendja mua dhe dua të ecë kundër një vendimi. Kjo nuk mund të lejohet. Vendimet e Komitetit Qendror duhen zbatuar.

Unë mendoj se te Maqoja ka mendjemadhësi, prandaj ai duhet të shkundet. Atij i pëlqen mendja e tij, i duket se vetëm pikëpamjet e tij janë të drejta. Ne kënaqemi që shokët tanë të bëhen specialistë të bujqësisë, por duhet të dëgjohen edhe shokët e bazës,

sepse edhe ata kanë eksperiencë. Shoku Maqo nuk bën autokritikë. Unë nuk e kam parë një herë atë që të thotë se këtë gjë e kam parë shtrembër. Ai flet për të tjerët, kurse te vetja e tij s'sheh asnjë dobësi. Kemi shokë të tjerë, që bashkë më punën e mirë kanë edhe gabime, por ata i thonë haptazi dhe i pranojnë. Kështu veprojnë, për shembull, shokët Adil Çarçani e Josif Pashko. Ndërsa kur vjen te Maqoja, nuk ndodh kështu. Edhe shokët e tjerë të rretheve më thonë se e kanë vështirë të bisedojnë me shokun Maqo. Ku është shkaku? Shkaku është te mendjemandhësia.

Për të realizuar planet në bujqësi, për të ngritur rendimentet etj., nuk është një punë e lehtë. Sikur të kishim edhe njeriun më të mbaruar në krye të sektorit të bujqësisë, puna nuk mund të vente mbarë po u shkëputëm nga eksperiencia e bazës siç bën Maqo Çomo. Kjo është vërejtur edhe në kuadro të tjerë të bujqësisë. Prandaj Maqoja duhet të korrigohet. Nuk mund të lejojmë të ecet në rrugë të kundërt. Drejtuesit e bujqësisë kanë eksperiencë, po pikëpamjet e gabuara të ndonjërit duhet të luftohen. Ata duhet të jetojnë me problemet e Partisë, me eksperiencën dhe me vrullin e bazës dhe të ecin kurdoherë në rrugën e caktuar nga Komiteti Qendror.

Unë kam biseduar me shokët e Fierit dhe më kanë thënë se detyrat do t'i realizojnë, prandaj edhe rrethet e tjera duhet të bëjnë një luftë të tillë këmbëngulëse për të zbatuar detyrat. Të mobilizojmë Partinë që në vitin 1960 të arrijmë rezultate të kënaqshme, të realizojmë detyrat, të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë për të arritur objektivet e caktuara nga Komiteti Qendror.

Për të gjitha këto çështje, shoku Hysni të organizojë një mbledhje me specialistët e bujqësisë.

Kisha edhe një çështje tjeter. Sekretariatit i është paraqitur një relacion për kuadrot e bujqësisë. Nga ky relacion del se Ministria e Bujqësisë ka grumbulluar nëpër NB-të shumë specialistë të lartë dhe të mesëm. Në qoftë se Byroja Politike është dakord, unë propozoj që të bëhet një rishikim i kuadrove të NB-ve, për t'i shpërndarë ata në favor të kooperativave bujqësore. Shoku Maqo duhet të ketë parasysh se NB-të nuk janë potenciali i bujqësisë së Shqipërisë, sepse vendimtare në fushën e prodhimit bujqësor janë koooperativat. Në NB-të n'e kemi suksese, por e vërteta është se edhe forca në këtë sektor ka shumë. Në NB-të ka tani një veprimtari të organizuar dhe, po të heqim një ose dy specialistë, puna e tyre nuk do të prishet. Ka koooperativa bujqësore që nuk kanë asnje llogaritar, kurse në NB-të ka një grup të tërë kontabël. Por, siç na ka paraqitur edhe Kryeministria një relacion, koooperativat bujqësore duhet të pregettin vetë kuadrot e lartë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## TE REALIZOJME MIRE DETYRAT PER ZHVILLIMIN E AGRUMEVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

16 prill 1960

Agrumet për vendin tonë kanë një rëndësi të madhe. Lidhur me këtë ne të caktojmë një afat që deri në pranverën e vitit 1962 të realizohen detyrat e caktuara në vendimin e Plenomit të Komitetit Qendror të Partisë për vitin 1960 dhe të mos e lëvizim planin që kemi aprovuar për agrumet. Derisa në Plenum kemi vendosur që gjatë pesëvjeçarit të dytë të mbillen 600 000 rrënjë agrume, atëherë duheshin marrë masat organizativo-teknike për realizimin e kësaj detyre dhe jo të na dalë këtu se «nuk kemi siguruar bazën materiale të nevojshme». Ne kemi të drejtë të pyesim: «Pse nuk janë harxhuar fondet e caktuara

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në analizë zbatimi i vendimit të Plenomit të KQ të PPSH «Mbi zhvillimin dhe përmirësimin e kulturës së agrumeve».

për këtë qëllim nga Plenumi i Komitetit Qendror? Pse janë harxhuar për tjetër gjë dollarët e parashikuar për agrumet? Vendimet e Byrosë Politike nuk mund të shkelen. Prandaj për këto të përgjigjet Ministria e Bujqësisë dhe personalisht ministri, Maqo Çomo.

Është e palejueshme që agrumet e mbjella kanë zënë vetëm 12 për qind. Kjo dëshmon se për këtë çështje nuk është treguar kujdesi i duhur. Një gjendje e tillë ka të bëjë si me plotësimin e nevojave tonë, ashtu dhe me marrëveshjet që kemi me miqtë tanë. Ne propagandojmë se jemi vend i portokalleve dhe i limonave, por detyrat nuk po i plotësojmë. Ministria e Bujqësisë duhet të bëjë kujdes që motopompat që do të sjellim nga jashtë, të mos shpërndahen sa andej-këtej por të jepen me kriter, të mirëmbahen e të ruhen.

Zhvillimit të agrumeve nuk i është kushtuar rëndësia e merituar. Është lehtë të thuhet se «nuk dimë të bëjmë shartime», po këtu del një pyetje: Ç'përpjekje janë bërë për preqatitjen e kuadrit, pa të cilin nuk mund të plotësohen këto detyra që kemi përpara? Edhe për shartimet duhet që kooperativat bujqësore të preqatin kuadrin e nevojshëm.

Sipas detyrave të Plenumit, në qoftë se nuk gabohem, është parashikuar që në Stjar të bëhen breza pyjorë mbrojtës, por në këtë drejtim nuk po shohim që të bëhet ndonjë punë serioze. Po të ecim kështu dhe të vijë ndonjë ngricë, mund të ndodhemi para të papriturave. Prandaj në qoftë se fidanet që kemi vlejnë vetëm për vende të ftohta, atëherë të siguroj-

më të tjera. Të shikohen edhe rezultatet e farërave «nerënë» dhe «trifoliata» që kemi sjellë në vjetët 1956-1957.

Në radhë të parë ne duhet të sigurojmë me fidane bregdetin, por edhe zonat e tjera të mos i lëmë jashtë kujdesit. Orientimin e dhiënë nga Plenumi i Komitetit Qendror duhet ta shikojmë, sepse në kushte të reja ka edhe zona ku mund të mbillen më shumë agrume. Rrethi i Sarandës, për shembull, të orientohet në radhë të parë që të mbjellë me agrume kodrat dhe jo tokat e bukës. Përsa i përket çështjes së largësisë që duhet të kenë agrumet njëri nga tjetri, kjo të shikohet nga teknikët dhe të vendoset. Të merren masa që për agrumet të caktohen një numër teknikësh të lartë, të cilët të kujdesen për rritjen dhe për zhvillimin e tyre.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## PARTIA ËSHTË E FORTË KUR ZHVILLON LUFTËN E KLASAVE DHE ZBATON VIJËN E MASAVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

18 prill 1960

Ne i japim një rëndësi të veçantë popullit dhe organizatës së Partisë në rrëthim e Kolonjës. Populli i Kolonjës është patriot, prandaj organizata e Partisë duhet të punojë më mirë.

Në radhë të parë, në udhëheqje duhet të ekzistojë një unitet i shëndoshë në fryshtë partie. Kam përshtypjen se ti, shoku sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Kolonjës, je i butë. Me këtë nuk dua të them që të hidhesh në ekstrem, të jesh arrogant, por të caktosh mirë detyrat e përgjegjësitë dhe të kërkosh llogari, të mos bësh lëshim ndaj asnijërit. Këtë gjë ne

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua raporti «Mbi gjendjen e organizatës së Partisë në rrëthim e Kolonjës» paraqitur nga aparat i KQ të PPSH.

kemi bindjen se ti mund ta bësh, se edhe shokët e tjerë me të cilët punon kanë eksperiencë.

Përsa i përket kryetarit të komitetit ekzekutiv të KP të rrerhit, mendoj se te ai ka liberalizëm, prandaj kjo t'i vihet mirë në dukje dhe të porositet që të mos mendojë se Kolonja është e kolonjarëve. Në një rrerh mund të punojnë edhe shokë që janë nga rrerthe të tjera, kush mendon ndryshe, kush ka pikëpamje lokaliste, duhet t'i hiqet veshi. Në këtë drejtim duhet të punoni për forcimin e udhëheqjes në frysmin e shëndoshë të Partisë, që shokët të jenë të lidhur me njëri-tjetrin, sepse edhe në rrerhin e Kolonjës ka mundësi që armiku të zhvillojë punën e tij.

Në Kolonjë ka pasur ballistë, bile edhe ekspONENTË TË «Ballit Kombëtar», prandaj shokë të Kolonjës mos bini në qetësi, por forconi vigjilencën dhe zhvilloni luftën e klasave. Kjo nuk do të thotë që të mos shikoni ndryshimin e njerëzve gjatë këtyre 15 vjetëve, por sipas njerëzve duhet hedhur edhe çapi. Ata që bëjnë gabime të sqarohen, ndërsa armiqtë të goditen me forcë. Edhe në këtë drejtim mbështetuni në masat e popullit, se kështu do të forcohet gjithnjë e më shumë dashuria e popullit për Partinë. Në tërë veprimtarinë tuaj mban parasysh se Partia është e forte, përveç të tjerave, edhe kur zhvillon drejt luftën e klasave e zbaton si duhet vijën e masave.

Të mos harrojmë se lufta e klasave zhvillohet edhe kundër shfaqjeve të huaja. Të marrim një çështje: Në Kolonjë, në të kaluarën ka qenë traditë që burrat rrinin me pushkë në krah, ndërsa tani duhet të mbajnë krahas pushkës edhe kazmën për ndërtimin

e socializmit. Në Kolonjë mund të ekzistojë mentaliteti që «ne jemi luftëtarë» dhe ka rrezik që puna të nënveftësohet. Prandaj të punohet që njerëzit të edukohen me dashuri për punën. Përpjekje të mëdha duhen bërë sidomos për zhvillimin e blegtorisë, por kjo nuk do të thotë të lini pas dore misrin dhe grurin. E gjithë puna politike të ketë për bazë sukseset ekonomike, efektet e saj të shihen në rezultatet konkrete të prodhimit. Me siguri, ju do të arrini më tepër suksese ekonomike, por kini parasysh që të mos vetëkënaqeni, sepse këtë mund ta shfrytëzojë elementi armik.

Krahas veprimtarisë së armikut të brendshëm, të mos harrohet për asnjë çast veprimtaria e armikut të jashtëm. Për ju, përveç armiqve të tjerë të jashtëm, ka rëndësi lufta politike kundër monarko-fashistëve grekë. Kjo luftë të konsiderohet një çështje e madhe patriotike. Propaganda kundër monarko-fashizmit grek duhet t'ju preokupojë më tepër. Populli i Kolonjës e di ç'ka hequr nga reaksionarët grekë, prandaj të jeni kurdoherë vigjilentë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## **RENDIMENTET E LARTA NË BUJQËSI ARRIHEN ME LUFTË TË MADHE, ME ORGANIZIM TË MIRE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**18 prill 1960**

Siç e dimë projektplani i pesëvjeçarit të tretë  
është hartuar duke pasur parasysh plotësimin e nevo-  
jave të popullit për të arritur një nivel jetese më të  
lartë. Prandaj, duhet të bëjmë luftë të madhe për të  
realizuar detyrat e planifikuara. Po të pranojmë zbrit-  
jen e shifrave, ky është një falimentim. Ne si Byro  
Politike duhet ta dëgjojmë bazën, por edhe ta orien-  
tojmë e ta drejtojmë.

Për të realizuar planin duhet të shikojmë se ku  
janë të metat dhe t'i korrigojmë ato. Vetëm rritja e  
ditëve të punës në kooperativat bujqësore është një

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi disa pikëpamje që janë  
shfaqur në disa rrethe nga specialistët e bujqësisë lidhur me  
detajimin e planit të pesëvjeçarit të tretë në sektorin e buj-  
qësisë.

rezervë e madhe. Tendenca e disa kuadrove është të neglizhojnë zbatimin e detyrave dhe të kërkojnë rru-gën më të lehtë duke propozuar uljen e shifrave të planit. Ata nuk i shohin drejt objektivet e shtetit tonë, prandaj ne duhet t'ua bëjmë të qarta, t'i bindim që të luftojnë për realizimin e kuotave të caktuara. Diskutimi i shifrave bëhet para aprovimit të tyre, ndërsa pas aprovimit, s'ka më diskutim, por mobilizim për t'i realizuar ato, se ndryshe krijohen vështirësi të mëdha. Ja, për shembull, dje erdhi njoftim nga Moska që nuk na jepin 20 000 tonë drithëra. Po sikur të mos kishim ndihmën e Kinës, si do të bënim? Atëherë, ose do të falimentojmë, ose do të mobilizohemi më shumë për të arritur shifra më të mëdha. Natyrisht, ne do të ndjekim rru-gën e dytë, atë të realizimit të planit. Po a mendon kështu çdo kuadër e specialist? Natyrisht, baza nuk e di që Bashkimi Sovjetik nuk na jep 20 000 tonë drithëra, se po ta dinte nuk do të propozohej nga disa ulja e shifrave për hapjen e tokave të reja, për prodhimin e drithërave të bukës etj. Sikur të ulin planin të gjitha rrëthet, atëherë ku do të dalim? Kjo do të thotë të falimentosh. Ne nuk do të biem në këto pozita, përkundrazi, gjithë Partia dhe populli do të ngrihen në këmbë dhe do të realizojnë detyrat e planit.

Ti, shoku Hysni, duhet të zhvillosh një mbledhje me specialistët e bujqësisë dhe t'u shpjegosh atyre vijën e Partisë, që ata të kenë një kuptim më revolucionar për planin e shtetit. Partia nuk mund të bëjë siç thonë disa specialistë të bujqësisë, të cilët s'kanë besim në forcat e fshatarësisë punonjëse. T'u bëhet

thirrje specialistëve që të vënë të gjitha dijenitë e tyre për të realizuar detyrat e Partisë. Kur specialisti të thotë se do të marrim kaq rendiment, të gjykojë në fryshtë e Partisë dhe jo të niset nga mendimi i gabuar për të qenë «brenda» e të planifikojë shifra të ulëta. Nuk është çështja siç thotë Maço Çomo që «s'kemi caktuar norma për rendimentet». Po përtendencën që të ulet rendimenti, mos vallë janë caktuar norma?

Në bujqësi ne kemi suksese. Po ç'është ai koncept se «kuadrot e bujqësisë u vranë e u lodhën?». Kush mendon kështu, s'është në rregull. Pse u vranë kuadrot e bujqësisë? Mos kanë luftuar më pak ata të industrisë? Kjo fryshtë do të thotë: «Dale të lehtësohemica, se u rraskapitëm». Një koncept dhe qëndrim i tillë nuk është i drejtë, sepse kuadrot e bujqësisë kanë bërë detyrën që u takon. Nuk është mirë që para Kongresit IV të Partisë të mos jenë sqaruar këto koncepte. Prandaj kemi të bëjmë me një problem të madh ideologjik.

Komiteti Qendror ka luftuar dhe lufton që këto çështje të kuptohen në mënyrë revolucionare. Në qoftë se në Vlorë ose në Fier disa kuadro kërkojnë t'u ulet plani i rendimentit, pse s'veprojnë ndryshe, të marrin të gjitha masat e të propozojnë që rendimenti të rritet? Pse të trembemi duke vënë si shkak kohën e keqe? Kushtet atmosferike ne i marrim parasysh, por çështja është që të mos justifikojmë me kohën e keqe dobësitet subjektive e konceptet jomobilizuese, përkundrazi, të diskutohet në fryshtë e Partisë. Me këtë nuk dua të them që të mos bëhen vërejtje e sugjerime.

me, por që Partia të luftojë për realizimin e rendimenteve.

Shokët i dinë vështirësitet ekonomike që kemi, prandaj komitetet e Partisë të qëndrojnë në lartësinë e duhur dhe të mobilizohen për zbatimin e detyrave. Mund të thuhet se për hapjen e tokave të reja duhen traktorë, por s'është e drejtë të thuhet që s'ka toka. Duhet të kemi kujdes se këto nuk janë vetëm çështje teknike, por edhe çështje të mëdha parimore. Detyra e Partisë është që të sqarojë njerëzit se rendimentet e larta arrihen me luftë të madhe, me organizim të mirë. Unë jam i bindur se, po të diskutohet drejt e të vlerësohen si duhet mundësitë e forcat e njerëzve, detyrat e parashikuara në plan jo vetëm mund të realizohen, por edhe të tejkalojen.

Jemi para Kongresit IV të Partisë. Armiku nuk del dot me parullat e Konferencës së Tiranës, sepse ajo situatë ka mbaruar, por ne nuk duhet të harrojmë aspak se ai ndërron taktikat, por jo qëllimet. Prandaj duhet vigjilencë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verballi i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## PA RININË BUJQËSIA NUK MUND TË ECE SI DUHET

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

18 prill 1960

Rinia kudo punon mirë dhe ka rezultate. Partia duhet të mbështetet fuqimisht te rinia. Kjo nuk është vetëm një parullë, por një realitet, sepse nuk ka aksion që të ketë ndërmarrë rinia e të mos e ketë realizuar. Ja sepse Partia ka pasur dhe ka besim të plotë te rinia.

Kur themi se Partia ka pasur dhe ka besim të plotë te rinia duhet të nënkuftojmë edhe anën tjetër që Partia, duke i ngarkuar rinisë një aksion të caktuar, duhet të mbështetë edhe kërkesat e saj. E kemi theksuar dhe herë të tjera se në vendin tonë është krijuar një besim i madh te rinia, por prapëseprapë,

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi zbatimin e aksioneve ekonomike që Partia i ka besuar rinisë», paraqitur nga Komiteti Qendror i BPPSH.

ka disa të moshuar që, kur rinia merr ndonjë aksion, thonë: «Kjo është punë të rinjsh ose kalamanësh». Në qoftë se kjo nuk thuhet hapur, shfaqet në formë të ndryshme për shembull kur rinia nuk mbështetet dhe nuk ndihmohet sa duhet për realizimin me sukses të këtij ose të atij aksioni.

Organizatat e rinisë duhet të bëjnë një propagandë të madhe në drejtim të bujqësisë, me pikësynim që të rinxjtë të mos largohen nga fshati. E themi këtë, sepse ka raste që të rinxjtë nuk duan të qëndrojnë në fshat. Të rinxjtë kanë më tepër mundësi zhvillimi, sepse venë në ushtri, në fabrika dhe në aksione, që janë aq tërheqëse për ta. Prandaj, qenia e tyre në fshat ndihmon shumë në ngritjen e nivelit kulturor e shoqëror. Natyrisht, kjo nuk bëhet me anën e masave administrative, por duke ngjallur te rinia fshatare dashurinë e madhe për bujqësinë. Kjo ka rëndësi të madhe, sepse pa rininë nuk mund të ecë si duhet bujqësia. Në këtë kuadër të shikohen edhe aksionet e ardhshme të rinisë, sepse bujqësia nuk është aksion i vogël, dhe rinia është ajo që do të çojë të renë në fshat. Në qoftë se do të aktivizojmë rininë në fshat, ne do të kemi përfitime të mëdha.

Edhe në ushtri duhet punuar që të rrënjoset dashuria për fshatin e për bujqësinë. Unë isha në një aktiv të ushtrisë dhe shtrova çështjen që oficerët të kenë parasysh se në kohë paqeje do të venë në sektorë civilë. Prandaj, edhe në radhët e ushtrisë duhet të bëhet një punë e organizuar dhe me plan, në mënyrë që të mos e shkëputim ushtarët nga fshati, nga bujqësia, por ta mbajmë të lidhur me të. Nga ana tjetër,

ka njerëz në ushtri që specializohen në përdorimin e teknikës, dhe kjo duhet t'i bëjë ata që, kur të ikin nga anija ose nëndetësja, të ëmarrin në dorë makinën dhe, për një kohë të shkurtër, të bëhen teknikë, të zotët e punës në fabrikë ose në uzinë.

Mund të jetë e drejtë ajo që doli këtu se pemët mbillen në vjeshtë, por mua më duket se Partia duhet të zhvillojë një punë të madhe me rininë, e cila të kuptojë se investimet që bëhen tanë në bujqësi, janë për të ardhshmen e punonjësve, prandaj njerëzit të mos mendojnë vetëm për nevojat imediate. Po e pamë këshlu, për shembull, mbjelljen e pemëve, atëherë zënia e tyre do të jetë mjaft e vogël. Një gjë të tillë fshatari nuk e shikon shumë, kurse rinia duhet ta shikojë, sepse ka të bëjë më të ardhshmen e saj. Me rininë duhet bërë një punë e veçantë për të ngritur nivelin agroteknik.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mblodhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# KUR MERREN ZOTIME, TË MBAHET PËRGJEGJËSI PËR REALIZIMIN E TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

18 prill 1960

Meqenëse në këtë mbledhje të Sekretariatit janë disa sekretarë të komiteteve të Partisë, mendoj të themi disa gjëra të përgjithshme, të cilat duhen mbajtur parasysh prej tyre.

Në radhë të parë është çështja që, kur merren zotime, të mbahet përgjegjësi për realizimin e tyre. Zotimet merren në bazë të planit. Plani nuk hartohet nga lart, por bëhet në bazë, si rezultat i diskutimit me punonjësit, prandaj duhet të ecet me bindje që ai të realizohet. Kjo kërkon që Partia të mobilizohet mirë dhe të luftojë çdo shfaqje të mosbesimit në realizimin e planit. Këtu qëndron roli dhe përgjegjësia e Partisë.

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtuan masat për grumbullimin dhe përpunimin e qumshtit, në bazë të një informacioni të paraqitur nga Drejtoria e tregti-financës pranë aparatit të KQ të PPSH.

Nuk duhet të përzihen dobësitë që ekzistojnë në punën organizuese me kushtet e vështira atmosferike. Kush përpinqet t'i përziejë këto, ai bën gabim. Gjithashtu, nuk duhet menduar se planet tona janë të pastudjuara. Natyrisht vështirësi ka, por kushtet e tanishme nuk janë më ato të vjetëve të kaluar. Nuk është e drejtë të mendohet se në bujqësi ne s'kemi suksese. Ai që thotë se nuk ka suksese në bujqësi, gaban rëndë. Çështja është që t'i përforcojmë sukseset që kemi, të arrijmë rezultate të reja më të mëdha, gjë që është e mundur me luftë dhe me përpjekje, sepse edhe investimet nuk janë të pakta. Rol të rëndësishëm për të pasur më shumë rezultate në bujqësi luan entuziazmi dhe mobilizimi i mëtejshëm në punë.

Kështu duhet t'i shikoni kuotat e caktuara në planin e tretë pesëvjeçar për bujqësinë, ju, shokë të rretheve. Kjo do të thotë që të luftohet për rendimente të larta dhe jo që të parashikohen rendimente të ulëta për të qenë brenda. Ata që mendojnë për të caktuar shifra më të vogla për të qenë brenda, nuk veprojnë në frymën e Partisë.

Projektplani që u shkon rretheve nga lajt, përbën një bazë të shëndoshë dhe është mbështetur në rezultatet e arritura deri tani në bujqësi e në blegtori dhe në mundësitë që kemi për të shtuar akoma më tepër prodhimin. Ky plan që diskutoni mund të duket i madh, por duhet të keni parasysh se është real, sepse bazohet, përveç të tjerave, edhe në ngritjen e nivelit agroteknik e kulturor të fshatarësisë, si dhe në avantazhet e kolektivizimit të bujqësisë. Me këtë plan, ne sigurojmë një rritje më të madhe të nivelit të jetesës së puno-

njësve sesa në pesëvjeçarin e dytë, por që, natyrisht, është e ulët në krahasim me disa vende të tjera të demokracisë populllore.

Duhet të dini se deri tani buxheti ynë është mbështetur në kreditë e dhëna nga shtetet miq. Këto kredi duhen shlyer dhe kjo arrihet me sukses duke realizuar edhe rendimentin e misrit e të grurit që është caktuar për hektar, gjë që është llogaritur dhe ka mundësi jo vetëm realizimi, por edhe tejkalimi. Këto nuk janë vetëm dëshira, por janë mundësi reale. Ndonjë rrëth mund të thotë: si mund të pranohet që rendimenti i misrit të jetë mesatarisht 15 kv për hektar, kur ne në vitin 1959 kemi marrë 8 kv për hektar? Një llogaritje e tillë është e gabuar, sepse nuk duhet të merreshin 8 kv për hektar. Këtu ka pasur të meta të mëdha organizimi e drejtimi, kanë ndikuar edhe kushtet klimaterike. Po të forcohet organizimi, të ngrihet entuziazmi, të shtohet mekanizimi, plehërimi i tokave, agroteknika dhe puna e vetë kuadrove, këto detyra kanë mundësi të realizohen.

Ne u kemi kërkuar miqve të na jadin 20 mijë tonë drithëra, por ja që nuk do të na i jadin. Në këtë gjendje, ne detyrohem i të harxhojmë nga rezervat. Po si mund të lejohet kjo? Duke diskutuar për uljen e shifrave të planit, a nuk është kjo edhe në dëm të rezervës shtetërore? Prandaj plani duhet realizuar medoemos. Me këtë ne nuk themi që të mos diskutohet, por diskutimet të janë në fryshtën e drejtë dhe të shëndoshë të Partisë, në bazë të kushteve dhe të nevojave të vendit tonë, sepse nuk mund të ecet në atë mënyrë, sikurse tha këtu një shok nga rrëthi, që

plani i qumshtit nuk realizohet, meqenëse nuk është realizuar numri i lopëve. Ju, shokë të rretheve, duhet të mendoni si udhëheqës dhe të keni si duhet në dorë situatën, të keni kujdes për të gjitha çështjet, por kryesore është çështja e bukës, po të kemi bukë, do të kemi edhe mish edhe qumësht.

Byroja Politike mendon se mund të rritet si rendimenti i drithërave të bukës, ashtu dhe hapja e tokave të reja. Ndonjëri mund të thotë se ka toka për të hapur, por nuk kemi krahë pune, prandaj duhet të shtohet fuqia motorike. Natyrisht, e mira s'ka fund, por çështja është që të mobilizojmë mirë tërë forcat e punës. Ne kemi nevojë për bukë, prandaj është e domosdoshme të mobilizohemi më shumë, të kapim më mirë lëvizjen e 300-ditëshit. Komiteti Qendror nuk mund të lejojë që të ketë konfuzion dhe të zhvillohen diskutime në fryshtë disfatiste. Ne kemi me mijëra shembuj që njerëz të mrekullueshëm në bujqësi e kanë organizuar punën mirë dhe marrin prodhime të bollshme. Ne kemi kooperativa që kanë marrë prodhime të pakrahasueshme edhe me ndërmarrjet bujqësore. Të gjitha këto duhet të na bëjnë që të luftojmë për realizimin e planit. Kjo gjë nuk duhet thënë vetëm për bujqësinë, por për të gjithë sektorët ekonomikë. Këto duhet të jenë të qarta për udhëheqjen e Partisë në rrëth dhe për anëtarët e thjeshtë të Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **REPARTET XHENIERE TË PUNËS TË PREGATITIN NJERËZ ME PROFESIONE TË NDRYSHME**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**18 prill 1960**

Repartet xheniere të punës duhet të jenë të përgëndruara. Ata që janë efektivë të këtij reparti, kur të çmobilizohen, të venë të punojnë në ato vende për të cilat janë specializuar, si për shembull në bujqësi, në ndërtim etj. Por kjo duhet bërë në mënyrë të organizuar.

Në grupe të caktuara, ushtarët e reparteve xheniere të punës duhet të marrin profesione të ndryshme, për shembull, disa të mësojnë se si të përdorin dinamitin, në mënyrë që nesër, kur këta të shkojnë, për shembull, në miniera, të dinë se si të punojnë. Pra të veprohet në mënyrë të organizuar dhe të gjithë të marrin profesione të ndryshme, sepse kështu do të shërbejnë më

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua relaciioni «Mbi repartet xheniere të punës» paraqitur nga Drejtoria administrative pranë KQ të PPSH.

mirë për ndërtimin e socializmit në degët e ndryshme të ekonomisë sonë. Kur afrohet koha e çmobilizimit, Partia mund të kërkojë që disa pjesëmarrës të reparteve xheniere të punës të qëndrojnë e të punojnë në objektet ku janë sot. Në qoftë se kjo bëhet me anën e punës bindëse të Partisë, në rrugë të drejtë, nuk do të kemi kundërshtime, e të tjerët të venë në fshat.

Duhet menduar edhe për të ardhshmen e ushtarëve që janë bujq ose që kanë profesione të tjera. Me ata të bujqësisë mund të zhvillohen leksione në mënyrë që të mos shkëputen nga bujqësia dhe, kur të venë për të punuar në ndërmarrjet bujqësore shtetërore ose në kooperativat bujqësore, të çojnë frymën e shëndoshë të Partisë. Ata që venë në ndërtim, duhet gjithashtu t'i edukojmë dhe jo vetëm t'u kërkojmë punë.

Natyrisht, repartet xheniere të punës kanë arritur një radhë suksesesh, por dihet se ato nuk kanë pasur shumë disiplinë. Kjo shpjegohet edhe me faktin se këto reparte kanë qenë të shpérndara. Prandaj organet e Partisë në ushtri duhet të punojnë që të forcojnë disiplinën në punë të njerëzve të këtyre reparteve. Edhe çështja e ushqimit të tyre duhet parë. Ata që bëjnë punë të rëndë, të marrin më tepër ushqim, sipas normave që janë caktuar.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## **ORGANIZATAT E PARTISE NË KUFI TË JENE TË FORTA, TË PASTRA, MONOLITE**

*Nga fjala e mbajtur në takimin me ushtarakët  
e forcave të kufirit*

**25 prill 1960**

Ju përshëndes nga zemra, shokë, për festën tuaj, 15-vjetorin e themelimit të forcave të kufirit dhe ju falendëroj për punën tuaj të lavdishme dhe heroike, për patriotizmin e lartë që po tregoni vazhdimisht në çesh-tjen më të shenjtë siç është ruajtja e kufijve të Republikës sonë Popullore!

Mesazhin tuaj unë do t'ua bëj të ditur shokëve të Komitetit Qendror dhë nga ana e tyre dhe imja ju transmetoj juve, të gjitha reparteve të kufirit e të ndjekjes, të gardës dhe të gjithë punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, urimet më të nxehta dhe falenderimet e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë për punën tuaj. Jam shumë i gëzuar që erdhët sot këtu, në aparatin e Komitetit Qendror, jo vetëm se dita e sotme është një datë e shënuar për gjithë Partinë dhe popullin tonë, siç është festa e 15-vjetorit të krijimit të forcave të

kufirit, po jam i gjëzuar gjithashtu që mora takim direkt me ju, oficerë, nën oficerë dhe ushtarë të këtyre reparteve.

Mendimi ynë kurdoherë ka qenë dhe është se ju e keni kryer kurdoherë detyrën me besnikëri të madhe, ashtu sikurse e kërkojnë Partia dhe interesat e popullit dhe të atdheut. Ju e kryeni si duhet këtë detyrë të lartë se jeni bijtë e popullit dhe të Partisë dhe i kuptoni mirë vuajtjet dhe përpjekjet që ka bërë populli shqiptar për t'ia arritur kësaj dite që Shqipëria të bëhet e lirë, e pavarur, sovrane dhe të ndërtojë me sukses socializmin, jetën e lumtur në vendin tonë. Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha këto përpjekje vigane, të gjitha ato rrëke gjaku që ka derdhur populli ynë gjatë historisë së tij, është e kuptueshme që ju, bijtë e popullit shqiptar dhe të Partisë sonë, i keni kryer dhe do t'i kryeni me ndër detyrat që ju janë ngarkuar.

Detyra juaj e kufitarit është nga më të shenjtat, sepse për këta kufij, për këtë truall, populli ynë ka luftuar kundër pushtuesve të ndryshëm dhe tradhtarëve. Imperialistët e kanë pasë copëtuar vendin tonë. Kur u caktuan kufijtë e sotëm të Shqipërisë, atëherë në botë sundonte plotësisht imperializmi, prandaj nuk kishte si të caktoheshin kufijtë e një populli të vogël në mënyrë të drejtë. Në këto kushte, jo vetëm që toka të gjera të atdheut tonë mbetën jashtë këtyre kufijve, por edhe shumë pjesë të kufijve të sotëm u caktuan sipas interesave të imperialistëve dhe jo në bazë të kufijve etnikë, për të lënë brenda këtyre kufijve të gjitha trojet që i përkisnin me të drejtë popullit tonë.

Kufijtë e sotëm të Shqipërisë u caktuan, pra, sipas

interesave të imperialistëve dhe të klikave reaksionare në vendet fqinje me Shqipërinë, që ishin miq të imperialistëve anglezë, francezë, amerikanë, gjermanë etj.

Në konferencat ndërkombe të kaluarën zëri i Shqipërisë as që zihej në gojë fare e jo më pastaj të thirreshin në këto konferenca përfaqësuesit e popullit shqiptar dhe të thoshin fjalën e tyre për mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë. Një gjë e tillë përrpara nuk bëhej, d.m.th. imperialistët, pas luftërave që shpallnin, përcaktonin, sipas dëshirave dhe sipas interesave të tyre dhe të miqve të tyre, zonat dhe kufijtë e popujve, pa marrë parasysh interesat jetike dhe të drejtat e këtyre popujve.

Sidoqoftë Shqipëria, në saje të luftës së popullit shqiptar, arriti t'u imponojë imperialistëve kufijtë e saj aktualë. Por, sikurse e dini, megjithëse u përcaktuan këta kufij në Londër, liria e popullit tonë nuk u sigurua, populli nuk gëzonte të drejtat që i takonin. Në vendin tonë erdhën okupatorë të ndryshëm edhe pas vendosjes së këtyre kufijve, te ne u vendosën regjime antipopullore.

Prandaj u desh që populli shqiptar të ngrihej përsëri në këmbë dhe nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë të luftonte për lirinë dhe për ekzistencën e tij gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në saje të përpjekjeve heroike të popullit shqiptar, u arrit të konsolidoheshin një herë e përgjithmonë kufijtë e atdheut tonë, të bëhen ata të paprekshëm dhe populli shqiptar të vihet në rrugën e lavdishme të ndërtimit të socializmit. Kjo është fitorja më e madhe e popullit shqiptar.

Gjatë këtyre 15 vjetëve ju vetë keni qenë dëshmi-

tarë të sukseseve të mëdha të popullit tonë, të udhëhequr nga Partia jonë, në çdo fushë të aktivitetit; ju keni qenë njëkohësisht dëshmitarë të përpjekjeve të panumërtë që kanë bërë dhe bëjnë armiqëtë e popullit, të Partisë dhe të socializmit për të të dëmtuar ndërtimin paqësor të socializmit në vendin tonë. Ju veçanërisht keni qenë dëshmitarë të shumë akteve armiqësore të zhvilluara nga armiqëtë në kufijtë tanë tokësorë, detarë ose ajrorë. Këto përpjekje armiqësore nuk kanë qenë vetëm në drejtim të thyerjes së thjeshtë të kufijve me diversantë ose me spiunë, por edhe me sulme të tëra kundër integritetit tokësor të atdheut tonë, kundër interesave të Republikës sonë Popullore. Por të gjitha këto akte dhe përpjekje armiqësore, Partia jonë, populli, Ministria e Punëve të Brendshme dhe repartet e saj të sigurimit dhe të kufirit i kanë përballuar me sukses dhe u kanë dhënë grushte vdekjeprurëse jo vetëm spiunëve e diversantëve, por edhe sulmeve të organizuara të forcave të armatosura borgjeze, siç kanë qenë, për shembull, sulmet e armatosura të bëra në kufijtë tanë të Jugut.

Juve ju bie merita nga më kryesoret për mbrojtjen me lavdi, me vetëmohim dhe me heroizëm të kufijve të atdheut tonë. Ju e dini dhe e çmoni mirë se thyerja më e vogël e kufirit nga ana e armiqve i sjell dëm ndërtimit të socializmit te ne. Hyrja e armiqve të veçuar ose në grupe, nga kufiri, ka qëllime të errëta, për të të dëmtuar, në shkallë të vogël ose të madhe, interesat e popullit, të Republikës, të socializmit dhe të paqes. Këto ju i keni të qarta. Prandaj punën tuaj e karakterizon vazhdimisht një patriotizëm i lartë dhe një vigjilencë e

madhe. Ky patriotizëm dhe kjo vigjilencë janë traditë për popullin tonë.

Por patriotizmi dhe vigjilenca e popullit tonë u ngritet në një nivel akoma më të lartë, u bënë akoma më të ndërgjegjshme në saje të udhëheqjes së Partisë sonë, puna e së cilës bëri që të realizohet gjithë kjo kthesë e madhe në historinë e Shqipërisë. Partia bëri që të realizohet një kthesë e madhe edhe në ndërgjegjen e njerëzve, të krijohen njerëz të rinj, që mendojnë, para së gjithash, për interesat e përgjithshme dhe interesat personale t'i lidhin ngushtë me interesat e përgjithshme të atdheut.

Njerëzit e Shqipërisë së re tanë e kuptojnë se jeta dhe lumturia e tyre janë të siguruara vetëm në një republikë demokratike popullore, ku ndërtohet socialistimi dhe ku udhëheq një parti marksiste-leniniste.

Edhe përpëra shqiptarët ishin patriotë, ata e donin shumë atdheun e tyre. Gjyshërit dhe etërit tanë kanë dërdhur shumë gjak për lirinë dhe për pavarësinë e atdheut, por ata nuk arriten t'i siguronin këto, sepse nuk kishin një udhëheqëse të tillë që t'i mobilizonte, t'i bashkonte, t'u hapte horizonte të qarta për të ardhshmen dhe t'u ngrinte ndërgjegjen që të kuptionin se atdheu nuk janë vetëm 4-5 dynymët e tyre ose të fqinjët të tyre, por është e gjithë Shqipëria, se jeta e mirë nuk duhet të sigurohet vetëm për ata dhe për familjen e tyre, por për gjithë popullin shqiptar.

Tani nuk ekziston më mentaliteti i dikurshëm që sa të rroj, të jem mirë t'ne dhe familja ime, pa të tjerët le të bëjnë ç'të duan. Një mentalitet i tillë ka ndryshuar shumë te ne. Partia ngriti ndërgjegjen e popullit në

një shkallë të tillë që çdo njeri, i madh a i vogël, burrë apo grua, mendon që interesat e jetës së tij janë të lidhura ngushtë me interesat e gjithë popullit. Kur populli të jetë mirë edhe familja ose individi do të jetojnë mirë, kur gjithë populli jeton në mjerim, nuk ka lumburi dhe mirëqenie as për individin, as për familjen.

Partia i likuidol pikëpamjet borgjeze dhe mikroborgjeze në këtë çështje kaq të madhe, pa të cilën nuk mund të ngrihej, të forcohej dhe të përparonte vendi ynë, Shqipëria jonë e dashur.

Ju jeni djemtë e popullit dhe të Partisë, të rritur dhe të frysmezuar me idealet e tyre, prandaj këtu e kanë burimin sukseset në punën tuaj, këtu e kanë burimin sukseset e të gjithë njerëzve në Shqipëri, në të gjithë sektorët e punës, sukseset në ndërtimin socialist.

Por një çështje e tillë kaq e madhe për popullin, siç është ndërtimi i socializmit pas Luftës së Dytë Botërore, u shtrua, jo vetëm në Shqipëri, po edhe në vende të tjera të Evropës dhe të Azisë. Raporti i forcave në botë dhe gjendja ndërkombëtare tani kanë ndryshuar aq shumë saqë imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, revisionistët, nuk e kanë më forcën që kanë pasur dikur. Forca e tyre dobësohet dita-ditës. Tani ne jemi më të fortë se ata. Ju këto gjëra i dini pasi në repartet keni punëtorët politikë që ua shpjegojnë. Çështja është që ju asnjëherë nuk duhet të harroni se imperialistët kanë për qëllim skilavërimin e popujve. Por, tashmë atyre u kanë ikur nga duart qindra milion njerëz që i kishin skllavëruar dhe i kishin detyruar të punonin për ta, duke i shfrytëzuar deri në palcë. Kur këta popuj ngrinin krye, imperializmi përpinqej t'i shtypte. Këta

popuj, tani, jo vetëm u ikën nga duart imperialistëve, por janë bërë një forcë kolosale. Qëllimet e veta imperialistët asnjëherë nuk i kanë ndryshuar, ndërsa tani, për shkak të dobësisë së tyre të madhe, ata po ndryshojnë taktikën, por po të gjijnë rastin ata e shpailin edhe luftën. Kjo kërkon që ne të jemi kurdoherë vigjilantë, t'i kryejmë sa më mirë detyrat tonë dheasnje fije të mos i lëshojmë armikut, të mos flemë, të mos na zërë gjumi mbi fitoret e arritura, të forcojmë unitetin tonë. Luftë sivjet, mot, për dy vjet, mund të mos ketë. Ujku qimen e ndërron por zakonin nuk e harron, prandaj në këtë situatë armiku do të përdorë të tjera metoda për të na dobësuar në rast se ne do të biem në gjumë. Një nga mjetet e imperializmit për të na lusluar dhe për të na dobësuar është lufta ideologjike për të na përcarë edhe me anë të agjenturës së tij, oportunistëve dhe revisionistëve modernë.

Pas Luftës së Parë Botërore, kur u thye Gjermania e Kaizerit, në Gjermani ka pasur një lëvizje të madhe revolucionare, në të cilën militonin, Karl Libknehti, Roza Luksemburgu etj. Ky revolucion arriti në një lëvizje shumë të fuqishme, por imperialistët forcuan socialdemokratët, revisionistët e atëhershëm, dhe me ndihmën e tyre arritën të shtypin revolucionin në Gjermani. Pra dhe përpara, kur lëvizja revolucionare merrte hov të madh, dilnin oportunistë dhe revisionistë po aq të rrezikshëm sa janë sot revisionistët modernë sidomos revisionistët jugosllavë që sulmojnë marksizëm-leninizmin. Lenini, Partia Bolshevikë dhe të gjitha partitë e tjera marksiste në Perëndim luftuan pa mëshirë kundër oportunistëve dhe revisionistëve.

Imperialistët për të hutuar dhe për të çorientuar proletariatin, që është kudo forca kryesore e lëvizjes revolucionare, udhëheqësja e masave të gjera populllore për përbërësjen e kapitalizmit dhe për vendosjen e socializmit, përdorin vazhdimit renegatët e marksi-zëm-leninizmit, si armën kryesore ideologjike kundër unitetit tonë dhe në radhë të parë revisionistët modernë.

Qëllimi i tyre është të dobësojnë partitë marksiste-leniniste të të gjitha vendeve, të dobësojnë forcën e tyre revolucionare dhe, po të arrijnë të dobësojnë partinë, ata e kanë lehtë të dobësojnë pushtetin dhe regjimin e demokracisë popullore te ne. Me një fjalë ata e kryejnë më së miri shërbimin që kërkon prej tyre imperializmi.

Mirëpo revisionistët nuk do të kenë sukses ashtu sikurse nuk kanë pasur edhe më parë. Dihet se Lenini ka bërë një luftë të pamëshirshme kundër revisionistëve dhe oportunistëve të kohës së tij që ishin personalitetë të dëgjuara dhe me autoritet të madh si Kautski e Bernshtajni me shokë. Lenini, me vendosmëri dhe argumente të pakundërshtueshme, i demaskoi ata. Prandaj Partia jonë dhe parti të tjera marksiste-leniniste në botë e kanë demaskuar dhe do ta demaskojnë vazhdimit këtë agjenturë të egër të imperializmit. Revisionistët thonë: «imperializmi tani nuk është më agresiv, prandaj nuk duhet bërë revolucion, si më parë, në kohën e Leninit. Tani, vazhdojnë ata, nuk ka më luftë klasash. Atje ku nuk është bërë revolucion punëtorët do ta marrin fuqinë në dorë duke u bërë funksionarë të kapitalizmit dhe në këto kushte dalngadalë do të ndryshojë situata». Kjo është antimarksiste, e nuk mund të

ndodhë kurrë. Kishit parë ju ndonjëherë që një bez ose një aga t'u thoshte fshatarëve: «hajdeni, ore miq, merrni çiflikun se ai ju përket juve që e punoni»? Keni parë ju ndonjëherë ose keni dëgjuar të ketë ndodhur që një fajdexhi t'ua falë borxhlinjve të hollat që u ka dhënë me fajde? Kurrë nuk ka ndodhur një gjë e tillë. Edhe sot ne themi se epoka është me të vërtetë e re, po imperializmi është ai që ka qenë, shtypës i popujve, shkaktar i luftërave, që edhe tani realizimet e mëdha të shkencës kërkon t'i përdorë kundër njerëzimit. Pra imperializmi nuk e ka ndryshuar karakterin e tij. Përderisa ka imperializëm, do të ketë edhe luftë klasash, revolucion, diktaturë të proletariatit. Por revisionistët modernë i kanë likuiduar të gjitha këto parime themelore të marksizëm-leninizmit.

Të gjitha këto që thashë t'i keni parasysh edhe ju në punën tuaj shumë të rëndësishme siç është ruajtja e kufijve të shenjtë të atdheut. Tani nuk kanë ndodhur sulme frontale, bile, siç e dini, ka shumë kohë që sulme të tillë nuk po bëhen. Por duhet pasur parasysh se armiku asnje ditë nuk do të heshtë për të dërguar agjentët e vet në vendin tonë. Tani është koha e agjenturave të maskuara, e hedhjes së diversantëve për të organizuar me anën e tyre lidhjet e informacionit në dëm të Republikës sonë. Prandaj ju duhet t'i përshtateni takтикës së tyre me vigjilencë të përhershme, duke kapur shkelësit e kufirit dhe agjentët dhe, së bashku me organet e tjera të sigurimit në thellësinë e vendit tonë, të asgjësojmë armiqtë për të mos lejuar që të na bëjnë sabotime dhe për të marrë informata.

Kjo nuk do të thotë se ata nuk do të bëjnë edhe

goditje ku të mundin kundër individëve, sikurse kanë bërë shumë herë. Për shembull po të gjunjë ndonjë nga ushtarët tanë të veçuar ose në grupe të vogla edhe do t'i godasin me siguri. Prandaj porositë e Partisë dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme t'i zbatoni me përpikëri të madhe, të mos lejoni të kapërcehet kufiri nga armiqtë, të jeni të matur në veprime dhe të tre-goheni të zgjuar. Pastaj kini parasysh edhe situatën që po kalojmë.

Kini kujdes që në asnjë mënyrë të mos lejohet që të vihet në rrezikjeta e ushtarit. Kur shihni se ushtari vihet në rrezik atëherë qëlloni. Por në radhë të parë, përpjekjet më të mëdha t'i bëni pér t'i kapur shkelësit e kufirit, pasi kapja e një ushtari osc e një oficeri të vendeve kufitare, që shkelin kufirin tonë, ka rëndësi më të madhe nga ana politike sesa ta vrasësh atë.

Pra rëndësi të madhe ka kapja e shkelësve të kufirit, por të keni kurdoherë parasysh që kufiri në asnjë mënyrë të mos kapërcehet<sup>1</sup>. Në rast se shkelësi insiston, pasi të frikësohet duke qëlluar në erë, po të mos dëgjojë të tërhiqet, atëherë i bini në kokë. Pastaj edhe kur ushtari ynë është në rrezik dhë shkelësi i kufirit ndodhet brenda kufirit tonë, prapë qëlloni.

Ushtarët tanë kanë qenë shembullorë dhe nuk kanë bërë asnjë veprim jashtë kufirit tonë, nuk kanë qëlluar. Kështu duhet të veprojnë ata edhe në të ardhshmen, në mënyrë që asnjë incident të mos ndodhë jashtë kufijve. Pala jonë duhet të jetë gjakstohtë, sepse kjo është rruga e drejtë. Prandaj të punoni kurdoherë ashtu

---

<sup>1</sup> Nga armiqtë.

si ka thënë Xerzhinski për punëtorët e sigurimit dhe të kufirit që këta duart t'i kenë kurdoherë të pastra, kokën të ftohtë dhe zemrën të zjarrtë. Shihni, pra, që për këta punëtorë nuk ka formulë më të bukur. Në këtë kuptim ju i keni mbrojtur dhe do t'i mbron si duhet kufijtë e atdheut.

Sikurse keni dëgjuar, si në Greqi, ashtu edhe në Jugosllavi situata është shumë e rëndë. Reaksiuni në Greqi është tërbuar dhe nuk ka javë dhe ditë që atje të mos kalojnë nëpër gjyqe njerëz të ndershëm, patriotë, komunistë e demokratë dhe të dënohen kush me vdekje, kush me burgim të përjetshëm etj. Ky është një terror i egër kundër forcave demokratike në Greqi.

Ju e dini se populli grek është një popull i mirë. Me gjithë terrorin, lëvizja për liritë demokratike tanë në Greqi ka marrë një hov të mirë, që e ka shqetësuar shumë reaksiionin.

Terrori në Greqi ka shpërthyer jo vetëm kundër forcave demokratike, por reaksiuni atje ushqen edhe qëllime revanshiste dhe ekspansioniste mbi Shqipërinë për «Epirin e Veriut». Prandaj reaksiuni grek dhe tradhtarët tanë punojnë që të organizojnë grupe diversantësh aktivë dhe spiunë kundër vendit tonë.

Kjo kërkon që veçanërisht në kufirin me Grezinë ju duhet të jeni shumë vigjilentë, luftarakë, të mos lejoni që të cenohet asnjë çikë kufiri ynë, që të vënë mend qeveritarët grekë e forcat e reaksiionit në Greqi dhe të kuptojnë një herë e mirë se kufiri ynë është i pakapërcyeshëm. Po edhe sikur ndonjë të guxojë të kalojë, atëherë brenda tokës sonë mos e kurseni plumbin.

Në rast se ata duan që ne të tregohemi miq, ne

jemi gati të miqësoheni me ta, por të dihet se kush vjen si armik ne e presim si armik. Prandaj asnje lëshimi të mos bëhet në kufi.

Edhe në kufirin jugosllav të njëjtën vigjilencë dhe vendosmëri të tregoni për mbrojtjen e kufirit.

Puna armiqësore që zhvillohet, pra, në kufijtë tanë është e koordinuar midis këtyre dy shteteve, midis agjenturave të imperializmit. Prandaj vigjilanca e kufitarëve tanë në të gjithë kufirin tonë tokësor duhet të jetë e madhe. Sigurisht armiqëtë nuk kanë çfarë të na bëjnë më tepër, veçse ndonjë veprim me anën e shkeljes së kufijve, por populli dhe Partia kanë në mbrojtje të kufijve bijtë e tyre besnikë që u shkurtojnë këmbët e u shpojnë kokën armiqve. Tjetër gjë ata nuk kanë ç'të na bëjnë dhe si revisionistët jugosllavë, ashtu edhe monarko-fashistët grekë do të falimentojnë si deri sot në këtë veprimitari të tyre.

Situata zhvillohet në favor të forcave revolucionare. Ja për shembull në Korenë e Jugut, sidomos në Seul, kryeqyteti i saj, studentët kanë shpërthyer demonstrata të fuqishme revolucionare dhe Sin Man Rija dha urdhër të shtihej në masë. Kjo e egërsoi edhe më shumë gjendjen se u vranë me dhjetëra dhe u plagosën me qindra studentë, populli u revoltua pa masë saqë po tronditet froni i Sin Man Risë dhe Uashingtoni ka filuar të shqetësohet seriozisht.

Po kështu janë ngritur në demonstrata të mëdha proteste edhe në Afrikën e Jugut me qindra njerëz. Kudo në vendet kapitaliste po bëhen greva të mëdha punëtorësh që paralizojnë jetën ekonomike. Po ç'tre-gjnjë këto? Këto po tregojnë gjithnjë e më qartë për

çdo njeri se sistemi kapitalist po kalbet vazhdimisht. Më parë krizat ekonomike ndodhnin një herë në 8 ose në 10 vjet, kurse tani ato janë më të shpeshta. Edhe vetë SHBA kanë frikë nga një krizzë e madhe ekonomike që është afruar dhe që dëmton në radhë të parë punonjësit.

Të gjitha këto bëjnë që imperialistët t'i kenë popujt kundër, prandaj në qoftë se do të guxojnë të shpërthejnë një luftë të re ata do të marrin një dënim të rrufeshëm, gjë që do të sjellë shkatërrimin e tyre të plotë, përfundimtar.

Në këto drejtime, pra, ju, shokë, duhet të jeni vigjilentë dhe të zgjuar dhe ashtu si e keni mbrojtur kufirin gjer tani, po ashtu vazhdoni ta mbroni, sepse kufiri është gjëja më e shenjtë për atdheun.

Por që ta kryeni me nder dhe si duhet këtë detyrë të shenjtë, duhet në radhë të parë të keni Partinë të fortë në repartet tuaja. Pa Partinë, ashtu sikurse në çdo sektor, edhe në kufi nuk mund të ketë asnje sukses.

Të gjitha sukseset që ka arritur populli ynë pas Çlirimt të atdheut i detyrohen Partisë sonë, vijës së saj të drejtë, forcës së saj revolucionare, entuziazmit dhe hovit të madh të komunistëve që luftojnë kudo në ballë dhe udhëheqin popullin, që dinë ta edukojnë dhe ta organizojnë atë për të kryer detyrat e mëdha që i ka vënë përpëra Partia, të cilat shërbejnë për të siguruar mirëqenien e tij të vazhdueshme.

Prandaj punoni që organizatat e Partisë në kufi t'i keni të forta, të pastra, monolite, që të mos i çajë dot armiku. Dhe që t'i keni organizatat e forta, brumi ekziston, ai është i shëndoshë, sepse komunistët e kufirit vijnë kryesisht nga radhët e punëtorëve e të fsha-

tarësisë punonjëse. Populli ynë pastaj është shumë i mirë, ai ka tradita të lashta patriotike, trashëgon virtute shumë të larta. Por bashkë me to njerëzit tanë trashëgojnë edhe plot mbeturina, likuidimin e të cilave është në gjendje ta bëjë vetëm Partia.

Zemrat duhet të jenë të hapëta në mbledhjet e Partisë, secili të thotë haptazi ç'mendon, të mos ketë frikë nga asnjeri. Nganjëherë mund të bësh edhe gabime, mund të thuash diçka jo të drejtë ose që nuk është me vend, por po e the brenda në Parti, dije se nuk ke bërë gabim, shokët do të të ndihmojnë të korrigjohesh, të edukohesh. Ç'të keqe ka të flasësh hapur në Parti? Përkundrazi, ajo ka vetëm të mira si për Partinë, ashtu edhe për vetë anëtarin. Kurse të thuash pakënaqësira jashtë Partisë, një punë e tillë nuk ndreq, por dëmton.

Kur fëmija ka ndonjë hall, shkon e ia thotë nënës, prandaj edhe komunisti çdo shqetësim ose çdo gjë që e mundon duhet të shkojë e t'ia thotë Partisë. Nëna nuk të vret, nuk ta do kurrë të keqen. Kështu është edhe me Partinë.

Kur është i shëndoshë i tërë kolektivi, shpejt ndrezen edhe gabimet edhe njerëzit. Edhe në një kolektiv prej 4-5 vetash sikur 2-3 prej tyre të kenë vese dhe vetëm 1 ose 2 të jenë të shëndoshë, të shëndoshët duhet të mos lëshojnë në pozitat e tyre, përkundrazi me vendosmëri të punojnë që të përmirësojnë dhe të ndreqin shokët edhe kur ata janë më të shumtë në numër. Këtu qëndron, pra, roli dhe forca e Partisë.

Ju duhet ta doni shumë komandantin tuaj, zëvendëskomandantin dhe ata, gjithashtu, nga ana e tyre, t'ju duan ju si sytë e ballit. Ata duhet të mendojnë se

e gjithëjeta e tyre, i gjithë vlerësimi i tyre për punën dhe për zotësinë e tyre bëhet kur ata të jenë të dashur me trupën, me ushtarët. Komandanti duhet të jetë i sjellshëm me ushtarët, por njëkohësisht edhe i vendosur për zbatimin e urdhërave nga të gjithë vartësit. Atëherë do të vlerësohen mirë si komandanti, ashtu edhe zë-vendësit. Dhe kur një komandant nuk sillet mirë, nuk ka se si të vlerësohet mirë nga Partia.

Urdhri është urdhër, ai duhet zbatuar në kohë dhe plotësisht, sepse përfaqëson një veprim të rëndësishëm. Në rast se nuk e zbaton, nga kjo pakujdesi dëmtohet çështja e madhe e popullit. Prandaj komandanti duhet të jetë ekzigjent, të kërkojë zbatimin e vendimeve dhe që të arrihet kjo Partia duhet të punojë mirë me njërexit, që urdhrin, rëndësinë e zbatimit të tij, ta kuptojnë mirë ushtarët. Kur këta të bëhen të ndërgjegjshëm dinë vetë pastaj si ta zbatojnë. Pra urdhri duhet të shoqërohet me një sqarim të plotë politik. Partia të shohë pulsin e ushtarëve, q'mendojnë, q'bëjnë ata sepse edhe për zbatimin më të mirë të atij urdhri mund të kenë mendime shumë të mira. Prandaj të dëgjohet me vë-mendje edhe zëri i ushtarit, se ai e di mirë gjendjen në terrenin ku jeton. Urdhri do të dalë më i plotë kur të merren parasysh edhe mendimet e ushtarëve. Partia dhe komanda duhet ta dëgjojnë edhe zërin e ushtarëve, ndjenjat dhe dëshirat e tyre, të kenë parasysh vërejtjet, gëzimet dhe hidhërimet, ndryshe marrëdhëni midis tyre do të ishin burokratike.

Ju jeni djemptë e popullit dhe të Partisë, keni ndjenjat, gëzimet dhe brengat tuaja. Prandaj komandanti dhe Partia duhet të jenë sa më pranë jush. Kështu do

të bëhet e pakapërcyeshme posta e kufirit dhe asnëjë nuk do të guxojë të kalojë. Kështu nuk do ta zërë gjumi kurrë ushtarin, ashtu ai nuk do të ketë frikë as nga shiu, as nga era, apo nga bora.

Shokët e qendrës ju duhet t'ju ndihmojnë më shumë për dëfrimin dhe për argëtimin, pavarësisht se ka edhe disa vështirësi për këtë punë. Atje ku jetoni dhe punoni ju, në përgjithësi, janë vende malore, të izoluara, ku nuk mund të vijë dot në shumë raste as automobili, pra edhe kinemaja. Po në krahasim me përpëra tanë diçka po bëhet. Me gjithë përmirësimet, duhet të tregohet akoma më shumë kujdes për postat kufitare në çdo drejtim, që nga furnizimi me ushqim e deri te mjetet e argëtimit.

Nga raportet që kam dhe nga sa më kanë thënë shokët, megjithëse edhe vetë ju mund të më informoni, di se në postat nga pikëpamja ushqimore jeni mirë, po kështu edhe me veshmbathje. Tani mbetet që postat tonë sa të jetë e mundur të zbukurohen, të bëhen më të pastra, të ketë atje libra, gazeta, revista, mjete sportive, çlodhjeje etj.

Ndërtimi i banesave për oficerët e kufirit nuk është e mundur të zgjidhet menjëherë. Për këtë qëllim janë caktuar fonde dhe gjendja është duke u përmirësuar. Për fëmijët e oficerëve që punojnë në postat kufitare të Shqipërisë së Jugut janë marrë masa që të shkojnë me bursë të shtetit në konviktin e Gjirokastrës. Duhen bërë përpjekje që atje ku ka mundësi të sigurohet ndonjë dinamo e vogël që të prodhojë energji elektrike për ndriçimin e postave.

Punët në vendin tonë nuk shkojnë keq. Ekonomia

jonë është vënë në rrugë të mbarë, sido që në disa sektorë ekonomikë kemi akoma vështirësi. Por me kohë ne do të zgjidhim shumë probleme, ashtu sikurse kemi zgjidhur shumë të tjera deri tani.

Ndërtime të mëdha do të bëjmë në pesëvjeçarin e tretë në industri, në miniera, në transport e në bujqësi dhe këto do të ndihmojnë që populli të jetojë më mirë.

Forcë të madhe do t'i vëmë bujqësisë që të kapërcejë vështirësitë aktuale, që të rriten rendimentet e kulturave bujqësore, që populli të ketë më shumë për t'u ushqyer dhe të jetojë më mirë. Do të marrim masa që të forcohet mekanizimi i bujqësisë. Në vitin 1965 na duhet të kemi disa mijëra traktorë të tjerë nga rrith 4 000 që kemi sot. Kjo ka rëndësi shumë të madhe për bujqësinë. Një çështje tjetër është ajo e sigurimit të plehut kimik; në pesëvjeçarin e ardhshëm ne do të ngremë dy fabrika të mëdha plehrash kimike. Rëndësi ka gjithashtu problemi i bonifikimeve të mëdha dhe i ujitjes së tokave. Në fund të vitit 1965 do të arrijnë të ujitim 42 për qind të sipërsaqes së tckës së punueshme.

Të gjitha këto masa, të bazuara edhe në kolektivizimin e bujqësisë, që tani në përgjithësi ka përfunduar, do të ndihmojnë që të rriten rendimentet e kulturave bujqësore e blegtorale, të kemi më shumë bukë, mish, gjalpë, lesh, fruta, zarzavate etj., të ushqehemi e të vishemi më mirë dhe më lirë.

Pesëvjeçari i tretë, pra, do të shënojë një hap të madh përpara nö përmirësimin e jetës së popullit tonë në saje të forcimit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të industrisë dhe të përparimit të bujqësisë. Për kulturën

do të merren gjithashtu masa të rëndësishme, do të zgjerohet edhe më shumë rrjeti i shkollave. Rëndësi të madhe do t'i kushtohet preqatitjes dhe ngritjes së kuadrove për industrinë e veçanërisht për bujqësinë.

Natyrisht për t'i realizuar të gjitha këto detyra duhet të bëjmë përpjekje të mëdha. Kjo kërkon një frymë më të lartë revolucionare, një organizim më të shëndoshë në punë, një luftë më të madhe nga secili për të realizuar detyrat atje ku punon. Çdo gjë varet nga puna. Sa të punosh aq edhe do të marrësh. Toka jonë ka mundësi të japë shumë, por me kaq pak ditë-punë, të kënaqurit me pak, lënia e punës së sotme për nesër që bën fshatarësia jonë kooperativiste nuk ka si të ketë fitime të mëdha nga bujqësia. Fshatarët tanë janë të zgjuar, prandaj po ta organizojë më mirë punën Partia, ata do ta kuptojnë se kjo është rruga e mirëqenies.

Edhe në industri klasa punëtore, megjithëse është e re, me prejardhje fshatare dhe me stazh të paktë, po korri suksese njëra pas tjetrës. Ja, edhe aty fshatarë janë ata që punojnë e që nuk kanë veçse pak vjet që janë larguar nga fshati, por shihni ç'ndryshime kanë bërë sepse punojnë në mënyrë të organizuar. Një ndryshim i tillë duhet të bëhet edhe në fshat.

Vija e Partisë ka qenë dhe është për pjesëmarrjen në shkallë të gjerë të grave në punë. Në krahasim me të kaluarën, gruaja merr tani pjesë në punë në të gjitha fushat e jetës së vendit tonë. Por Komiteti Qendror, duke mos qenë i kënaqur, pasi akoma mund të bëhet edhe shumë më tepër në këtë drejtim, ka marrë disa vendime të reja për këtë problem dhe tani në Parti,

në rini dhe në masat punonjëse në përgjithësi, ka të tjera pikëpamje për gruan, po kuptohet gjithnjë e më shumë se gruaja është një forcë e madhe jo vetëm për punë, po edhe për përparimin e shoqërisë sonë.

Teza leniniste se socializmi nuk mund të ndërtohet pa pjesëmarrjen e gruas duhet kuptuar thellë. Prandaj gruaja duhet të ketë mbështetjen nga të gjithë, se te ne ka akoma fanatizëni, ka akoma shumë hezitime për t'i besuar asaj punë drejtuese. Këto pengesa duhen kapërcyer, se gruaja është përparimtare. Më parë ajo ka qenë shumë e shtypur po tanë është çliruar, prandaj të mos i pritet rruga për të punuar.

Gruaja që del në punë do të bëhet e zonja për të drejtuar dhe për ta çuar punën akoma më përpara. Ajo do të fitojë dituri. Partia dhe vendi ynë kanë nevojë për ngritjen kulturore të gruas. Gruaja është e zonja të bëjë çdo punë si edhe burri, por ajo dallohet veçanërisht për një ndershmëri në punë më të madhe nga të burrit dhe për këtë të mos na vijë keq ne, burrave, po ky është realiteti.

Kur ne të prepatitim mëma dhe motra të tilla siç i kërkon Partia mendoni sa i prepatitur do të jetë brezi ynë i ri. Nënët tona, sado të paditura që ishin, na edukuan në atë mënyrë sa brezi ynë nuk kursen asgjë për Partinë. Po sikur të ishin më të mësuara nënët tona, frytet e punës së tyre do të ishin akoma më të mëdha. Por njerëzit lindin, rriten, punojnë, plaken dhe vdesin. Do të vijë koha që do të na zëvendësojnë brezat e rinj që po rriten, të cilët me siguri do ta bëjnë punën akoma më mirë se ne, sepse do të jenë një burim i dalë nga mëma që do të jenë shumë më të mësuara e shumë më

të zonjat se nënët tonë. Në të ardhshmen, kur gratë do të jenë më të mësuara, djemtë dhe vajzat tuaja do të jenë shumë më të zotë nga brezi ynë.

Të rintjtë e të rejet që janë anëtarë të organizatës së rinisë kanë detyra të mëdha. Atje ku nuk ka organizata-bazë të Partisë, punën politike me masat duhet ta bëjë rinia, sepse Partia jonë ka besim të plotë politik te shokët e rinisë, të cilët, pavarësisht se nuk janë në Parti, duan dhe luftojnë për të vënë në jetë vijën e Partisë. Nga ju, shokë kufitarë, asnje të mos mbetet jashtë organizatës së rinisë sepse ju jeni nga té rintjtë më të dalluar të vendit tonë. Partia të jetë e zgjuar, të punojë me rinninë dhe të sjellë nga radhët e saj gjak të ri në Parti, pasi pa këtë gjak të ri Partia nuk jeton dot.

Partia e komunistëve është partia e së resë, prandaj në radhët e saj ajo duhet të sjellë vazhdimit njerez të rinj. Anëtarët e vjetër të Partisë kanë pjekurinë e tyre që Partia e vlerëson shumë, po vjen koha që ata nuk e kanë më dinamizmin dhe hovin e të riut. Një njeri i shkuar me moshë matet shtatë herë për të prerë një herë, dhe kjo nuk është keq, por i riu i futet me sulm dhe çan malin, si i thonë. Sigurisht të rintjtë mund të bëjnë edhe gabime më shumë, po nuk prish punë, ata do të ndreqen me eksperiencën që do t'u jasin shokët e vjetër. Të rintjtë nga ana e tyre sjellin dinamizmin dhe vullnetin e papërkulur të tyre, i shtyjnë të vjetrit përpara, dhe në të njëjtën kohë të rintjtë mësojnë nga eksperienca dhe nga urtësia e të vjetërve.

Të luftoni që Partinë ta forconi, ta mbani të pastër, të luftohen mbeturinat borgjeze dhe mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve, hatëret, pakënaqësitë, të luftoni

që të zgjidhen me durim e me vendosmëri problemet e vështira. Vështirësi në punë ka kudo, po njerëzit t'i shikojnë ato me guxim dhe t'i kapërcejnë. Duke pasur kurdoherë parasysh interesat e Partisë dhe të popullit nuk duhet të tërhiqeni pas gjërave të vogla. Po për të pasur sukses në këto drejtime duhet të punoni shumë dhe të mësoni me këmbëngulje marksizëm-leninizmin.

Të përvetësuarit e marksizëm-leninizmit mund të jetë edhe ca i vështirë për ju, por ju duhet të gjeni kohën dhe me këmbëngulje të mësoni, sepse nuk janë të paktë te ju ata që kanë mbaruar 7-vjeçaren. Ata që do të vijnë për të kryer shërbimin pas jush do të jenë në numër shumë më të madh që do të kenë mbaruar 7-vjeçaren dhe dihet se po të kesh mbaruar këtë shkollë ke një bazë të mirë për të mësuar më tej.

Për këtë qëllim dega Politike e reparteve ushtarakë të Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të organizojë mirë punën, në mënyrë që mësimet që do të merrni, të jenë aktuale, që teoria të jetë e lidhur me praktikën, mësimet të mos kenë shumë teori që ju të mos i kuptoni dot dhe t'ju ulet kurajoja, po gjëra të thjeshta, që t'i kuptoni me radhë e dalngadalë, e më vonë t'u futeni edhe gjërave të mëdha, të lidhura e të ilustruara me shembuj nga praktika e vendit tonë që ju e njihni. Kështu teoria do të bëhet shumë më e kuptueshme për ju.

Edhe përsa i përket kulturës së përgjithshme, ju nuk duhet të kënaqeni dhe të qëndroni me shkollën që keni bërë. Në shërbimin ushtarak në zonën e kufirit nuk keni mundësi të ndiqni gjimnazin, po mundësi të mësoni keni. Për këtë shokët e degës politike t'ju ndih-

mojnë dhe t'ju shërbejnë mirë me libra, jo vetëm me romane dhe me gazeta, por t'ju sigurojnë, midis të tjera, edhe disa tekste shkolllore. Këtu nuk e kam fjalën për tekste, të matematikës, të fizikës etj., se për t'i mësuar këto duhen mësues, por për tekste të kulturës së përgjithshme, si libra historie, gjeografie, të shkencave të natyrës etj., në mënyrë që me anën e tyre ju të ndihmoheni që t'ju zgjerohet horizonti. Në këtë drejtim ka mundësi që ju të mësoni dhe mund t'ju krijohen këto mundësi, sepse kjo është në interesin tuaj.

Ju duhet të mbani letërkëmbim të rregullt me familjet tuaja, t'u shkruani vazhdimisht prindërve dhe të afërmve tuaj, se edhe ata pastaj do t'ju shkruajnë në rregull. Çështja e familjes, e dashurisë, e harmonisë dhe e forcimit të saj, ka rëndësi të madhe, sepse nga familjet e vogla të veçanta, nga lumturia dhe mirëqenia e tyre varet mirëqenia dhe lumturia e gjithë familjes sonë të madhe, që ne e quajmë Shqipëri, atdheu ynë i dashur.

Dhe sigurisht ai që e do shumë familjen, do edhe fqinjin e tij, fshatin ose qytetin e tij dhe kështu me radhë gjithë Shqipërinë. Po një njeri që nuk do dhe nuk respekton vëllanë ose motrën e tij, nuk ka si t'i ketë të pastra ndjenjat e dashurisë për fqinjin ose për fshatin e tij etj. Ka edhe njerëz që kanë vështirësi në familje, po ato duhet të zgjidhen në mënyrë të drejtë, i vogli të jetë i sjellshëm ndaj të madhit, ndaj pleqve tanë sidomos, që nuk para i kuptojnë disa gjëra të reja. Prandaj në marrëdhëni me ta ne duhet të kemi takt, sepse është e vështirë që plaku ta kuptojë menjëherë të renë. Plaka shumë herë nuk e kupton nusen e djalit,

por edhe nusja merr inat me plakën nganjëherë për hiçgjë.

Gjëra të tilla ngjasin në familje, por njerëzit me mend, njerëzit e Partisë, duhet t'i rregullojnë këto shfaqje në familje, sepse Partia ka për mision të udhëheqë gjithë jetën e vendit dhe jo më gjëra të tilla të vogla.

Kam pasur rast të takohem me shumë fshatarë të zonave kufitare, të cilët më kanë folur mirë për sjelljet dhe për qëndrimet e kufitarëve. Kjo është një gjë shumë pozitive me rëndësi të madhe dhe kështu duhet të vazhdoni edhe në të ardhshmen, sepse ai fshatari që është në kufi jo vetëm është njeriu ynë, po rron edhe në një vend delikat. Prandaj, pa pasur dashurinë dhe mbështetjen e popullit që keni aty pranë, nuk mund ta kryeni mirë detyrën tuaj të shenjtë. Populli ka shumë sy e veshë, kurse në rast se izolohesh, vëtëm dy sytë dhe veshët e tu do të kesh, me ta nuk ke ç'të shohësh e ç'të dëgjosh më parë. Prandaj lidhjet me popullin t'i keni sa më të ngushta, sa më të përzemërta.

Edhe një herë ju falenderoj nga zemra për kryerjen e detyrës suaj fisnike në dobi të atdheut e të popullit, ju uroj gjithnjë suksese në punën tuaj dhe të jeni të bindur se Komiteti Qendror dhe Qeveria ushqejnë për ju kufitarët një dashuri të veçantë.

Rroftë Partia jonë e lavdishme e Punës!

Të rrojë populli ynë heroik dhe punëtor!

Rrofshin kufitarët tanë trima!

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## **NGRITJA E NIVELIT TË LEKSIONEVE, VARET NË RADHË TË PARË NGA VETË PEDAGOGET**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**3 maj 1960**

Në çështjen e kuadrit duhet të nisemi nga mundësitë reale e jo nga dëshirat. Është e vërtetë që prodhimi ka kuadro, po kush do ta bëjë punën e tyre në rast se do t'i heqim ata e t'ua japim shkollave të larta? Kur të kemi kuadro më shumë, do të japim edhe për këto shkolla. Gjendja e kuadrit duhet të përmirësohet dhe kjo do të arrihet brenda mundësive tonë. Por dua të tërheq vëmendjen se në materialin që na është paraqitur nuk thuhet asgjë për preqatitjen e kuadrit, flitet vetëm për nivelin e leksioneve. Po kush do t'i japë këto leksione? S'ka dyshim se për këtë duhet kuadri i nevojshëm.

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua relacioni i Drejtorisë së arsim-kulturës pranë aparatit të KQ të PPSH «Mbi nivelin e leksioneve në Universitetin Shtetëror të Tiranës dhe në Institutin e Lartë Bujqësor».

Jam i mendimit që të mos marrim ndonjë vendim të gjatë për çështjen e leksioneve, po mund t'i japim një këshillë Ministrisë së Arsimit dhe drejtorive të aparatit të KQ që të ndihmojnë nga pikëpamja organizative për përmirësimin e leksioneve. Megjithëkëtë, duhet thënë se ngritja e mëtejshme e nivelit të leksioneve, varet, në radhë të parë, nga puna e vetë pedagogëve. Në qoftë se e kuptojnë mirë rëndësinë që ka edukimi i brezit të ri, ata do të prepatiten dhe do të zhvillojnë leksione me cilësi të lartë, ndryshe do të dalin para studentëve me bagazhin që kanë, pa e zgjegruar më tej diturinë e tyre.

Ne kemi bindjen se pedagogëve nuk u mungon vullneti dhe me bazën që kanë, do të bëjnë vazhdimisht përpjekje për të zhvilluar dijenitë e tyre. Ndonjëri mund të thotë se ndoshta nuk ka libra sa duhet, kjo mund të ndodhë, por e vërteta është se ai që do të ngrejë nivelin e vet, do të kërkojë dhe do të gjejë edhe materialin që i nevojitet. Ne shikojmë se disa pedagogë e bëjnë mirë punën, prandaj edhe të tjerët duhet të ndjekin shembullin e tyre. Në këtë drejtim të punojnë më mirë Partia dhe organizata e rinisë. Rinia duhet të ndihmojë pedagogët dhe studentët. Në qoftë se studentët janë të zellshëm dhe bëjnë pyetje, pedagogu do të detyrohet të prepatitet mirë dhe nuk do të ulet autoriteti i tij para tyre.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## PUNA PËR PRANIMET NË PARTI DUHET TË ZHVILLEHET MË ME PERSPEKTIVË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

4 maj 1960

Çështja që ngriti shoku Rrapo [Dervishi] se nuk është punuar sa duhet që punëtorët të hyjnë në Parti, duhet të na preokupojë. Mundet që kjo të mos ndodhë kudo, por derisa ngjet në Tiranë është edhe një sinjalizim që na tërheq vëmendjen për të shtuar kujdcsin në rrethe të tjera. Problemi është që të punohet për të ngjallur te punëtorët dëshirën për t'u pranuar në Parti. Natyrisht, ne nuk mund të futim në Parti të gjithë punëtorët, sepse në radhët e Partisë hyn një pjesë e klasës, pjesa më e ndërgjegjshme dhe më e përparuar e saj, këtë duhet ta kemi mirë parasysh. Nga ana tjetër, në gjirin e punëtorëve ka edhe nga ata që kanë ardhur

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në analizë zbatimi i detyrave të Kongresit III të PPSH mbi përbërjen dhe shpërndarjen e forcave të Partisë.

dje nga fshati dhe pas një viti kërkojnë të pranohen në Parti. Këtë s'mund ta marrin si një punëtor të formuar.

Ashtu si shokët edhe mendimi im është se në lidhje me pranimet në Parti ka pasur përmirësime, në radhë të parë në pranimin e elementeve që vijnë nga klasa punëtore. Megjithatë punën e praninieve në Parti nga radhët e klasës punëtore nuk duhet ta dobësojmë, por ta forcojmë gjithënjë e më shumë.

Një nga kërkesat ndaj punëtorëve që do të pranojmë në Parti është që ata të jenë me kualifikim teknik, kjo do ta shtyjë edhe atë që dje ka ardhur nga fshati të bëjë luftë për ngritjen e tij teknike. Në qoftë se ai është i kualifikuar do të jetë shembull edhe në realizimin e planit të prodhimit. Kjo çështje varet shumë nga kuptimi që i jep organizata-bazë. Ajo mund të thotë se ky njeri sot nuk është i zoti, por ka të dhëna të tilla që do ta përvetësojë teknikën. Të mos harrojmë se ka edhe ndonjë që fiton kualifikim me qëllim që të sigurojë më shumë të ardhura. Prandaj cilësitë e njerëzve duhet të shikohen në rrugën revolucionare të Partisë dhe jo në rrugën burokratike. Detyra për pranimin e punëtorëve në Parti ka rëndësi të madhe. Realizimi i kësaj detyre kërkon një punë serioze e të organizuar. Numri i të pranuarve me gjendje punëtore nuk duhet të bjerë. Gjatë këtyre 15 vjetëve te ne është shtuar numri i klasës punëtore, prandaj këtej e tutje pranimet nga klasa punëtore duhet të vijnë duke u rritur.

Në fshat duhet të punohet më shumë për të gjallëruar organizatat atje ku është e nevojshme dhe të luftohet për të ngritur organizata-bazë atje ku nuk ka.

Kooperativa bujqësore nuk mund të ecë në qoftë se nuk ka organizatë-bazë partie, që ta udhëheqë e ta shpjjerë përpara. Këtu është e domosdoshme të koordinohet puna e pranimeve në Parti, e njerëzve që kanë luftuar me ata që janë të rinj dhe punojnë e dallohen në punë dhe si aktivistë shoqërorë.

Për nëpunësit duhet të jemi më të shtërnguar. Kam përshtypjen se pranohen shumë nëpunës, gjë që duhet ta shohim. Edhe ata pak nëpunës që do të pranohen duhen parë se cilët janë, sepse ka prej tyre që janë vërtet të mirë dhe kërkojnë të futen në Parti, por ka edhe karrieristë. Po kështu nëpunësit që do të pranohen, të vijnë nga ata që punojnë në vende kyçë e që duhet të janë komunistë.

Pranimin e elementeve të rinj, Partia duhet ta shikojë në prizmin e luftës për ndërtimin e socializmit dhe për ruajtjen e pastërtisë së radhëve të saj. Tani nuk jemi në kushtet e Luftës Nacionalçirimitare, por ndërtojmë socializmin. Edhe kjo është luftë, në procesin e së cilës duken edhe ata që duhen pranuar në Parti. Atje ku është lufta më e madhe atje duhet të bëhen edhe më shumë pranime në radhët e Partisë.

Puna për pranimet në Parti duhet zhvilluar me perspektivë. Nuk e di se si kanë dalë përqindjet orientative për pranimet në Parti, por do të ishte mirë që këto të vinin nga baza dhe të janë rezultat i një studimi serioz. Kjo punë do t'i nxitë edhe më tepër komitetet e Partisë për ta vlerësuar akoma më shumë problemen e pranimeve në Parti. Pa u bazuar në studimet e komiteve të Partisë të rretheve, ne e kemi vështirë të jemi sa më objektivë në caktimin e përqindjeve, pra do të gabo-

hemi. Do të vepronët mirë Komiteti i Partisë i Qytetit të Tiranës sikur të bënte një studim në bazë të përbërjes së popullsisë, të sektorëve të punës dhe të dilte me orientime e me perspektiva për pranimet gjatë dy vjetëve të ardhshëm.

Të marrim sektorin e tregtisë. Me anë të studimit do të konkretizohet se sa punonjës ka ky sektor, sa prej tyre nuk mund të pranohen, sa mund të pranohen gjatë dy vjetëve dhe të caktohen detyra për preqitjen dhe për edukimin e tyre. Po të bëhet një studim i tillë për të gjitha organizatat-bazë, atëherë do të dalë një orientim më i drejtë në caktimin e përqindjeve për shtresat e veçanta.

Eshtë e domosdoshme që të zhvillohet një punë më e mirë për pranimin e shoqeve në Parti. Ka gra punëtore, kooperativiste, mësuesc, inxhiniere, që punojnë pa u lodhur për zbatimin e vijës së Partisë. Çështja që gratë të ngrihen në vende drejtuese është e drejtë dhe këtë nuk duhet ta neglizhojmë, por në Parti do të futen ato që e meritojnë. Të mos pranosh në Parti gra në një kohë kur ka prej tyre që e meritojnë plotësisht, është krim. Partia duhet t'i ndihmojë e t'i nxitë ato që të luftojnë me të gjitha forcat e tyre për çështjen e Partisë e për realizimin e planit të shtetit dhe të kërkijnë të bëjnë pjesë në radhët e komunistëve.

*Botohet për herë të parë sëpas tekstit të nxjerrë nga proces-verballi i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## TE KUPTOHET DREJT NEVOJA DHE RENDESIA E INFORMIMIT TE PARTISE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

4 maj 1960

Komititetet e Partisë të rretheve është e domosdoshme të na dërgojnë informacione të shkurtëra. Kur nuk ka çështje që duhet njofuar Komiteti Qendror, atëherë nuk është nevoja medoemos të na shkruajnë. Por ka edhe probleme për të cilat mund dhe duhet të informohet Komiteti Qendror. Ja, për shembull, nuk mund të lejohet që në kufirin e Korçës e të Gjirokastërës të ndodhë diçka dhe Komiteti Qendror të mos e dijë. Ky nuk është qëndrim i drejtë.

Praktika na tregon se komitetet e Partisë nuk na informojnë për probleme të tillë me karakter politik dhe ideologjik. Në nuk kërkojmë raporte ose analiza

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi zhvillimin e fushatës për dhënie llogari e zgjedhje në organizatat-bazë dhe në konferencat e Partisë

për gjithë gjendjen e rrethit, por të njoftohemi herë pas herec për çështje me rëndësi që dalin në rreth. Këto informacione duhet t'i dërgohen Komitetit Qendoror në kohë dhe jo «si kofini pas të vjele». Në qoftë se në Tiranë ndodh një gjë dhe Komiteti Qendoror njoftohet «pas një viti», atëherë një informacion i tillë nuk ka asnjë vlerë. Kjo nuk do të thotë që shokët e rretheve të vrashin mendjen se përsë t'i shkruajnë Komitetit Qendoror. Jeta i nxjerr vetë problemet, mjafton që të kuptohet drejt nevoja dhe rëndësia e informacionit të Partisë nga baza deri në qendër.

Këtu u diskutua edhe çështja e komisioneve të ndryshme për probleme të Partisë. Kjo nuk ka ndonjë gjë të keqe, puna është që komisionet të mos jenë formale, por të aktivizohen për zbatimin e detyrave të caktuara. Çdo komision që ngrihet të ndihmojë komitetin e Partisë për ta mbajtur atë në korrent në lidhje me problemet e ndryshme. Në këto komisione është mirë të ketë përfaqësues nga organizatat e masave, nga arsimi etj., sipas problemeve që duhen zgjidhur. Me komisione mund të veprojë edhe organizata-bazë e Partisë, pranë së cilës të ketë një aktiv të gjerë njerëzish.

Ta marrim si shembull një organizatë-bazë. Parasaj shtrohen detyra të tillë si: të aktivizojë organizatën e rinisë e të gruas, të realizojë detyrat e bujqësisë etj. Problemët janë nga më të ndryshmet. Një nga këto mund të jetë mbrojtja e pronës socialiste, atëherë krijohet një komision për ta parë këtë çështje. Kështu mund të krijohen edhe komisione të tjera për çështje të caktuara e në kohë të caktuar.

Kisha për të theksuar edhe diçka tjetër. Mjaft sekretarë të organizatave-bazë të Partisë nuk punojnë për të aktivizuar mirë të gjithë komunistët. Më duket se ata që dinë të flasin ose të shkruajnë bukur janë më të preferuar për t'u aktivizuar. Kjo bën që nga këta të zgjidhen në udhëheqje. Nuk them që në udhëheqje kudo të zgjidhen sekretarë partie punëtorë, por atje ku janë mundësítë duhen zgjedhur pikërisht punëtorë, të cilët në fillim mbasse s'dinë të drejtojnë, por kanë cilësi të tjera të mira dhe do të mësohen e do të aftësohen për sekretarë organizate.

Komititetet e Partisë të rretheve duhet të luftojnë me ashpërsinë më të madhe shfaqjet e karrierizmit dhe grindjet që manifestohen në disa organizata-bazë dhe në byrotë e tyre, sepse këto të çojnë edhe në mosmarrëveshje politike. Komunistët nuk janë në Parti për të siguruar privilegje. Të gjitha këto kanë të bëjnë me edukimin. Kjo ka rëndësi të madhe. Komunistët duhet të luftojnë për të zbatuar deri në fund vendimet e Partisë dhe të Qeverisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**TELEGRAM URIMI DËRGUAR KQ TË PK  
TË INDONEZISË ME RASTIN E 40-VJETORIT  
TË THEMELIMIT TË PK TË INDONEZISË**

**22 maj 1960**

**KOMITETIT QENDROR  
TË PARTISË KOMUNISTE TË INDONEZISË**

**X h a k a r t ē**

**Të dashur shokë,**

Me rastin e festës së 40-vjetorit të themelimit të Partisë Komuniste të Indonezisë, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, në emër të të gjithë komunistëve dhe të popullit shqiptar, ju dërgon përvetësimin më të përzemërta dhe vëllazërore.

Partia Komuniste e Indonezisë, e mbështetur në mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, ka luttuar gjithmonë me vendosmëri kundër shfrytëzimit kolonial të imperialistëve holandezë dhe japonezë, përlirinë dhe pavarësinë e vendit, përmbrojtjen e interesave jetike të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve të Indonezisë, për përparimin ekonomik e social

të atdheut të vet. Në këtë luftë të gjatë dhe të vështirë 40-vjeçare, Partia juaj u rrit dhe u forcua nga pikë-pamja organizative dhe ideopolitike.

Partia Komuniste e Indonezisë, në pararojë të mësive punonjëse, mori pjesë aktive në preqatitjen e proklamatës së pavarësisë, në formimin e republikës indoneziane në vitin 1945, duke luftuar kundër ushtrive japoneze, britanike dhe holandeze. Sot ajo si frymëzuese e Frontit të Përbashkët Kombëtar, lufton me vendosmëri kundër ndërhyrjes së imperialistëve të huaj dhe kundër reaksionit të vendit për ta çuar deri në fund revolucionin demokratik të filluar më 1945, për pavarësinë e plotë të vendit, për çlirimin e Irianit Perëndimor nga zgjedha e pushtuesve holandezë.

Duke zbatuar me urtësi marksizëm-leninizmin, në kushtet konkrete të vendit, Partia Komuniste e Indonezisë ka luftuar dhe lufton me konsekuençë kundër revizionizmit modern si dhe kundër çdo shfaqjeje të huaj për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, për forcimin e unitetit të radhëve të partisë. Si një parti e sprovar e tipit leninist ajo jep sot një kontribut të shquar për forcimin e unitetit të çeliktë të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, për forcimin e solidaritetit ndërkombëtar të punonjësve në fryshtën e internacionalizmit proletar, për triumfin e fryshtës dhe të parimeve të Bandungut, për triumfin e politikës së bashkekzistencës paqësore, për paqen dhe për miqësinë midis popujve.

Partia e Punës e Shqipërisë, e cila ushqen ndjenjat më të sinqerta të miqësisë për Partinë Komuniste të Indonezisë, u uron nga zemra gjithë komunistëve indo-

nezianë suksese të mëtejshme në luftën e tyre për të mirën dhe për lumi turinë e popullit punonjës të Indonezisë!

Rroftë Partia Komuniste e Indonezisë!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **NDËRTIMET KËRKOJNË NJË ORGANIZIM DHE DREJTIM MË TË PËRSOSUR**

*Fjala e mbylljes në Plenumin XVI të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**26 maj 1960**

Dëshiroj të them edhe unë disa fjalë. Ky Plenum ka një rëndësi shumë të madhe pasi ka të bëjë me ndërtimet në vendin tonë, një nga sektorët jetikë për zhvillimin e ekonomisë sonë popullore, për zhvillimin e forcave prodhuese, për ngritjen e mirëqenies së masave tona punonjëse. Të gjitha veprat që kemi ndërtuar dhe do të ndërtojmë, fabrikat, shkollat, bonifikimet e mëdha, rrugët, urat etj. janë fryt i duarve të ndërtuesve tanë dhe sikurse thuhet në raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH këto vepra duhen konsideruar

---

<sup>1</sup> Plenumi XVI i zgjeruar i KQ të PPSH, që zhvilloi punimet më 25 dhe 26 maj 1960, dëgjoi dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Për një zhvillim të mëtejshëm të ndërtimeve, për ngritjen e tyre në një shkallë më të lartë teknike, që t'u përgjigjen në kohë dhe si duhet kërkesave gjithmonë në rritje që shtron ndërtimi i vrullshëm i socializmit në vendin tonë».

si një sukses shumë i madh i politikës së Partisë në fushën e ekonomisë.

Këto vepra u ndërtuan së pari, për arsyet të vijës së drejtë të Partisë sonë, të proporcioneve të drejta që janë mbajtur gjatë dy planeve pesëvjeçare në lidhje me zhvillimin e gjithanshëm të vendit, të mobilizimit dhe të edukimit të popullit dhe të të gjithë kuadrove tanë të ndërtimit, faktorë pa të cilët nuk mund të arrihej ndërtimi i gjithë këtyre veprave.

Së dyti, sukseset dhe të metat që janë vërtetuar gjatë kësaj kohe në zhvillimin e ekonomisë duhet të na shërbejnë për të ardhshmen, për të cilën jemi të gjithë të ndërgjegjshëm se do të jetë e ndritur. Kjo e ardhshme varet nga duart e punonjësve tanë, në radhët e të cilëve zënë një vend shumë të rëndësishëm punonjësit e ndërtimeve.

Në planet tona të ardhshme, duke filluar që nga pesëvjeçari i tretë, do të investojmë shuma të mëdha, veçanërisht në sektorin e ndërtimeve. Do të investohen, mund të themi, gati sa dyfishi i ndërtimeve të pesëvjeçarit të dytë. Që të realizohet gjithë ky plan madhështor, siç theksohet në raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH, siç u theksua edhe nga shumë shokë që diskutuan, duhet që Partia, pushteti dhe kuadrot tanë të marrin një sërë masash urgjente dhe të domosdoshme, siç u radhitën në raport dhe në diskutimet, duke i dhënë secilës rëndësinë e vet.

Për realizimin e gjithë këtyre detyrate të mëdha, në të ardhshmen do të merren edhe masa të tjera, pa të cilat nuk mund të ecet përpara, si për shembull, masa për preqatitjen dhe për edukimin e kuadrove, që

ata të jenë të aftë për të zgjidhur gjithë këto probleme të mëdha që shtron përpara Partia.

Në të ardhshmen ne duhet të ndërtojmë më shpejt, më mirë dhe më lirë. Një nga detyrat kryesore për arritjen e këtij qëllimi është hartimi i projekteve. Realizimi i kësaj detyre kërkon kuadro dhe ne, brenda një kohe të shkurtër, nuk mund të pregetitim në shkollë aq kuadro sa na duhen. Kjo nuk duhet të na dekuarajojë dhe të na pengojë të mobilizohemi për punë akoma më të mëdha.

Përveç burimeve kryesore për pregetitjen e kuadrove, kemi mundësi të nxjerrim edhe mjaft kuadro nëpërmjet shkollës së jetës, nga praktika. Prandaj t'i kushtojmë shumë kujdes organizimit më të mirë të punës dhe forcimit të disiplinës së saj, si dhe mësimit të punonjësve të ndërtimit me metodat më të përparuara në fushën e ndërtimeve. Këta do të jenë faktorë të rëndësishëm për të plotësuar mungesat e përkohshme që kemi akoma për kuadro të lartë teknikë.

Është fakt se ne kemi ndërtuar gjithë këto veprame rëndësi të madhe për ekonominë e vendit tonë, jo me shumë inxhinierë e arkitektë. Për ngritjen e veprave të reja ne kemi aktivizuar edhe shumë njerëz të tjerë që kanë fituar një praktikë shumë të mirë në jetë. Prandaj lufta për nxjerrjen e kuadrove nga praktika, krahas me pregetitjen e tyre në shkolla, nuk duhet të lihet mënjanë. Edhe për një kohë relativisht të gjatë ne do të kemi mungesa kuadrosh edhe në sektorin e ndërtimeve, edhe në atë të projektimeve. Prandaj një nga format e pregetitjes së kuadrove të jetë edhe praktika.

Shumë njerëz që diskutuan këtu kanë qenë punëtorë të thjeshtë, që nuk kanë mbaruar as shkollën 7-vjeçare, por ata sot kanë marrë përsipër të drejtojnë vepra ku investohen nga 100-200 milion lekë. Ja këtu foli shoku Ferhat Pupuleku që punon në Cërrik. Ai është babë i 6-7 fëmijëve, megjithatë pas punës ndjek edhe shkollën 7-vjeçare, duke qenë i ngarkuar me drejtimin e punimeve me rëndësi në Cërrik. Megjithëse është pa shkollë, si dhe shumë shokë të tjerë, ai bëri këtu plot vërejtje të vlefshme.

Por ne kemi edhe kuadro me shkollë të lartë, që edukojnë dhe ndihmojnë nga afër kuadrot që kanë dalë nga praktika dhe të gjithë punojnjësit e ndërtimit. Këta janë kuadro të vjetër dhe kuadro që kanë mbaruar shkollat pas Çlirimit. Partia i falenderon si kuadrot e vjetër, patriotë, që punojnë me ndërgjegje për lulëzimin e vendit tonë, ashtu edhe kuadrot e rinj, të cilët të gjithë së bashku, në unitet dhe me frymën e Partisë kanë vënë të gjitha forcat dhe punojnë për të mirën e popullit.

Komiteti Qendror i Partisë, Byroja Politike e KQ të PPSH dhe Qeveria e vlerësojnë lart punën e të gjithë kuadrove që punojnë në ndërtim, pavarësisht se herë -herë ata edhe kritikohen për të metat që kanë, ose për gabimet që bëjnë. Kjo ata nuk i dekurajon se është vështirë që të gjenden të tillë që të mos bëjnë gabime dhe të mos kenë të meta. Në punë njerëzit do të kenë edhe të meta e gabime, por në përgjithësi kuadrot e ndërtimit bëjnë një punë të mirë, me vullnet, me guxim dhe me perspektivë. Ata po bëjnë përpjekje sericze për ta përmirësuar punën e tyre. Këtë e treguan edhe

diskutimet me nivel të lartë që bënë këtu shokët e sektorit të ndërtimeve, me të dhëna e me shifra konkrete, me propozime shumë të vlefshme, si edhe me kritikë për punën e tyre dhe të shokëve.

Më kanë treguar se si inxhinier Thoma Filipeu, në kohën kur do të bëheshin argjinaturat e lumit Shkumbin, e kuptoi se, sipas punimeve të parashikuara, do të mbyteshin fushat, prandaj ai ngriti zërin deri në Qeveri dhe kështu u shpëtuan fushat nga përmbytja. Të tillë teknikë dhe punonjës kërkon populli dhe Partia jonë. Ata do të jenë kurdoherë të nderuar nga Partja, nga Qeveria dhe nga populli ynë.

Shumë shokë bënë këtu propozime dhe sugjerime shumë të vlefshme. Mjaft prej tyre që u bënë nga shokët diskutantë nuk ishin prekur dhe nuk mund të prekeshin me hollësi në raportin e Byrosë Politike, por ato duhet të vihen në jetë. Prandaj, ato të nxirren dhe të bëhen objekt i një diskutimi të gjithanshëm e serioz nga shokët drejtues të sektorëve të ndërtimit. Edhe në rast se një propozim përmban elementë që nuk mund të realizohen brenda një kohe të shkurtër, për arsyе financiare, megjithatë të mos lihet në harresë. Çdo propozimi t'i caktohet afati dhe, kur t'i vijë radha, të vihet në zbatim. Çdo propozues duhet të ketë satisfaksion për propozimin e tij, për konkluzionet e punës së tij dhe ta dijë që në këtë ose në atë kohë propozimi i tij do të zbatohet sepse kjo është në interes të ndërtimit të vendit tonë. Në rast se propozimi nuk ka leverdi ekonomike, t'i shpjegohet autorit se teza, shpikja ose metoda e propozuar prej tij nuk mund të vihet në zbatim. Pra, shokët drejtues të ndërtimit t'u kushtojnë kujdes

propozimeve që u bënë këtu dhe për ato që do të rezultojë, se kanë interes të vihen në jetë, të merren masa për zbatim.

Si në raport ashtu edhe në diskutimet u theksua se në ndërtimet nuk mund të ecet me metoda primitive, prandaj, për të ndërtuar shpejt, mirë dhe lirë sot dhe në të ardhshmen, kur ndërtimet do të janë akoma më të koniplikuara, neve do të na duhen më shumë mekanizma. Tani ne disponojmë një numër të konsiderueshëm mekanizmash, por, megjithëse të pamjaftueshme, nuk vihen plotësisht në shfrytëzim, për shkak të të metave serioze në përdorimin e tyre.

Shokët që punojnë në ndërtim përpiken dhe janë të ndërgjegjshëm, por forma e organizimit të punës, disiplina në punë dhe kontrolli i organeve të Partisë dhe të pushtetit nuk janë në lartësinë e duhur. Planet dhe projektet e ndërtimeve, për një arsy e ose për një tjetër, objektive apo subjektive, nuk studohen si duhet. E kam fjalën kur janë të gjitha mundësitë, se ka edhe gjëra që nuk varen nga ne, sepse ka raste që edhe për ato që varen nga ne, krijohet një farë konfuzioni dhe nuk shfrytëzohen sa duhet mundësitë që kemi, si mekanizmat etj.

Prandaj shokët e ndërtimit të janë përgjegjës dhe të vlerësojnë se kanë në duart e tyre pasuri kolosale që duhen shfrytëzuar në maksimum për të mirën e popullit. Byroja Politike dhe Qeveria kërkojnë nga çdo punonjës i ndërtimit, nga organet e ndërtimit dhe nga organizatat-bazë përkatëse të Partisë që të marrin të gjitha masat, bile të bëjnë të pamundurën që mekanizmat të shfrytëzohen si duhet.

Një problem me rëndësi që na shtrohet përparrë është çështja e materialeve të ndërtimit. Në këtë sektor ne duhet ta përmirësojmë gjendjen. Përveç atyre që u thanë në lidhje me metodën e organizimit, me kujdesin që duhet treguar përpunimin e betonit, të llaçit, të tullave etj., të cilat luajnë rol vendimtar në fushën e ndërtimeve, në pesëvjeçarin e ardhshëm Byroja Politike dhe Komiteti Qendror do të marrin masa më serioze përsa i përket ndërtimit të disa fabrikave të reja përpërmirësimin e cilësisë së materialeve të ndërtimit dhe për t'i shluar ato edhe më shumë.

Sikurse keni vënë re, në projektvendimin që është dhënë më parë për t'u rishikuar, këto probleme figuronin, ndërsa në këtë projektvendim që keni tanë në dorë ato nuk janë formuluar qartë, prandaj duhen shënuar edhe këtu. Për shembull përsa i përket çështjes së fabrikave të tullave me bira dhe të tullave silikate ne do të ndërtojmë në të ardhshmen të tjera fabrika të tillë të mëdha. Gjithashtu, në projektvendim është shënuar që të studjohet çështja e ngritjes së një fabrike të re për panela të parafabrikuara brenda mundësive që kemi. Por ne duhet të nisemi më parë nga më të nevojshtmet dhe nga më urgjentet, pastaj të kalojmë në gjëra më të mëdha, sepse të gjitha gjërat që na duhen nuk mund t'i bëjmë menjëherë, se nevojiten fonde të mëdha, forca pune dhe teknikë. Megjithatë ne kemi mundësi të ndërtojmë më shumë se deri tanë.

Mendojmë se në të ardhshmen nuk do të vërtetohen gabimet që u bënë në fillim në lidhje me ndërtimin e disa objekteve të rëndësishme për prodhimin e materialeve të ndërtimit dhe të disa artikujve të tjerë. Ne

bëmë rikonstrukcionin e tyre, por në fakt ato që bëmë janë fabrika të reja. Ne kemi vepruar kështu nga fu-karallëku ynë dhe nga mundësitë e kufizuara që kemi. Në të ardhshmen fabrikat që do të ndërtojmë do të kenë një kapacitet më të madh për të plotësuar më mirë nevojat tona. Ja për shembull, fabrikat e çimentos që parashikojmë të ndërtojmë, do të kenë secila kapacitet mbi 100 mijë tonë çimento në vit me mundësi për ta rritur më vonë kapacitetin e tyre. Qëllimi është të mos bëjmë rikonstruksione se këto na kushtojnë shumë shtrenjtë. Prandaj në këtë drejtim duhet të marrim masa.

Gjithashtu mund të sjellim nga jashtë edhe një sasi lënde druri dhe kemi shpresë se gjendja e banesave për punonjësit do të përmirësohet vazhdimesht, por natyrisht jemi akoma larg plotësimit të të gjitha nevojave. Në projektvendim i vihet detyrë Qeverisë, Komisionit të Planit etj. që të hartojnë një plan perspektiv për 15-20 vjet për ndërtim baneshash. Drejtoria e statistikave ka bërë një studim të mirë për gjendjen e banesave në vendin tonë. Në bazë të tij ne mund të dalim me një plan perspektiv për përmirësimin e gjendjes së banesave në Shqipëri. Kjo do të jetë një perspektivë e shkëlqyer që i hapet popullit tonë, i cili sheh përpjekjet e mëdha që bëjnë Partia dhe Qeveria për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të strehimit të punonjësve. Kurrë nuk janë ndërtuar kaq shumë ndërtesa banimi në vendin tonë sa pas Çlirimt e megjithatë ka mungesa të mëdha.

Shokët duhet të jenë të ndërgjegjshëm se organet e ndërtimit kanë një punë sa të lavdishme aq edhe të

rëndë. Gjatë pesëvjeçarit të tretë do të investohen rreth 40 miliard lekë për ndërtim, nga 23 miliard në pesëvjeçarin e dytë. Kjo është një barrë kolosale që do të mbajnë organet e ndërtimit në supet e tyre. Ne mund të bëjmë edhe ndonjë shkurtim, por ka mundësi të bëhen edhe shtesa. Prandaj nga të gjithë punonjësit me përgjegjësi të ndërtimeve duhet një organizim i shëndoshë i punës dhe një luftë këmbëngulëse me të metat dhe dobësitë, një luftë e vendosur për projekte sa më të mira, të thjeshta e sa më pak të kushtueshme. Partia duhet të punojë vazhdimisht për edukimin e punonjësve të ndërtimit.

Në raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH thuhet se ndërtimet që është duke bërë shteti janë kolosale. Por të mos harrojmë ndërtimet në fshat, se edhe ato janë të mëdha. Edhe ndaj atyre duhet ushtruar kontroll, edhe ato duhen furnizuar dhe duhen ndihmuar. Deri tani ndërtimet në fshat i kemi ndihmuar në mënyrë indirekte. Shtëpitë që janë ngritur atje i kanë bërë punonjësit e ndërtimit, të cilët, pasi kanë mbaruar shkollat dhe kurset tonë, janë shkëputur dhe kanë shkuar e punojnë në fshatra, duke pasur kështu interes material më të madh. Një gjë e tillë do të na ngjasë përsëri, sepse në fshat do të bëhen ndërtime akoma më shumë në të ardhshmen. Prandaj së pari, të kujdesemi që t'u japim materiale ndërtimi edhe fshatarëve, sepse ata kanë nevojë për to dhe këto materiale që kërkohen shumë në treg, i nxitin fshatarët t'i shtojnë prodhimet bujqësore. Ndërtimet në fshat mund të bëhen shkak që të ndodhin largime kuadrosh nga sektori i ndërtimeve. Prandaj duhet të punojmë për të preqatitur

me shumicë kuadro të ndërtimit që të plotësojmë si nevojat e shtetit ashtu edhe të fshatarësisë.

Çështja e mekanizimit në ndërtim duhet të kuptohet drejt. Përderisa të mekanizojmë bujqësinë në shkallë të gjerë ne jemi të detyruar të gozhdojmë shumë forca pune në fshat. Prandaj duhet t'i harmonizojmë punët në mënyrë që edhe ndërtimet të mos na mbeten pa punëtorë, edhe bujqësia të mos braktiset. Kjo kërkon që mekanizimet të shtohen si në bujqësi, ashtu edhe në sektorin e ndërtimeve. Por brenda një kohe të shkurtër ne nuk mund të mekanizojmë gjithçka. Fuqia punëtore duhet të vijë në mënyrë të organizuar në ndërmarrjet e shtetit dhe në këtë çështje do të luajë një rol të madh organizimi i mirë i punës nga Partia. Prandaj Partia të mos e dobësojë asnjëherë kujdesin e vet jo vetëm për ndërmarrjet nacionale po edhe për ato lokale.

Eshtë shumë preokupant, i nevojshëm dhe i domosdoshëm ndërtimi në të gjitha shkallët. Ka shumë rrethe që qahen, se qendra nuk i ndihmon sa duhet, por kërkesave dhe nevojave për kuadër, për fuqi punëtore atje nuk u vënë rëndësinë e duhur. Nuk kuptohet, se, po të mos merren këto masa në kohën e duhur, vëllimi dhe cilësia e ndërtimeve nuk mund të ecin përpara. Prandaj Partia duhet të mobilizohet mirë në këtë drejtim.

Çështja e preqatitjes së kuadrove në praktikë lyp nga Partia një kujdes dhe organizim të mirë të kurseve. Duhet të tregohet kujdes i madh në edukimin dhe në preqatitjen e specialistëve tanë që nga kategoria e parë e deri në të shtatën. Kjo duhet bërë vazhdimisht.

Rëndësi të madhe ka për vendin tonë zhvillimi i industrisë, përparimi i bujqësisë, por këto dhe sektorët

e tjerë të ekonomisë varen shumë nga ndërtimet. Pra sektori i ndërtimeve ka rëndësi të madhe, kështu që kuadrot e ndërtimit t'i mësojmë dhe t'i edukojmë, por edhe t'u krijojmë kushte të mira. E theksoj këtu, dhe Komiteti Qendror vazhdimisht e ka ngritur problemin, që entet furnizuese të furnizojnë sa më mirë dhe më shpejt qendrat e ndërtimit, sidomos ato të punonjësve që janë larg familjeve.

Entet e furnizimit bëjnë një gabim të madh që nuk interesohen sa duhet për furnizimin e kantiereve të ndërtimit dhe bëhem i vetë ne shkaktarë që ndërtimet të mos na shkojnë mirë. Atje punojnë njerëz punëtorë që japid gjithçka për të mirën e vendit, prandaj duhet të tregohet një interesim i vazhdueshëm për përmirësimin e jetës së tyre.

Në të ardhshmen ne duhet të shohim çështjen e aplikimit të disa formave organizative në ministri, në ndërmarrjet ose në kantieret e ndërtimit. Këtu në Plenum ne i shtrojmë detyra Byrosë Politike dhe Qeverisë që ta studjojnë këtë çështje, të gjejnë forma më të përshtatshme që ndërtimet të kryhen më me lehtësi dhe të evitohen atje shumë pengesa e gabime dhe të ecin më mirë punët. Bëmë mirë që ne i përqëndruam ndërmarrjet në kantiere, por ka disa që janë zgjeruar shumë dhe nuk arrijnë dot të kontrollojnë të gjithë sektorët. Kështu për shembull Ndërmarrja e Ndërtimit në Shkodër shtrihet që nga Tropoja e deri në Rrëshen. Megjithë-këtë këtu ne nuk mund të japid një vendim të prerë mbi këtë çështje, por kjo duhet parë me kujdes.

Dëshiroj të theksoj edhe një çështje tjeter. Shumë flasim për të përdorur materiale vendi në ndërtime,

por bëjmë shumë pak për këtë çështje. Shokë të ndërtimit, kjo punë varet edhe nga ne, nga direktivat që ne japim, por zbatimi i tyre varet shumë nga Ministria e Ndërtimit, nga këmbëngulja juaj sidomos për të përdorur në shkallë të gjerë materialet e vendit. Kur themi të përdoret kallami, qerpiçi, guri, ato me të vërtetë të përdoren, por të kemi parasysh që të mos na kushtojnë këto materiale më shumë nga tullat, prandaj të gjenden forma e metoda që të na kushtojnë më lirë, të bëhen mirë dhe shpejt që të plotësojmë sa më mirë dhe sa më shumë nevojat e popullit.

Në lidhje me përdorimin në shkallë më të gjerë të gurit në ndërtime, ne duhet të shohim mundësinë që të sjellim edhe disa makineri ose të ngremë fabrika të vogla për të lehtësuar përpunimin e tij, që të na kushtojë më lirë dhe të zëvendësojmë tullat. Direktivat janë dhënë për këtë çështje, por Komiteti Qendoror i Partisë dhe Qeveria janë vënë përpara llogarive të tillë saqë kanë konkluduar se ato nuk na leverdisin.

Çështja e stallave të hapura ose gjysmë të hapura është ngritur vjete me radhë nga ana e specialistëve. Flitej që gjithë eksperienca shekullore e baballarëve dhe e gjyshërve tanë në këtë drejtim duhej hedhur poshtë se mos na ngordhin lopët nga të ftohtit, kurse del që nuk është ashtu. Këtej e tutje të mos ndodhë më që punonjësit e Ministrisë së Bujqësisë, të NB-ve ose të kooperativave bujqësore të bëjnë stalla moderne dhe të mbuluara nga të katër anët, sepse ato na kushtojnë shumë.

Edhe për kallama ne kemi porositur shpeshherë se c'duhet të bëhet, sidomos nga ana e kooperativave buj-

qësore. Ato kanë bërë diçka, por jo në shkallë të gjerë ashtu sikurse ka porositur Komiteti Qendror. Kjo çështje duhet të merret mirë në dorë nga Partia.

Ndërtimi i objekteve duhet bërë pa zënë tokat e bukës, se ato janë flori. Vihet re se ndërtimet bëhen pa kriter, duke i ngritur edhe në toka të punueshme, gjë që na ka kushtuar shumë. Kjo çështje duhet të merret seriozisht nga ana juaj, të bëhet ekonomizimi i tokave të bukës dhe ndaj atyre që nuk binden të merren masa. Shtëpitë e fshatarëve vazhdojnë të ndërtohen me rrugën e vjetër, pa kontroll, secili e ngre shtëpinë atje ku do. Kjo duhet evituar.

Përsa u përket ndërtimeve në fshatra nuk mund të bëjmë një planifikim si në qytete, po një farë orientimi të përgjithshëm ne e kemi dhënë, që shtëpitë e reja të bëhen atje ku ekziston qendra kryesore e fshatit dhe atje me siguri ka shumë vende bosh, prandaj atje të bëhet shkolla, kinemaja, klub i etj. Kujdesi për të mos zënë tokat e bukës duhet të jetë një preokupacion kryesor i projektuesve dhe i ndërtuesve tanë. Kjo çështje duhet të jetë nën kontrollin e rreptë të Partisë. Ashtu sikurse Partia edhe komitetet ekzekutive zbatojnë planimetrinë e qyteteve dhe nuk lejojnë që të dilet jashtë caqeve që janë caktuar në planin rregullues, edhe në fshat çdo kooperativë bujqësore, këshilli populor dhe kryesia e kooperativës nuk duhet të lejojnë që të veprohet sipas dëshirës së çdo fshatari.

Edhe në sektorët ushtarake po bëhen ndërtime të mëdha. Dihet mirë se mbrojtja e vendit ka rëndësi të madhe. Ju jeni njerëz partie, jeni patriotë dhe e kuptoni të gjithë vijën e Partisë, prandaj e kuptoni edhe rën-

dësinë e ndërtimeve në sektorin ushtarak, sidomos tani kur gjendja ndërkombe të është e tillë që ne për asnjë moment nuk duhet ta dobësojmë vigjilencën, sepse para nesh qëndron imperializmi, armiku kryesor i popujve, që nuk fle por armatoset dhe kërkon ta hedhë botën në zjarr.

Ne duhet të luftojmë për paqen, por njëkohësisht duhet të jemi vigjilentë, të mbrojmë interesat e vendit tonë dhe të të gjitha vendeve socialiste. Kurrë armiqtë tanë nuk do të na gjejnë në gjumë dhe të çarmatosur. Kjo është si një e një që bëjnë dy.

Ne e kemi pasur dhe e kemi të qartë se ç'përfaqësojnë revizionistët jugosllavë dhe si veprojnë ata. Partia jonë vë re se në çdo rast, kur gjendja ndërkombe të acarohet, duket menjëherë fytyra e vërtetë e revizionistëve jugosllavë. Partia jonë e ka thënë kurdoherë se, në momentet e zbutjes së atmosferës, revizionistët përpiken të veprojnë të maskuar për të infiltruar në radhët tona, si krimbi në ndonjë të çarë, për të luftuar unitetin tonë, për të goditur Partinë tonë marksiste-leniniste, për t'i shërbyer imperializmit.

Është e qartë për të gjithë se ç'është Titoja me shokë. Ai revizionist ka qenë, është dhe do të jetë. Fjalët e tyre kanë qenë dhe janë blofe. Partia jonë, duke ndjekur me besnikëri marksizëm-leninizmin, kurrë nuk ka gabuar dhe kurrë nuk do të gabojë në lidhje me revizionistët. Situatat kanë qenë të vështira, por Partia jonë ka mbrojtur vijën marksiste-leniniste, popullin e vet dhe kampin e socializmit, Bashkimin Sovjetik dhe i ka demaskuar pa mëshirë imperialistët e revizionistët. Kjo i jep Partisë sonë dhe Komitetit të saj Qendror një satis-

faksion që në luftën e vet të vështirë ka ecur drejt. Kjo ne nuk na bën fodullë, por ne jemi krenarë për vijën e drejtë të Partisë sonë, për besnikërinë e saj ndaj marksi-zëmi-leninizmit. Në këtë rrugë do të ecë vazhdimisht Partia jonë dhe në këtë rrugë ajo ka përkrahjen e plotë të partive të tjera motra dhe të të gjithë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkontaktare.

Prandaj neve na vihet detyrë të realizojmë me sukses detyrat e mëdha, të rënda e të vështira që na vihen përpara. Përgjegjësi të madhe kemi përpara popullit tonë. Ne me duar lidhur as kemi qëndruar as qëndrojmë. Puna e Partisë dhe e kuadrove të saj ka dhënë dhe jep rezultate. Por në punën tonë ka edhe të meta, objektive dhe subjektive, ka plot vështirësi, të cilat nuk i fshehim. Por ne kemi bindjen dhe guxmin që të luftojmë kundër tyre dhe t'i kapërcejmë ato. Të përsitojmë nga entuziazmi i popullit, të shfrytëzojmë si duhet materialet dhe të kryejmë me sukses detyrat.

Shokët drejtues dhe projektues të ndërtimit, në ndërtimet që bëhen në vendin tonë të kenë kurdoherë parasysh edhe çështjen e sizmikës. Vitin e kaluar kemi pasur lëkundje të rënda në Lushnjë, në Fier etj. dhe sot kemi marrë një lajm të hidhur se në Korçë sot ka rënë një tërmet shumë i fortë, ku janë vrarë dy veta në qytet, 6 në fshatra dhc rrëth 100 veta të plagosur, nga të cilët vetëm 2-3 veta janë rëndë. Në bazë të të dhënavë paraprake 15-20 për qind të banesave në qytet janë bërë të pabanueshme. Tërmeti ka marrë drejtimin e Voskopojës, të Vithkuqit, të Rrëzës dhe të qytetit. Lëkundje ka pasur edhe në Përmet dhe rrëth tij, por të lehta, më të rënda kanë qenë ato të Korçës. Menjëherë

dërguam për ndihmë mjekë, infermierë, barëra, çadra, bukë, pasi është prishur mulliri i blojes, dhe organizuam një komision qendror për studimin e gjendjes, morën masa për rregullimin e ndërtesave dhe për t'i ardhur në ndihmë sa më shpejt popullit të Korçës.

Kjo është një fatkeqësi, por ne duhet të bëjmë përpjekje që ta përballojmë. Prandaj, shokët e ndërtimit të kenë shumë kujdes për çështjen e sizmikës. Përveç kësaj, Ministria e Ndërtimit të marrë masa në bazë të udhëzimeve që do t'i japë komisioni qeveritar për riparimin sa më shpejt të dëmeve që u janë shkaktuar shtëpive të banimit në zonën e dëmtuar nga lëkundjet e tërmetit.

Së fundi, dëshiroj të theksoj që materialet e këtij Plenumi të studjohen mirë, si raporti i Byrosë Politike, i mbajtur nga shoku Spiro Koleka, ashtu edhe vendimi. Ato të punohen mirë në aktive dhe çdo punonjës i organeve të Ministrisë së Ndërtimit, i dikastereve të tjera dhe i ndërmarrjeve të ndryshme që kanë lidhje të ngushtë me ndërtimet, t'i mbajë, si i thonë fjalës, nën jastëk, dhe, duke u bazuar në to, të ecë në mënyrë krijuese. Ne do të jemi të kënaqur që këto direktiva, gjatë zbatimit të tyre, të pasurohen sa më shumë, të vërtetohet e të korrigohet edhe ndonjë gjë që nuk është parashikuar mirë, se jeta mund të nxjerrë edhe gjëra të reja. Kjo tregon vitalitetin e madh të Partisë sonë, eksperiencën e saj të madhe që na korrigjon të gjithëve.

Prandaj të armatosemi me materialet e këtij Plenumi për pesëvjeçarin e ardhshëm, pasi jemi përpëra Kongresit IV të Partisë që do ta shpallim në muajin nëntor me parullën e mobilizimit të gjithanshëm të

Partisë dhe të popullit për realizimin e planeve në industri, në bujqësi e kudo, për tejkalimin e detyrave të caktuara në këtë pesëvjeçar dhe të shkojmë në pesëvjeçarin e ardhshëm me detyra të realizuara.

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **TE ECIM PËRPARA DUKE FORCUAR KURDOHERË UNITETIN, EKONOMINË, EDUKIMIN, VIGJILENCËN**

*Fjala në mitingun e organizuar në kooperativën  
e bashkuar bujqësore të Brezhdan-Zdojanit  
të rrethit të Peshkopisë*

**31 maj 1960**

Të dashur shokë dhe shoqe kooperativistë të Brezhdanit dhe të Zdojanit,

Jam shumë i lumtur që erdha në Peshkopinë tonë dhe veçanërisht në kooperativën tuaj të bashkuar, përtu takuar me ju, popull punëtor, trim dhe besnik i Partisë. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë ju uroj nga zemra përparime në punën tuaj, lumturi në jetë juve dhe fëmijëve tuaj!

Jeta juaj në kooperativë do të bëhet çdo vit e më e bukur, se tani fatin tuaj e keni vetë ju në dorë, ju që punoni për lumturinë e të gjithë popullit nën udhëheqjen e Partisë, pa bejlerë, pa agallarë e pa bajraktarë gjakpirës.

Tani nuk mund të luajnë më si përpara me fatin e popullit as armiqtë e brendshëm as imperialistët dhe

revisionistët jugosllavë, sepse populli shqiptar është zot i fateve të tij, në atdheun e tij të dashur, të cilin e çlroi përgjithmonë dhe po e zbukuron e po e ndryshon nga dita në ditë.

Është gjë e bukur kur vjen në Peshkopi dhe shikon këto toka të punuara kaq mirë, këto kodra të lulëzuara rrëth e rrotull, sidomos këta njerëz të gëzuar dhe të lumtur. Këtë e bëri populli me luftën dhe me punën e tij nën udhëheqjen e Partisë.

Partia ju tha juve që të ngriheshit me pushkë në dorë për të fituar lirinë, tokën, demokracinë dhe ju e dëgjuat fjalën e Partisë, rrëmbyet pushkën dhe luftuat kundër armiqve të egër dhe të fuqishëm dhe së bashku me gjithë popullin fituat, se kishit të drejtë, se e drejta ishte me ne, pavarësisht se nuk kishim as armë sa na duheshin, as këpucë as rroba as bukë dhe jetuan me kroda, por ne kishim zemrën të fortë, moralin të lartë dhe qëllimin e madh që populli të jetonte përgjithmonë i lirë dhe i lumtur, që të mos i qëndronin bajraktari dhe beu mbi kurriz.

Armiqtë nuk kishin si të fitonin në këtë luftë se ata nuk e kishin popullin me vete dhe kush nuk ka popullin, kush nuk është me popullin, ai është i destinuar të humbasë, kush nuk është i lidhur me popullin dhe nuk e do atë, ai i ka ditët të shkurtëra. Prandaj ne themi se Shqipëria që u çlirua nga populli dhe ecën drejt socializmit, drejt jetës së lumtur është në duart tuaja dhe nuk ka forcë në botë që t'jua rrëmbejë atë nga duart.

Të dashur shokë dhe shoqe kooperativistë,

Partia i tha popullit se duhet të ecet shpejt drejt përparimit, se tani nuk mund të jetohet ashtu si jetohet përpara, domethënë nuk mund të jetohet duke ecur me hapa të ngadalshëm. Për këtë qëllim Partia këshilloi që fshatarësia të bashkonte forcat, sepse bashkimi bën fuqinë. Kjo kërkonte që fshatarësia të bashkonte tokat, forcat e punës dhe përpjekjet për të prodhuar më shumë për veten e vet, që jeta e fshatarësisë të bëhej më e mirë. Dhe fshatarët e dëgjuan fjalën e Partisë. Tani kudo në Shqipëri pothuajse në të gjitha fshatrat është kryer kolektivizimi i bujqësisë dhe do të vemi në Kongresin IV të Partisë me detyrën e plotësuar në lidhje me kolektivizimin. Ky është një sukses i madh.

Kolektivizimi i bujqësisë, të dashur vëllezër, siç e ndieni edhe vetë, kërkon që midis fshatarëve të ketë dashuri dhe bashkëpunim të ngushtë si në një familje të madhe. Për drejtimin e punëve të kooperativës ju keni zgjedhur kryesinë, por ajo që vendos është asambleja, ajo është zot i kooperativës. Këtë duhet ta dinë mirë të gjithë, kryetari dhe kryesia. Kryetari, kryesia dhe organizata-bazë e Partisë duhet të luftojnë që të vënë në zbatim medoemos atë që vendos asambleja. Për këtë qëllim ata duhet të mobilizohen që së bashku me ju të gjithë të vënë medoemos në jetë vendimet e asamblesë, sepse kjo është venia në vend e dëshirës së të gjithë kooperativistëve.

Kolektivizimi i bujqësisë nga viti në vit po ia ndryshon pamjen Shqipërisë. Tani bujqësia jonë është futur me të vërtetë në rrugën e përparimit. Në vendin tonë

janë rritur rendimentet e kulturave bujqësore, janë shtuar shumë sipërfaqet e tokave të punueshme, duke hapur toka të reja, duke tharë këneta e moçale, kjo punë do të vazhdojë edhe në 10 vjetët e ardhshëm dhe bonifikimi i fushave të vendit tonë do të ecë me ritme të shpejta. Nga këto punime ekonomia jonë ka pasur fitime të mëdha, sepse me dhjetëra mijëra hektarë toka të reja i janë shtuar bujqësisë në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë e të punës së palodhur të popullit tonë.

Ju, kooperativistë të Peshkopisë, jeni bujqë të dalluar, nga më të shqarrit në Shqipëri, sidomos përsa i përket kulturës së misrit, për kultivimin e të cilit nga ju duhet të marrin shembull të gjitha krahinat e vendit tonë.

Ne e dimë se sa bukur e punojnë tokëna fshatarët e Peshkopisë, se sa mirë e shfrytëzoni ju ujët dhe se ju e keni përmirësuar edhe teknikën e rritjes së misrit. Megjithatë ju duhet të përvetësoni metodat e reja të kultivimit të kësaj kulture të rëndësishme, në mënyrë që të merrni rendimente akoma më të larta se deri tani.

Kur vjen në rrethin tuaj dhe sheh tokat e mbjella me misër të forcohet besimi se ju jo vetëm do ta realizoni planin që keni caktuar, por edhe do ta tejkaloni atë. Ju keni punonjës të dalluar që marrin nga 60-70 kv misër për hektar. Me teknikën që keni tani, me plehërimin dhe ujitjen që u bëni tokave ju mund të arrini të merrni në çdo kooperativë rendimente më të larta se 24-25 kv për hektarë që merrni zakonisht, ju mund të arrini t'i stabilizoni rendimentet në 40-45 kv për hektarë. Ky do të ishte një sukses i madh për vendin tonë.

Punonjësit tanë thonë se do ta realizojnë këtë apo atë detyrë dhe do ta tejkalojnë, ata i vihen asaj me të gjitha forcat, se e dinë që produkti i punës së tyre nuk do të shkojë në hambarin e beut ose të bajraktarit, por në familjet e tyre, në favor të ekonomisë sonë popullore dhe të të gjithë popullit tonë që tani jeton si një familje e madhe e bashkuar si hekuri me çimenton që nuk do të ketë kurrë mortje. Dhe këtë e bëri Partia.

Prandaj në këtë familje të madhe jemi të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, të gjithë për një dhe një për të gjithë. Kur të përparojë Shqipëria, do të bëhet më e mirë edhejeta e të gjithë njerëzve tanë. Tani nuk është më si përpara kur secili mendonte vetëm përvete. Çështja e familjes është me rëndësi të madhe. Njeriu punon që ai dhe familja e tij të rrojnë sa më mirë. Por Partia na edukon që çdo punonjës, duke përmirësuar jetën e familjes së tij, duhet të mendojë edhe përmirësimin e jetës së familjes sonë të madhe, të Shqipërisë.

Shembull në këtë drejtim është kooperativa bujqësore. Më parë secili nga ju jetonte si individ dhe mundohej që me kafshët dhe me veglat e tij të punës të siguronte jetesën e familjes së vët, kurse tani punoni përfamiljen tuaj dhe për një familje më të madhe, përköoperativën bujqësore. Ju e kuptioni se, po të punohet si duhet, në mënyrë të organizuar, dhe po t'i shtoniditët e punës, me siguri që do të merrni më shumë drithë dhe të holla, me të cilat ju do të ushqeheni e do të visheni më mirë, do të pajisni më mirë shtëpitë tuaja, do të ndërtoni shtëpi të reja etj. Ekonomia kooperativiste po e bën fshatin tonë të lulëzojë dhe po ia

ndryshon faqen Shqipërisë. Shumë prej jush kanë kaluar nëpër Peshkopi, ka nga ju që kanë qenë edhe në Tiranë ose në vende të tjera të atdheut tonë, të cilat tani nuk mund t'i njohë në qoftë se i ka parë vetëm para çlirimit. Shqipëria është mbushur me fabrika, me shkolla, me rrugë e hekurudha të ndërtuara nga populli, fushat tona po lulëzojnë. Ndërsa para çlirimit kudo kishte vetëm mjerim dhe varfëri. Ku kishte atëherë fabrika? Kishte vetëm vende të zbratza, të shkreta.

Edhe për bujqësinë do të vijnë ditë më të bukura, sepse Partia jonë punon për të mirën e popullit. Ajo lufton që të hapen sa më shumë toka të reja dhe të mos lihet asnjë pëllëmbë tokë pa u punuar e pa dhënë prodhim. Por që të vihet në shfrytëzim gjithë kjo sipërfaqe e re duhet të sjellim edhe mekanizma, traktorë. Deri tani Partia ka sjellë me mijëra traktorë që në të kaluarën fshatarësia jonë s'i kishte njohur. Në pesëvjeçarin e ardhshëm do të sjellim 4 herë më shumë traktorë nga sa kemi deri tani. Brenda vitit 1965 ne do të sjellim edhe disa mijëra traktorë nga rreth 4 000 që kemi tani.

Bëni një krahasim midis punës që bëjnë qetë me traktorin. Me qetë fshatari mundohet shumë, kurse tokë tani e punon traktori dhe jo vetëm kaq po e punon më shpejt, më mirë dhe pa mundime. Më parë gruaja që endte punonte tërë natën nō vegje për të prodhuar 2 metra beze, kurse tani atë e prodhon kombinati më shumicë. Po kombinati që kemi ne, megjithëse nuk ka mbushur 10 vjet, konsiderohet i vjetruar, sepse do të ndërlohen të tjerë më modernë, që prodrojnë më shumë, më mirë dhe më lirë akoma.

Një problem tjetër i rëndësishëm për bujqësinë është që të shfrytëzojmë në maksimum, atje ku ka mundësi, vijat për ujitjen e tokave. Në bazë të vendimit të KQ të PPSH në vitin 1965, ne duhet të arrijmë që të ujitim rrëth 42 për qind të sipërfaqes së tokave të punueshme. Ju që keni eksperiencë e dini ç'do të thotë të futësh nën ujë sipërfaqe të mëdha misri, pambuku etj. Kjo do të thotë të rritësh në masë të konsiderueshme rendimentet e kulturave bujqësore.

Një faktor tjetër i rëndësishëm që do ta bëjë bujqësinë të përparojë është plehu kimik. Tani fshatarët i plehërojnë tokat e mbjella vetëm me pleh bagëtish. Shteti sjell nga jashtë edhe plehra kimike, por në sasi shumë të paktë sepse në kushtet tona nuk ka mundësi të sjellim më shumë. Por Partia ka menduar edhe për zgjidhjen e këtij problemi. Për këtë qëllim në pesëvjeçarin e ardhshëm do të ndërtohen dy fabrika të mëdha për prodhimin e plehrave kimike, një në Laç dhe një tjetër në Fier. Atëherë ne do të kemi më shumë plehra kimike për nevojat e bujqësisë sonë.

Pra, shikoni shokë, në një të ardhshme të afërt, ne do të shtojmë mekanizimin, do të zgjerojmë sipërfaqet e ujitshme të tokave nën kulturë, do të sigurojmë plehërimin e tokave me plehra kimike. Të gjitha këto do të bëjnë që fshatarësia dhe ekonomia jonë populllore të sigurojnë të ardhura me shumicë. Nuk thotë kot Partia se e ardhshmja e bujqësisë do të jetë e bukur. Këto masa do të bëjnë që jeta e fshatarësisë dhe e gjithë popullit tonë të përmirësohet.

Jeta e popullit tonë, pas Çlirimt, në përgjithësi është përmirësuar në masë të konsiderueshme, por në

të ardhshmen ne do të ecim me hapa akoma më të mëdhenj e më të guximshëm përpara, sepse edhe mundësitë do të jenë më të mëdha. Këto do t'i sjellin popullit tonë të ardhura shumë të mëdha që akoma nuk mund t'i mendojmë.

Prandaj, shokë dhe shoqe, detyra juaj është të prodhoni sa më shumë. Vitin e kaluar klima nuk ju ndihmoi dhe pësuat humbje në prodhim. Partia dhe Qeveria e kuptuan gjendjen tuaj dhe ua hoqi detyrimet që kishit ndaj shtetit. Kjo ishte një masë e drejtë. Tani që mbjelljet e pranverës i keni realizuar dhe tokat i keni punuar mirë, duhet t'i viheni punës për prashitjen e mirë të misrit që të plotësoni deficitet e viti të kaluar për të mirën tuaj dhe të të gjithë vendit.

Kisha për të ngritur edhe çështjen e mbjelljes së pemëve frutore. Ju duhet të merrni shembull në këtë drejtim nga ndërmarrjet bujqësore, që, përveç kujdesit për kulturën e misrit, të mbillni sa më shumë edhe pemë frutore. Jo se nuk keni mbjellë pemë, por keni mbjellë pak. Duhet të dini se frutat ju sjellin të ardhura të mëdha; ato janë, në radhë të parë, një ushqim i shijshëm dhe i shëndetshëm për ju vetë. Përveç asaj, kur të prodrojmë shumë, jo vetëm që do të furnizojmë me bollëk qytetet tona, por do të nxjerrim edhe në tregjet e jashtme. Vendet tuaja janë jo vetëm të bukurë, por edhe shumë të përshtatshme për frutikulturën. Prandaj mos lini kodër pa mbjellë me pemë frutore.

Bagëtinë mos e lini pas dore, se nuk ka bujqësi të përparuar pa blegtori. Ju keni disa dhen, por pak lopë. Brenda mundësive tuaja duhet t'i shtonit ato. Ju keni

mundësi të mbillni jonxhë, të bëni silazh të mirë, se prodhoni misër. Po të keni jonxhë dhe silazh me bollëk, jo vetëm do të rritni më shumë bagëti, por do të merrni prej tyre edhe rendimente më të larta. Prandaj mos i pakësoni bagëtitë. Kullotat tani janë ngushtuar, por jo në atë masë saqë të dëmtohen bagëtitë, ato janë ngushtuar për t'i vënë tokat nën kulturë që të merren prej tyre më shumë të ardhura. Kjo mënyrë shfrytëzimi e tokës do të bëjë të mundur që edhe bagëtitë të ushqehen më mirë dhe më shumë edhe në kohën kur për to nuk ka asnje mundësi që të kullosin jashtë.

Ne ishim mësuar t'i lëshonim bagëtitë kodrave, me gjithëkëtë nuk merrnim prej tyre më shumë se 35-40 kg. qumësht në vit nga një dele dhe 200-300 kg qumësht nga një lopë. Natyrisht shumë pak. Por në ndërmarrjet bujqësore e në kooperativat tonë bujqësore ka lopë, të cilat, duke u trajtuar mirë, japin nga 3-4 mijë litra qumësht në vit. Prandaj, metoda e ushqimit të bagëtive me koncentrate bën të merret më shumë qumësht nga bagëtitë, pra të sigurohen më shumë të ardhura. Në qoftë se ju do të punoni për të marrë rendimente më të larta nga misri, jo vetëm që do të siguron i veten tuaj me bukë, por do të keni edhe për të shitur, edhe për silazh. Në këtë mënyrë do të arrini të merrni nga çdo lopë 1 500, 2 000 deri 3 000 litra qumësht në vit. Në këtë drejtim duhet të luftohet dhe për këtë i kemi të gjitha mundësitë.

Çështja është që në kooperativat bujqësore duhet të forcohet akoma më shumë organizimi dhe disiplina. Punët nuk kryhen akoma mirë dhe, kur vjen fundi, ai që bën pa këtë-punë merr më pak. Organizimi i punës

në bazë skuadre në kooperativë ka rëndësi të madhe. Ju duhet të jeni kontrolluesit më të mirë të kryesisë dhe të drejtuesve të brigadave dhe të skuadrave, sepse çështja e ndarjes së punës, e zbatimit të normave, e kontrollit dhe sidomos e regjistrimit të tyre nuk varet vetëm nga një njeri. Llogaritari le të mbajë shënimet e tij për punën, por kooperativistët duhet ta kontrollojnë si i bën matjet ai, se kështu ka matur interesin e tij dhe të kooperativës. Të mos lejohet në asnje mënyrë që njerëz të pandërgjegjshëm të luajnë në kurri zëvendësuar nga fshatarëve. Partia nuk mund të lejojë gjëra të tillë, nga kushdo qoftë.

Edhe këtu te ju ish-sekretari i organizatës-bazë filloj të bënte intriga e dallavere për interesat e tij me qëllim që të dilte në krye, gjë që conte në dobësimin e kooperativës. Por Partia na mëson që në krye duhet të dalë ai që punon dhe që e do popullin, ndërsa atyre që sjellin përcarje t'u vihet druri. Partia nuk lejon të luhet me interesat e popullit. Kur punon mirë Partia të lëvdon, kur bën gabime të heq veshin. Po nuk punove të zëvendëson, po bëre intriga të dënon, se ajo nuk mund të lejojë që të preket interesi i kolektivit. Organizata-bazë e Partisë e kooperativës bëri mirë që mori masa ndaj ish-sekretarit, sepse ai nuk ishte në rrugë të drejtë. Kjo masë duhet ta bëjë atë të vëré mend dhe punë të atilla si ato që bëri ai të mos lejohen **asnijëherë**.

Kundër veprimeve të padrejta çdo kooperativist të ngrihet e ta thotë hapur mendimin e tij, të kritikojë atë që punon keq. Partia është me ata që kritikojnë drejt dhe mbrojnë interesat e punës. Askush nuk duhet

të mendojë se mund të bëjë si të dojë. Kështu, sekretari i organizatës-bazë ose kryetari i kooperativës duhet të punojnë në rrugën e Partisë, të veprojnë ashtu si thotë asambleja. Ndryshe ndodh si në kohën e Zogut. Mirëpo për të zhdukur atë kohë u derdh shumë gjak dhe u dogjën fshatra e qytete. Por ato kohë ikën një herë e përgjithmonë. Njeriu i lig mund të gënjejë për pak kohë e pak njerëz, por të tërë e përgjithmonë nuk i gënjen dot, mund të kalojë me hile 5-6 muaj, po më vonë do t'i dalë patjetër boja dhe i tregohet vendi.

Partia i vë të gjitha çështjet në vend, mbron deri në fund interesat e popullit, organizon punën që punonjësit të prodrojnë më shumë dhe të jetojnë më mirë. Prandaj ta duam si shpirtin Partinë. Partia nuk është diçka abstrakte, ajo është kudo, edhe këtu te ju. Në rast se në çdo kooperativë bujqësore, fabrikë apo qendër pune do të kemi një organizatë-bazë Partie të shëndoshë, e shëndoshë do të jetë edhe udhëheqja. Në rast se nuk do të jenë të shëndosha organizatat-bazë të Partisë, udhëheqja do të jetë si një pemë me rrënjet mbi ujë që nuk e ka të gjatë. Në rast se ajo do t'i ketë rrënjet të shëndosha edhe trungun do ta ketë të fortë edhe frutat do t'i bëjë të mira.

Partia është pra në bazë, në gjirin e popullit. Ti djalin e ke rritur, e ke dërguar në shkollë e pastaj në ushtri ose në veprat e pesëvjeçarit. Ai u kthyte andej anëtar partie, ka parë e ka mësuar shumë, por kjo nuk duhet t'i rritë mendjen dhe të kujtojë se i di të gjitha. Mendja e popullit është e madhe. Prandaj komunistët vazhdimisht duhet të mësojnë nga populli. Për këtë themi se organizata-bazë e Partisë duhet të ushqehet

nga populli, nga baza, se vetëm kështu do të shkojmë në socializëm me Partinë në krye.

Në socializëm jeta është e bukur sidomos për gratë, sepse në socializëm dhe në komunizëm gratë do të jenë krijesa të nderuara për punën e tyre të madhe që bëjnë, për ndershmërinë e tyre. Atje ku punojnë gratë ka më pak vjedhje, ato edhe në fabrika e në ndërmarrje janë më të kujdeshme dhe më punëtore. Të gjitha këto janë virtytet e mëdha të popullit tonë. Ai që futet në Parti pa këto virtyte, nuk mund të jetë komunist i mirë. Në të ardhshmen gruaja do të jetë shumë më e çliruar dhe më e nderuar se përpara.

Po çfarë ka bërë Partia për ju gratë? Gjëra të mëdha. Tani gratë dalin kudo lirisht, shkojnë në punë e në shkolla. Është një gëzim i madh për ne, kur shohim se këtu në Peshkopi, ku më përpara kishte fanatizëm, shkollat fillore, 7-vjeçare, të mesmet dhe deri në universitet ndiqen edhe nga vajzat tuaaja. Ky është një sukses i jashtëzakonshëm. Tani gratë e Peshkopisë kanë filluar të dalin në punë me shumicë. Fanatikët, të dashur vëllezër dhe motra, kujtonin se gruaja mund të ishte e ndershme po të qëndronte brenda në shtëpi. Po nuk është kështu. Gratë tona që dalin në punë nuk janë më pak të ndershme nga ato që rrinë në shtëpi.

Partia na mëson se, për të luftuar në jetë, duhet të regjesh në punë, në luftë. Edhe vajzat e gratë, po u regjën në luftë dhe në punë, dinë ta mbrojnë nderin e tyre më mirë sesa kur mbahen të ndrydhura brenda katër mureve. Çështja është se pa gruan nuk mund të shkojmë në socializëm. Gruaja duhet të jetë e barabartë me burrin, të punojë dhe të ketë po ato të drejta.

Gruaja që i ka fituar këto është e zonja ta mbrojë vetë nderin e saj.

Shikoni vajzat dhe djemtë që rriten tani, ata nuk do të kenë frikë ngajeta, nuk do të kenë frikë se mos i pengon ose i prek njeri. Edukimi i Partisë është i madh sidomos në drejtimin që në radhë të parë ndershmëria të jetë e paprekur. Partia merr masa kundër atyre njerëzve që nuk tregohen të ndershëm. Partia gjëzohet shumë kur sheh që gratë punojnë dhe po shkelmojnë fanatizmin.

Unë e di se në mes tuaj ka që besojnë te perëndia etj. Këta mund të besojnë, po ne me prova u themi se nuk është kështu. Më parë thuhej se qelli ishte i perëndisë, kurse tani në Hënë dhe në quell kanë shkuar raketat. Së shpejti do të venë edhe njerëz në Hënë e në trupat e tjerë qellorë. Deri tani kanë dërguar qen, për provë, pastaj do të dërgohen edhe njerëz. Besoj se edhe nga brezi ynë kanë për të shkuar për të parë çfarë ka atje.

Imperialistët me ata amerikanë në krye këto përparime kërkojnë t'i shfrytëzojnë për qëllimet e tyre grabitqare. Kapitalistët kanë qenë e kurdoherë do të jenë armiq të popujve, sepse jetojnë duke i shfrytëzuar e shtypur ata dhe kur e shohin se po u ikën fuqia nga duart, duan të bëjnë luftë. Prandaj ata po armatosen vazhdimisht, për të goditur vendet socialiste. Por luftët imperialistët nuk mund ta bëjnë kur të duan, se dhe ata e llogaritin me kë do ta bëjnë luftën.

Ne jemi më të fortë nga imperialistët në shumë pikëpamje, me ne janë shumica e popujve kudo në botë, kurse kapitalistët nuk e kanë me vete popullin, se duan

ta çojnë atë në luftë drejt vdekjes. Popujt në vendet kapitaliste nuk do të luftojnë për milionerët e për shfrytëzuesit. Popujt e vendeve socialiste nuk e duan luftën, se ata punojnë për paqen. Po t'i godasë ndokush popujt e vendeve tona, ata do të dinë përse luftojnë, ata do të luftojnë për të mbrojtur atdheun, shtëpinë dhe pasurinë e tyre, jetën e lumtur që kanë krijuar vetë, prandaj në raste të tilla do të tregohen të pamë-shirshëm për të asgjësuar armiqtë. Politikisht, pra, ne jemi shumë të fortë.

Vendet socialiste, kanë qenë dhe janë për paqen. Ne nuk duam luftë dhe, duke u mbështetur në forcat tona, kemi shpresë të arrijmë që të mos ketë luftë. Këtë shpresë e bazojmë në forcën tonë ekonomike, në forcën dhe teknikën tonë ushtarake. Ne nuk do t'i hedhim poshtë armët po nuk i hodhën armiqtë tanë. Sa më të fortë të jemi ne, aq më shumë do të shtyhet lufta. Po të mos ishim të fortë, po të mos na e kishin frikën armiqtë, lufta do të kishte filluar prej kohësh. Sikur të kishin këllqe Fiqri Dine e Murat Kaloshi me shokë do të ktheheshin duke pasur dëshirë të madhe t'i merrnin edhe një herë pasuritë e fuqinë që kishin. Por nuk kanë forcë, ata kanë vdekur, ata u zhdukën, si i thonë fjalës me soj e sorollop. Kështu edhe imperialistët po shkojnë drejt vdekjes se koha po punon gjithnjë e më shumë për socializmin dhe për paqen, duan apo nuk duan imperialistët. Ne nuk mburremi, po kështu janë punët.

Merreni me mend si ishim kur filluam Luftën Nacionalçlirimtare. Shumë njerëz thoshin: «si do të fitojnë partizanët?» e megjithatë ne fituam. Po si ishim atë-

herë dhe si jemi. Tani jemi qindra herë më të fortë, më të pasur dhe shumë herë më të armatosur.

Megjithatë ne duhet të jemi të gatshëm për të përballuar çdo rrezik. Ne nuk themi se tani koha është për luftë, por imperialistët kërkojnë situata të vështira ndërkombëtare, mirëpo manovrat e tyre nuk u shkojnë te ne dhe veprimet e tyre shërbejnë që populli t'i njohë më mirë se cilët janë ata.

Ata që i ndihmojnë imperialistët në rrugën e tyre janë revisionistët jugosllavë, të cilët janë të lidhur kokë e këmbë me imperialistët amerikanë e ato që thonë se gjoja janë duke ndërtuar socializmin janë fjalë të rreme. Regjimi që ka vendosur Titoja me shokë në Jugosllavi është një regjim që shkon duke forcuar borgjezinë.

Në fshatin jugosllav, të ashtuquajturat kooperativa bujqësore që kanë ngritur nuk janë të tillë, si këto tonat, ato janë organizma që thithin pasurinë e fshatarëve. Në Jugosllavi nuk ka kooperativa bujqësore, atje sundojnë kulakët dhe agallarët që kanë filluar në shkallë të gjerë të blejnë tokat e fshatarëve. Në fshatin jugosllav po ndodh si te ne në kohën e Zogut, të Lalë Krosit, të Myftar Kaloshit etj. Ky regjim, pra, është duke lulëzuar në Jugosllavi.

Në të gjitha drejtimet revisionistët jugosllavë janë lidhur me kapitalizmin ndërkombëtar dhe janë hedhur kundër vendit tonë me të gjitha forcat. Ata nuk kanë asnje ndryshim nga krajlet serbë. Përsa u përket qëndrimeve dhe synimeve kundër vendit tonë, janë si ata.

Por kohët ndryshuan. Tani nuk mund të bëhen hapur veprime të tillë. Titoja u mundua me intrigë e

dallavere që ta bashkonte Shqipërinë me Jugosllavinë, por Shqipëria qëndroi e lirë, e pavarur dhe i përballoi sulmet dhe manovrat e revisionistëve jugosllavë. Ata nuk kanë pasur dhe kurrë nuk do të kenë sukses në synimet e tyre ndaj vendit tonë; atdheu ynë do të mbetet i paprekur.

Revisionistët jugosllavë kanë bërë të gjitha përpjekjet që të dobësojnë Partinë tonë, por në këtë drejtim ata nuk kanë pasur asnjë sukses. Ata hodhën diversantë dhe spiunë, por të gjithë i kapëm, ata u përpoqën të dhunojnë hapësirën tonë ajrore, por ne as i kemi lejuar, as do t'i lejojmë, ashtu si nuk do të lejojmë as aeroplanët amerikanë, anglezë, grkë etj. Ju keni dëgjuar se si i kemi ulur një aeroplan amerikan dhe një anglez që shkelën hapësirën tonë ajrore.

Tani Shqipëria nuk është një vend që mund të merret nëpër këmbë, ajo ka ushtrinë e vet, flotën e vet ajrore dhe detare, ka artileri, tanksa. Prandaj imperialistët amerikanë e miqtë e tyre në Itali, në Greqi dhe në Jugosllavi duhet t'i bëjnë mirë llogaritë me ne, se te vendi ynë do të ndeshen në një kala shumë të fortë e të pamposhtur.

Përpjekjet e revisionistëve jugosllavë kundër vendit tonë nuk do të kenë kurrë sukses.

Ata na akuzojnë ne se përzihemi në çështjen e Kosovës, pasi gjoja kjo është punë e tyre e brendshme. Ne nuk përzihemi në punët e brendshme të Jugosllavisë, përkundrazi ata janë përzier në punët tona. Përsa u përket kosovarëve që janë vëllezërit tanë, ne nuk mund të mos interesohemi. Ne i demaskojmë revisionistët se kanë vrarë e kanë prerë kosovarë, prandaj

ndaj këtyre mizorive ne nuk mund të qëndrojmë indiferentë.

Ne u themi revizionistëve jugosllavë të sillen si njerëz me shqiptarët e Kosovës, t'i lënë të jetojnë të lirë në tokat e tyre, t'u hapin shkolla, të mos i vrasin dhe të mos i shpërngulin në Turqi, se masat që kanë marrë ata kanë për qëllim që në tokën e Kosovës të mos ketë shqiptarë. Kundër veprimeve të tillë ne nuk mund të heshtim dhe nuk do të heshtim asnjëherë. Për këtë çështje ata nuk mund të thonë se ne përzihemi në punët e tyre të brendshme.

Ne kërkojmë drejtësi për vëllezërit tanë të Kosovës. Por dihet se të drejtat një minoritet mund t'i gjëzojë vetëm në një vend socialist, atje ku drejton një parti marksiste-leniniste, kurse partia e Titos është parti antimarksiste dhe vetë Titoja me shokët e tij janë antileninistë me damkë. Edhe ne kemi në vendintonë një minoritet të vogël grek, por ai gjëzon të gjitha të drejtat, ka shkollat në gjuhën e vet etj. Ata e duan Shqipërinë dhe Partinë tonë me gjithë shpirt, sepse Partia u dha tokën për të cilën minoritarët kishinëndërruar me shekuj. Tani ata janë bashkuar edhe në kooperativa bujqësore dhe askush nuk i pengon në punën dhe në jetën e tyre. Kurse në Kosovë bëhen një mijë e një mizori.

Prandaj ne u themi revizionistëve jugosllavë se do të bënin më mirë të mos e sulmonin Partinë dhe Qeverinë tonë në lidhje me këtë çështje, të mos e ngacmojnë këtë plagë se do të jetë në dëmin e tyre.

Këtu, ju jeni në kufi dhe për t'u gënjer revizionistët jugosllavë propagandojnë se gjoja përtej kufirit

njerëzit ushqehen dhe jetojnë më mirë, se gjoja atje është parajsë. E vërteta është se fshatari ynë jeton më mirë se fshatari jugosllav. Shikoni tokat tona si janë, të lulëzuara, të pastruara, në parcela të mëdha. Ndryshe ndodh andej. Megjithëse andej jetojnë vëllezërit tanë shqiptarë, të cilët janë punëtorë sa edhe ne, regjimi që kanë mbi kokë i shtyp e i varfëron, atje sundon kulaku dhe agai, prandaj populli është në mjerim e në varfëri. Prandaj e ka koi propaganda jugosllave që përpinqet t'i gënjejë fshatarët tanë. Mund të ketë ndonjë të marrë, që i gënjeri nga propaganda revizioniste lë atdheun e familjen dhe kalon kufirin. Një patriot i madh ka thënë se atdheu kurrë nuk merret në thundër të këpucës, atdheu është më i shtrenjtë nga çdo gjë, sepse atje është familja, babai, nëna, motrat, vëllezërit, gruaja dhe fëmijët, atje prehen koskat e gjyshërve tanë. Njerëz që tradhtojnë atdheun janë shumë pak dhe titistët i duan ata që t'i dërgojnë si diversantë, por ata përsëri bien në duart tona.

Prandaj, shokë dhe vëllezër, duhet të jemi po aq vigjilentë kundër revizionistëve sa edhe kundër imperialistëve. Ne jemi shumë më të fortë se armiqtë tanë dhe ata do të dështojnë në veprimtarinë e tyre të fëlliçur. Por krahas me vigjilencën, që nuk duhet ta dobësojmë asnjëherë, të mobilizohemi për të kryer detyrat që kemi për realizimin e planeve tona, sepse sa më të fortë të jemi ekonomikisht dhe politikisht, aq më të pamposhtur do të bëhem.

Ju uroj nga zemra suksese në punë! Partia dhe Qeveria janë të bindura se te ju kanë nga punonjësit më të mirë dhe më besnikë, që e duan me gjithë shpirt

çështjen e popullit, atdheun e Partinë, që e kanë kuptuar vijën e drejtë të Partisë e janë mobilizuar për ta zbatuar atë deri në fund, sepse kjo do t'ju sjellë të mira juve dhe familjeve tuaja. Partia do të vërë të gjitha forcat për t'ju ndihmuar sa më shumë, sepse kjo përbën qëllimin e saj, që populli të përparojë çdo ditë e më shumë dhe të jetojë i gjeluar, i begatshëm dhe i lumtur. Kini besim se populli ynë do t'i realizojë dëshirat dhe detyrat, sepse ai ka në udhëheqje Partinë e tij, ka ndihmën e vendeve socialiste, prandaj edhe çdo vështirësi do ta kapërcejë me sukses.

Ju uroj edhe një herë nga zemra, të dashur koooperativistë dhe kooperativiste, suksese sa më të mëdha përlulëzimin e kooperativës suaj!

*Botohet me disa shkurtime  
sipas origjinalit që gjendet  
në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## **VEPRAT QË NDĒRTON DHE GEZON POPULLI YNË I MBRON ME VIGJILENCË**

*Fjala në mitingun e organizuar me punonjësit  
e Peshkopisë*

**1 qershor 1960**

Të dashur shokë dhe shoqe të rrethit të Peshkopisë,

Jam shumë i lumtur dhe i gjuar që ndodhem sot midis jush, jam gjithashtu i gjuar t'ju sjell me këtë rast përshëndetjet e Komitetit Qendror të Partisë, të Qeverisë dhe të Presidiumit të Kuvendit Popullor! Më lejoni t'ju uroj jetë të lumtur e të gjuar të gjithëve ju dhe familjeve tuaja, t'i uroj gjithë popullit të rrethit tuaj suksese sa më të mëdha në punën e lavdishme të ndërtimit të socializmit në vendin tonë dhe veçanërisht në rrethin e Peshkopisë, t'ju uroj për sukseset që keni korruj gjatë këtyre vjetëve në rrugën e drejtë ku na prin Partia jonë e dashur!

Kam disa kohë që s'kam ardhur në rrethin tuaj, por shoh me gjësim ndryshime të mëdha që janë bërë si në fshatra ashtu edhe në vetë qendrën e rrethit, në Peshkopi, e cila nga viti në vit po zbukurohet. Shumë

shtëpi të reja banimi për punonjësit, dhe krahës tyre shkolla pedagogjike, shtëpia e kulturës, kinemaja e re, kopshtet dhe çerdhja moderne, spitali, hoteli, teknikumi bujqësor, zdruktëtaria e re dhe fabrika e frutave zbukurojnë tanë Peshkopinë. Të gjitha këto vepra janë ndërtuar nga populli dhe për popullin, ato u ndërtuan nga punëtorët e mrekullueshëm të rrethit tuaj, që jeta e njerëzve të bëhet gjithnjë më e gëzuar dhe më e lumtur. Jeni ju, shokë, që keni krijuar gjithë këto pasuri dhe ia keni ndryshuar faqen rrethit. Është një kënaqësi e madhe për Partinë kur sheh se ky rreth, i lënë pas dore në të kaluarën, po lulëzon dhe po kthehet në një kopësht të bukur. Është kënaqësi e madhe kur shikon në radhë të parë gëzimin dhe lumturinë në fytyrat e popullit heroik të këtij rrethi që brez pas brezi ka luftuar për ditët që gëzojmë sot. Veprat që ndërton dhe gëzon populli ynë i mbron me vigjilencë.

Qysh në kohët më të vjetra kanë buçitur këto male kreshnike nga pushkët e stërgjyshërvë tuaj kundër të huajve që kërkonin të na robëronin, kundër hordhive turke, atyre të krajlëve serbë dhe në kohët tona kundër hordhive fashiste italiane dhe gjermane. Bjtë heroikë të Peshkopisë kanë rënë në këto male duke dhënë jetën e tyre të shtrenjtë për këto ditë të lumtura që jeton sot i gjithë populli shqiptar. Gjaku i kulluar, heroizmat e bijve më të mirë të popullit tonë që ranë në luftë për lirinë dhe për pavarësinë e atdheut, na frymëzojnë ne, të rinjve, nipër dhe stërnipër të tyre, për të ecur përpëra me guxim dhe me besim në luftën për ndërtimin e jetës së re. Për këtë qëllim të lartë ranë dhe derdhën gjakun e tyre në Luftën Nacionalçirrim-

tare bijtë më të mirë të popullit të rrethit të Peshkopisë. Në këto male luftoi trimërisht shoku Haxhi Lleshi. Nga gjiri i popullit tuaj dolen heronjtë Nazmi Rushiti dhe Gjok Doçi si edhe qindra dhe mijëra luftëtarë të tjerë të udhëhequr nga Partia jonë e dashur që nuk kursyen as jetën e tyre për popullin.

Liria dhe pavarësia e Shqipërisë u arritën me luftë të ashpër kundër pushtuesve dhe bajraktarëve gjakpirës që sundonin mbi popullin dhe e kishin bërë këtë pré dhe rajá të tyre. Por Lufta Nacionalçlirimtare i dha fund një herë e përgjithmonë atij sundimi, u varros pushteti i tyre që nuk do të ngrihet kurrë më, sepse tani në fuqi është vetë populli i udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë, nga marksizëm-leninizmi.

Momentet e vështira pas luftës ne i kemi kapërcyer me sukses. Ato ishin momente me të vërtetë shumë të rënda, kur duhej ngritur dhe rindërtuar vendi i shkataerruar nga lufta, kur duhej ndërtuar ekonomia, duhej zhdukur mjerimi, varfëria dhe errësira. Populli dhe Partia kishin besim të plotë se do t'ia dilnin me sukses kësaj ndërmarrjeje të madhe. Ky besim i popullit tonë ishte kalitur që në vjetët e vështirë të luftës çlirimtare. Prandaj, duke filluar që nga ditët e para të Çlirimt, populli shqiptar nën udhëheqjen e Partisë po bën heroizma po aq të lavdishme dhe të shkëlqyera sa edhe ato të kohës së luftës. Në saje të mobilizimit të plotë të të gjitha forcave të popullit tonë, të udhëhequr nga Partia, ne e rimëkëmbëm atdheun tonë të dashur që na e kishin shkaterruar armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, të cilët kujtonin se Partia dhe populli ynë i kishin ditët të shkurtëra. Populli do të rrojë në shekuj,

në shekuj do të rrojë dhe pjella e tij, Partia e lavdëshme e Punës e Shqipërisë.

Forca e madhe e popullit, patriotizmi i tij i lartë dhe drejtësia e vijës së Partisë bënë që gjatë 15 vjetëve të pasçlirimit në vendin tonë të realizohen ndryshime kolosale. Këto ndryshime regjimet e kaluara nuk do t'i bënin as për njëqind vjet.

Politika e drejtë e Partisë bëri që në vendin tonë të ngrihej një industri e fuqishme që as mund të ëndërrrohej në të kaluarën. Tani Shqipëria është e mbushur me fabrika dhe kombinate që janë prona juaj, që janë prona e gjithë popullit, që drejtohen nga djemtë dhe vajzat tuaja të edukuara nga Partia me ndërgjegje të lartë dhe me besnikëri të pakufishme ndaj popullit për t'i shërbyer atij deri në fund. Industria jonë punon tani me rendiment të lartë dhe është bërë burim shumë i rëndësishëm përfurnizimin e popullit me shumë sende të nevojshme përfjetën e tij të përditshme. Industria jonë e re i sjell popullit shqiptar të ardhura të konsiderueshme, me të cilat do të zhvillohen më tej ekonomia dhe forcat prodhuase të vendit tonë.

Ju e dini se në Shqipëri ka naftë. Në të ardhshmen naftë ne do të prodrojmë akoma më shumë. Deri tani në vendin tonë janë zbuluar disa fusha nafte. Grupe gjeologjike janë duke punuar përfundimisht të zbuluar fusha të tjera nafte si dhe burime gazi nafte dhe gaz metan, me qëllim që t'i sigurohen ekonomisë sonë të ardhura të mëdha. Një pjesë të naftës që nxjerrim ne e përpunojmë në vend, në rafineritë që kemi ndërtuar. Por sasia e prodhimit që vjen duke u shtuar do të na detyrojë që në të ardhshmen të ngremë rafineri të tjera

akoma më të mëdha, më të fuqishme në mënyrë që pjesa dërrmuese e naftës së prodhuar te ne të përpunohet në vend dhe kështu ta forcojmë më shumë ekonominë tonë popullore.

Përveç naftës, në vendin tonë ka edhe miniera që nuk kanë ekzistuar por që tani janë në zhvillim të plotë. E tillë është miniera e rrëthit tuaj, një nga më të mirat e vendit, nga më rentablet dhe që i siguron ekonomisë sonë popullore të ardhura të konsiderueshme. Kjo është Miniera e Bulqizës, e cila ndodhet në fushën që njihet në histori me emrin fusha e Torviollit ku Heroi ynë Kombëtar, Skënderbeu, ka luftuar në krye të popullit kundër hordhive të pushtuesve turq. Në ato fusha, pra, ku është derdhur gjaku i kulluar i stërgjyshërve tanë, tani rrjedh flori, atje nxirret kromi që është një pasuri e madhe për popullin. Punëtorët e kësaj miniere tani punojnë shumë mirë, atje ne kemi punëtorë dhe kuadro që jo vetëm e realizojnë, por edhe e tejkalojnë planin. Ata janë bijtë dhe vëllezërit tuaj të edukuar nga Partia, që punojnë me vetëmohim për të ardhshmen e lumtur të vendit.

Kromi është një pasuri e madhe për popullin shqiptar. Në pesëvjeçarin e ardhshëm ne do të ndërtojmë një kombinat të madh të ferro-kromit<sup>1</sup>, ku do të punojnë disa mijëra punëtorë. Kjo ndërmarrje do ta bëjë kromin tonë më të vlefshëm dhe ne po studojmë mundësitë që sasitë e kromit që prodrojmë të përpunohen

<sup>1</sup> Kjo vepër nuk u ndërtua në pesëvjeçarin e tretë, sepse marrëveshja për ndërtimin e saj u shkel nga revisionistët sovjetikë dhe çekoslllovakë.

plotësisht në vend, me qëllim që të ardhurat e ekonomisë sonë popullore të jenë më të mëdha. Kromi, pra, ka vlera të mëdha dhe gjithë kjo pasuri gjendet në rrëthin tuaj. Afër kombinatit të madh metalurgjik të ferro-kromit do të ngrihet edhe një fabrikë e madhe plehrash kimike. Natyrisht, juve, si bujqë të dalluar, një vepër e tillë ju intereson shumë. Them bujqë të dalluar sepse është fakt se fshatarësia e rrëthit të Peshkopisë është mjeshtre për prodhimin e misrit. Misri është një kulturë shumë e vlefshme.

Përveç fabrikës së plehrave kimike në Milot, gjatë pesëvjeçarit të tretë, ne do të ngremë gjithashtu një fabrikë tjeter plehrash kimike në Fier. Këto fabrika do të na sigurojnë sasi të mjaftueshme plehrash përritjen e mëtejshme të rendimenteve të kulturave bujqësore. Kjo do të bëjë që edhe ju të merrni rendimente shumë më të larta se këto që merrni tani. Në rrëthin tuaj sot ka parcela ku merren 50 dhe 60 kv misër për ha. Shokët e Partisë dhe të pushtetit në rrëth kanë parcela eksperimentale në të cilat synojnë të arrijnë rendimente akoma më të larta, mbi 100 kv për ha. Kjo është e mrekullueshme. Natyrisht rendimente kaq të larta nuk mund të arrihen në të gjithë sipërsfaqen e punueshme të rrëthit, por me plerhat kimike ne do të përpinqemi që këto rendimente t'i stabilizojmë dhe të mos marrim më pak se 30 kv për ha.

Shteti ynë do t'i ngrëjë këto fabrika të mëdha me qëllim që të forcohet dhe të zhvillohet më tej bujqësia jonë. Ju e dini se si ka qenë bujqësia jonë në të kaluarën. Ajo ka qenë me ekonomi të copëtuara, ku punonin fshatarë të mjeruar dhe të shtypur, në toka që ishin

në pjesën më të madhe pronë e bejlerëve dhe e agallarëve. Kurse tani koha e shkuar nuk kthehet më. Populli, në saje të punës së tij të palodhur dhe të politikës së drejtë të Partisë, është vënë në rrugë të mbarë edhe në çështjet ekonomike, duke zhvilluar harmonikisht të gjithë sektorët që kanë interes dhe janë në të mirën e tij. Kjo politikë e drejtë u arrit se Partia është e lidhur me popullin, se ajo mëson nga pjekuria, guximi dhe iniciativa e pashtershme e tij. Partia, duke ndjekur me besnikëri mësimet e marksizëm-leninizmit, nuk ka gabuar në zhvillimin e ekonomisë, të industrisë dhe të bujqësisë në vendin tonë, por e ka çuar vazhdimisht vendin nga suksesi në sukses.

Të gjithë konstatojmë me kënaqësi se deri tani në vendin tonë janë tharë dhe po thahen moçale e këneta dhe mund të themi me siguri se në të ardhshmen bonifikimet në Shqipëri do të ecin me rëlme të shpejta. Kjo ka një rëndësi të madhe, sepse do të bëhet e mundshme që edhe në ato fusha; deri tani moçalore, të punojë kudo, pa frikë, traktori.

Ne shikojmë me kënaqësi që edhe në rrethin tuaj janë zhdukur ferrat dhe gjerdhet, janë krijuar parcela të bucura që të kënaqet zemra kur i sheh, janë punuar kodra të cilat janë transformuar në kopshte të bucura me pemë frutore.

Kështu zhvillohen punët te ne. Por, po të hedhësh një sy në anën tjetër të kufirit, do të shohësh një pamje krejt të kundërt nga kjo jona. Atje të pinë ferrat, gjerdhet dhe hendeqet, atje ka plot toka të lëna djerrë. A mos vallë vëllezërit tanë kosovarë dhe dibranë janë më pak punëtorë nga ju? Jo. Ata janë aq punëtorë sa

edhe ne që jemi të një gjaku me ta, vetëm se ndryshon regjimi ynë me të atyre. Regjimi ynë është regjimi i popullit, kurse te ata sundon regjimi i klikave dhe i gospodëve, prandaj sundon edhe mjerimi e varfëria.

Ç'do të bëhet më vonë në rrethin tuaj? Tani këtu kemi vetëm 30 traktorë, kurse në të ardhshmen numri i tyre do të shtohet shumë. Në pesëvjeçarin e ardhshëm ne parashikojmë të importojmë edhe disa mijëra traktorë të rinj nga rreth 4 000 që kemi tani. Kjo do të jetë një forcë shumë e madhe e cila do t'i japë hov zhvillimit të shpejtë të bujqësisë që, së bashku me sigurimin e plehrave kimike dhe shtimin e sipërfaqeve të ujitshme, do të influencojë shumë për ngritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore. Atëherë ne do të kemi krijuar të gjitha kushtet për një bujqësi të përparuar. Prandaj le të fillojmë që tani përpjekjet për rritjen e rendimenteve, të cilat me krijimin e këtyre kushteve do t'i ngremë medoemos në një shkallë më të lartë.

Ne jemi realistë. Nuk jetojmë me ëndrra as me lugë të zbrazët. Ato që ka thënë Partia kurdoherë janë kryer. Atë që ajo i thotë popullit sot, nesër populli do ta bëjë realitet patjetër. Këto që kemi realizuar deri tani nuk na kanë rënë nga qielli. Ato janë fryt i punës dhe i djersës së popullit. Asgjë nuk bëhet pa punë dhe pa përpjekje. Por tani ne kemi krijuar edhe një tjetër kusht vendimtar për përparimin e bujqësisë, atë të bashkimit të fshatarëve në kooperativa bujqësore. Pa këtë kusht nuk mund të përparonte bujqësia jonë, nuk mund të shfrytëzoheshin të gjitha këto mundësi që ka krijuar dhe po krijon Partia.

Në lidhje me kolektivizimin e bujqësisë populli

ynë, fshatarësia jonë patriote ndoqi me besim vijën e Partisë. Ajo shikon se bashkimi bën fuqinë, bashkimi në punë çan malet dhe një bashkim të tillë të forcave të fshatarësisë sonë e siguron kolektivizimi i bujqësisë. Ne do të shkojmë me ballë hapur në Kongresin IV të Partisë se e realizuam detyrën shumë të rëndësishme që na ishte ngarkuar, kolektivizimin e bujqësisë, të ardhshmen e lumtur të fshatarësisë sonë.

Të dashur shokë dhe shoqe,

Punët në vendin tonë shkijnë shumë mirë. Tani te ne janë krijuar kushte ekonomike dhe politike për të hedhur hapa më të mëdhenj përpara. Këto do të konkretizohen në Kongresin IV të Partisë. Ky Kongres do të jetë një ngjarje e madhe historike për Partinë dhe për popullin shqiptar, sepse ai do të aprovojë planin e tretë pesëvjeçar, që do ta ngrëjë ekonominë dhe kulturen e vendit tonë në një nivel akoma më të lartë dhe jeta e popullit tonë do të përmirësohet më shumë.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë ne do të bëjmë investime kolosale. Në këtë drejtim po ju tregoj se vetëm në sektorin e ndërtimeve gjatë 5 vjetëve të ardhshëm ne do të investojmë afro 40 miliard lekë për ndërtimin e fabrikave dhe të kombinateve të reja, për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë sonë, të transportit dhe sidomos për shtimin e shtëpive të banimit. Por për ndërtimin e shtëpive të banimit, si në qytet ashtu dhe në fshat, kini parasysh, të dashur shokë dhe vëllezër, këshillat e Komitetit Qendror të Partisë që të mos bëhen ndërtime të shpërndara, sidomos në fshat, dhe të zihen kështu tokat e bukës. Fshatrat në rrëthin tuaj janë të

ndërtuara bukur dhe të grumbulluara. Kjo është një anë shumë e mirë. Frandaj këtë karakteristikë të fshatrave tuaja ta ruani edhe në të ardhshmen. Kur ngrini shtëpi të reja, mos u përhapni, po i përqëndroni ndërtimet në qendër të fshatit. Një masë e tillë është e mirë nga çdo pikëpamje, si nga ana ekonomike, ashtu edhe nga ana edukative, nga ana e forcimit të miqësisë dhe e vëllazërimit ndërmjet fshatarëve. E theksoj këtë se ka disa krahina në vendin tonë, ku fshatarët vazhdojnë akoma me atë mentalitetin e vjetër, t'i ndërtojnë shtëpitë në mënyrë të shpërndarë. Kjo shkakton humbje toke dhe vështirëson jetesën e njerëzve në kushtet e reja që po krijuhen në vendin tonë. Në të ardhshmen ne do të ndërtojmë për popullin më shumë shtëpi banimi, sepse sidomos në qytete ka nevoja të mëdha. Kongresi IV i Partisë do të aprovojë planin e ardhshëm pesëvjeçar, realizimi i të cilit ka një rëndësi të madhe jetike për popullin shqiptar dhe do ta zbulurojë akoma më shumë jetën e tij. Por kjo e ardhshme e shkëlqyer që na pret do të ndërtohet vetëm me punë. Këtë populli ynë e ka të qartë dhe ai e di se vetëm puna e nderon njeriun dhe zbuluron jetën. Por që të realizohen planet tona me sukses, duhet organizim i shëndoshë në punë në të gjithë sektorët. Në industri klasa punëtore është më e organizuar dhe më e disiplinuar, sepse dihet që puna dhejeta në fabrikë i kalit punëtorët, u fut atyre shpirtin e disiplinës së hekurt për të realizuar dhe për të tejkaluar planin për të mirën e popullit. Me fshatarësinë Partia duhet të punojë akoma më shumë dhe më mirë, që punët të kryhen në mënyrë më të organizuar. Në të vërtetë të gjithë duan të punojnë dhe duhet thënë se

nuk ka fshatar që të mos dojë ta ketë plot shtëpinë, sepse gjithkush e di se pa punë nuk mbushet hambari. Por për këtë varet shumë se si punojnë organizatorët e kooperativës, kryesia, kryetari, brigadieri, skuadërkomandanti, të cilët duhet të lidhen mirë me kooperativistët dhe t'i çojnë këta të organizuar mirë në frontin e prodhimit, ashtu siç bëjnë oficerët e zotë që i kanë edukuar si duhet ushtarët e tyre dhe në rast rreziku u qëndrojnë si grusht armiqve dhe i shpartallojnë. Pra duhet organizuar mirë puna edhe në kooperativat bujqësore.

Shokë dhe vëllezër të dashur të Peshkopisë,

Partia ka kurdoherë besim te ju, për realizimin e detyrave që ju janë vënë përpara, se jeni fshatarë të përparuar. Këtë ju e keni treguar me prova. Ju jeni të frymëzuar nga një patriotizëm dhe besnikëri e madhe ndaj Partisë dhe popullit prandaj Komiteti Qendror i Partisë ka bindjen e plotë se ju, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, do ta realizoni dhe do ta tejkaloni planin e këtij viti për të mirën e të gjithë popullit dhe për të mirën tuaj.

Ne gjithashu jemi të bindur se arsimi dhe kultura në rrethin tuaj do të ecin me vrull përpara dhe unë ju përgëzoj se në këtë drejtim keni pasur mjaft suksese. Në rrethin tuaj janë hapur kudo shkolla dhe organizata e Partisë kë punuar me mend duke arritur që rrethi i Peshkopisë të sigurojë kuadro arsimtarësh vendës. Të gjithë jemi bijtë e këtij trualli, po e vërteta është se vendësi i njeh më mirë njerëzit; mësuesi i vendit është i lidhur më ngushtë me prindërit e fëmijëve, prandaj

e ka më lehtë për t'i mësuar dhe për t'i edukuar mirë nxënësit. Rrethi i Peshkopisë në saje të punës së mirë të udhëheqjes së organizatës së Partisë ka arritur t'u japë kuadro edhe rretheve të tjera. Një tjetër meritë për organizatën e Partisë të rrëthit tuaj është se në shkollat tuaja mësojnë edhe vajza. Të themi të drejtën këtu ka pasur fanatizëm dhe vazhdon të ketë akoma, megjithëse më pak. Natyrisht kjo nuk është e mirë. Këto anë negative do t'i kuptojnë të gjithë, kush më shpejt e kush më vonë, por dërgimi i vajzave në shkollë ka rëndësi të madhe, sepse dituria që do të marrin aty do t'i pajisë ato për të luftuar më mirë në jetë që të mos presin të ushqehen nga të tjerët. Pra, megjithëse në këtë drejtim ju keni ecur mîrç, duhet punuar akoma më shumë dhe më me kurajë. Kjo është rruga që na ka hapur Partia dhe që populli e ndjek me besim se është për të mirën e tij.

Detyrë kryesore për ne të gjithë është që atdheun ta kemi të fuqishëm nga çdo pikëpamje. Por atdheu ynë nuk është i veçuar në botë, ai jeton në këtë planet. Pra neve nuk na interesojnë vetëm sukseset e brendshme të vendit, por ndjekim me vëmendje edhe ç'ndodh jashtë vendit tonë. Partia jonë ndjek një politikë të jashtme të drejtë.

Kaluan kohët kur vendet e vogla jo vetëm nuk përfilleshin fare, por merreshin nëpër këmbë, kurse ligjin e bënин vetëm shtetet e mëdha e të fuqishme imperialiste. Tani ato kohë nuk kthehen më, ato kanë perënduar një herë e përgjithmonë. Si rezultat i triumfit të revolucionit populor edhe një shtet i vogël siç është shteti ynë ka politikën e tij të pavarur. Zëri i vendit tonë

dëgjohet sot me respekt dhe do të dëgjohet edhe në të ardhshmen. Politika e shtetit tonë është një politikë paqësore. Populli dhe Partia jonë e duan dhe luftojnë për paqen. Ne jemi kundër luftërave grabitqare që vetëm imperialistët kanë interes t'i bëjnë. Popujt janë kundër tyre, sepse ato u shkatërrojnë ekonominë, u djegin shtëpitë dhe u rrëmbejnë jetën njerëzve. Luftën e duan vetëm pasanikët, kapitalistët, çifligarët dhe mi-liarderët për të grabitur dhe shtypur popujt, për të mos i lënë ata të ngrenë kokë, por t'i mbajnë të nënshtuar. Shteti ynë ka deklaruar qysh në fillim politikën e tij paqësore dhe ai do të luftojë në mënyrë konsekiente për të.

Kur popujt flasin për paqen, këtë ata e faktojnë me vepra, luftojnë konkretisht për këtë çështje të madhe dhe nuk bëjnë si imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, revizionistët jugosllavë, që vetëm llomotitin për paqen, për të gënijyer popujt.

Kursi i turpshëm i politikës agresive të imperialisteve amerikanë ka tronditur besimin e popullit ndaj qeverisë amerikane. Tani në SHBA ka një lëvizje të gjerrë nga ana e njerëzve përparimtarë, të cilët e kritikojnë ashpër politikën agresive të qeverisë së vendit të tyre dhe të vetë Ajzenhauerit, këtij pseudopresidenti faqezi.

Si rezultat i luftës së popullit të Koresë së Jugut, u përmbyss diktatura e egër e shërbëtorit besnik të imperializmit amerikan, Sin Man Risë, që kishte vënë në bazë të politikës së tij terrorin dhe kriminalitetin mbi popullin. Sin Man Rija u përmbyss pikërisht në një vend ku sundojnë ushtritë amerikane. Qeveria që erdhi në fuqi pas Sin Man Risë është një tjetër vegël e imperia-

listëve amerikanë që përpinqet ta gënjejë popullin koren, i cili lufton akoma nëpër rrugë. Ngjarjet e Koresë tregojnë se atje ku sundon çizmja e ushtarit amerikan dhe e shërbëtorëve të imperialistëve populli nuk duron shtypjen e rëndë, po ngrihet në luftë dhe megjithëse atje ka forca të armatosura amerikane dhc sundojnë kriminelë si Sin Man Rija me shokë, populli ka fituar besimin se i bashkuar ai mund t'i rrëzojë qeveritarët e shitur te imperialistët amerikanë.

Ngjarje si në Kore u vërtetuan edhe në Turqi. Fuqia e popullit të zemëruar bëri që të përmbyset edhe aty qeveria e Menderesit dhe ai së bashku me ish-presidentin Bajar dhe bashkëpunëtorët e tyre tanë dergjen në burgje. Ata ishin njerëzit më besnikë të imperialistëve amerikanë që zbatonin me këmbëngulje një politikë në kundërshtim me interesat e popullit turk; populli që nuk duroi dot shtypjen dhe terrorin, bëri që qeveria antipopullore e Menderesit të përmbyset.

Republika jonë Popullore ka marrëdhënie diplomatike me republikën turke, gjë që është në të mirën e të dy popujve tanë. Populli shqiptar ka simpati për popullin turk. Kryetari i qeverisë së re turke, gjenerali Gursel, deklaroi se do të ndjekë politikën e Qemal Ataturkut, një politikë që c bëri Turqinë të pavarur dhe sovrane nga imperialistët. Një politikë e tillë do ta shpëtojë Turqinë nga mjerimi e nga shtypja e imperialistëve amerikanë dhe e miqve të tyre dhe vetëm në këtë mënyrë Turqia do të gjejë rrugën e zhvillimit paqësor. Ne i urojmë popullit turk një politikë të tillë.

Politika e jashtme e Republikës sonë Popullore ka qenë, është dhe do të jetë një politikë paqësore, por kjo

s'do të thotë se ne duhet ta shuajmë vigjilencën ndaj imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre, nga të cilët më të zellshmit dhe më kryesorët janë revizionistët jugosllavë. Ata janë një agjenturë e imperialistëve me tërë kuptimin e fjalës, jo vetëm nga ana e politikës dhe e propagandës, por edhe nga aktet e tyre. Revizionistët jugosllavë janë renegatë të marksizëm-leninizmit.

Kundër vendit tonë revizionistët jugosllavë kanë bërë dhe bëjnë një mijë komplate. Dihet se qëllimi i tyre kryesor ishte dhe është të shkatërrojnë Partinë dhe unitetin e çeliktë të popullit tonë rrëth Partisë, të do-bësojnë fuqinë mbrojtëse dhe ekonominë e vendit tonë dhe të arrijnë kështu që një ditë të gllabërojnë Shqipërinë. Kjo është politika e pasardhësve të krajlevë serbë që i rrëmbyen dikur Shqipërisë Kosovën. Ata mendonin kështu të krijonin imperatorinë mesjetare të Stefan Dushanit, por harruan se tani rrojmë në shekullin XX, në shekullin e triumfit të ideve të leninizmit.

Revizionistët jugosllavë na kanë halë në sy për qëndrimin tonë të drejtë, të vendosur e parimor, por edhe ne i urrejmë në kulm ata sepse janë tradhtarë revizionistë dhe të shitur te imperialistët. Ata nuk duan që populli ynë të jetë i lirë dhe sovran. Udhëheqësve revizionistë të Beogradit u duket çudi se ku e gjijnë shqiptarët këtë forcë, këtë kurajë të madhe që të flasin kaq hapur kundër «shtetit të madh të fuqishëm jugosllav». Kështu mund të mendojnë vetëm borgjezët reaksionarë që thoshin se popujt e vegjël nuk kanë të drejtë të flasin dhe të mbrojnë veten e tyre. Të tillë janë edhe revizionistët jugosllavë. Por ata gabohen. Ne po ua themi revizionistëve të Beogradit se ku e gjejmë këtë

forcë. Kur në Evropë endeshin ujqërit dhe nuk linin të dëgjohej zëri i popullit shqiptar, atëherë dëgjohej kënga e mauzerëve dhe e nagantëve të bijve të këtij populli. Këtë këngë e kanë dëgjuar krajlët serbë në fushat e Kosovës, ku burrat shqiptarë të udhëhequr nga Bajram Curri, Isa Boletini dhe patriotë të tjera, luftonin për lirinë e atdheut dhe për ndalimin e shkëputjes së Kosovës nga mëma Shqipëri. E ka dëgjuar këtë këngë krajl Nikolla i Cernagores nga malësorët kreshnikë të Shkodrës, saqë ministri i jashtëm i carit të Rúsise aso kohe e këshilloi atë të tërhiqej nga Shkodra që të mos i vihej zjarri Evropës.

Këtë këngë e kanë dëgjuar bukur për pesë vjet me radhë fashistët italianë e gjermanë dhe tradhtarët e vendit. Të drejtën, pra, që të jetojmë, të flasim dhe të mbrohem, e kemi fituar me gjak dhe s'ka forcë në botë që të na e mbyllë gojën, dashkan apo nuk dashkan zotérinjtë revizionistë të Beogradit. Populli ynë ka të drejtë të mbrojë pavarësinë dhe lirinë e tij kombëtare dhe të shpallë haptazi politikën e tij të jashtme. Këtë të drejtë e ka fituar me gjak e me sakrifica.

Revizionistët jugosllavë shpifin dhe cirren se «shqiptarët përzihen në punët tona të brendshme». Nuk jemi ne që përzihemi në punët e brendshme të Jugosllavisë, por kanë qenë dhe janë ata që kanë dashur të shkatërrojnë Partinë dhe shtetin tonë. Prandaj ne i kemi demaskuar dhe i demaskojmë pa mëshirë keqbë-rësit që kërkojnë t'i bëjnë varrin popullit shqiptar. Ata cirren duke thënë se gjoja ne ndërhyjmë në çështjet e tyre të brendshme kur flasim për Kosovën. Në këtë çështje via e Partisë sonë ka qenë e drejtë dhe do të

mbetet e drejtë. Ata nga ana e tyre interesohen të bëjnë zhurmë për ndonjë nënshtetas të tyre që kanë këtu, dhe që bën spiuallëqe, kurse ne nuk paskemi të drejtë të kujdesemi për gati një milion shqiptarë në Kosovë, ndaj të cilëve po bëhen gjithë ato veprime antinjerëzore.

Prandaj Partia dhe populli ynë për asnjë çast nuk do të lënë pa demaskuar veprimet e këtyre armiqve të popullit, të Partisë sonë dhe të marksizëm-leninizmit. Ne do të vazhdojmë t'i demaskojmë pa rezervë dhe deri në fund veprimet e imperialistëve dhe të revisionistëve jugosllavë, sepse kështu ne kemi mbrojtur paqen, socializmin, atdheun tonë.

Ne me popullin jugosllav jemi miq, e duam dhe do ta duam atë, por ne nuk pajtohem me klikën që sundon në Jugosllavi, sepse ajo kërkon t'i bëjë varrin popullit tonë dhe vendeve socialiste në dobi të imperialistëve.

Revisionistët jugosllavë nuk presin veçse momentet më delikate për t'u ardhur në ndihmë imperialistëve në këtë drejtim. Kur aeroplani spiun amerikan shkeli hapësirën ajrore të Bashkimit Sovjetik, akt banditesk ky që indinjoi të gjithë njerëzit e ndershëm në botë, vetëm mareshali Tito u erdhi në ndihmë imperialistëve amerikanë duke thënë se shtetet e mëdha tani duhet të hiqen mënjanë pasi nuk u treguan të zonjat për zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare, dhe natyrisht iu dashka besuar Titos t'i rregullojë punët ndërkombëtare!

Ne u themi revisionistëve jugosllavë t'i lënë mënjanë shpifjet e turpshme ndaj politikës marksiste-leniniste të Partisë sonë në lidhje me Kosovën. Ata le të rrinë urtë dhe të mos lëndojnë plagën që kanë në

trup, në rast se nuk duan t'u bëhet gangrenë. Kur ne ngremë zërin që me shqiptarët e Kosovës të sillen si njerëz është një detyrë humanitare dhe vëllazërore nga ana jonë, përkundrazi ata, duke organizuar spiunazh, komplotë dhe terror, janë mësuar të ndërhyjnë në punët e të tjerëve. Por kush ndërhyjn në punët tona ne ia presim duart.

Populli ynë, shokë dhe vëllezër të Peshkopisë, dëshiron të jetojë në paqe dhe në miqësi me të gjithë popujt, veçanërisht me popujt fqinjë, por në bazë të kushteve të njoitura të barazisë, të leverdisë reciproke dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit. Partia dhe populli ynë do të jenë shumë vigjilëntë ndaj të gjithë atyre që do të guxojnë të prekin lirinë dhe integritetin tokësor të shtetit dhe të atdheut tonë. Ne do të jemi si kemi qenë kurdoherë, vigjilëntë kundër intrigave të revisionistëve jugosllavë, të shovinistëve grekë dhe të neofashistëve italianë që nuk ia duan të mirën popullit tonë. Po asnjëherë nuk do të na gjejë njeri në gjumë, ne jemi kurdoherë të gatshëm të mbrojmë interesat e atdheut dhe të popullit në çdo çast, nga cilado anë që ai të kërcënohet.

Armiqtë e popullit shqiptar duhet ta dinë se Shqipëria nuk është e vetme si më parë, ajo ka miq të fortë dhe besnikë.

Dje, të dashur shokë dhe vëllezër, Kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor, shoku Haxhi Lleshi, iftuar nga republikat popullore motra të Azisë, u nis në krye të një delegacioni zyrtar për një vizitë miqësore në Kinë, në Mongoli, në Republikën Demokratike Popullore të Koresë dhe në Republikën e Vietnamit. Populli

shqiptar ka një dashuri dhe admirim të madh për popullin heroik kinez që po ndërton me sukses socializmin dhe gjëzohet për përparimet e vrullshme të këtij populli të madh, në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe në luftën e tij të vendosur për mbrojtjen e të drejtave të tij legjitime. Të gjitha vendet socialiste e karakterizojnë si një skandal ndërkombëtar qëndrimin agresiv të imperialistëve amerikanë dhe të të gjithë përkrahësve të tyre, të cilët pengojnë pranimin e Kinës së madhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në të gjitha forumet ndërkombëtare. Por politika aggressive e imperialistëve me siguri do të dështojë dhe populli i madh kinez do të zërë vendin që i përket me të drejtë në të gjitha institucionet ndërkombëtare.

Populli shqiptar ushqen një dashuri të madhe për vëllezërit e tij të vendeve socialiste të Azisë, me të cilët ne jemi lidhur në miqësi të ngushtë vëllazërore. Vizita zyrtare e delegacionit që u nis dje do të ndihmojë për forcimin e miqësisë, të lidhjeve dhe të bashkëpunimit vëllazëror midis vendeve tonë.

Politika marksiste-leniniste e vendeve socialiste do të triumfojë dhe do të bëjë që të dështojë politika banditeske e imperialistëve amerikanë që duan të hedhin botën në një katastrofë të re.

Edhe një herë, vëllezër dhe motra të rrethit të Peshkopissë, ju uroj jetë të lumtur, punë të mbarë dhe suksese sa më të mëdha në realizimin e detyrave që keni përpara, në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së rrethit tuaj! Unë dëshiroj me gjithë zemër t'i ktheni në vepra synimet tuaja për të fituar flamurin e Kongresit IV të Partisë dhe nga ana ime do t'ju duartrokas

me gjithë zemër në Kongres, në qoftë se do të plotësoni kushtet për ta merituar këtë flamur!

Rroftë populli heroik dhe besnik i rrethit të Peshkopisë!

Rroftë Partia jonë heroike e Punës!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në  
gazeten «Zëri i popullit»,  
Nr. 132 (3661), 3 qershor 1960*

*Botohet me disa shkurtime  
sipas origjinalit që gjendet  
në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## **PUNËT ECIN MIRË KUR KOMUNISTËT JANE NË BALLË TË LUFTËS ME VËSHTIRËSITË**

*Fjala në takimin me kuadrot e Partisë dhe të pushtetit  
të rrethit të Peshkopisë*

**1 qershor 1960**

Jam shumë i gjëzuar që erdha në rrethin tuaj dhe ndiq një kënaqësi të madhe që takohem me ju, kuadrot drejtues të Partisë dhe të pushtetit në rreth. Ju përshtëndes në emër të Komitetit Qendror dhe ju uroj përpunën dhe përpjekjet tuaja të gjithanshme në drejtim të përmirësimit të jetës së popullsisë, në forcimin e organizatës së Partisë dhe të ngritjes së ekonomisë së popullit të rrethit tuaj!

Peshkopia është një rreth bujqësor i rëndësishëm, këtu është gjithashtu edhe një nga minierat tona më të rëndësishme dhe rentable që i siguron ekonomisë sonë të ardhura të mëdha, e kam fjalën për Minierën e Bulqizës. Përveç kësaj, tani në qytetin tuaj është duke u ndërtuar edhe një fabrikë dhe uroj që ekspeditat gjeologjike të zbulojnë jo vetëm krom, por edhe minerale

të tjera të vlefshme. Kjo do të ishte një fitore e madhe për gjithë vendin tonë!

Për zhvillimin dhe përparimin e atdheut tonë Partia dhe nën udhëheqjen e saj pushteti popullor po bëjnë të gjitha përpjekjet për realizimin e planeve. Si kudo edhe në rrethin tuaj në këtë drejtim ka pasur suksese të mëdha, por ka edhe të meta. Zhvillimi i ekonomisë sonë po ecën në përgjithësi me hapa të mëdhenj përpara.

Ne kemi suksese si në industri, ashtu edhe në bujqësi, të cilat i detyrohen vijës së drejtë të Partisë. Jeta ka treguar se Partia jonë, megjithëse është një Parti e re, ka pasur kurdoherë një vijë të drejtë edhe për zbatimin e drejtë të marksizëm-leninizmit në drejtim të zgjidhjes së problemeve ekonomike. Që vija ekonomike e Partisë sonë ka qenë e drejtë këtë e tregon përmirësimi i jetës së popullit tonë çdo vit. Në këtë drejtim tani ne kemi hedhur baza për zhvillimin dhe për forcimin e mëtejshëm të industrisë sonë, për përparimin e bujqësisë, për çështjen e arsimit dhe të kulturës. Të gjitha këto suksese do të na lejojnë që ta zhvillojmë me ritme akoma më të shpejta ekonominë e vendit tonë.

Punët në përgjithësi na shkojnë mirë. Rrethi juaj është bujqësor dhe ka mundësi që ta zhvillojë akoma më shumë bujqësinë. Viti i kaluar ishte i keq për rrethin tuaj dhe si pasojë ju nuk e realizuat planin, morët rendimente të ulëta në kulturat bujqësore dhe dolët jo mirë me blegtorenë, sepse nuk ju favorizoi klima. Megjithatë ne mendojmë se po të mobilizohej më shumë Partia dhe pushteti në rreth për ta organizuar më mirë punën në kooperativat bujqësore, ne do të kishim përballuar një pjesë të madhe të fatkeqësive të natyrës.

Ne shpresojmë se këtë vit bujqësor ju do të arrini rezultate më të mira. Komiteti Qendror i Partisë e konsideron Peshkopinë si një nga rrëthet e përparuara në sektorin e bujqësisë, sidomos për misrin që është kultura kryesore e rrëthit tuaj. Për këtë kulturë ju duhet të punoni që të merrni flamurin duke u bazuar te eksperiencia e madhe e fshatarësisë. Rëndësi të madhe në këtë çështje ka sidomos organizimi i mirë i punës, që është faktori më i rëndësishëm. Po të organizohen mirë punët edhe vështirësitë mund të kapërcehen, po të mos organizohet puna si duhet edhe eksperiencia e një-rëzve më të mirë humbet.

Rrethi juaj ka kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë. Ju keni një fshatarësi që ka përvojë përsa i përket kultivimit të misrit, prandaj organizoni mirë punën që të realizoni dhe të tejkaloni rendimentet që keni caktuar, 25 kv për ha. Mundësi tejkalimi ka, se këtu shembujt e shkëlqyer tregojnë se në disa kooperativa ka pasur parcela ku janë marrë 50-60-70 kv për ha. Edhe disa shokë drejtues të rrëthit kanë krijuar parcela eksperimentale, ku mendojnë të marrin deri në 100 kv për ha e më tepër. Natyrisht ne nuk kërkojmë që shifra të tillë të realizohen në gjithë rrëthin, po ka mundësi që si rrëth të ngjiteni më lart nga rendimentet që janë marrë deri tanë.

Në kooperativat bujqësore që vizitova pasqë disa gjëra që nuk më pëlqyen, sidomos në çështjen e ditëve të punës. Atje kishte kooperativistë të mirë, të lidhur shumë me punën, por që kanë bërë mesatarisht deri në 110 ditë-punë në vit. Kjo është shumë pak. Atje nuk zbatohen metodat e përparuara agroteknike, misrit i

bëjnë vetëm një prashitje, megjithëse forca pune kanë, duke u nisur nga fakti se kanë ujë, kënaqen që marrin 25 kv për ha, kurse nuk duhet të kënaqen, por të ecin edhe më përpara.

Në përgjithësi ditët e punës që bëhen në kooperativat tuaja janë të pakta. Luftoni që të përqafohet gara e shpallur nga kooperativistët e rrethit të Gjirokastrës për të bërë 300 ditë-punë në vit. Kjo është e domosdoshme, se vendi në rrethin tuaj është shumë i bukur dhe i përshtatshëm, për t'u bërë me të vërtetë një kopësht. Ka mundësi që ju të zhvillon kultura intensive dhe gjithë këto kodra kaq të mira që keni këtu të mbushen me pemë.

Në kooperativat bujqësore ka rezerva të mëdha në shfrytëzimin e forcave të punës. Prandaj kooperativistët nuk duhet të kënaqen me ato që kanë arritur, por të punojnë për të shtuar të ardhurat duke hapur më shumë toka të reja dhe duke i mbjellë me pemë frutore dhe atje ku ka mundësi të zgjerohen tokat e mbjella me misër dhe me kultura të tjera që kanë rëndësi të madhe.

Edhe në blektori ju jeni prapa. Këtu kam të bëj me kuadro, prandaj do të flasim edhe për të mirat edhe për dobësitë tona. Ju nuk duhet të bini në pozitat e atyre që ankohen e thonë se nuk kemi ku t'i kullosim bagëtitë. Kur prishim livadhet që t'i shfrytëzojmë për toka buke, ne bëjmë llogari se kjo punë do të sjellë të ardhura më shumë, ndryshtë nuk kemi pse ta bëjmë një gjë të tillë. Llogaritë duhet të jenë të tillë që në vend të kullotave natyrale më mirë të mbjellim misër, jonxhë etj., por edhe bagëtitë të mos i pakësojmë. Vetëm dhitë do t'i pakësojmë gradualisht që të ruajmë dhe të shtoj-

më pyjet, por edhe të ardhurat nga dhitë do të përpinqemi t'i zëvendësojmë me të ardhura të tjera përfshatësinë, që ajo, jo vetëm të mos dobësohet ekonomikisht, por përkundrazi t'i krijohen kushte që të jetojë më mirë.

Përsa u përket lopëve, dhenve, derrave, shpendëve, bletëve duhet të bëjmë përpjekje të realizojmë planet e vendosura. Këto ne nuk do t'i pakësojmë, përkundrazi do ta shtojmë numrin e tyre. Luftën më të madhe ne duhet ta bëjmë në drejtim të rritjes së rendimenteve. Prandaj krijimi i këtyre kushteve, si hapja e tokave të reja, shtimi i sipërfaqeve të mbjella me misër, jonxhë etj., do të bëjë që ushqimet përfshinë medoemos të shtohen shumë më tepër dhe të jenë më të bollshme se ushqinet që merrte bagëtia në prozhme e në livadhe ku lihej të kulloste më parë.

Kur i lëshonim bagëtitë nëpër çaire nuk merrnim rendimente të larta në qumësht, mish, lesh etj., përkundrazi rendimenti ka qenë i ulët.

Praktika e kullotjes së bagëtive në çaire e në livadhe nuk na ka dhënë rezultate. Duhet të shtojmë sipërfaqen e mbjellë me misër dhe në rrëthim tuaj ka mundësi kolosale përfshirë gjë të tillë dhe kjo do të na ndihmojë që të shtojmë jo vetëm bagëtitë, por edhe prodhimtarinë e tyre. Prandaj fshatari si çdo gjë që i thotë Partia edhe këtë çështje me siguri do ta kuptojë, po puna është që ta kuptojë sa më parë.

Rëndësinë e zhvillimit të blegtorisë, ju shokët e Partisë e të pushtetit, ta kuptoni mirë dhe të punoni intensivisht që bashkë me bujqësinë të ecë edhe blegtoria. Synoni dhe punoni edhe përfshimin e krerëve,

po luftoni në radhë të parë sa më shumë për rendimentet. Kryesorja në këtë çështje është të prodrojmë sa më shumë dhe për këtë rëndësi të madhe ka sigurimi i bazës ushqimore. Këtë e kemi thënë dhe do ta themi vazhdimisht se është problem i madh.

Baza ushqimore sigurohet kryesisht me jonxhë dhe me silazh. Për kultivimin e jonxhës ju keni tradita. Për rrëthin tuaj kjo mund të bëhet si janë bërë bimët industriale në rrëthet e tjera, sepse do t'ju sigurojë të ardhura të rëndësishme, jo vetëm si ushqim për bagëtitë, por do të keni mundësi të shitni edhe farën e saj. Parvjet rrëthi juaj siguroi 20 milion lekë të ardhura vetëm nga fara e jonxhës. Sikur t'i vini rëndësi kësaj çështjeje ju mund t'i trifishoni këto të ardhura, sepse fara kërkohet shumë në të katër anët e vendit tonë. Ne importojmë farë nga jashtë dhe e gjejmë me vështirësi të madhe. Prandaj zhvilloni kulturën e jonxhës dhe përdoren i për ushqimin e bagëtive e për farë, por jo të zini me të tokat e misrit.

Problem tjetër për ju është çështja e frutikulturës. Toka dhe klima e rrëthit tuaj janë shumë të përshtatshme për fruta. Prandaj mos u kënaqni me ato që keni gjetur nga prindërit ose me ato pak që keni mbjellë edhe vetë. Për këtë qëllim, si rrëth, duhet të keni një plan pesëvjeçar të detajuar, optimist dhe optimal dhe brenda 4-5 vjetësh të gjitha kodrat e bukura të rrëthit tuaj t'i mbushni me pemë frutore. Populli dhe organizata e Partisë e rrëthit tuaj i kanë të gjitha mundësitë për ta realizuar një detyrë të tillë. Frutat do t'ju sjellin të ardhura të mëdha. Ato nuk duhet të mbillen si në të kaluarën, por të krijohen plantacione të tëra, domethënë

bloqe të mëdha, të tregohet kujdes i madh për mbjellen, zënien dhe rritjen e tyre, të ketë skuadra të veçanta për frutikulturën. Edhe në kooperativat bujqësore të mos mbillen pemë të veçuara, por në bloqe dhe të caktohen skuadra për këtë punë që të kujdesen për to, ashtu sikurse për arat ose për bagëtitë, sepse frutat na sigurojnë valutë dhe për ta gjen kurdoherë treg, brenda e jashtë vendit. Për fruta e perime jashtë ka shumë kërkesa. Nga vende të ndryshme vijnë me aeroplanë për të blerë preshët dhe qepët tona e jo më frutat.

Në nibledhjen e përfaqësuesve të vendeve socialiste që bëmë në Moskë në muajin shkurt të këtij viti u diskutua problemi i zhvillimit të bujqësisë të vendeve të demokracisë populllore të Evropës, si dhe masat që duhet të merren për planet tona mbi këtë çështje. U shtrua problemi i frutave, i vreshtave, u rekomandua që të zgjerohet sa më shumë prodhimi i frutave për të cilat ka kërkesa. Për këtë qëllim ne kemi një plan të gjerë, kemi krijuar edhe fidanishte, po mbjellim fruta nëpër bloqe dhe për ta shpejtar këtë punë do të sjellim fidane edhe nga jashtë.

Për rrushin kemi pasur një plan mjast të gjerë dhe do të vazhdojmë ta realizojmë, po jo në atë masë të madhe që ishte parashikuar, pasi shumë nga vendet socialiste janë duke mbjellë rrush, prandaj askush prej tyre nuk na e blen rrushin, nuk ka kërkesa nga ata as për verën e rakinë, se i prodhojnë vetë. Kështu përsa u përket rrushit dhe verës do të ecim me kujdes. Për ato që kemi vënë ose që kemi në plan të mbjellim nuk ka asnje rrezik se na mbeten, po për një plan më të gjerrë në shtimin e vreshtave ne nuk do të punojmë. Ne

duhet të mbjellim lloje rrushi të zgjedhur për nevojat e tregut tonë dhe për të plotësuar kërkesat e jashtme, sepse në vendin tonë rrushi piqet shpejt. Pra ka mundësi që në fillim të sezoni ne të eksportojmë mjaft rrush, ashtu sikurse ndodh me frutat e tjera e zarzavatet. Kështu edhe vreshtat tona do të jenë rentabël. Ne edhe verë do të shesim, por jo nga kjo që prodrojmë tani, se nuk është verë, po uthull.

Prandaj duhet ta zhvillojmë shumië frutikulturën dhe ju këtu keni mundësi të mëdha. Por që këto mundësi t'i ktheni në realitet, të mobilizoni Partinë, pushatetin dhe kuadrot t'i organizoni mirë, sidomos në kooperativat bujqësore. Ne kemi suksese të mëdha në bujqësi se arritëm të realizojmë kolektivizimin e bujqësisë në përqindje të kënaqshme. Rrethi juaj ka kolektivizuar rreth 50 për qind të tokës, pra jeni pak prapa, por edhe ne nuk ju këshillojmë që të ecni me 100 km në orë. Në radhë të parë të bëni përpjekje për të futur në kooperativat ekzistuese ato familje që kanë mbetur jashtë. Sa për në malësi mos u shpejtoni, se shpejtimi mund të sjellë dëme. Këtë e ka thënë kurdoherë Partia jonë. Mirëpo disa rrethe kanë marrë zjarr, po ngrenë kooperativa me 40 hektarë dhe për t'i bërë me 50 ha heqin dynymë nga oborri i anëtarëve, gjë që nuk është mirë dhe ngjall pakënaqësi.

Në malësi kooperativat bujqësore tanë për tanë nuk duhen ngritur. Forcat e tepërtë të krahut të drejtohen në qendrat e punës, sepse nuk është me vend që të krijuhen kooperativa bujqësore që bëjnë bukë vetëm për 3 muaj dhe pastaj t'i mbajë shteti në kurriz. Organet shtetërore në këtë drejtim duhet të punojnë me mend.

Kolektivizimin e bujqësisë ne e kryem me sukses, pa gabime parimore dhe politike që mund të dëmin tonin çështjen e kolektivizimit, megjithëse gabime aty-këtu, nga njëri apo tjetri janë bërë dhe ato duhen ndrequar. Tani çështja është që të mos kënaqemi me kooperativat që kemi krijuar, por të luftojmë për ta organizuar sa më mirë punën në kooperativat ekzistuesc. Kjo duhet të jetë një luftë e vazhdueshme. Prandaj tani neve na shtrohet si detyrë e rëndësishme forcimi organizativ i kooperativave bujqësore.

Kjo duhet kuptuar mirë. Partia dhe populli duhet ta kuptojnë se vetëm një njeri nuk mund të vendosë formën e organizimit më të mirë të punës. Po të mos mbështetet në masat dhe po të mos ua bëjë të kuptueshme si duhet atyre rëndësinë e organizimit të mirë të punës, Partia do të ketë vështirësi në arritjen e qëllimit që synon. Fshatarësia jonë duhet të kuptojë se vetëm me punë të palodhur ne do të arrijmë bollëkun. Duke i bërë bisht punës, duke mos kuptuar se duhet të punojnë të gjithë, duke mos i mobilizuar të gjitha forcat e mundshme të punës, nuk mund të kemi rezultatet e dëshiruara. Po të mos kuptojë fshatarësia, se të gjithë, burra e gra, duhet të dalin në punë dhe të bëjnë një punë të ndershme, të frytshme, të normuar, të organizuar e të kontrolluar, nuk mund të arrijmë rezultatet që dëshirojmë. Këtë gjë Partia me një propagandë aktive duhet t'uua bëjë të kuptueshme kooperativistëve duke e lidhur punën politike dhe propagandistike me punën në arë.

Një gjë e tillë mund të duket e lehtë, por në jetë gjen mjast vështirësi. Partia nuk u trembet vështirë-

sive, por lufton e punon që të ecet drejt. Këto gjëra i madh e i vogël duhet t'i kuptojë në fshat.

Tani çështja është se si duhet parë kjo propagandë. Së pari, të kapen mirë kyçet. Kryesia e kooperativës të udhëhiqet mirë nga organizata-bazë e Partisë e cila duhet të marrë vendime të drejta dhe të kontrollojë zbatimin e tyre, domethënë të punohet që komunistët të jenë në ballë të punës dhe të luftës me vështirësitë. Komunistët të mos qëndrojnë prapa, të mos punojnë në depo e të merren me rritjen e pulave, që janë nga punët më të lehta, por të shkojnë atje ku fronti i punës është më i rëndë. Kjo është hallka kryesore që lidh fshatarësinë me punën.

Pastaj vijnë edhe hallkat e tjera, brigadierët, skuadërkomandantët, teknikët e lartë e të mesëm. Këta, t'i edukojë më shumë organizata-bazë e Partisë, që të kenë frymë të lartë mobilizimi, organizimi e metodës pune të shëndoshë, se ata janë oficerët e punës në kooperativat bujqësore, që inkuadrojnë forcat dhe çojnë ushtrinë e punës në luftën e prodhimit, në fitore. Prandaj Partia t'i edukojë, t'i mobilizojë e t'i kalitë me një disiplinë të hekurt në radhë të parë këta kuadro. Këta të janë njerëzit më të aftë, më të qëndrueshmë, më punëtorë dhe më të ndershëm në kooperativë. Këto cilësi duhet t'i kenë medoemos këta njerëz dhe Partia t'ua forcojë ato çdo ditë. Partia t'i korrigojë ata kur gabojnë, se njerëz pa të meta nuk ka, të mos i godasë dhe të mos i hedhë poshtë menjëherë, por vetëm kur ndonjëri e mbush kupën, vetëm atëherë të ndëshkohen.

Në rast se në kooperativë këta njerëz do të janë të

mirë ne do të kemi një rritje të shpejtë të ekonomisë bujqësore dhe mundësitetë i kemi. Së pari, Partia jonë është shumë e fortë dhe me plot komunistë që kanë një ndërgjegje të lartë, që e kanë treguar shpirtin e sakrificës shumë herë në momente të vështira edhe tani që lufta për ndërtimin e socializmit është më e komplikuar nga ajo që kemi bërë në mal. Ata që kanë marrë pjesë në Luftën Nacionalçirimitare duhet të jenë në ballë të luftës për ndërtimin e socializmit, ata duhet të mos tërhiqen në asnjë moment por të gjitha forcat t'i vënë në shërbim të popullit. Njerëzit e Luftës Nacionalçirimitare të mos janë kryelartë vetëm për faktin se kanë marrë pjesë në luftë, sepse vetëm me të kaluarën nuk jetohet. Nuk duhet të nënveftësohen ata që, për një arsy apo për një tjetër ose sepse ishin të rinj, nuk kanë qenë në luftë. Të vjetrit duhet ta kenë të qartë se lufta për ndërtimin e socializmit është një luftë tjetër e madhe dhe e lavdishme, nga e cila dalin çdo ditë luftëtarë po aq heroikë sa ata të luftës që u bë për çlirimin e Shqipërisë.

Kuadrot e vjetër janë një thesar i madh për Partinë dhe popullin tonë. Ata janë besnikë të sprovuar për çështjen e popullit. Por besnikërinë dhe vuajtjet e tyre ata duhet t'i lidhin ngushtë me kuadrot e rinj heroikë, me popullin që po vazhdon luftën për ndërtimin e socializmit. Partia jonë i ka të gjitha mundësitetë që me një organizim më të mirë të punës t'i forcojë kooperativat bujqësore dhe me siguri ato do të ecin përipara.

Ju e dini se interesi personal është i lidhur ngushtë me interesin e përgjithshëm, por në këto çështje duhet

shumë kujdes. Mos kërkoni që fshatari të thotë vetë «urdhëroni ma merrni oborrin». Kjo nuk ndodh. Një kohë e tillë do të vijë, por tani në këtë fazë Partia e ka lejuar oborrin për shumë arsy. Kryesorja është se në këtë fazë vetëm me të ardhurat nga kooperativa bujqësore fshatarësia nuk i plotëson dot të gjitha nevojat. Po t'i plotësojë atëherë ajo nuk ka përsë ta mbajë lopën dhe të humbasë kohën. Për të do të ishte më mirë të shkonte në dyqanin e kooperativës të blinte qumshtin ose zarzavatet. Tani për tani një gjë e tillë nuk i sigurohet.

Pastaj duhet të krijohet edhe besimi i kooperativisteve te kooperativa, besim i cili nuk krijohet vetëm me fjalë, por me punë; me punë do të krijohet bollëku dhe kur të krijohet ky bollëk, atëherë mund t'i themi kooperativistit: «ç'të duhet oborri kooperativist». Por tani ai përveç ndjenjës mikroborgjeze që ka për tokën ndien edhe nevojë ta ketë. Do të vijë koha që fshatari nuk do ta ketë edhe këtë, por tani në asnjë mënyrë nuk duhet t'ia marrim oborrin se një masë e tillë do të ishte e parakohshme. Nuk është mirë të shkojmë në kundërshtim me ndjenjat e fshatarit, por të luftojmë që kooperativat bujqësore të jalin rendimente të mëdha e të marrin prodhime të shumta që kooperativisti t'i shikojë të mirat e kolektivizimit të bujqësisë.

Kur i lëmë oborrin, ne e ndihmojmë fshatarin që është futur në kooperativë, të mbajë një lopë dhe disa bagëti të imta, pula, ndonjë derr etj. Në këtë parcelë ai prodhon misër për silazh ose jonxhë. Një ndihmë të tillë ekonomike ne kemi interes t'ia japim fshatarit, sepse tani për tani me kooperativën bujqësore nuk

kemi krijuar një forcë të tillë ekonomike sa të mundim t'i plotësojmë të gjitha nevojat e fshatarësisë dhe të furnizojmë rregullisht klasën punëtore, që lufton heroikisht për ndërtimin e socializmit dhe që i jep ekonomisë popullore gjithë këto të mira. Punonjësit e fabrikave, të minierave dhe të administratës duhet të ushqehen se edhe ata i japin shoqërisë, prandaj ndërmarrjet bujqësore dhe kooperativat bujqësore duhet t'i furnizojnë qytetet. Por derisa nuk e kemi krijuar bollëkun në kooperativat bujqësore ne nuk mund t'i themi kooperativistit ta lërë oborrin se me të ai plotëson mjaft nevoja të tij.

Në rast se kooperativistët duan ta shkurtojnë ose ta lënë fare oborrin «malet tona më të larta». Kjo do të tregonte se ata e kuptojnë që puna në kooperativë krijon bollëkun e jo oborri kooperativist. Pra interesi personal si kudo edhe në kooperativat bujqësore duhet të lidhet dhe të kombinohet në çdo etapë me interesin e përgjithshëm.

Partia duhet të jetë shumë e vëmendshme dhe e kujdeshme që të mos bëhen padrejtësi ndaj kooperativistëve në lidhje me pagesat e ditëve të punës, me normat etj. T'u kërkojmë fshatarëve që ta kuptojnë drejt rëndësinë e normave dhe të ditëve të punës, vetëm se ato duhet të figurojnë drejt në regjistër dhe kur në këtë çështje bëhet ndonjë padrejtësi Partia të mos lejojë t'i hahet e drejta kooperativistit që ka punuar, në dobi të atij që ka tërhequr këmbën zvarrë. Për hatërin ose për miqësinë me brigadierin kooperativisti nuk duron t'i cenohet e drejta. Nuk lejohet që t'i regjistrohen më shumë ditë-punë ndonjërit pa i bërë

ato. Këto janë të rrezikshme. Kundër këtyre shfaqjeve Partia të jetë në ballë të luftës.

Askush të mos mendojë se fshatari këto gjëra nuk i sheh dhe nuk i kuption. Sytë e popullit janë të zgjuar dhe të mprehtë, zemra e popullit është e gjerë dhe në rast se ai nuk flet një herë e dy, këtë e bën për respekt ndaj Partisë dhe për dashurinë ndaj kooperativës. Ndonjëri edhe mund të mendojë: «e ç'tia them në sy në mes të asamblesë këtë dobësi», sepse, me gjithëqë ky veprim është i gabuar, ai ka edhe disa anë të mira.

Prandaj Partia t'i ketë parasysh këto gjëra. Populli të fal një herë, por kur ti e mbush kupën ta vesh ftyrës, bic nga fiku dhe dëmton vëten dhe Partinë. Partia këto gjëra t'i shohë mirë dhe të punojë që të ngrihet vigjilanca e gjithë fshatarëve kundër këtyre gjérave e të shtrohen këto në asamblé dhe kjo të mos bëhet një gjë formale.

Ju duhet t'ua shtroni kooperativistëve pikëpamjen e Partisë, planin e zhvillimit të kooperativës, që ata ta kuptojnë se ky është në të mirën e tyre. Por duhet të keni parasysh edhe propozimet e popullit, ato t'i dëgjoni e t'i shqyrtoni me kujdes. Prandaj, kur ka vërejtje ato të mos hidhen poshië. Partia dhe pushteti në fshat, në lokalitet ose në rrëth e deri në qendër t'i studjojnë ato me vëmendje, dhe jo vetëm kaq, por t'u thonë fshatarëve se kjo dhe ajo do të bëhet, kurse këto të tjerat nuk është e mundur të bëhen në këtë fazë për këto ose ato arsyen.

Ndodh shpeshherë që shifrat orientuese nuk diskutohen si duhet në bazë, nuk dëgjohet zëri i organizatës së Partisë dhe i kryesisë së kooperativës, se ata

që vijnë nga rrethi dhe drejtojnë mbledhjen u thonë se ky është plan. Nëse është kështu, atëherë përsë e kanë sjellë këtu? Nëse e kanë sjellë që edhe unë të them fjalën time, atëherë më lejo të them mendimin. Pra vërcjtjet e bazës duhet të kihen parasysh.

Komititetet e Partisë kanë pasur të meta në këtë drejtim. Të meta kanë pasur edhe organet e pushtetit. Komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve nuk janë interesuar sa duhet për një problem të tillë. Këtë përshtypje kam unë për çështjen e drejtimit të kooperativave bujqësore. Prandaj komitetet e Partisë duhet t'i ndihmojnë më shumë njerëzit e pushtetit sidomos në lokalitete dhe në këshillat e fshatrave, me qëllim që ata të mobilizohen plotësisht për të ndihmuar më shumë bujqësinë dhe kooperativat bujqësore. Komitetet ekzekutive të KP të rretheve duhet t'i vënë rëndësi sidomos forcimit të organeve të pushtetit në lokalitete, të cilat duhet të janë të lidhura ngushtë me kooperativat bujqësore dhe me popullin, të dëgjojnë vërejtjet dhe kërkesat e tyre dhe të luftojnë që ato të plotësohen kur janë të mundshme. Pra ai të punojë që ndihma të jepet dhe plani të zbatohet.

Drejtuesit e komitetet e kështu të lokaliteteve duhet të janë njerëz që të kenë lidhje të ngushtë me kryetarët e kooperativave bujqësore, të ndjekin zhvillimin e tyre, t'u japid ndihmë konkrete në luftën që bëjnë ata me vështirësitë. Po të veprohet kështu atëherë ne do të kemi një pushtet me të vërtetë afër bazës e që interesohet konkretisht për të.

Të luftojmë që të preqatitim kuadro të fortë për pushtetin, se me bashkimin e kooperativave bujqësore

në ekonomi të mëdha do të lindë nevoja edhe për ndryshime të disa hallkave të pushtetit. Ne duhet të kemi këshilla pushteti në të gjitha kooperativat e bashkuara. Atëherë në çdo lokalitet në vend të 12 këshillave do të kemi 3 ose 4, domethënë aq sa do të janë edhe kooperativat e bashkuara. Kjo do të kërkojë suprimimin e këshillave të lokaliteteve dhe krijimin e një këshilli fshati të fuqishëm që do të drejtojë të gjithë kooperativën e bashkuar dhe që do të lidhet drejtpërsëdrejti me rrethin pa qenë nevoja të kemi një hallkë të ndërmjetme.

Kur të kemi këto forma drejtimi edhe kuadrot duhet të janë më të aftë për të bërë një punë më të madhe nga ajo që zhvillohet sot. Prandaj të bëhet një punë e vazhdueshme me kuadrin e kooperativave bujqësore, se me bashkimin e disa kooperativave në të ardhshmen, do të janë po ata kryetarë, por duhet të janë më të mësuar që të mund të drejtojnë një ekonomi më të madhe, pasi nga ata do të varet ngritja ekonomike e kooperativave të bashkuara. Këta kuadro do të kenë përgjegjësi të madhe, prandaj t'i mësojmë dhe t'i edukojmë.

Çështja e arsimit të përgjithshëm, teknik, profesional dhe marksist-leninist duhet të na preokupojë vazhdimisht me gjithë punën e madhe që kemi. Pa mësim nuk zgjidhen detyrat që na janë ngarkuar. Tani vazhdimisht dalin njerëz të rinj, të mësuar, të cilët nuk kënaqen vetëm me një drejtim në përgjithësi të përgjegjësit pa shkollë. Më parë edhe mund të kalohej, se niveli arsimor e kulturor në përgjithësi ishte i ulët, mirëpo tani ndryshuan kohët, po dalin me qindra kuadro të rinj. Gati të gjithë kuadrot tanë drejtues kanë

mbaruar shkollën e lartë me shkëputje nga puna ose me korrespondencë, me gjithë punën e tyre të madhe. Ata që nuk e kanë mbaruar, po e vazhdojnë, se puna kërkon dituri dhe mësim.

Sigurisht në punë ka vështirësi, sidomos për shokët që punojnë në kooperativat bujqësore, por edhe këta duhet të mësojnë ashtu si bëjnë shumë të tjerë, duke ndjekur njëkohësisht edhe format e arsimit që ka caktuar Partia. Pra çështjes së mësimit t'i vihet rëndësi e madhe ashtu sikurse punës.

Kujdes të madh duhet të tregoni ju edhe në luftën kundër fanatizmit. Në rrëthin tuaj ka pak më tepër fanatizëm se në disa rrethe të tjera. Por populli i krahanës së Peshkopisë nuk qëndron më poshtë nga ai i krahanave të tjera. Populli juaj shquhet për trimërinë, për ndershmërinë dhe në lidhje me gruan them se nuk është fanatic i verbër; këtë kujdes ai e tregon për të mbrojtur nderin e saj. Mirëpo morali i njerëzve të Partisë sonë duhet të jetë i tillë që t'u japë besim të plotë atyre që punojnë për aktivizimin e gruas në punë.

U thashë shokëve të Partisë në kooperativa se gratë nuk para i dërgojnë në punë. Partia këshillon që shqet të shkojnë në shkollë e të futen në punë, sepse pa gruan socializmi nuk mund të ndërtohet. Gruaja është një nga faktorët kryesorë që do të ndihmojë për ndërtimin e shoqërisë së re, është ajo që do të lindë dhe do të rritë brezat e ardhshëm dhe do t'i edukojë ata. Gruaja duhet të marrë pjesë në prodhim e në jetën shoqërore krah për krah me burrin. Atëherë ne do të kemi një brez të ardhshëm të edukuar nga gra heroike dhe punëtore.

Këtë gjë fshatarët tanë po e kuptojnë dhe në shumë krahina të Shqipërisë gruaja po shkon përpara. Por ka edhe disa krahina ku gruaja është akoma prapa. Këtë çështje do ta kuptojnë të gjithë, por sa më shpejt ta kuptojnë aq më mirë do të jetë. Kjo është e reja në vendin tonë.

Populli ynë është përparimtar, ai e përqafon shpejt të renë, por roli i Partisë është të bëjë që çdo gjë e re të përqafohet sa më shpejt, të bëhet kthesë rrënjosore në këtë drejtim dhe të ecim përpara. Këtë gjë Partia duhet ta kuptojë mirë e drejt dhe të punojë me këmbëngulje për ta vënë atë në jetë.

Pikëpamjet fetare dhe besimet e kota vetëm me punë mund të luftohen. Prandaj me punë, me edukim, me shkollë dhe me mësim ne do të ecim përpara. Ju duhet të jeni akoma më të guximshëm në këtë drejtim, por të mos shkohet në akte fërkimi të palejueshme me popullin. Vazhdoni të punoni sidomos me rininë në radhë të parë, me gratë dhe me njerëzit përparimtarë. Kundër atyre që bëjnë propagandë fetare në dëm të pushtetit luftoni dhe mos kini mëshirë. Veprimtarinë e tyre ia bëni të qartë popullit që ai ta kuptojë konkrektisht se filan fetar po shfrytëzon besimin e tij duke dashur që fenë ta përdorë në dëm të shtetit dhe të ekonomisë. Atëherë kushdo goftë ai që dënohet, populli do të thotë se mirë ia bënë. Situata tani ka arritur që edhe prapanikët të mendojnë e të dallojnë se cili është interes i atdheut, i kooperativës bujqësore dhe cili është interes i klerikëve, injorantë e reaksionarë. Këtë ia bëni të qartë popullit.

Kur një njeri të keq ia bën të njojur popullit kush

është, cdhe sikur ta pushkatosh, do të gjesh përkrahjen e tij, bile populli do ta kërkojë vetë dënimin e tij. Por kur nuk ia bën të qartë popullit ai nuk bindet. Prandaj qoftë edhe një klerik, kur dëmton interesat ekonomike ose politike të popullit, ai të demaskohet përparrë tij. Ju e dini se çfarë kanë bërë priftërinjtë katolikë, ata organizonin komplotë, fshihnin pushkë në kisha për t'i përdorur kundër pushtetit, por forcat tona të Sigurimit të Shtetit i kanë kapur dhe i kanë demaskuar. Çfarë tha populli për Patër Anton Harapin që dogji vendin bashkë me gjermanët, kur e mësoi kush ishte ai? «Mirë ia bënë», tha populli. Por, po të mos i kishim demaskuar armiqtë, populli do të thoshte «more, ç'po bëhet kështu nga kjo qeveri, pse na godet fenë?». Prandaj, po të mobilizojmë popullin të jemi të bindur se Partia dhe pushteti do t'i zhdukin këto të meta e pengeza që ekzistojnë dhe do të arrijmë suksese akoma më të mëdha se deri tani në punën tonë.

Mund t'ju them, jo për t'ju bërë qejfin, se qendra juaj, Peshkopja, është një qytet i bukur dhe i pastër. Për ngritjen e këtij qyteti të ri dhe në interesimin për jetesën e punonjësve duket kujdesi i Partisë dhe i pushtetit në rreth. Një kujdes i tillë duhet të tregohet në të gjitha drejtimet, sepse në rrethin tuaj janë bërë gabime të palejueshme, sidomos në çështjen e përvetësimeve e të shpërdorimeve. Komiteti ekzekutiv i këshillit popullor dhe ai i Partisë i rrethit tuaj në lidhje me përvetësimet e me grabitjet që janë bërë në kooperativat e konsumit janë kritikuar si nga Qeveria, ashtu edhe nga KQ i PPSH. Të tilla gjëra nuk duhen lejuar. Njerëzve që kryejnë veprime të tilla në dëm të shtetit

dhe të popullit, t'u bëhet luftë e pamëshirshme se ata me veprimet e tyre komprometojnë politikën e Partisë e të Qeverisë sonë në sytë e popullit dhe dëmtojnë ekonominë.

Në emër të KQ ju këshilloj të tregoni kujdes që të mos përsëriten shfaqje të tillë. Veprime si këto kanë ndodhur edhe në rrethin e Fierit, dhe jo vetëm një herë, për mungesë vigilance dhe kontrolli nga ana e Partisë, e pushtetit dhe nga ana e masave të popullit. Kjo do të thotë se duhet punuar akoma më shumë për forcimin e ndërgjegjes së njerëzve. Në qoftë se ne flemë, i ligu komprometon të tjerët. Ai që është i lig gjenn forma dhe metoda, vete te punonjësi i ndershëm dhe në qoftë se nuk e komprometon dot nga ana financiare të paktën afrohet me të për të fshehur veprimet e tij. Atje ku gjen, i ligu bën lëshime, jep më lirë, më shpejt, ruan për t'i dhënë «mikut» nga gjëja e mirë, pastaj veprime të tillë bëhen zakon dhe pak nga pak shkon më thellë derisa ia arrin qëllimit. I ligu këtë e bën që të mos zbulohet puna e tij, por dhe po të zbulohet të mos jetë i vogël rrethi i të komprometuarve. I ligu nuk është budalla, ai e di se pushteti ynë merr masa të rrepta kundër përvetësuesve e shpërdoruesve, por ka edhe masa edukative. Në rrethin tuaj janë marrë disa masa të rrepta kundrejt personave të tillë. Ne e dimë gjithashtu se në përvetësimet ishin komprometuar edhe shumë njerëz të tjerë, por menduam, dhe me ndërgjegje vendosëm, që ata t'i edukojmë. E vërteta është se këta njerëz kanë shkelur ligjet, kanë dëmtuar ekonominë popullore, por Partia tha që këta mjafton t'i këshillojmë që të mos e përsëritin më një gjë të tillë dhe të dënohen

vetëm shkaktarët kryesorë. Mirëpo në rast se nuk do të vazhdojmë të bëjmë një punë politike dhe propagandistike të organizuar mirë kundër përvetësimeve dhe në qoftë se nuk do të vendoset një kontroll i fortë kundër njerëzve të tillë, ata përsëri mund të kalojnë në pozita jo të shëndosha dhe të bien edhe një herë në gabime.

Një gjë e tillë ndodhi në Fier. Komiteti i Partisë atje vuri re se përmungesë vigjilence dhe kontrolli, ata që ishin pushuar nga puna për përvetësime përsëri ishin futur po në ato punë, me vlera të mëdha materiale. Në vende ku ka vlera të mëdha materiale, të vendosen në radhë të parë njerëz të ndershëm dhe që kanë edhe njohuri financiare. Njeriu i ndershëm nuk do të gabojë; kuptohet kush gabon në mënyrë të pandërgjegjshme, atë Partia e fal.

Prandaj, në sektorin e tregtisë duhet treguar shumë kujdes. Tregtia nga natyra është sektor i tillë që, po të mos jesh i ndershëm, të hollat të kalojnë pa kujdes nëpër duar, gjë që çon nga deficiti në deficit. Në qoftë se malli paketohet e peshohet në rregull nuk ke pse të dalësh deficit. Ka raste që peshoret nuk janë në rregull, por ka edhe raste që grumbulluesi fut dorën në misrin e fshatarit dhe, si pa gjë të keq, i thotë 10 për qind lagshti. Kjo bën që shteti të realizojë disa dhjetëra milion lekë plus. Po shtetit pluse të tilla nuk i duhen, sepse ato u takojnë fshatarëve. Mirë këto pluse se përsëri popullit i kthehen, po ç'të bësh me ato përvetësime që u bëhen fshatarësisë dhe popullit. Prandaj e theksoj edhe një herë që në tregti duhet të vendosen njerëz të ndershëm.

Realizimi i planit katërmujor te ju disi shkon mirë.

Situata në rrethin tuaj duket se nuk paraqitet keq për vitin 1960. Tani varet nga ju që planin e këtij viti ta realizoni me sukses dhe ta tejkaloni, që rrathi i Peshkopisë të vijë me ballë hapur në Kongresin IV të Partisë. Ju duhet të luftoni që të realizoni rendimentet në grurë, në misër etj. Natyrisht ka edhe vështirësi objektive, por, po të mobilizoheni, i keni të gjitha kushtet, sepse pleh u keni hedhur arave, punimet e tokës i keni bërë bukur. Tani duhet t'u vini kujdes të madh prashitjeve, vjeljes e grumbullimit të prodhimeve dhe realizimit të detyrimeve ndaj shtetit. Ky është një problem i dorës së parë, pasi nuk e kemi realizuar detyrën e Kongresit III të Partisë për sigurimin e bukës në vend, gjë që na bën të importojmë 40-50 mijë tonë drithë çdo vit.

Popullin kurrë nuk e kemi lënë dhe s'do ta lëmë pa bukë, por nuk është mirë që edhe Peshkopia, rreth i përmendur për misër, të kërkojë misër. Rrethi juaj, jo vetëm duhet të shlyejë në rregull detyrimet, por të mbajë edhe rezerva drithi. Prandaj duhet të vihen të gjitha forcat për realizimin e planit të drithërave që të shpëtojmë nga importimi mijëra tonë drithë në vit, që i kushton shumë vendit.

Për çështjet politike nuk do të zgjatem. Në përgjithësi situata jonë është shumë e fortë në çdo pikëpamje. Imperialistët, me ata amerikanë në krye, jo vetëm po dobësohen, por edhe po demaskohen rëndë politikisht nga veprimet e tyre agresive dhe të pamatura që bëjnë, bile edhe në sytë e aleatëve të tyre, të cilët e kanë të vështirë t'i mbrojnë. Politika e kampit tonë ka rezultate direkte në dobësimin e imperializmit.

Gjithçka ka ndodhur në Kore, në Japoni, në Turqi

etj. është rezultat i drejtpërdrejtë i luftës së masave punonjëse në ato vende kundër shtypjes dhe shfrytëzimit. Popujt shohin se forca shtypëse e borgjezisë që sundon mbi ta është shumë e madhe dhe nuk është ashtu siç përpiken ta paraqitin, prandaj ngrihen në një mënyrë ose në një tjetër për të flakur tej sundimin e imperializmit.

Imperializmi është për luftë, për shkatërrimin e vendeve socialiste, por atij i duhen edhe aleatë të bindur. Prandaj të hapim sytë dhe të jemi vigjilentë.

Ne jemi dhe do të jemi për paqen dhe çdo situatë do ta shfrytëzojmë në favor të paqes. Vigjilentë do të jemi dhe armiku kurrë nuk do të na gjejë në gjumë. Ne kemi qenë dhe do të jemi kurdoherë vigjilentë ndaj veprimeve agresive të imperializmit dhe të revizionizmit jugosllav.

Partia jonë lidhur me demaskimin e revisionistëve jugosllavë ndjek një vijë të drejtë politike të bazuar në Deklaratën e Moskës të vitit 1957. Revisionistët e Beogradit janë demaskuar, por çështja është që t'i çejrim plotësisht maskën çdo taktike të tyre, se taktika e tyre mund të ketë një farë suksesi kur situatat paraqiten gjoja të qeta.

Revisionistët jugosllavë kanë vazhduar dhe vazhdojnë sulmin kundër nesh, jo vetëm me fjalë e me propagandë, por edhe me aksione. Sidomos me propagandë dhe me agjenturë ata përpiken të gënjejnë njerëzit tanë që jetojnë në kufi me ta se gjoja në Jugosllavi na qenka «paraja».

Në Jugosllavi nuk është parajsë, por skëterrë. Këtë nuk e them se revisionistët jugosllavë i kemi armiq, por

sepse gjendja ekonomike atje është me të vërtetë e vështirë. Për vetë popullin jugosllav gjendja ekonomike dhe morale është e rëndë, të mos flasim pastaj për Kosovën ku patriotët kosovarë i vrasin, i burgosin, i largojnë në Turqi. Në fshatin jugosllav po forcohen kulakët, po u merren tokat fshatarëve të varfër. Vetë statistikat e tyre vërtetojnë gjendjen e rëndë të fshatit jugosllav.

Prandaj, të jemi shumë të vëmendshëm, vigjilentë dhe të pamëshirshëm kundër çdo orvatjeje të revizionistëve. Kufiri ynë të bëhet gardh i pakalueshëm, jo vetëm nga rojet tona heroike të kufirit, por edhe nga Partia dhe i gjithë populli, sepse kemi të bëjmë me pavarësinë e atdheut, me ndërtimin e socializmit që kërkojnë të na e pengojnë revizionistët jugosllavë që janë të shitur kokë e këmbë te imperializmi amerikan. Por si imperialistëve ashtu edhe revizionistëve nuk do t'u ndritë asnjë orvatje kundër vendit tonë.

Të keni kujdes Partinë, se pa Partinë nuk ka ditë të mira për popullin tonë. Partinë ta forcojmë si çeliku, në Parti të kalitet uniteti bolshevik. Përpara interesave të Partisë dhe të popullit flakni tej interesat e vogla personale. Në mes të komunistëve duhet të ekzistojë një dashuri e madhe, e pastër, marksiste-leniniste. Unë mund të të kritikoj rëndë, se të dua, prandaj e bëj këtë, kështu e shpëtojmë shokun nga çdo rrezik. Domethënë të ketë në Parti dashuri marksiste-leniniste dhe jo hatëre. Të luftohen pikëpamjet mikroborgjeze në organizatën-bazë të Partisë, se nga hatëret e mbeturë, nga pikëpamjet mikroborgjeze ngjasin pakënaqësi dhe këto, pastaj, ndonjë komunist i papjekur i kalon në platformë

mëm politike. Të forcohet Partia me njerëz të rinj, jo se të vjetrit nuk janë të vlefshëm, pa këta nuk ecën Partia, por të futet në Parti gjak i ri, gra, të rinj, vecse të mos harrojmë kriterin, jo prano për të pranuar, por më parë të punohet me njerëzit më të dalluar, të pre-gatiten ata e pastaj të propozohen për në Parti. Partia të çelikoset se çdo gjë me Partinë do të realizohet.

Në emër të Komitetit Qendror ju uroj nga zemra suksese në punë dhe sidomos në realizimin e tëjkalimin e planit të vitit 1960!

*Pastaj shoku Jashar Menzelxhiu, sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Peshkopisë, në emër të kuadrove të pranishëm, pasi falenderoi shokun Enver Hoxha për këshillat dhe për ndihmën që dha me ardhjen e tij në këtë rreth, premtoi se organizata e Partisë e rrethit do të mobilizohet me të gjitha forcat për realizimin e të gjitha detyrave që ka përpara dhe me besim të plotë do të bëjë që të meritojë flamurin e Kongresit IV të PPSH.*

*Botohet për herë të parë si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## ME VULLNET TË ÇELIKTË MINATORET KAPËRCEJNE ÇDO VËSHTIRESI

*Fjala në mitingun e punëtorëve të Minierës së Bulqizës  
në rrethin e Peshkopisë*

2 qershor 1960

\

Të dashur shokë punëtorë,

Ju falenderoj nga zemra për dashurinë dhe entuziazmin e madh që po shprehni ju, punonjësit e kolektivit heroik të Minierës së Bulqizës, një prej minierave më të mira të atdheut tonë!

Kjo qendër e rëndësishme ekonomike e vendit tonë nga asgjë që ishte para çlirimt, nëpërmjet vështirësive të mëdha dhe punës së palodhur të punëtorëve, sot është bërë një qendër ekonomike që njihet mirë në të gjithë vendin. Në mes jush ka shumë punëtorë të vjetër, pionierë të kësaj miniere, të cilët që në ditët e para të Çlirimt, kur populli mori fuqinë në dorë, filluan të punojnë këtu me heroizëm në kushte shumë të vështira. Por këto vështirësi u kapërcyen në saje të vullnetit të klasës sonë punëtore dhe të vijës së drejtë të Partisë.

Nevojat e mëdha të ekonomisë sonë popullore i

bënë punëtorët dhe komunistët, që erdhën për të pnuuar në këtë minierë, të papërkulur, të luftojnë me sukses me vështirësitë e mëdha të natyrës, të përballojnë mungesën e mjeteve materiale dhe t'i jasin ekonomisë popullore krom.

Por qysh nga ajo kohë Bulqiza juaj ka ndryshuar shumë. Ju, të dashur shokë punëtorë, e bëtë këtë vend një nga minierat e stabilizuara të Republikës sonë Popullore, e cila realizon, bile, edhe tejkalon planin e shtetit. Dhe nuk kishte si të ndodhët ndryshe, sepse këtu punon një pjesë e klasës sonë punëtore heroike që e kuption rolin e saj drejtues në sistemin e demokracisë sonë popullore. Zotimi që mori këtu drejtori, në emrin tuaj, për të tejkaluar atë që keni marrë më parë, e gjëzon shumë Partinë. Prandaj unë i shpreh me gjithë zemër klasës punëtore të Bulqizës urimet më të mira për ta plotësuar me sukses këtë zotim, gjithashtu ju përgëzoj për heroizmin, besnikërinë dhe dashurinë e madhe që ju keni për Partinë dhe për popullin tonë!

Përpjekjet e Partisë sonë kanë qenë për shtimin dhe forcimin e klasës sonë punëtore, për ta edukuar dhe për ta kalitur atë, pa të cilën do të ishte e pamundur të qëndronte në këmbë regjimi i demokracisë popullore dhe të arriheshin sukseset e deritanishme në ndërtimin e socializmit. Partia jonë në këtë drejtim ka arritur rezultate. Asaj i dilte detyra e ngritjes së industrisë sonë, pa të cilën vendi nuk mund të ecte përpara. Por baza kryesore e industrisë së vendit tonë janë minierat. Prandaj Partia jonë i zgjeroi dhe i pasuroi ato, si nxjerrjen e naftës, minierat e kromit, të bakrit, të hekurit etj., dhe në punë e sipër u krijuat edhe klasa jonë

punëtore, besnike e Partisë dhe e popullit, një klasë punëtore e denjë për të udhëhequr atdheun tonë drejt socializmit dhe komunizmit.

Nga radhët e klasës sonë punëtore kanë dalë dhe dalin vazhdimisht heronj të punës. Minierat tona nuk janë më si në të kaluarën, pa kuadro. Në fillim ne nuk kishim kuadro, por tani kemi pregetitur një numër të madh kuadrosh të mesëm dhe të lartë, teknikët tanë. Ne kemi arritur të pregetitim gjithashtu një numër të madh punëtorësh të kualifikuar, gjë që duket edhe në realizimin e planeve në këtë minierë.

Minierat tona tani janë të pajisura mirë. Megjithëse në këtë drejtim ne kemi akoma shumë për të bërë, çështja është që në miniera të jenë të siguruara:jeta e punëtorëve, mjetet e nevojshme për lehtësimin e punës së tyre në nxjerrjen dhe transportimin e mineralit, jetesa më e mirë dhe kushtet e banimit e të furnizimit normal të punëtorëve. Në të ardhshmen ne besojmë të bëjmë dhe është e sigurtë se do të bëjmë më shumë për modernizimin e minierave tona. Me gjithë këtë, kujdesi për mbrojtjen e punëtorëve, ashtu si dhe për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës, duhet të jetë shumë i madh.

Kromi, sikurse e dini, ka një rëndësi shumë të madhe për ekonominë e vendit tonë. Ai është një mineral i vlefshëm, që i sjell të ardhura të konsiderueshme atdheut, sidomos kromi i Bulqizës që është i pasur. Ne jemi duke hapur edhe miniera të tjera dhe shpresojmë të kenë edhe ato perspektiva të mira, se tani cilësia e mineralit të tyre nuk është si ajo e minierës suaj. Por ekzistojnë fabrika për pasurimin e kromit dhe, duke

marrë parasysh vlerën e kromit në tregjet ndërkombe-tare, ne do të ngremë për këtë qëllim një fabrikë për ferro-kromin, që do ta furnizoni ju, e cila do të jetë një kombinat me shumë rëndësi për ekonominë tonë. Byroja Politike mendon që në një fazë të mëtejshme të tërë kromin e prodhuar në vendin tonë ta përpunojmë në vend dhe ta shesim të gatshëm, sepse kështu do të kemi fitime të mëdha për ekonominë.

Ju duhet të organizoni mirë punën dhe të kuptoni rëndësinë e madhe që ka kromi për ekonominë tonë popullorë. Ju, me ekipet gjeologjike, duhet të punoni për të siguruar rezervat e duhura të kromit jo për 15 vjet, por për një periudhë më të gjatë kohe.

Kështu do të veprojmë edhe me naftën. Deri tanë ne kemi ndërtuar dy rafineri, por pjesa më e madhe e naftës sonë eksportohet brut. Me sigurimin e rezervave të naftës që po kërkojmë, ne do të ngremë edhe rafineri të tjera akoma më të mëdha se këto që kemi ngritur. Natyrisht, këto do të bëhen në mënyrë të studjuar, për aq sa mban ekonomia jonë dhe jo menjëherë. Sidoqoftë perspektivat e naftës janë të mëdha.

Ne do të ecim përpara gjithashtu edhe në shfrytëzimin e mineralit të hekurit. Me këtë mineral ne kemi një pasuri të madhe dhe rezervat e njoitura janë të mira. Hekuri ynë ka një përqindje të madhe nikeli, metal deficitar, që kërkohet shumë nga vendet e tjera. Si hekuri ashtu edhe nikeli kanë rëndësi të madhe për ekonominë tonë. Komiteti Qendror i Partisë ka menduar të ngrihet kombinati metalurgjik në Shqipëri, prandaj u ka propozuar miqve për këtë çështje dhe në

parim ky propozim është aprovuar<sup>1</sup>, me qëllim që Shqipëria të ndihmohet ta shfrytëzojë si duhet hekur-nikelin dhe të krijohet baza e metalurgjisë së zezë edhe te ne. Kombinati metalurgjik do të jetë një ndërmarrje e madhe për vendin tonë, që do të vihet në funksionim me anën e energjisë elektrike. Prandaj paralelisht me ngritjen e tij, parashikohet të ngrihet dhe një hidrocentral i madh në afërsi të Kukësit. Ndërtimi i kombinatit metalurgjik që do të jetë baza e industrisë sonë, do të jetë një fitore e madhe në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të Shqipërisë. Punimet paraprake për këtë vepër të madhe parashikohet të fillojnë nga fundi i këtij pesëvjeçari. Me ngritjen e kësaj vepre, në Shqipëri do të prodhohen një sërë artikuujsh hekuri, sidomos për ndërtimet, që deri tani ne i importojmë.

Plani ynë i ardhshëm është studjuar me kujdes. Në të parashikohen të bëhen investime të mëdha, afërsisht deri në 60 miliard lekë, vetëm në sektorin e ndërtimeve investimet do të arrijnë 38-40 miliard. Kjo tregon rritjen e madhe e të vazhdueshme të buxhetit tonë, të ekonomisë sonë populllore.

Sic e shikoni perspektiva e zhvillimit të minierave në vendin tonë është e mirë. Partia dhe Qeveria hartojnë plane në këtë drejtim dhe i realizojnë ato në kohën e caktuar. Këto suksese janë bërë të mundshme, sepse njerëzit tanë që punojnë në miniera janë të zotë, besnikë dhe e kuptojnë rëndësinë që kanë minierat për zhvillimin e ekonomisë sonë populllore.

Zhvillim të madh në pesëvjeçarin e ardhshëm do

---

<sup>1</sup> Shih në këtë vëllim shënimin f. 71.

të marrë industria. Do të ndërtohet një kombinat i madh për prodhimin e plehrave fosforike<sup>1</sup>. Një tjetër kombinat plehrash kimike do të ndërtohet edhe në Fier e përveç këtyre, do të ndërtohen kombinate e fabrika të tjera për prodhimin e çimentos, të tekstileve, të këpucëve, të sheqerit etj.

Një situatë të tillë e krijoj Partia, qëjeta e popullit në pesëvjeçarin e ardhshëm të përmirësoset në të gjitha drejtimet, që populli të ketë më shumë mallra të konsumit të gjerë, të një cilësie më të mirë dhe më të lira. Partia lufton që të krijojë kushte ekonomike dhe kulturnore më të mira për popullin.

Në këtë drejtim do të ndihmojë shumë edhe përparimi i bujqësisë që tanë ka hyrë në një rrugë të drejtë pasi 83-84 për qind e tokës janë kolektivizuar. Ky është një sukses i madh. Tani neve na vihet detyrë që t'i forcojmë kooperativat bujqësore nga ana organizative, Partia të punojë për ngritjen e ndërgjegjes së kooperativistëve dhe për forcimin e dëshirës së tyre për punë, që t'i kushtohet kujdes i madh organizimit të punës në kooperativat bujqësore për realizimin dhe për tejkalimin e planeve.

Partia lufton që në bujqësi të futen metodat e përparuara agroteknike në të gjitha drejtimet, të shfrytëzohen si duhet mjetet e mekanikës bujqësore dhe të merren masa të mëtejshme për kullimin dhe për ujitjen e tokave.

Shteti, në të ardhshmen, do ta ndihmojë bujqësinë duke shtuar më tepër mjetet e mekanikës bujqësore.

---

<sup>1</sup> Është fjala për Uzinën e Superfosfatit në Laç.

Por me shtimin e këtyre mjeteve nuk do të thotë se fshatari duhet t'i braktisë qetë. Ata ne duhet t'i ruajmë se na nevojiten si për punë, ashtu edhe për transport. Partia do të kujdeset gjithashtu që të shtohen shumë sipërfaqet e tokave të ujitshme, prandaj po punohet që në fund të pesëvjeçarit të tretë 42 për qind e tokave të futen nën ujë.

Por që të kryhen si duhet këto detyra dhe të jatin rezultatet e duhura, fshatarësia jonë kooperativiste duhet të bëjë përpjekje që të përvetësojë agroteknikën, si në përdorimin e plehrave kimike, në përdorimin e ujërave për ujitje, në prashitjet dhe në të gjitha punët e tjera bujqësore. Fshatari ynë të gjitha këto detyra po i vë në jetë. Është fakt se këta faktorë kanë bërë që të rriten rendimentet e kulturave bujqësore në vendin tonë. Për shembull në rrëthim e Peshkopisë merren rendimente të larta në misër, ka ekonomi që kanë arritur të marrin deri në 100 kv misër për ha. Ne nuk pretendojmë që një rendiment i tillë të realizohet në masë, por duhet të luftojmë dhe mund të marrim 30 dhe 40 kv misër për ha në shkallë rrëthi që kështu të stabilizojmë gjendjen e rendimenteve. Kooperativa bujqësore e Maminasit, në rrëthim e Durrësit, e ka stabilizuar rendimentin e pambukut dhe merr mesatarisht 15-18 kv pambuk për ha në toka pa ujë, në të njëjtën kohë kur, po në rrëthim e Durrësit, ka kooperativa që marrin 7-8 kv pambuk për ha në toka me ujë. Kjo tregon se kooperativistët e Maminasit i janë futur mirë kësaj pune.

Masat që po merren për t'i ardhur në ndihmë bujqësisë na bindin se prodhimet bujqësore do të rriten

dhe në këtë mënyrë do të ngrihet niveli i jetesës së popullit tonë. Këtë synon plani ynë i ardhshëm pesëvjeçar që do ta vendosë Kongresi IV i Partisë. Prandaj le të punojmë të gjithë që të shkojmë me duar plot në këtë Kongres, në radhë të parë klasa punëtore, e cila fjalën e Partisë nuk e bën kurrë dy dhe vendimet e saj jo vetöm i realizon, por i tejkalon. Kështu ne do t'i tregojmë Kongresit forcën e madhe të popullit dhe të Partisë sonë, pjekurinë e saj në fushën e realizimeve ekonomike, politike, në rritjen e vigjilencës revolucionare dhe në mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit.

Në të gjitha këto drejtime Partia jonë ka luftuar heroikisht dhe ka zënë vendin e merituar në radhët e partive marksiste-leniniste, të cilat flasin me admirim për qëndrimin e saj. Sigurisht, në punët e Partisë sonë ka edhe të meta, por gabime që të vënë në rrezik ndërtimin e socializmit në vendin tonë nuk ka. Në këtë çështje neve na ka ndihmuar fakti që Partia jonë është një populli revolucionar, e një klase punëtore të vogël, por të kalitur në luftë, e një klase punëtore me origjinë nga fshatarësia jonë shumë revolucionare dhe patriote. Prandaj ajo kurrë nuk e ka humbur busullën dhe nuk ka gabuar. Megjithëkëtë, Partisë sonë nuk i është rritur mendja, ajo ka qenë, është e do të jetë kurdoherë e thjeshtë dhe besnike e parimeve të pavdekshme të marksizëm-leninizmit. Këta kanë qenë faktorët që e kanë ndihmuar Partinë tonë të ecë drejt dhe të mos gabojë në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Me politikën e saj të drejtë, Partia jonë bëri që edhe elementët e borgjezisë, që nuk ia kanë dashur

kurrë të mirën Partisë, të thonë se ata vetëm për një gjë mund ta kritikonin klasën punëtore të Shqipërisë dhe Partinë e saj: vetëm se u morën atyre pasurinë, asgjë tjetër nuk mund të thonë kundër pushtetit popullor. Dhe nuk kanë ç'të thonë, se Shqipëria brenda 15 vjetëve u mbush me fabrika, u thanë moçale e këneta, u ndërtuan shkolla, spitale, shtëpi banimi etj., ndërsa, kur ata ishin në fuqi, nuk bënë gjë tjetër përvëçse vranë e ropën popullin dhe grabitën fshatarësinë.

Prandaj, situata e brendshme e vendit tonë është shumë e fortë, lidhjet e Partisë me popullin janë të çelikta saqë edhe miqtë habiten kur vizitojnë Shqipërinë. Kjo është kryesorja. Ka komunistë që bëjnë gabime në punën e tyre. Populli e kuption këtë dhe u heq veshin, se njerëz që të mos gabojnë nuk ka, por njerëzit përmirësohen. Derisa edhe guri kur lëmohet bëhet i bukur për ndërtim, aq më tepër njeriu duke u ndihmuar, do të ecë përpara. Populli sheh forcën e madhe transformuese të Partisë, sheh se Partia i dha lirinë dhe i siguroi pavarësinë prandaj ai e do atë me gjithë shpirt. Tani kufijtë e atdheut tonë janë të paprekshëm se populli është vigjilent, se ai ka luftuar e lufton për këtë liri. Ne luftojmë vazhdimisht për paqen, por në rast se imperialistët na prekin ne nuk i trembemi luftës. Populli ynë nuk e do luftën, po sa herë që armiqtë na kanë rënë në qafë, ne kemi luftuar dhe kemi dalë fitimtarë mbi ta.

Revizionistët jugosllavë janë si ujku që qimen e ndërron por jo zakonet. Kështu edhe ata vetëm taktikën ndërrojnë. Revizionistët jugosllavë janë agjenturë e imperializmit amerikan. Në portet jugosllave bën «vizitë miqüsore» flota amerikane. Populli thotë: «Fshati që

duket, s'do kallauz». Ata kanë qenë, janë dhe do të mbeten revizionistë. Megjithëse e heqin veten marksistë, në të vërtetë janë deri në fund tradhtarë të marksizëm-leninizmit, janë renegatë dhe shërbëtorë të imperialistëve amerikanë.

Prandaj kundër revizionistëve jugosllavë të mos ulet vigjilencia, sidomos në krahinën tuaj kufitare. Ata do të përpiken si kurdoherë të dërgojnë diversantë, se ndjekin po atë politikë si dhe padronët e tyre, veprojnë pikërisht sipas fjalës së popullit: «Si babai dhe i biri, kungull dhe bostan çairi».

Kur flasim për vigjilencë të mos e kuptojmë se kjo duhet të mbahet lart vetëm nga rojet heroike të kufirit, por edhe nga i gjithë populli. Prandaj të forcohen sa më shumë lidhjet e ngushta të kufitarëve me popullin. Por që populli të jetë vigjilent duhet edukuar, duhet të mbahet në korrent, të demaskohen para tij armiqtë dhe metodat e tij kundër nesh. Prandaj Partia të mobilizohet në këtë drejtim.

Revizionistët jugosllavë bëjnë mizori, veçanërisht, kundër minoritetit tonë në Jugosllavi dhe kur ne ngrëmë zérin për të mbrojtur vëllezërit tanë shqiptarë, ata na thonë: «përse përziheni në punët tona të brendshme». Por ne mbrojmë vëllezërit tanë të gjakut nga padrejtësitë që u bëhen se nuk janë pak po janë një milion shqiptarë që jetojnë atje. Le të përpiken të na akuzojnë si shovinistë revizionistët jugosllavë, ne luftojmë kundër padrejtësive që i bëhen popullit shqiptar të Kosovës, të Dibrës etj.

Kështu qëndrojnë çështjet në përgjithësi. Ne kemi përpara shumë detyra për të kryer dhe ato nuk janë

të lehta, por ne nuk u trembemi. Ato kërkojnë mobilizim të gjithanshëm nga i madh e i vogël. Prandaj të punojmë që t'i kapërcejmë vështirësitë dhe të realizojmë planet, sepse të gjitha detyrat që na ka caktuar Partia deri tanë dhe ato që do të na caktojë në të ardhshmen Kongresi IV i Partisë, me punën tonë të palodhur ne do t'i realizojmë. Partia dhe populli kanë besim në forcat e veta, uniteti i tyre është i çeliktë. Ne kemi një popull të mrekullueshëm, përparimtar dhe pa shumë pretendime, që e kuption fare mirë vijën e Partisë dhe perspektivën e së ardhshmes së shkëlqyer që e pret. Kjo ka shumë rëndësi. Të mbrojmë pastërtinë e radhiёve të Partisë sonë dhe të marksizëm-leninizmit, nga cilido që do të përpinqet ta shtrembërojë atë, jashtë ose brenda Partisë. Ruajtja e pastërtisë së marksizëm-leninizmit është sigurimi i së ardhshmes së popullit shqiptar. Me këtë çështje Partia jonë nuk lejon të luhet nga kushdo goftë.

Ju uroj nga zemra, të dashur shokë dhe shoqe, shëndet të mirë dhe suksese në punë! Kam bindjen se ju, si kurdoherë, jo vetëm do ta realizoni, po edhe do ta tejkaloni planin, dhe zotimin që morët kam besim të plotë se ju, kolektivi heroik i Bulqizës me komunistët në krye, do ta mbani dhe detyrat do t'i realizoni.

Rroftë Partia jonë e dashur e Punës!

Rroftë klasa jonë heroike punëtore!

Rrofshin punëtorët e Bulqizës!

*Botohet për herë të parë me  
disa shkurtimë sipas origjinalit  
që gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

# PUNA NË KOOPERATIVËN BUJQËSORE SIGURON TË ARDHISHMEN E LUMTUR TË FSHATARIT TONE

*Fjala në mitingun e organizuar në fushën  
e Valikardhës me fshatarët e lokalitetit  
të Zerqanit të rrëthit të Peshkopisë*

**2 qershor 1960**

Të dashur fshatarë të lokalitetit të Zerqanit,

Jam shumë i gjëzuar që ndodhem sot midis jush. Dëshira ime dhe juaja ishte që të kisha ardhur në Zerqan, por shokët më thanë se për shkak të urës nuk shkojmë dot. Sidoqoftë ne arritëm e u takuam së bashku këtu, në këtë vend historik.

Këtu në fushën e Valikardhës, 500 vjet më parë stërgjyshërit tanë, të udhëhequr nga heroi i lavdishëm i popullit tonë, që nuk do të harrohet në shekuj, Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, luftuan kundër hordhive të pasallarëve dhe të sultaneve turq. Asnjëherë nuk u mund Skënderbeu në luftërat kundër turqve, por i udhëhoqi me lavdi shqiptarët kundër ushtrive të panumërtë dhe shumë të forta turke. Populli ynë dhe ko-

mandanti i tij i lavdishëm, megjithëse të paktë në numër, ishin shumë më të fortë se ata.

Skënderbeu me popullin shqiptar në ata vjetë heroikë u bënë gardh dhe shpëtuan qytetërimin evropian nga sundimi i otomanëve. Prandaj për Skënderbeun nuk flet me krenari vetëm populli shqiptar, por të gjithë popujt e Evropës, për të kanë shkruar libra shumë njerëz të shquar evropianë të shekujve të kaluar, filozofë, historianë, shkrimitarë, ku tregohen trimëritë e popullit tonë dhe heroizmat e Skënderbeut. Po ku e gjeti forcën Skënderbeu? Përgjigjen e ka dhënë vetë ai kur thotë se këtë forcë unë e gjeta te populli. Dhe me të vërtetë forca kurdoherë qëndron te populli dhe jo te një ose disa njerëz.

Si i gjithë populli ynë, ashtu edhe populli i krahi-nës suaj, gjatë historisë së tij, kurrë nuk e ka hequr pushkën nga dora. Kurdoherë që rrezikohej fati i at-dheut, këto male, gërxhe e lugina kanë gjëmuar nga oshëtima e pushkëve të popullit tonë liridashës kundër sunduesve të huaj dhe armiqve të tij të brendshëm. Kështu gjatë Luftës Nacionallirimtare populli u ngrit në këmbë dhe i përlau një herë e përgjithmonë fashistët italianë e gjermanë dhe tradhtarët e vendit, bejlerët, agallarët, bajraktarët, të gjithë ata që ishin kundër tij.

Ai që është kundër popullit e ka jetën të shkurtër, sepse populli në mos sot, nesër, të ligut i tregon vendin. Populli është i pavdekshëm, ai përtërihet vazhdimesh dhe nuk shuhet kurrë. Këtë e ka vërtetuar historia. Populli ynë shumë ka vuajtur gjatë shkujve, por ai nuk u zhduk. Mbi vendin tonë kanë shkelur shumë pushtues të huaj, bile herën e fundit ushtri shumë të

forta e të pajisura me armët më moderne, por popullin tonë nuk e shtypën dot.

Ashtu si të gjitha krahinat e Shqipërisë edhe rrathi i Peshkopisë, e veçanërisht lokaliteti i Zerqanit ka qenë një qendër e lavdishme e Luftës Nacionalçirimitare përlirinë dhe lumturinë e popullit tonë. Këtë do ta shkruajë historia, se populli i lokalitetit tuaj, nën udhëheqjen e Partisë, u bë çerdhe e luftës partizane. Ju nuk u trembët edhe kur jeta juaj dhe e fëmijëve tuaj ishte në rrezik, nuk u trembët se do t'ju digjeshin shtëpitë, por u lidhët me Partinë dhe morët pjesë në luftë kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve gjakpirës përtë fituar lirinë e humbur dhe kështu ndodhi. Populli i udhëhequr nga Partia fitoi, përmbysi pushtetin e gjakpirësve, ngriti pushtetin e tij dhe tani po ndërton socializmin.

Tani në këtë vend ne nuk jemi mbledhur ashtu si gjatë Luftës Nacionalçirimitare. Tani në vendin tonë është një periudhë qetësie, paqeje; në saje të luftës që bëri populli nën udhëheqjen e Partisë po punohet përritjen e mirëqenies së popullit, përtu siguruar brezave të ardhshëm një jetë pa brenga e pa halle, një jetë të kulturoar dhe të begatshme. Pikërisht përkëtë qëllim të lartë punon Partia.

Sukseset e popullit shqiptar dhe të Partisë së tij, në këtë drejtim janë të dukshme dhe vetëm ata që nuk na e duan të mirën i mbyllin sytë përpëra këtyre sukseseve. Por këta janë të paktë. Sidoqoftë edhe njerëz të tillë, kur shikojnë gjithë këto ndryshime të mëdha që janë bërë gjatë këtyre 15 vjetëve, e kanë vështirë të flasin keq kundër pushtetit, se të gjithë e shohin dhe e ndiejnë se ky pushtet punon vetëm përtë mirën e

popullit, shohin se tani qđo gjë në vendin tonë po ndryshon; kështu kanë ndryshuar shumë Peshkopia, Bulqiza, Tirana etj. E kush i ka bërë të gjitha këto? Populli i udhëhequr nga Partia.

Ju e dini mirë se puna të nxjerr në dritë. Dembeli që rri nën fik dhe pret t'i bjerë kokrra në gojë, do të presë ditë e natë dhe do të vdesë urie, ndërsa ai që punon, që mbjell misër e pemë, që rrit bagëtitë, që ndërton kanale dhe plehëron tokat, ai do ta ketë kurdoherë hambarin plot dhe do të rrojë i lumtur e plot shëndet. Pra puna po e bën popullin shqiptar të korrë gjithë këto suksese të mëdha dhe puna është një nga virtytet e mëdha të popullit tonë. Populli ynë tërë jetën ka punuar, por e kanë pasë grabitur bejlerët, bajraktarët dhe Ahmet Zogu me hajdutët që kishte përreth. Por tani që Partia dhe pushteti janë të popullit dhe punojnë vetëm për të mirën e tij, besimi i fshatarësisë dhe i klasës punëtore te Partia dhe te pushteti i tyre është i plotë.

Partia na mëson se për të ndërtuar jetën e lumtur duhet të punojnë të gjithë, burra e gra. Ka pasur disa krahina të vendit tonë ku punonin vetëm burrat, por ka pasur edhe disa të tjera, ku gratë punonin më shumë se burrat. Në Jug të Shqipërisë, afër Gjirokastrës, kanë ekzistuar të dyja këto shfaqje. Brenda në qytet nuk punonin gratë, por vetëm burrat, kurse afër Gjirokastërës, në Lunxhëri e në Zagori, që kanë fare pak tokë, punonin gratë. Për këtë poeti ynë i madh A.Z. Çajupi ka kënduar këngën:

\* . . . . .

*Burrat nënë hie  
Lozin, ku vendojnë;  
pika që s'u bie  
se nga gratë rrojnë!*

\* . . . . . "

Por tani burrat e Zagorisë dhe të Lunxhërisë i janë futur punës njëlloj si gratë, kurse në qytetin e Gjirokastrës gratë i janë përveshur punës ndërtimitare. Tani në këtë qytet ndërmarrjet ekonomike, si fabrika e cigareve, e lëkurëve etj., janë mbushur plot me gra, gjë që tregon se tani të gjithë e kanë kuptuar se, që të rrojmë mirë, duhet të punojmë.

Ju fshatarët e lokalitetit të Zerqanit jeni punëtorë të mirë, njerëz përparimtarë. Djemtë dhe vajzat tuaja ndjekin shkollat fillore e 7-vjeçare dhe shumë prej tyre edhe të mesmet e të lartat. Disa nga lokaliteti juaj kanë mbaruar shkollën dhe janë bërë mjekë, inxhinierë, mësues. Kjo ka një rëndësi shumë të madhe. Të respektoni punën e mësuesit se është e nderuar. Kur ishte kryeministër, Dimitrovin e pyetën se ç'punë preferonte më shumë, ai ishte përgjigjur se, po ta lejonte Partia, dëshira e tij ishte të bëhej mësues në fshat. Këtë ai e thoshte se ishte bir i popullit dhe donte me gjithë zemër që populli të zhvillohej, të arsimohej dhe të kulturohej, të merrte dituri, sepse me dituri bëhet çdo gjë, kapërcëhet çdo vështirësi, krijojen pasuritë për popullin, për mirëqenien e tij.

Partia jonë ka hapur nga të katër anët shkolla

fillore e 7-vjeçare, me dhjetëra shkolla të mesme, universitetin dhe institute të larta, me qëllim që të mësojnë djemtë e popullit dhe, kur të mbarojnë, të shkojnë përsëri t'i shërbejnë popullit në fabrika, në miniera, në fshat, në shkolla etj., me qëllim që çdo rreth të ketë sa më shumë specialistë të lartë. Dhe kjo kohë do të vijë. Në fund të pesëvjeçarit të ardhshëm do të kemi shumë kuadro për bujqësinë, të dalë nga shkollat tona. Atëherë vendi ynë do të ecë përpara në çdo sektor, ashtu edhe në bujqësi, ku ju keni eksperiencë të madhe, sidomos në kulturën e misrit, që është një kulturë e rëndësishme.

Prandaj duhet të mobilizoheni që të punoni sa më shumë dhe tokës të mos i merrni 20-25 kv për ha misër, sepse ju keni mundësi të merrni edhe mbi 30 kv për ha. Toka duhet të punohet shumë mirë dhe në kohë, të ujitet në kohë, t'i bëni jo një prashitje po disa, ujita të bëhet me brazda dhe misrit t'i hidhet aq ujë sa i duhet; në këtë mënyrë do të shihni, se do të keni misër me bollëk. Të merrni masa për shtimin e sasisë së plehut dhe atë ta përdorni sa më shumë në tokat e kooperativës.

Kini kurdoherë parasysh se pasuria juaj kryesore, shpëtimi juaj janë tokat e kooperativës. Kooperativa do të sjellë lumturinë në familjet tuaja dhe jo oborri kooperativist. Prandaj, në radhë të parë, të vini të gjitha forcat në fushat e kooperativës dhe kur të gjeni kohë shfrytëzoni edhe oborrin kooperativist, se edhe ky, krahas të ardhurave të kooperativës, do t'ju japë një farë ndihme.

Por ka njerëz që nuk e kanë kuptuar akoma këtë çështje dhe humbasin kohën që është e shtrenjtë si

flori, duke u marrë më shumë me oborrin e tyre dhe në ekonominë e kooperativës bëjnë vetëm nga 80-90 ditë-punë në vit. Kjo është fare pak. Çdo kooperativist duhet të bëjë mesatarisht 300 ditë-punë në vit. Edhe një herë e theksoj se, po t'i vini më tepër rëndësi punimit të tokave të kooperativës, me siguri do të merrni rendimente të larta.

Ju duhet të jeni të bindur se rruga ku na udhëheq Partia është e drejtë, është për të mirën e popullit tonë punëtor dhe paqedashës. Po duhet të mbajmë parasysh se kemi edhe armiq që nuk flenë dhe, po të na gjejnë të dobët, na godasin. Por Partia, Qeveria e populli ynë nuk flenë dhe armiqtë e brendshëm e të jashtëm kurrë nuk do të na gjejnë në gjumë. Vuajtjet që ka pësuar populli ynë dhe gjaku që ka derdhur gjatë shekujve e kanë bërë atë që në një dorë të mbajë kazmën dhe në tjetrën pushkën. Të jemi plotësisht të sigurtë se armikut i japim goditje të fuqishme kur ne ecim përpara, kur ngremë vazhdimisht ekonominë, kur jemi sa më të fortë politikisht, kur shtërngojmë gjithnjë e më shumë radhët tona rreth Partisë. Dhe ju e shikoni vetë si janë katandisur armiqtë e brendshëm, ata janë leqendisur për vdekje. Megjithatë gjuhën e kanë, akoma pëshpëritin kur gjejnë ndonjë budalla që u beson lehtë.

Por ne kemi edhe armiq të jashtëm, ndaj të cilëve duhet të jemi vigjilentë, e në radhë të parë ndaj imperialistëve amerikanë dhe revisionistëve jugosllavë, të cilët të lidhur kokë e këmbë me imperialistët, përpiken të pengojnë popullin tonë e të dëmtojnë Republikën tonë Popullore.

Së shpejti do të aprovojmë planin e tretë pesëvje-

çar. Plani i tretë pesëvjeçar do të jetë i tillë që do të ndihmojë për ngritjen e mirëqenies së popullit tonë.

Të gjitha këto fitore të popullit tonë u siguruan në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë, që e mbësh-  
tet gjithë punën e saj në mësimet e marksizëm-leni-  
nizmit.

Shqipëria tani është shumë e fortë dhe zë vendin e merituar në arenën ndërkombëtare, thotë fjalën e vet dhe jep kontributin e saj në politikën e jashtme pavarësisht se është e vogël. Këtë vend Shqipëria e fitoi në saje të vijës së drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Prandaj, të dashur shokë, t'i përvishemi punës me të gjitha forcat, të përdorim si duhet dhe në mënyrë të organizuar të gjitha mjetet që kemi në duar, si traktorë, makina, fabrika, uzina etj., që të marrim sa më shumë prej tyre. Edhe në kooperativë kështu të vepron, mos lejoni që njerëzit të dalin në punë kur e sa të duan. Tani ne kemi ngritur kudo kooperativa, që është forma më e mirë e organizimit të punës në fshat, për lumturinë e popullit. Atje ne kemi kryesi, organizatë-bazë, brigada dhe skuadra. Komiteti ekzekutiv i lokalitetit dhe i rrethit tani janë në gjendje që, së bashku me asamblenë, të organizojnë punën si duhet në skuadra dhe brigada dhe të shkohet në punë si një ushtri e disiplinuar. Prandaj në kooperativë të luftohet për zbatimin e rregullave dhe të normave të caktuara nga Partia për të mirën e kooperativistëve dhe të të gjithë popullit tonë.

Kush bën një ditë-punë të plotë dhe të mirë ai i siguron jo vetëm vetes dhe familjes së tij të ardhura,

po gjithë familjes së madhe, kooperativës. Skuadërkomandanti, brigadieri, llogaritari e deri te kryetari, duhet të luftojnë për drejtësinë më të madhe në punë, interes personal të lidhet me atë të kooperativës, të zhduken hatëret dhe mëritë, që në kolektiv të ekzistojë dashuria dhe drejtësia.

Ka raste kur një kooperativisti të ndërgjegjshëm i shkruhet më pak punë nga sa ka bërë, ndërsa një tjetri që s'e meriton i shkruhet më shumë. Këto padrejtësi populli i shikon. Prandaj udhëheqja e kooperativës duhet të jetë e shëndoshë dhe e drejtë, ajo të zbatojë vendimet e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë, vendimet që merr asambleja e kooperativës. Përderisa për një çështje vendoset në asamble, kryesia atë duhet ta aprovojë dhe ta zbatojë me një disiplinë të hekurt. Kryesia duhet t'i caktojë punë secilit dhe cilido të kryejë mirë detyrën që i ngarkohet.

Pra, të punojmë pa u lodhur se vetëm me punë krijohetjeta e lumtur, të forcojmë kooperativën, se ajo do të sigurojë të ardhshmen e lumtur të fshatarit tonë.

Të rrojë Partia jonë e lavdishme e Punës!

Rroftë fshatarësia kooperativiste e rrëthit të Peshkopisë!

Edhe një herë ju uroj nga zemra jetë të lumtur e të gëzuar në familje dhe suksese akoma më të mëdha në ekonominë tuaj kooperativiste!

*Botohet për herë të parë me  
ndonjë shkurtim sipas origji-  
nalit që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*

## **PARTIA ËSHTË E BINDUR SE RRETHI I MATIT DO TË ECË KURDOHERË PËRPARA**

*Fjala me kuadrot e Partisë dhe të pushtetit  
të rrithit të Burrelit*

**2 qershor 1960**

Organizata e Partisë e rrithit të Burrelit ka arritur suksese në punën e saj, në radhë të parë ajo është zgjeruar e forcuar. Këtu, në Burrel, Partia ka kuadro besnikë e të devotshëm për çështjen e socializmit, që kanë një eksperiencë të mirë si në punën politike dhe organizative të Partisë, ashtu edhe në drejtim të pushtetit dhe të ekonomisë.

Por duhet të pranojmë se shokët e Partisë dhe të pushtetit në rrithin e Burrelit kanë nevojë për një ndihmë akoma më të madhe nga ana e qendrës. Ndihmë ju është dhënë nga qendra, por mendoj se Komiteti Qendror dhe Qeveria duhet të tregojnë akoma më shumë kujdes në drejtim të ndihmës që duhet t'u jepet Partisë, pushtetit dhe popullit të krahinës suaj.

Populli i Burrelit, si i gjithë populli shqiptar është trim dhe besnik i Partisë. Armiqtë janë përpjekur që

banorët e kësaj krahine të ishin nën influencën e satrapit Zog. Po si mund t'i arrihej këtij qëllimi, kur Zogu i kishte marrë shpirtin edhe popullit të Matit? Ky gjakpirës nuk vuri asnë gur për të mirën e kësaj krahine. Vetëm një burg po, atë e ndërtoi dhe, një farë princi Xhelal Zogu, bëri një fole për vete, ndërsa populli vuante të zezat e ullirit. Ja sepse populli i Matit, ashtu si i gjithë populli ynë, nuk ishte as me feudalët as me Zogun. Reaksionarë e bajraktarë u orvatën që matjanët të mos ishin me Partinë, të mos luftonin për çlirimin e vendit, por ata, përvèç disa pengesave që sollën, nuk mundën ta bënin me vete, popullin e kësaj krahine, i cili përkrahu dhe mori pjesë në Luftën Nacionallirimtare.

Edhe pas Çlirimit qëndrimi politik i popullit të Burrelit mund të themi se ka qenë shembullor. Gjatë kësaj kohe asnë problem të rëndësishëm politik nuk ka pasur Partia dhe pushteti popullor në këtë krahinë. Kjo tregon se populli i Matit, si i gjithë populli ynë dhe si pjesë përbërëse e tij, ka qenë dhe është i lidhur si mishi me thoin me Partinë. Dhe kjo është e shpje-gueshme se populli i këtij rrëthi ka qenë i shtypur, i mbajtur në injorancë e nën kërcënimin e bajraktarëve. I udhëhequr nga Partia ai shpëtoi nga mjerimi dhe sot ndërton një jetë të re, të lumtur e të begaishme.

Në të gjithë vendin tonë, kushtet ekonomike kanë qenë të vështira, por duke marrë parasysh edhe konfiguracionin e rrëthit tuaj, këtu ka akoma më shumë vështirësi ekonomike. Prandaj, edhe në këtë drejtim duhet ta shohim çështjen dhe të marrim masa që populli i Matit të bëjë një hap të madh përpara në përmirësi-

min e jetës së tij, pse ka mundësi të mëdha, që organizata e Partisë duhet t'i shfrytëzojë më mirë se deri tani.

Në këtë drejtim duhet bërë një punë më e gjerë politike kundër mentalitetit të vjetër lidhur me prodhimet bujqësore, për rregulla e për organizim më të mirë të punës, për likuidimin e paragjykimeve fetare, të cilat këtu në rrëthim tuaj janë të përhapura. Në këtë drejtim një rol të madh duhet të luajë puna politike e Partisë.

Një punë të tillë duhet ta bëjë edhe shkolla. Ne mund të themi se në këtë drejtim në Mat kemi po aq përparime sa edhe në shumë krahina të tjera të vendit tonë. Si kudo, edhe këtu janë hapur shkolla fillore dhe shumë 7-vjeçare. Tani këto shkolla duhet të bëhen me të vërtetë çerdhe të kulturës e të luftës kundër paragjykimeve fetare. Nëpërmjet djemve dhe vajzave që ndjekin shkollat, do të futet e reja edhe në shtëpitë e fshatarëve të Matit.

Në këtë çështje rol të madh do të luajnë mësuesit, që janë edukatorët e brezit të ri. Ata asnjëherë të mos harrojnë detyrat që kanë ndaj familjeve të nxënësve për likuidimin e mbeturinave të huaja, që janë të papajtueshme me ideologjinë dhe me shoqërinë tonë.

Partia është e bindur se në këtë drejtim nuk do të hasen pengesa të pakapörcyeshme. Rezistencë ka, por kjo vjen sidomos nga rutina e vjetër në kuptimin e shpejtë të së resë. Byroja Politike është e bindur se me një punë kömbëngulëse nga ana e Partisë dhe e levave të saj, e reja revolucionare do të fitojë. Por e vjetra nuk shkulet lehtë. Prandaj Partia ta marrë mirë në dorë këtë çështje, se kjo në këtë rrëth do të jetë një ndihmë

e madhe për zhvillimin e ekonomisë, veçanërisht të bujqësisë.

Rrethi juaj është bujqësor dhe blegtoral. Prandaj i vini rëndësi të madhe kësaj çështjeje. Komunistët dhe punonjësit e organeve të pushtetit t'i vënë detyrë vetes të mësojnë mjeshterinë e bujqësisë, që Burreli të ecë përpara. Për këtë qëllim Partia dhe pushteti duhet të bëjnë një punë të organizuar dhe frontale.

Kini parasysh se kurdoherë metoda kryesore e Partisë është bindja. Nuk është mirë që të na drejtohen për shembull 20 gra të Planit të Bardhë dhe të na parashtronjë gjithë ato gjëra, që ju duhet t'i kishit zgjidhur drejt. Një masë që merr Partia duhet ta mendojë mirë, pastaj të bindë popullin për zbatimin e saj. Bindja në këto çështje luan kurdoherë rolin vendimtar.

Për çdo masë që merret duhet ecur me kujdes se edhe në rrethin e Korçës, ku ka kooperativa bujqësore të vjetra e njerëzit ia kanë ndierë lezeten pronës kooperativiste, edhe atje oborrin kooperativist nuk e lëshojnë, e aq më tepër këtu në Burrel. Prandaj byroja e komitetit të Partisë të mos marrë vendime të papjekura. Kur Partia dhe Qeveria e kanë caktuar këtë oborr, do të thotë se ai është i nevojshëm të mbahet. Prandaj i kemi kritikuar ata që veprojnë ndryshe, duke u orvatur ta zvogëlojnë ose ta heqin oborrin kooperativist.

Dihet se anëtari i kooperativës është fshatar dhe, megjithëse është futur në kooperativë, nuk është zhdukur akoma nga ndërgjegjja e tij ndjenja e pronës private. Fshatari ka psikologji mikroborgjeze. Këtë psikologji, megjithëse më pak, e gjen edhe te punëtorët. Përveç kësaj, në këtë fazë oborri kooperativist është i nevoj-

shëm edhe nga pikëpamja ekonomike. Në rast se arrijmë të krijojmë bollëkun në kooperativë, domethënë që fshatari të shohë se të ardhurat e mëdha i vijnë nga kooperativa dhe jo nga oborri kooperativist, dhe, kur ai jo me fjalë, të ketë mundësi të blejë në kooperativë edhe qumshtin, mishin, zarzavatet, frutat etj., atëherë ai vetë do ta shohë si pengesë oborrin e tij kooperativist.

Dhe kjo ditë do të vijë në vendin tonë. Por tani të luftohet që të zbatohet statuti i kooperativës dhe kufizimi i oborrit kooperativist të zbatohet vetëm me dëshirën e vetë kooperativistëve ose të asamblesë. Kjo do të ishte një punë shumë e mirë.

E kam fjalën se si duhet të kuptohet nga ju kuadrot lufta për zhvillimin e ekonomisë në rrithin tuaj. Duhet të bëhet një punë e madhe për forcimin ekonomik dhe organizativ të kooperativave bujqësore. Të mos kënaqemi vetëm me faktin se tani i ngritëm kooperativat dhe me kaq mbaroi çdo gjë. Në këtë drejtim ju keni shumë për të bërë. Tani duhet të luftoni që atje ku ka kushte të krijojen kooperativa të reja mbi bazën e bindjes dhe të vullnetit, por në mal, ku akoma nuk ekzistojnë kushtet e duhura për kolektivizimin e bujqësisë, mos u nxitoni, se në vend që të bëni mirë, do të bëni keq.

Pra, forconi organizativisht kooperativat ekzistuese. Për t'ia arritur këtij qëllimi në radhë të parë duhet që Partia të jetë e fortë, sidomos përsa u përket unititetit në gjykimin e vendimeve dhe ndihmës që duhet t'u jepet kryesisë dhe gjithë punonjësve në kooperativë. Komunistët në fshat mund të mos jenë të ditur, por ata duhet

të pajisen me dituri, që, kur të marrin vendime, të jenë të matur dhe të pjekur, sepse kështu do të kenë mundësi të marrin vendime të drejta. Duhet të vëmë në lëvizje gjithë aftësinë dhe propagandën e Partisë për t'i bërë kooperativistët që të shkojnë frontalisht në punë. Një gjë e tillë ka rëndësi të madhe.

Për t'ia arritur këtij qëllimi komunistët duhet të jenë vetë të pastër. Para se të luftojnë mbeturinat në ndërgjegjen e fshatarëve, duhet të luftojnë mbeturinat në ndërgjegjen e tyre, ndryshe puna nuk ecën. Lufta kundër mbeturinave që ekzistojnë te njerëzit tanë, të mos ndërpritet. Për t'ia arritur këtij qëllimi, ju, shokët e Burrelit, duhet të studjoni vazhdimesht marksizëm-leninizmin, teorinë tonë të lavdishme. Kjo do të na bëjë ne që të mos gabohemi dhe të spastrohemi. Mundësitë janë, me gjithë vështirësitë që kanë disa shokë, të cilëve u mungon kultura e nevojshme. Por Komiteti Qendror me leksione dhe me forma të ndryshme përpinqet që ta bëjë më të lehtë punën për t'u përvetësuar idetë e marksizëm-leninizmit dhe për t'i zbatuar ato në praktikë. Kështu lufta kundër mbeturinave e bën më të lehtë kuptimin e marksizëm-leninizmit. Pra, me këtë teori është e nevojshme të armatosen mirë jo vetëm komunistët, por me forma e me rrugë të ndryshme e të kuptueshme, të armatosen edhe masat punonjëse, sepse kështu do të arrijmë suksese në rrugën që na ka caktuar Partia.

Për përvetësimin e marksizëm-leninizmit duhet më shumë vullnet. Në rrethin tuaj të shtroni detyrën që organizata e Partisë të jetë më e fortë, më dinamike e më energjike. Jo vetëm në rrethin tuaj, por edhe

në shumë rrethe kërkohet kurajë, dinamizëm, energji, guxim, iniciativë, karakteristika këto të një partie marksiste-leniniste dhe që i ka Partia jonë. Kështu ne mund ta vëmë sa më shpejt në lëvizje popullin.

Si kudo, dhe te ju njerëzit janë punëtorë, por ka edhe disa dembelë, ka kooperativa bujqësore të mira, por ka edhe kooperativa bujqësore me dobësi. Edhe këto të fundit duan të krijojnë bollëk, por, për t'i arritur kësaj, duhet të shkunden nga dobësitë që kanë. Dhe kjo është e mundur se edhe këtu ka njerëz punëtorë. Me këtë frymë të edukojë organizata e Partisë komunistët dhe punonjësit, kjo ka rëndësi të madhe. Përsa i përket disiplinës në punë, bashkatdhetarët tanë të Veriut kanë shumë cilësi të mira, të cilat Partia duhet t'i zhvillojë më tej.

I forconi, pra, kooperativat bujqësore nga ana organizativo-ekonomike. Partia në radhë të parë t'i edukojë kuadrot me disiplinë të çeliktë e me ndershëmëri. Brigadieri mund të mos jetë shumë i zoti, por kur ne ta kemi edukuar, t'i kemi treguar sa rëndësi ka të jetë i ndershëm, se nga mosmbajtja mirë e llogarive mund të krijohen shumë gjëra të padëshirueshme, si hatëret, mëritë etj., që mund të marrin pastaj edhe karakter politik, atëherë do ta kemi bërë atë të vëmendshëm që të drejtojë si duhet brigadën. Nga një pakujdesi e brigadierit ndonjë kooperativist mund të thotë: «e mo, po s'qenka gjë edhe kooperativa». Këtu faji është i brigadierit, por faj ka edhe sekretari i organizatës-bazë të Partisë edhe kryetari i kooperativës që nuk e kanë mësuar e nuk e kanë ndihmuar brigadierin se si të punojë. Prandaj t'i ndihmojmë njerëzit që të punojnë

mirë dhe ndershmërisht. Edhe skuadërkomandantët e llogaritarët luajnë një rol të madh në mbarëvajtjen e kooperativës. Po të mos jetë në rregull llogaritari, koooperativa nuk mund të ecë mirë.

Mos harroni se Partia është vërtet kundër vënies së interesit personal mbi interesin e përgjithshëm, por ajo nuk e hedh poshtë interesin personal të kooperativistëve. Përkundrazi, e kombinon atë me interesin e kolektivit dhe me interesin e përgjithshëm, duke ia nënshtruar këtij të fundit. Prandaj të evidentohen mirë ditët e punës, të krijuhen kushte që kooperativat të mos ndajnë lekë një herë në 7-8 muaj, por, sot për sot, ka mundësi që kooperativistët të marrin paradhënie të paktën një herë në 3 muaj. Ditët e punës të paguhen me drejtësi. Këto detyra të mos neglizhohen kurrë, se ato përbëjnë kyçin e forcimit të punës në kooperativën bujqësore.

Ekonomia, që të shkojë mbarë, kërkon llogari dhe kontroll. Pa llogari asgjë nuk mund të bëhet. Edhe një familje e mirë pa llogari nuk shkon përpara. Po ç'ndodh? Ka familje si në fshat, ashtu edhe në qytet që nuk veprojnë mirë, ecin sipas disa zakoneve, që duhen zhdukur, sepse démtojnë si ekonominë ashtu edhe ata vetë. Te ne fshatari aktualisht konsumon pak mish. Por, kur bën dasmë, ther tri qé, duke shkatërruar kështu ekonominë. Prandaj duhet bërë ekonomi. E përsë të therësh 5 dele? Jepu miqve një karamele, llokume ose pastë apo ndonjë gotë raki sa të të urojnë, të këndojnë, të hedhin valle dhe të gëzojnë të gjithë së bashku. Edhe darkë do të bëjë ai që martohet, se kjo është një ngjarje me rëndësi në jetën e njeriut, por të ftojë

vetëm njerëzit më të afërt. Zakone të tilla të dëmshme për ekonominë duhen luftuar. Kjo lyp që Partia t'i mësojë njerëzit të bëjnë ekonomi, të ecin me llogari, të hartojnë planc dhe t'i realizojnë ato.

Planet ju nuk i keni realizuar as në misër e grurë as në mish, në qumësht e në blektori dhe as në duhan, në pyllëzime etj. Ju ishit zotuar të merrnit 800 litra qumësht nga çdo lopë, kurse keni marrë vetëm 180 litra. Edhe me mbjelljet nuk e keni realizuar planin, gjë që ju ul prodhimin. Për këto duhet të mendoni mirë si ju edhe ne, sepse mbjelljet nuk po bëhen në kohë. Sigurisht faktori kryesor është mungesa e qeve. Në gjithë rrethin ju keni vetëm 20 traktorë fizikë, prandaj ne do të marrim masa që t'ju dërgojmë traktorë të përshtatshëm në një sasi më të madhe, në mënyrë që t'u vijmë në ndihmë kooperativave bujqësore. Organet e Partisë dhe ato të pushtetit nuk kanë treguar kujdesin e duhur në këtë drejtim kur u krijuan kooperativat, kështu që tanjore keni 1 000 që mangut në kooperativat bujqësore, një pjesë e të cilave nga disa fshatarë janë therur oscjanë shitur. Si pasojë, në rrethin tuaj punohet me forcë tërheqëse mangut. Prandaj duhen marrë masa që të zhduken këto dobësi, se, që të punohet toka, duhen medoemos kafshët e punës bashkë me mobilizimin e organizatës së Partisë dhc me edukimin e punonjësve.

Një burim i madh për forcimin e ekonomisë suaj janë frutat. Ato nuk mbijnë vetvetiu, por duhen mbjellë dhe duhet interesuar shumë për to. Mirëpo ju s'keni fidanishte. Në rrethin e Korçës, të Fierit, të Lushnjës, të Tiranës etj., jo vetëm shteti, por edhe kooperativat

bujqësore kanë krijuar fidanishtet e tyre. Mendoni, pra, për të ardhshmen e rrethit, për atë se çfarë pemësh do të mbillni. Krijoni si në çdo rreth mundësinë që 10-12 kooperativa të kenë fidanishte për të plotësuar nevojat e veta me fidane dhe për t'u shitur kooperativave fqinje. Deri tani për një punë të tillë te ju as që është vënë ujët në zjarr.

Organizata e Partisë këtu nuk duhet të luftojë që fshatari të sigurojë vetëm bukën. Partia duhet t'i mësojë njerëzit të rrojnë më mirë, të kenë të hanë edhe mish, zarzavatë, qumësht, fruta, të kenë edhe lckë në xhep. Por kur kooperativa ndan nga 2 kg drithë dhe nga 10-12 lekë për ditë-punë kjo tregon se puna atje nuk shkon mirë. Prandaj duhen marrë masa në këtë drejtim.

Ne, kur të kthehem i në Tiranë, do ta shohim më mirë e në mënyrë të veçantë këtë çështje. Po është e domosdoshme, që në radhë të parë organizata e Partisë këtu të punojë më me gjallëri për forcimin e kooperativave bujqësore, për t'i bërë ato të afta që të kryejnë sa më shpejt dhe më mirë punimet bujqësore.

Unë mendoj, ashtu siç mendoni edhe ju, se në rrethin tuaj ka shumë rezerva, se me një mobilizim më të mirë të masave fshatare shumë punime mund të bëhen edhe pa mekanizim. Ka rrethe ku kodrat janë hapur me bel. Shteti është gati t'ju japë edhe ndihmë, por jo të kërkoni të bëni kanale, që kushtojnë me dhjetëra milion vetëm për të ujitur 50 hektarë tokë. Në Kinë vetë fshatarët grumbullojnë gurë e argjil dhe krijojnë prita e pellgje ku grumbullojnë sasi të mëdha uji. Edhe në Peshkopi janë duke vepruar kështu. Po

të punoni edhe ju në këtë mënyrë mund të ujitni qindra hektarë tokë. Po edhe për këtë çështje nuk e keni vënë ujet në zjarr. Prandaj nuk duhet kërkuar çdo gjë nga shteti.

Për t'u plotësuar qejfin fshatarëve ne kemi bërë disa lëshime. Unë isha në Tropojë në vitin 1952, shumë fshatarë më kërkuan ndihmë për të ndërtuar kanale. Këtë problem e shtrova në Byronë Politike. Për njërin prej këtyre kanaleve na thanë se nuk kushton më shumë se 10 milion lekë, kurse ai kushtoi mbi 35 milion dhe për të ujitur vetëm 100 hektarë tokë. Një punë e tillë nuk është aspak me leverdi. Në këtë mënyrë nuk mund të ecet. Për kanale shteti mund të investojë vetëm atëherë kur mund të vihen nën ujë sipërsaqe të konsiderueshme tokash, pra kur ka interes të madh, por jo për interesat e ngushta të një fshati të jepen pa kursim çimento, hekur e miliona lekë.

Pra, ju shokë të Partisë e të pushtetit nuk e keni nxitur inisiativën e masave në lidhje me detyrat e vëna nga Komiteti Qendror për pyllëzimet dhe për ujitjen. E theksoj, pra, edhe një herë se ju nuk jeni preokupuar sa duhet për këto probleme. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe në rrethe të tjera. Në dhjetor të vitit të kaluar isha në Elbasan. Shokët atje morën një vendim shumë të mirë për çështjen e pyllëzimeve, por kur pas disa muajsh e verifikova zbatimin e tij doli se nuk kishin bërë asgjë. Kështu nuk duhet të ecet. Vendimet duhen zbatuar, ndryshe nuk ka si të ngrihet ekonomia, dhe të gjitha mundësitë ju i keni.

Përsa u përket çështjeve me karakter të përgjithshëm, mund të themi se punët na shkojnë mirë, me

gjithë vështirësitë dhe të metat që kemi. Industria dhe bujqësia janë përparojnë vazhdimisht. Në industri në përgjithësi planet realizohen dhe tejkalojen, megjithëse brendapërbrenda ndonjë sektori të veçantë ka edhe deficite. Ka ndërmarrje që nuk realizojnë planet, por këto kompensohen nga ndërmarrjet e tjera që i realizojnë dhe i tejkalojnë. Sigurisht nuk shkon çdo gjë në mënyrë të përsosur, edhe aty ka plot gjëra që nuk ecin si duhet, por në përgjithësi punët shkojnë mirë.

Vitin e kaluar kemi pasur dëme në bujqësi dhe janë vërtetuar të meta për arsyet subjektive dhe objektive. Për shkak të kushteve jo të mira atmosferike nuk realizuam planin e drithërave të bukës dhe na janë krijuar deficite edhe në planin e prodhimeve blegtorale etj. Sivjet ra shumë shi dhe kjo shkaktoi që mbjelljet të bëhen me vonesë. Megjithatë deri tani bujqësia nuk paraqitet keq. Për shembull, grurin nuk është kemi keq dhe, po të mos prishet në kohën e pjekjes, do të dalim mirë. Përsa i përket misrit, kushtet i kemi shumë të favorshme. Prandaj të vëmë të gjitha forcat për të përfunduar mbjelljet e misrit dhe për t'i bërë shërbimet e duhura dhe, atje ku ka ujë, ky të përdoret mirë.

Partia duhet të luftojë këtu që ujët të shfrytëzohet me ekonomi me metodën e ujitjes me brazda. Për këtë qëllim janë hapur edhe kurse e janë marrë edhe masa të tjera mbi mënyrën e ujitjes. Kjo t'u mësohet fshatarëve dhe të kontrollohen se si e bëjnë. Ka njerëz që përtojnë të shkojnë natën për ujitje, mirëpo ujët është fiori, prandaj në kohën e ujitjeve ai duhet shfrytëzuar ditën dhe natën. Pra, t'i bëhen shërbimet misrit, në

mënyrë që të arrijmë të plotësojmë edhe deficitet e vjetëve të kaluar.

Rol të madh për zhvillimin e kulturës së pambukut tani do të luajnë shërbimet që do t'i bëhen, sepse u mboll me vonesë. Po të mos mbajë koha do të jemi keq me pambuk, si vitin e kaluar. Me duhanin vjet dolëm mirë, por jo si cilësi. Sivjet të luftohet si për sasinë, ashtu edhe për cilësinë dhe shpresojmë se ky vit do të jetë i mbarë për duhanin.

Të kemi të gjithë parasysh se jemi në prag të Kongresit të Partisë, ku do të japim llogari për realizimin e planeve, prandaj të punojmë që të shkojmë ballëhapur e faqebardhë para popullit. Pra të vemi në Kongresin e Partisë me plan të realizuar dhe të mobilizojmë Partinë, kuadrot e të gjithë punonjësit që të punojnë për tejkalimin e detyrave që na janë caktuar.

Plani i ardhshëm do të jetë akoma më i ngarkuar. Realizimi i tij do ta përmirësojë shumë jetën e popullit. Do të zhvillohet më tej industria, do të ndërtohen fabrika e kombinate të mëdha, uzina mekanike, fabrika të cimentos, të plehrave kimike, të ferro-kromit, një kombinat i ri tekstili etj. Do të ngrihen edhe shumë fabrika të vogla për prodhime ushqimore dhe mallra të tjera të konsumit të gjerë. Do të rritet mekanizimi i bujqësisë.

Ndërtimet do të janë kolosale. Për këtë qëllim do të investohen afér 40 miliard lekë. Kjo do të thotë se detyra të vështira dhe përgjegjësi të mëdha rëndojnë mbi supet tona. Këto detyra patjetër duhet t'i realizojmë. Kjo kërkon punë të organizuar, disiplinë dhe përpjekje për prebatitjen dhe për edukimin e kuadrove.

Për realizimin e këtyre detyrave të mëdha na duhen shumë kuadro, të cilët çdo rreth duhet t'i sigurojë në radhë të parë vetë, ndërsa fuqia punëtore për gjithë këto vepra do të sigurohet kryesisht nga fshati, natyrisht sipas një plani, sepse nuk duhet të na mbeten prapa punët e bujqësisë. Për këtë qëllim do të mëkanizojmë deri në një farë shkalle punimet bujqësore. Fshati ka shumë fuqi punëtore të pazënë me punë, që do të na nevojitet për veprat e shumta që do të ndërtojmë. Të nxirren krahët e punës që janë të tepërt e të krijojen kështu mundësi që t'i ngremë më shpejt fabrikat e reja. Të luftojmë me këmbëngulje të madhe për të bërë realitet direktivën e Komitetit Qendror që çao kooperativist të bëjë 300 ditë-punë në vit. Është e habitshme se si edhe në Peshkopi ku fshatarët janë punëtorë kanë bërë mesatarisht nga 100-120 ditë-punë në vit. Mirëpo kështu nuk mund të ecet. Prandaj duhet luftuar shumë për shtimin e ditëve të punës nga kooperativistët.

Edhe në rrethin tuaj ka mjaft fuqi punëtore rezervë, prandaj luftoni shumë që ajo të përdoret racionalisht. Bëni mirë llogaritë se udhëzimet e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë janë të bazuara dhe lidhen me nevojat e ekonomisë sonë populllore. Pa realizimin e tyre nuk mund të ecet. Për shembull, që të arrijmë rendimente të larta në bujqësi nevojiten më shumë plehra kimike. Për këtë qëllim do të ndërtohen dy uzina të mëdha. Do të ngremë hidrocentralin e madh, bazën e metalurgjisë së zezë dhe shumë e shumë vepra të tjera. Por, derisa t'i ngremë ato, do të na dhëmbë shumë koka, por ne jemi komunistë dhe nuk duhet të

na zërë gjumi derisa kemi përpara detyra të pambaruara. Kështu ta kuptojmë çështjen. Tesera e Partisë është ajo që e dallon nga të tjerët anëtarin e Partisë dhe pikërisht për këtë ai ka më shumë përgjegjësi mbi kokë, për këtë duhet të përpiqet më shumë, duhet të lodhet më shumë se ai pa parti.

Përsa i përket politikës së jashtme ju jeni në dijeni. Gjendja ndërkombëtare e vendit tonë është e fortë. Uniteti i popullit tonë rrëth Partisë në luftën për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe kundër revolucionistëve në përgjithësi dhe revolucionistëve jugosllavë në veçanti është i çeliktë. Revolucionistët janë demaskuar, por duhet punuar për t'i demaskuar deri në fund, deri në shkatërrimin e tyre të plotë, ashtu sikurse bëri Lenini i madh, që i demaskoi deri në fund revolucionistët dhe të gjithë tradhtarët e marksizëm-leninizmit. Kështu do të luftojmë edhe ne kundër revolucionizmit modern.

Revolucionistët janë shumë të rrezikshëm se luftojnë me demagogji nën maskën e marksizëm-leninizmit e të socializmit, kurse në realitet e me vepra janë tradhtarë. Asnjë fjalë nuk thonë ata kundër imperialistëve amerikanë, përkundrazi i mbrojnë ata. Marrëdhëniet e tyre janë si ato midis padronit dhe cirakut.

Revolucionistët jugosllavë kanë ndërtuar fabrika e hidrocentrale, por ato janë të lidhura me interesat e imperialistëve amerikanë, që i kanë hedhur rrënjet mirë në ekonominë jugosllave. Veprat që kanë ndërtuar në Jugosllavi janë bërë me 2 miliard dollarët e amerikanëve. A mundet imperialistët amerikanë, armiq të tërbuar të socializmit, të jatin kredi për ndërtimin e socializmit? Por klikës së Titos ata i jatin se e njohin

mirë që i shërben imperializmit. Ata i përdorin revisionistët jugosllavë për të minuar ndërtimin e socializmit në vendin tonë, por nuk kanë pasur e nuk do të kenë kurrë sukses, megjithatë ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë.

Në një situatë të tillë, shokë, na vihen përpara detyra të rënda, por të lavdishme. Të punojmë në mënyrë të organizuar për realizimin e të gjitha detyrave tona, për forcimin e ekonomisë sonë, për përmirësimin e mirëqenies së popullit. Dhe që të arrijmë këtë, duhet të punojmë.

Për realizimin e të gjitha detyrave tona, në radhë të parë ne duhet të kalitim Partinë, ta edukojmë atë, ta mbajmë të pastër, të guximshme e monolite dhe ta bëjmë luftëtarë, ashtu si kurse e kemi pasur dhe e kemi. Këto janë karakteristikat e larta të Partisë sonë. Partia jonë është një parti revolucionare, marksiste-leniniste. Prandaj virtytet e saj të larta jo vetëm t'i nibajmë gjallë, por edhe t'i forcojmë e t'i shtojmë.

Të marrim masa për realizimin e planeve në çdo sektor. Të jemi të zgjuar dhe të mos na tërheqin gjerrat e vogla, por pa i harruar edhe të voglat, se nga këto lindin të mëdhatë. Për realizimin e këtyre detyrave barra bie në radhë të parë mbi komunistët.

Ne jemi të bindur, shokë, se organizata e Partisë e rrethit tuaj, që përbëhet nga shokë të vendosur, luftëtarë, do të korrë suksese shumë më të mëdha në të ardhshmen, sidomos në fushën ekonomike. Prandaj, organizoni më mirë punën dhe shfrytëzoni si duhet ndihmat që ju jep shteti.

Ju uroj nga zemra, shokë të Partisë, të organeve të

përshendetit, të organizatave shoqërore dhe ekonomike, të kooperativave bujqësore, suksese më të mëdha në punët tuaja! Të jeni të bindur se në punën tuaj heroike e të lavdishme do të keni kurdoherë ndihmën e Partisë, të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë brenda kufijve dhe mundësive që na lejohen.

*Botohet për herë të parë me  
ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*

## PUNA E ORGANIZUAR NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE TË LODH MË PAK DHE TË JEP MË SHUMË

*Fjala në takimin me kooperativistët e kooperativës së bashkuar bujqësore Shoshaj-Zenisht të rrithit  
të Burrelit*

3 qershor 1960

Ju falenderoj shumë për pritjen që më bëtë. Këtë pritje të ngrohtë dhe këtë dashuri ju e tregoni për Partinë dhe Qeverinë tonë, sepse unë jam biri juaj, bir i popullit shqiptar. Partia na ka ngarkuar me detyra të cilat duhet t'i kryejmë kurdoherë me nder e devotshmëri, të mos na rritet mendja, por ta vëmë veten gjithmonë në shërbim të popullit, sepse mbi popullin nuk mund të dalë askush. Kjo ka rëndësi të madhe. Të gjithë udhëheqësit, të gjithë drejtuesit këtë duhet ta kuptojnë mirë. Ky është parimi bazë i Partisë sonë. Ai që nuk i shërben si duhet popullit, nuk është njeri i mirë.

Ju më pritet me gëzim dhe kjo do të thotë sa të forta i keni ju lidhjet me Partinë dhe Qeverinë tonë.

Jam shumë i gjëzuar që erdha në kooperativën tuaj. Më thanë se kjo është një nga më të mirat e rrethit të Matit. Kjo do të thotë se te ju, kooperativistët, burra e gra, e kanë kuptuar si duhet të ardhshmen e tyre, e kanë kuptuar se kjo e ardhshme sigurohet duke u mbështetur në rendin kooperativist që do të ndërtohet vetëm me punë të palodhur.

Me punë ju keni arritur të zgjeroni fushat, të zhduknii gjerdhet, megjithëse ka akoma shumë për të bërë në këtë drejtim dhe ju nuk do t'ia përtoni kësaj pune që është për të mirën tuaj. Juve ju ka ardhur edhe shteti në ndihmë, kështu që një pjesë të mirë të tokave ju i punoni me traktorë. Traktori është një mjet i fuqishëm, pa të nuk mund të ecë përpara bujqësia në vendin tonë. Tani ne kemi afër 4 000 traktorë, po ata akoma nuk janë të mjaftueshëm. Qeveria mendon që në pesëvjeçarin e ardhshëm të sjellë edhe disa mijëra të tjerë. Kur të vijë kjo ditë, merreni me mend sa suksese do të arrihen në bujqësinë tonë.

Deri tani ne kemi bërë shumë përparime, po ato janë akoma të vogla. Partia nuk kënaqet me to. Prandaj do të sjellim një numër të madh makinerish që do të jenë të shumëllojshme, jo vetëm për punimin e tokave, po edhe për të bërë shërbime të tjera, që nga plugimet e thella e deri te mbjelljet, prashitjet, korrjet, shirjet. Këtë e bëjmë me qëllim që të marrim sa më shumë prodhime. Do të kemi edhe traktorë që do të shërbejnë për hapjen e tokave të reja siç i keni parë edhe vetë. Do të vijë koha që të gjitha kodrinat, këtu rreth e rrrotull, ju do t'i ktheni në toka të punueshme në vend të shkurreve e të kaçubeve që janë sot ku do

të inbillni vreshta dhe pemë që janë një pasuri e madhe për popullin.

Ju e dini fare mirë që tokat jo vetëm duhen punuar por edhe plehëruar. Tani ne ato i plehërojmë vetëm me plehun organik që është i pamjaftueshëm. Ne sjellim nga jashtë pleh kimik, po në sasi të pakta se na kushton shumë. Prandaj Partia ka vendosur të ngrihen dy fabrika të mëdha plehrash kimike që të kemi pleh në sasi të mjaftueshme për të marrë rendimente të larta edhe nc. Këto ne do t'i ndërtojmë se kemi Partinë të fortë, popullin heroik e punëtor dhe miq të fuqishëm që na ndihmojnë.

Po ç'është Partia e Punës? Ajo është Partia e djemve dhe e vajzave tuaja, domethënë ajo përbëhet nga njerëzit e popullit, që punojnë për popullin. Populli e di se Partia jo vetëm e udhëhoqi atë në luftën për çlirimin e vendit nga agallarët, nga bejlerët, nga mbreti faqizi e gjakpirësit e tjerë dhe nga pushtuesit fashistë, por brenda 15 vjetëve ia ndryshoi faqen Shqipërisë. 15 vjet qëndroi Zogu në fuqi, po ç'bëri? Asgjë. Ne nuk bëjmë propagandë. Këtë e tregojnë veprat që janë ndërtuar në këta 15 vjet, të cilat nuk janë pasuri e gjakpirësve, por e popullit, ato u ndërtuan që ai të ketë të vishet e të ushqehet më mirë. Çdo vit te ne bëhen ulje çmimesh që populli të ketë më shumë çdo gjë.

Ne nuk do të mjaftohemi me këto që kemi realizuari. Në pesëvjeçarin e ardhshëm do të ndërtojmë shumë vepra të reja, si fabrika të mëdha çimentoje, kombinat tekstili, uzina mekanike, SMT, qytete e qendra të reja punë. E ç'bëri Zogu në Burrel dhe në Mat?

Asgjë. Prandaj populli nuk kishte pse të qe me mbretin, që e la në injorancë dhe në varfëri. Vetëm burgun e Burrelit ndërtoi ai dhe një shtëpi në Burgajet. Kurse sot Burreli është transformuar në një qytet të ri plot me ndërtesa të bukura. Dhe çfarë do të bëhet këtu në të ardhshmen! Partia do ta bëjë Shqipërinë një vend të lulëzuar ku populli të rrojë i lumtur, i gjëzuar dhe i lirë, të ketë çdo gjë që i duhet për një jetë të begatshme e të kulturuar.

Zogu me sojin e tij e grabitet e popullin për 15 vjet rresht dhë, kur pushtuesit fashistë sulmuani vendin tonë, ata ikën duke e lënë popullin në mëshirën e agresorëve. Po tani ata janë katandisur këq. Ata që i shkuani prapa, Zogu i dëboi, nuk i mbante dot se i harxhoi paratë që i grabiti popullit. Pra njerëz të tillë, që e ropën dhe e varfëruan, populli i urren. Njerëzit e tjera që mori Zogu me vete, tani janë bërë agjentë të të huajve dhe rrojnë duke lypur ndonjë lek. Mallëkimi i popullit ata i zuri. Pavarësisht se disa janë gjallë, në buzë të varrit janë, ata e dinë sa u vlejti dhe sa u vlen lëkura. Forca e popullit u tregoi vendin, jo vetëm atyre, por edhe pushtuesve italianë e gjermanë që ishin të armatosur me topa e tanksa.

Tani Shqipëria është shumë e fortë. Nuk guxon njeri ta prekë si kanë vepruar më parë imperialistët në vendin tonë, se këtu është në fuqi populli dhe drejton Partia e Punës. Shqipëria tani ka dhe miq të fortë.

Në vendet tona socialiste fabrikat, minierat, toka, rrugët, ujërat dhe të gjitha pasuritë nuk janë pronë e pak njerëzve shfrytëzues, por pronë e gjigj-

thë popullit. Në vendet tona punohet që të prodhohet më shumë dhe më lirë, kurse në vendet kapitaliste ndodh e kundërtë. Shteti ynë investon miliarda lekë në bujqësi që fshatarësia të marrë më shumë prodhime që të ketë të hajë e të pijë më mirë, të ndërtojë shtëpi, shkolla etj., kurse e kundërtë ndodh në vendet kapitaliste.

Partia jonë lufton që njerëzit të rrojnë më shumë dhe ta gjëzojnë jetën. Prandaj ne duhet të punojmë mirë dhe si duhet kudo, në fabrika, në ara, në shkolla, në shtëpi etj. Puna është nder, ajo kurrë nuk e poshtëron njeriun. Çfarëdo pune qoftë ajo e nderon njeriun. Në të kaluarën puna konsiderohej si një barrë e rëndë, sepse në fuqi ishin ata që nuk punonin dhe detyronin të tjerët që të punonin për ta. Mirëpo tani në fuqi ka ardhur populli, prandaj njerëzit e punës nderohen, ndërsa dembelët dhe parazitët përbuzen dhe flaken nga shoqëria. Puna ka bërë që të zbukurohetjeta e popullit tonë, të zbukurohen kooperativat bujqësore. Prandaj të mos rrimë kurrë pa punë.

Por ka punë të organizuar dhe punë të paorganizuar. Puna e organizuar të lodh më pak dhe të jep më shumë. Edhe kooperativat bujqësore janë organizata ekonomike të fshatarëve ku duhet të bëhet një punë e organizuar dhe e drejtuar në brigada dhe në skuadra. Brigadat janë baza e punës në kooperativë. Format e punës në kooperativë duhet t'i vërë në lëvizje dhe t'i forcojë kryesia e saj që është e zgjedhur nga asambleja juaj. Ajo duhet t'i kushtojë kujdes të madh punës në brigada dhe në skuadra. Brigadat duhet të drejtohen si duhet nga brigadierët dhe nga skuadërkomandantët, të

cilët jo vetëm t'u caktojnë këtyre vendin e punës, normal që duhet të realizojnë, por të shënojnë me kujdesin më të madh ditët e punës të çdo kooperativisti. Kjo ka rëndësi të madhe. Çdo njeri duhet të paguhet sipas punës që bën. Kush punon shumë do të marrë dhe duhet të marrë më shumë. Prandaj askujt nuk i lejohet t'i hajë hakun tjetrit. Në rast se një kooperativist ka punuar shumë dhe skuadërkomandanti i shënon më pak, atëherë organizata e Partisë dhe kryesia e kooperativës duhet të mbajnë qëndrim dhe të njoftojnë asamblenë të thotë fjalën e saj, sepse fjala e asamblesë është vendimtare. Asambleja për çdo gjë me rëndësi në jetën e kooperativës duhet të thotë fjalën e saj.

Kur keni ndonjë ankesë ose çështje për të ngritur, para se të mblidhet asambleja ju duhet të shkoni te kryetari i kooperativës ose te sekretari i organizatës-bazë të Partisë dhe të flisni hapur e pa frikë. Partia është me ata që thonë të drejtën dhe që mbrojnë interesat e popullit. Ata duhet t'u dëgjojnë me kujdes dhe po është e drejtë çështja që shtroni, të marrin masa të shpejta, ndryshe, kur të mblidhet asambleja, ndaj tyre të kërcasë kritika dhe të merren menjëherë masa. Po nuk punuan mirë i zëvendësoni me të tjerë më të aftë, se populli ka plot djem e vajza të zotë që nuk vënë asgjë mbi interesin e përgjithshëm. Njerëzit bëjnë gabime, por Partia nuk i hedh poshtë, ajo u jep dorën të ndreqen; kështu Partia ka shpëtuar shumë njerëz.

Kryetarin e kooperativës ju e keni një shok shumë të mirë, komunist të vendosur, anëtar të byrosë së komitetit të Partisë të rrëthit dhe deputet të Kuvendit

Popullor. Mburreni ju, por mburremi edhe ne me kryetarin tuaj. Por Partia lufton dhe punon që nga gjiri i popullit të mos dalë një, po të dalin me qindra drejtues të tillë, se kemi shumë nevojë për ta, sidomos rrithi i Matit, popullin e të cilit regjimi i Zogut e la në errësirë dhe në varfëri. Dhe kësaj ne do t'ia arrijmë. Ky është qëllimi i madh i Partisë. Prandaj, vellezër, forconi kooperativën bujqësore dhe kjo do të arrihet duke punuar si duhet, duke treguar kujdes për grurin, misrin, frutat, blegtorianë etj.

Luistonit të merrni rendimente të larta nga bujqësia dhe nga blegtoria. Këtë do ta arrini kur misrit, grurit, blegtorisë e çdo gjëje t'i bëni shërbimet e duhura. Tani organizoni mirë punën për prashitjen dhe ujitjen e misrit. Ju keni mjaft toka nën ujë, prandaj mësoni të ujitni më me efekt dhe më me ekonomi, me brazda. Ujitja është një mjeshtëri më vete. Për këtë arsyen kemi porositur agronomët tanë që të mësojnë fshatarët si duhet të ujitin me brazda.

Në çështjen e ujitjes duhet vënë edhe rregull e disiplinë dhe të zbatohet orari, pasi njërit i vjen radha të ujite në mesditë, por tjetrit do t'i vijë radha të ujite edhe natën. Kështu duhet të punoni që t'ua kryeni mirë shërbimin bimëve dhe me siguri do të shihni se do të merrni më shumë prodhime për të cilat keni nevojë.

Mos harroni bagëtitë. Rëndësi të madhe ka që bagëtitë jo vetëm t'i shtonit si numër, por të shtonit edhe prodhimtarinë e tyre, si qumshtin, leshin etj. Ju mund të thoni tani se kullotat u ngushtuan, se nuk kemi ku i kullotim. Unë mund t'ju them se ju keni akoma mjaft

toka të lira dhe livadhe, që do t'u vijë koha të kthchen në toka buke, sepse kjo është në interesin tuaj, por është fakt se ju keni mundësi të mëdha, prandaj i shtonit bagëtitë dhe rritni prodhimtarinë e tyre. Ka te ne krahina që i kanë shkurtuar shumë livadhet, por kanë krijuar mundësi që lopët, dhentë etj. të kenë ushqim më shumë, të shtohen dhe të shtojnë prodhimtarinë e tyre. Këtë e kanë arritur sepse përdorin për ushqimin e bagëtive silazhet dhe jonxhën. Kështu ndodh në gjithë botën dhe në shumë vende nuk marrin 200-300 litra qumësht në vit nga një lopë, por 10 fish, 2 000-3 000 litra e më tepër.

Edhe në vendin tonë ka kooperativa bujqësore si në Myzeqe, Korçë etj. që marrin rendimente të larta nga lopët, pa folur pastaj për lopët e racës, që janë nga 3 000-4 000 litra qumësht në vit. Ju këtu kishit vendosur të merrnit mesatarisht 800 litra qumësht në vit nga çdo lopë. Mirëpo këtë detyrë nuk e realizuat dhe keni marrë shumë më pak. Kur e morët vendimin, ishit të sigurtë që do ta realizonit këtë shifër se mundësitë ishin. Kjo tregon se ju nuk u kujdesët sa duhet. Prandaj duhet të bëni më shumë kujdes për bagëtinë, se pa bagëti nuk mund të ketë bujqësi të përparuar. Dhe vendet në rrethin tuaj janë të përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë. Ju vetë i keni dashur dhe i doni bagëtitë.

Prandaj u kushtonit vëmendje këshillave për organizimin më të mirë të punës dhe për shtimin e rendimenteve. Rendimentet e ulëta ka ardhur koha që t'i mbeten së kaluarës dhe tanë të luftohet me ngulm për rendimente më të larta. Këtë ju do ta arrini kur të

lidheni më ngushtë me kooperativat bujqësore, duke punuar për forcimin e tyre organizativ dhe duke bërë plane të tilla që të jenë mobilizues.

Peshkopja është më përpara nga ju, megjithatë edhe atje rezultatet nuk janë të kënaqshme, kryesisht sepse kooperativistët bëjnë pak ditë-punë. Në Gjirokastër kanë hedhur parullën për të bërë 300 ditë-punë në vit. Prandaj edhe ju i shtonni ditët e punës. Kjo do të thotë që t'i japësh kooperativës më shumë që dhe ajo të të japë ty më shumë. Pra, të punoni më tepër, si burrat ashtu edhe gratë.

Në përgjithësi gratë në vendin tonë punojnë shumë. Partia i dha gruas lirinë, pra çlroi edhe gjysmën tjetër të shoqërisë. Atëherë përsë gjysma të punonte dhe gjysma tjetër jo? Përsë gjysma të kishte të drejta dhe gjysma tjeter të mos kishte? Por e kaluara ka lënë shumë mbeturina në dëm të grave. Mos vallë mendoni ju se gratë që punojnë janë më pak të ndershme nga ato që trinë brenda katër mureve të shtëpisë? Partia po punon që gruaja të bëhet e zonja, që të jetë në gjendje të mbrojë jetën dhe nderin e saj dhe të jetë e pavarur ekonomikisht. Kur bashkë me burrin punon edhe gruaja, në familje shtohen të ardhurat. Kjo është një gjë shumë e mirë. Prandaj luftoni që të zhduket mentaliteti i vjetër për gruan.

Për arritjen e këtij qëllimi në radhë të parë i vini rëndësi shkollës. Në Mati njerëzit kanë dëshirë të madhe për të mësuar. Tani Partia dhe pushteti po bëjnë gjithçka që të rinjtë dhe të rejtat të mësojnë, por duhet të përpinqen të mësojnë edhe të gjithë burrat dhe gratë, bile po të jetë e mundur edhe pleqtë, të mësojnë të

paktën sa për të lexuar gazetën që sjell çdo ditë plot lajme.

E ardhshmja e vendit tonë është e bukur. Çdo vit që kalon jeta te ne po zbukurohet. Për të gjithë janë duke u krijuar kushte ekonomike çdo vit e më të mira. Por duhet të jemi vigjilentë. Mos harroni se përballë nesh ndodhen imperialistët dhe revisionistët modernë që nuk flenë. Ata po punojnë që të hedhin botën në zjarrin e një lufte të përgjakshme. Prandaj edhe ne barutin e mbajmë të thatë që të mos na gjejë njeri në gjumë. Ne jemi për çarmatimin, por armët nuk i hedhim, se nuk kemi besim se do t'i hedhin edhe imperialistët. Ne punojmë me të gjitha forcat për përparimin ekonomik të vendeve tona, por jemi njëkohësisht edhe të armatosur mirë me armët më moderne.

Ju e dini se pas Çlirimit mbi vendin tonë fluturonin aeroplanë anglezë, italianë etj. dhe hidhnin fletushka propagandistike, ca penjë e gjilpëra e disa kokrra sheqer, sikur populli ynë kishte mbetur keq për gjilpërat e tyre. Mirëpo atëherë ne porsa ishim çiruar, nuk kishim aeroplanë, kurse tani ne i kemi dhe aq të mirë saqë askush nuk guxon më të hyjë në hapësirat tona. ajrore. Kur një aeroplan amerikan dhe më vonë një anglez provuan të hynin, u detyruan nga aeroplanët tanë të ulen në tokën tonë. Pilotët ne i lejuam të largoheshin sipas kërkuesës së tyre, por aeroplanët ua mbajtëm.

Pra, qelli i vendit tonë tanë është i pakalueshëm për armiqtë, se ne i kemi të gjitha mjetet për t'u mbrojtur.

Prandaj punoni të qetë në rrugën e Partisë, përvishjuni punës për realizimin e planeve, gjë që është në të mirën tuaj e të gjithë popullit.

Rroftë Partia jonë e dashur e Punës!

Rroftë populli trjmë i krahinës së Matit!

Rroftë Qeveria e RPSH!

*Botohet për herë të parë me  
ndonjë shkurtim sipas origjinalit që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*

## **PUNA DHE DITURIA E ZBUKUROJNE JETËN E NJERIUT**

*Fjala në mitingun e organizuar nga punonjësit  
e qytetit të Burrelit*

**3 qershori 1960**

Të dashur shokë dhe shoqe matjane,

Jam shumë i gjëzuar që vij përsëri në rrëthim e Matit e t'ju sjell përshëndetjet e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë sonë, juve, popullit kreshnik të kësaj krahine të lidhur kaq ngushtë me Partinë e Punës të Shqipërisë, me atë Parti që ju e doni me gjithë shpirt, se është Partia juaj që punon për ju e përgjithë popullin shqiptar.

Ndonjë mendjeshkurtër në të kaluarën mund të thçshte se Mati është me Ahmet Zogun! Po çfarë lidhje mund të kishte populli trim dhe punëtor i krahinës së Matit me një bandit të tillë si Zogu? Me këtë tradhtar, populli nuk mund të kishte asnjë lidhje, sepse satrapi Zog mbështetej vetëm te bajraktarët si Bilal Kolët, Abdurrahman Krosët e të tjera dhe aspak te populli i Matit, i cili nuk ishte me ta dhe me kusarët që rrinin

rreth tij, që e shtypnin dhe e rripnin popullin kurse atdheun ua shitën fashistëve italianë.

Të gjithë e dimë çfarë mjerimi i solli popullit shqiptar regjimi satrap i Ahmet Zogut derisa ai e shiti plotësisht vendin te i huaji. Veçanërisht çfarë i solli popullit të Matit? Nuk i solli asgjë, përveç mjerimit dhe injorancës. Ju e dini mirë se në rrethin tuaj nuk u ndërtua asgjë gjatë regjimit antipopullor të Zogut, përveç një shtëpie të ndërtuar nga një farë princi, Xhelal Zogu, dhe një burgu. Ndërsa brenda një periudhe 15-vjeçare Partia jonë e Punës ka bërë vepra të shumta e të mëdha që ia kanë ndërruar faqen Shqipërisë.

Regjimi i kalbur i Ahmet Zogut i solli dëme të mëdha gjithë Shqipërisë, dëme të mëdha ka pasur edhe krahina e Matit, popullin e së cilës ai e la në errësirë të thellë. Në të vërtetë në gjithë këtë rreth ai nuk hapi vçese 13 shkolla fillore, ndërsa regjimi ynë i demokracisë popullore ka hapur 55 shkolla të tillë, 11 shkolla 7-vjeçare dhe këtë vit do të hapë edhe një gjimnaz.

Në kohën e Zogut populli i Matit vuante nga sëmundjet. Regjimi i atëhershëm as që e çante kokën fare për hallet e këtij populli ashtu si për të gjithë popullin shqiptar. Kurse tani pushteti ynë popullor ndërton vazhdimisht spítale, ambulanca, maternitete, kopshte e çerdhe fëmijësh e jo vetëm në qytetin e Burrelit, por edhe në kooperativat bujqësore. Ky kujdes i madh, ky interesim i thellë i Partisë dhe i pushtetit tonë popullor, mbështetet në qëllimin e lartë për t'i shërbyer sa më mirë popullit, për të rritur brezin e ri të shëndoshë, të gjuar dhe të lumtur.

Ja, pra, çfarë ka bërë pushteti i popullit. Prandaj

populli i Matit, ashtu si i gjithë populli shqiptar, është i lidhur ngushtë me Partinë e tij të dashur dhe me pushtetin popullor, prandaj ai me plot të drejtë broho-ret me një entuziazëm kaq të madh për Partinë e tij të dashur që lindi nga gjiri i tij, për Qeverinë e tij dhë luston që këto të forcohen çdo ditë e më tepër, sepse kështu do të bëhet më e mirë edhe jeta e popullit shqiptar dhe bashkë me të edhe jeta e popullit të Matit si pjesë e tij përbërëse. Populli mallëkon të gjithë ata që i sollën dëme shumë të mëdha, duke e lënë për shumë kohë në vuajtje dhe në mjerime.

Po, kur ngordh një qen, ç'të flasësh më për të, e aq më tepër kur ngordh për së gjalli; si merhumi mbreti Zog, i cili tani ka mbetur ashtu si mbeten tradhtarët, në shërbim të spiunazheve të huaja. Ky njeri, që jetonte me aq salltanete dhe e rropi popullin tonë, tani është katandisur keq dhe rron diku në një qoshe të Francës. Të gjithë të tjerët që shkuan pas tij, i largoi se s'kishte me se t'i mbante, tani ata kanë mbetur rrugëve dhe u rderin dorën agjenturave të huaja për të mbajtur frymën gjallë, derisa t'u vijë edhe atyre fundi. I tillë është dhe do të jetë fati i tradhtarëve dhe i plehrave, të cilët populli i shporri një herë e përgjithmonë.

Regjimi i kötyre tradhtarëve mori fund një herë e përgjithmonë dhe ata që i sollën popullit vuajtje e mjerime të papërshkruara kurrë nuk do ta ngrenë më kokën. Tani mjaft prej tyre dergjen kötu në burgun e Burrelit që ata vetë e ndërtuan; le të rrinë aty se mirë janë.

Por politika e Partisë është e drejtë, Partia jonë

është zemërgjerë si populli, e mëshirshme siç është i niëshirshëm populli. Shumë nga këta njerëz të gabuar, në sajë të politikës së drejtë të Partisë, janë ndrequar. Partia u dha dorën, i ndihmoi të përmirësohen. Shumë nga ata që u liruan me rastin e amnistisë së 15-vjetorit të Çlirimit i panë vetë me sy dhe u bindën se të gjitha ato që dëgjonin dhe lexonin në gazetat tona, ishin plotësisht të vërteta dhe shkruajnë se kanë ndryshuar mendimin e se janë bindur për politikën e drejtë të Partisë dhe të Qeverisë sonë, që i sollën kaq të mira popullit e që ngriten kaq vepra të mëdha të cilat nuk mund të realizoheshin nga asnjë regjim tjetër.

Këto vepra madhëshiore u ndërtuan nën udhëheqjen e Partisë sonë, nga populli dhe për popullin.

Të dashur vëllezër matjanë,

Populli shqiptar rron ditë historike. Ai jeton në periudhën e ndërtimit të socializmit në vendin tonë, domethënë të ndërtimit të jetës së re. Gjithçka dhe çdo gjë në vendin tonë ka ndryshuar në interes të popullit. Në të katër anët e Shqipërisë janë ngritur fabrika, janë hapur miniera, janë ndërtuar dhe po ndërtohen hidrocentrale dhe plot vepra të tjera, të cilat janë për popullin, drejtohen nga djemtë dhe nga vajzat e popullit, që më parë ishin çobanë ose fare pa punë, ndërsa sot janë bërë punëtorë dhe teknikë të kualifikuar, inxhierë, agronomë e bujq të përparuar dhe me duart e tyre prodhojnë sende të dobishme për popullin.

Ju e dini mirë se pas Çlirimit te ne është ngritur një industri e re e fuqishme, e domosdoshme për ndërtimin e jetës së lumtur të popullit tonë, sepse është dega udhëheqëse e ekonomisë sonë popullorë. Në ven-

din tonë gjithashtu janë hapur shumë miniera që nuk kanë krahasim me ato që kishin hapur italianët. Kështu tani ne nxjerrim 7 herë më shumë naftë nga sa nxirrin Italianët në koncesionet e naftës që u kishte shitur Zogu. Puna e madhe e njerëzve tanë bëri që ne të nxjerrim shumë më tepër naftë dhe minerale të tjera se para çlirim. Ne sot nxjerrim 700 mijë tonë naftë, kurse në pesëvjeçarin e ardhshëm që do të aprovojë Kongresi IV i Partisë parashikojmë të nxjerrim akoma më tepër. Grupet gjeologjike po punojnë për të zbuluar zcna të reja naftë. Nxjerrja e naftës ka një perspektivë shumë të madhe për vendin tonë. Dhe në fakt të dhënrat e deritanishme tregojnë se prodhimi i naftës në vendin tonë do të rritet akoma më shumë. Për këtë qëllim do të ngrihen më vonë rafineri të reja për përpunimin e sasive të reja të naftës që do të prodhojmë. Po bëhen gjithashtu kërkime për të zbuluar rezerva gazi dhe kështu me naftë e me gaz në një të ardhshme do të arrijmë të prodhojmë me shumicë edhe ne sende të nevojës së parë për popullin dhe për ekonominë popullore.

Në pesëvjeçarin e ardhshëm do të ngremë në Fier një fabrikë të madhe për prodhimin e plehrave kimike për nevojat e bujqësisë dhe një fabrikë tjetër plehrash kimike do ta ndërtojmë në afersitë e Milotit.

Në pesëvjeçarin e tretë do të ngrihen edhe fabrika e kombinate të tjera për prodhimin e çimentos në sasi shumë më të mëdha nga sa prodhojmë sot, për tekstile dhe një sërë fabrikash të tjera. Tani s'jemi më si në vjetët e parë, kur fabrikat numëroheshin me gisht. Tani ato janë shtuar shumë e po shtohen nga dita në ditë.

Krahas industrisë, që në fillim Partia i vuri forca të mëdha edhe zhvillimit të bujqësisë. Kjo degë e ekonomisë ka një rëndësi të jashtëzakonshme për jetën e popullit, sepse pa bujqësinë nuk mund të ushqehet industria. Ju vetë keni luftuar dhe po luftoni për të zbatuar politikën e drejtë të Partisë në lëmin e bujqësisë. Hapi i parë i politikës së Partisë për përparimin e bujqësisë në vendin tonë, ishte zbatimi i Reformës Agrare. Fshatarëve iu dha toka për të cilën kishin ëndërruar me shekuj, ajo tokë që përdhunisht ua kishin zaptuar bejlerët dhe feudalët. Përveç kësaj mase shumë të rëndësishme, bujqësia jonë, mjaft e prapambetur, duhej të mëkëmbej nga shkatërrimet e luftës, se kafshët e punës ishin therur në sasi të mëdha, inventari i paktë bujqësor ishte pakësuar shumë etj. Prandaj Partia hodi parullën për kolektivizimin e bujqësisë, se vetëm kështu fshatarësia jonë mund të dilte përgjithmonë nga prapambetja dhe nga vërfëria.

Në çështjen e kolektivizimit Partia jonë eci me ngadalë, me kujdes, sipas mësimeve të Leninit të madh, prandaj triumfuam edhe në këtë çështje jetike. Fshatari ynë heroik dhe përparimtar i dëgjoi me kujdes fjalët e Partisë, i përpunoi ato në kokën e vet, secili këtë çështje jetike e bisedoi me shokët, me familjen, i shoshiti dhe iu bë e qartë rruga ku të çon kolektivizimi. Në këtë drejtim Partia priti vjete me radhë, se ishte e birdur që fshatarësia do ta përqafonte këtë rrugë. Dhe pikërisht kështu ndodhi: fshatarësia jonë ka hyrë tani përfundimisht në rrugën e kolektivizimit të bujqësisë. Në Kongresin IV të Partisë ne do të shkojmë me ballë hapët se e kryem me nder detyrën që na ishte ngarkuar.

Tani shumica dërrmuese e fshatrave tona janë kolektivizuar. Kjo ishte një rrugë e domosdoshme. Gjithë fshatarësia e kuptoi se bashkimi bën fuqinë dhe në këtë drejtim po punon me bindje të plotë, se e ka të qartë qëjeta e saj në kooperativë do të përparojë çdo vit e më shumë.

Që bujqësia të ecë përpara dhe me hapa të shpejtë, duhet të ndihmohet nga shteti e nga Partia. Por duhet thënë se ndihma e Partisë dhe e shtetit nuk mund të ketë efekt në ekonomitë individuale të shpërndara e të copëtuara, ajo mund të japë rezultate shumë të mira në ekonomitë e bashkuara, ku fshatarësia punon kolektivisht. Kështu ndihma e shtetit për fshatarësinë tanë po jepet në mënyrë të organizuar.

Që në ditët e para të pasçlirimit shteti filloi në mënyrë të vazhdueshme t'u japë kredi fshatarëve, me qëllim që të rimëkëmbej ekonomia e tyre. Por Partia mendoi se bujqësia nuk mund të shkonte si duhej përpara vetëm duke u dhënë kredi fshatarëve. Ndihma e shtetit do të kishte efekt më të madh kur të viheshin në dispozicion të bujqësisë sonë mjete pune të fuqishme siç janë traktorët. Prandaj ne sollëm shumë traktorë për punimin e tokave, për t'u bërë shërbime kulturore bimëve, për hapjen e tokave të reja etj. Deri tanë ne kemi rreth 4 000 traktorë fizikë në të gjithë vendin, por gjatë pesëvjeçarit të tretë do të kemi akoma më shumë makineri bujqësore.

Në krahinën tuaj tanë punojnë gjithsejt 20 traktorë. Natyrisht këta janë pak, por krahina juaj është malore e si e tillë vetë terreni nuk lejon që të përdomen kudo traktorë. Megjithatë edhe këtu Partia e ka

kujdes që në të ardhshmen të dërgojë akoma më shumë.

Me punën që do të bëjë populli ynë në gjithë vendin, po tani e kam fjalën për popullin e krahinës së Matit, pra me punën tuaj dhe me mjetet e mekanikës bujqësore të gjitha këto toka të bukura dhe shumë të mira që duken këtu rrotull, së shpejti do të pastrohen nga shkurret dhe do të mbillen me vreshta, mollë, dardha, kumbulla për të mirën e popullit të rrethit tuaj, për të mirën e gjithë popullit shqiptar.

Partia mendon, gjithashtu, që krahas me shtimin e numrit të traktorëve duhen hapur dhe tokat e reja; kjo është në interesin e fshatarëve dhe të gjithë ekonomisë sonë, sepse populli ynë po shtohet me shpejtësi. Tani kemi arritur në një milion e gjysmë njerëz. Kjo tregon se jeta te ne për çdo njeri është e siguruar. Shikoni si janë fëmijët tuaj, si lule e plot shëndet, prandaj, që të plotësojmë më mirë nevojat e tyre, duhen shtuar tokat e punueshme duke tharë moçalet e kënetat, duke spastruar tokat nga shkurret dhe nga drizat. Deri tani kjo është bërë në shkallë të gjerë dhe i janë siguruar kështu vendit dhe dhjetëra mijëra hektarë toka të reja. Puna në këtë drejtim po vazhdon dhe ne mendojmë se kënetat e moçalet brenda dy pesëvjeçarëve do t'i përkasin së kaluarës së vendit tonë.

Për rritjen e rendimenteve në bujqësi duhet gjithashtu ujë. Edhe për këtë problem të rëndësishëm kanë menduar Partia dhe pushteti. Janë hapur kudo kanale ujitëse dhe deri në fund të pesëvjeçarit të tretë parashikohet të ujiten afër 42 për qind të sipërfaqeve të

tokave. U gëzova shumë kur mësova se rrathi i Burrelit ka nën ujë më tepër se 45 për qind të sipërfaqeve të tckave të punueshme. Kjo është një pasuri e madhe që duhet të dini ta përdorni sa më mirë. Por nuk duhet të kënaqeni me kaq. Në këtë drejtim duhet më shumë inisiativë dhe të arrini që brenda një periudhe të shkurtër, një ose e shumta brenda dy vjetëve, me disa ndihma fare të pakta nga ana e shtetit, të arrini të ndërtoni vetë prita, hauze etj. ku të grumbulloni sasi të konsiderueshme uji të cilat t'i shfrytëzoni gjatë verës. Në këtë mënyrë mund të vihen nën ujë me qindra hektarë toka të tjera. Kjo punë duhet vazhduar sepse nuk kërkon mjete të kushtueshme.

Tani ne mund të themi me plot bindje se bujqësia jonë ka hyrë në rrugën e përparimit, prandaj të shfrytëzojmë plotësisht të gjitha mundësitë që janë krijuar dhe t'i përvishemi si duhet punës në bujqësi që të marrim nga toka sa më shumë prodhime, të rriten rendimentet kudo dhe për të gjitha kulturat.

Ju duhet të kujdeseni shumë për kulturën e misrit, të arrini që nga tokat e mbjella me këtë bimë të merrni rendimente të larta dhe të mos kënaqeni me ato që merrni sot, sepse dihet mirë që sa më mirë ta punosh tokën aq më shumë të jep. Prandaj përvishjuni punës në mënyrë të organizuar në kooperativat bujqësore, se në kooperativë është e mira juaj, se kooperativa ështëjeta juaj. Për të pasur rezultate sa më të mira, luftoni që ta keni të fortë kryesinë e kooperativës, të zgjidhni atje njerëzit më të mirë, organizatorë të aftë. Për këtë organizata e Partisë të vëré të gjitha forcat për forcimin e kooperativave bujqësore, komunistët të

jenë në ballë të luftës për zbatimin e detyrave dhe për të marrë nga toka rendimente sa më të larta. Asnjë komunist të mos fshihet nëpër depo ose në zyrat e koooperativës, vendi i tyre i punës të jetë në arë. Në rast se ka të atillë që nuk duan të shkojnë, u hiqni veshin jo vetëm në organizatën e Partisë, por edhe në mbledhjen e përgjithshme të kooperativës. Ai që mban teserën e Partisë ai ka edhe përgjegjësi më të mëdha. Komunisti duhet të jetë shembull, ai duhet të punojë më shumë; anëtarin e Partisë nuk duhet ta zërë gjumi, sepse të kesh në xhep teserën e Partisë do të thotë të kesh detyrime të mëdha ndaj Partisë dhe popullit. Komunistët të kenë parasysh traditat e lavdishme të shokëve të luftës, të cilët nuk kursenin as jetën përlirinë e atdheut dhe të popullit po hidheshin në zjarr, atje ku ishte rreziku më i madh. Edhe tani komunistët të veprojnë ashtu si vepronin shokët e tyre në luftë, të hidhen pa përtim në zjarrin e luftës së re për ndërtimin e socializmit. Kjo është rruga që duhet të ndjekin vazhdimisht anëtarët e Partisë dhe në këtë luftë të re do të njihen mirë komunistët e vendosur dhe konsekuentë, ata që janë gati për të punuar deri në fund për popullin.

Të dashur vëllezër dhe motra matjane, organizoni mirë punën në kooperativat bujqësore, në brigada e në skuadra, dhe u bëni si duhet shërbimet kulturave bujqësore, sepse tani ju punoni për veten dhe përfëmijët tuaj, zhvilloni blegtorianë, jo vetëm në numër, por edhe në drejtim të shtimit të prodhimeve të saj, për të marrë sa më shumë qumësht, lesh, mish etj. Por që nga bagëtitë të marrim rendimente të larta, në

radhë të parë, duhet t'u sigurojmë atyre ushqim të bollshëm.

Vendi ynë është blegtoral, populli ynë e do shumë blegtordinë, po megjithatë ka shumë krahina në vendin tonë, në të cilat mund të themi se akoma nuk tregohet kujdesi i duhur për trajtimin e bagëtive si në ushqimin ashtu edhe në strehimin e tyre. Mos mendoni se ushqimin bagëtive duhet t'ua sigurojmë vetëm në natyrë, por të mendojmë dhe të punojmë që t'u sigurojmë atyre, përveç ushqimit në natyrë, edhe ushqime të koncentruara, domethënë silazh, jonxhë dhe barëra të tjera. Për këtë qëllim i kushton kujdes të madh kulturës së misrit.

Problemi i frutikulturës është një çështje tjetër me rëndësi shumë të madhe veçanërisht për ju fshatarët e krahinës së Matit. Klima dhe toka e rrëthit tuaj janë të favorshme për zhvillimin e frutave. Ju i keni hyrë kësaj pune po deri tani keni bërë shumë pak. Prandaj përvishjuni punës duke filluar që nga sigurimi i fidaneve në vetë kooperativat bujqësore, sepse shteti me fidanishtet që ka nuk mund t'i përballojë të gjitha nevojat për mbjellje frutash që kërkon bujqësia jonë në të gjithë Republikën. Prandaj është mirë të cak-tchen disa kooperativa bujqësore për kultivimin e fidaneve me qëllim që t'i përdorin ato si për nevojat e veta ashtu edhe për t'u shitur kooperativave të tjera motra. Kështu po veprohet tani në të katër anët e Shqipërisë si në Korçë, në Shkodër, në Vlorë etj. ku po krijohen blloqe fidanesh frutore për të mbjellë pemë frutore jo vetëm në kooperativat e tyre, por për t'u plotësuar kërkesat për fidane të gjitha kooperati-

vave bujqësore që kanë rrëth e rrotull. Në këtë mënyrë do të arrihet që brenda disa vjetëve t'i shtojmë në sasi të mëdha pemët frutore. Pra, t'i kushtojmë kujdes kësaj çështjeje, të prodhojmë sa më shumë fruta që kanë rëndësi të madhe jo vetëm për ushqimin dhe për shëndetin e popullit, por edhe për të shitur jashtë shtetit, ku kërkohen shumë. Përveç kësaj, ju e dini se në vendin tonë po ndërtohen një sërë fabrikash për konservimin e frutave, ato duhet të furnizohen me lëndë të parë, pra me fruta. Kështu që sado fruta që të kemi, ato nuk na shkojnë dëm. Mbillni, pra, sa më shumë fruta në këto kodra, sepse, brenda një kohe të shkurtër, do të siguroni të ardhura të konsiderueshme.

Përparime të mëdha janë bërë në rrithin e Matit edhe në fushën e arsimit dhe të kulturës. Megjithatë do t'ju këshilloja t'i vini rëndësi akoma më të madhe ndjekjes së shkollave nga djemtë dhe nga vajzat e rrithit tuaj pa përjashtim. Ju lutem prindërve, veçanërisht, që të mos i lënë pa dërguar fëmijët në shkolla se ky do të ishte një krim i madh ndaj atyre që ju i doni aq shumë. Unë jam i sigurtë se shumë nga ju kanëën-dërruar të mësonin, por varfëria dhe regjimet antipullore nuk ju kanë lënë të vini në shkollë. Aq më tepër pra, përsë të mos e dërgosh fëmijën kur vetë je djegur për të mësuar? Pastaj kohët kanë ndryshuar. Tani mundësitë dhe kushtet për shkollë janë shumë të mëdha. Në kushtet e ndërtimit të socializmit dituria është po aq e nevojshme sa edhe buka. Përpara nuk kishte traktorë në vendin tonë, tani kemi, përpara nuk kishim as drithë elektrike, tani janë ngritur e po ngrihen

hidrocentrale, nuk kishim fabrika, tani ato i kemi ngri-tur dhe gjithnjë e më shumë të reja po ngremë në të katër anët e vendit, nuk kishim aeroplanë, tani i kemi. Por të gjitha këto duhet të drejtohen, hidrocentralet dhe fabrikat duhet të punojnë, aeroplanët duhen vënë në lëvizje. Fëmijët tanë nuk jetojnë ashtu si kanë jetuar gjyshërit tanë. Ata duhet të mësojnë, gjithnjë të mësojnë për të mirën e tyre e të atdheut.

Tani është shekulli i shkencës, prandaj ajo duhet mësuar e përvetësuar. Për këtë qëllim Partia ka hapur e akoma do të hapë shkolla të reja, që ato të bëhen qendra të rëndësishme për të mësuar fëmijët tanë dhe jo vetëm për ata, por, po të jetë e mundur, edhe për të kaluarit nga mosha.

U kushtoni, pra, rëndësi të madhe arsimt dhe kulturës se kështu do të fitoni dituri, se dituria e zbuluaron njeriun, i shton atij forca për t'i dhënë sa më shumë shoqërisë, ia lehtëson punën. Dhe dituria mësohet në shkollë, prandaj luftoni që fëmijët t'i ndjekin ato pa përjashtim.

Shqipëria është një vend ku jeta e popullit përmirësohet çdo ditë. Plani pesëvjeçar, direktivat e të cilat do të aprovojen në Kongresin IV të Partisë, do të jetë një hap i madh përparrë për përmirësimin e jetës së popullit. Populli ynë e shikon se ato që ka thënë Partia janë bërë realitet, se Partia fjalët i kthen në vepra, sepse është e lidhur ngushtë me popullin. Populli zbaton me besnikëri vijën e Partisë, se e do me gjithë zemër Partinë, e cila punon që t'ia bëjë jetën të lumtur dhe të gjëzuar. Po të dojë populli, çdo gjë realizohet.

Nën udhëheqjen e Partisë së tij heroike vendi ynë

është bërë i fortë, ka hyrë në radhën e shtetev të përpunuara dhe ka përpala një perspektivë të shkëlqyer.

Politika e vendit tonë është një politikë paqësore. Ne punojmë për ndërtimin e jetës së re, për të mbrojtur paqen, por nga ana tjetër sytë i mbajmë hapur; si thotë një fjalë, as miza nuk mund të kalojë tanë në kufijtë tokësorë, ajrorë dhe detarë të vendit tonë. Kaluan, për të mos u kthyer më, kohët kur tradhtari, Ahmet Zogu, lejoi të hynin më 7 prill 1939 në vendin tonë anijet dhe aeroplani të luftës të Italisë fashiste. Aeroplani armiq nuk mund të kalojnë lehtë mbi qiellin tonë si dikur. Kur ne nuk kishim aeroplanë, hynin përdhunisht në vendin tonë aeroplani e monarko-fashistëve grekë, neofashistëve italianë ose aeroplani anglezë etj., lëshonin me parashuta diversantë, fletushka për të gënjer popullin. Por, kur edhe ne u bëmë me aeroplanë, puna ndryshoi. Ju keni dëgjuar se si u orvat të fluturonte në hapësirën tonë ajrorë një aeroplane ushtarak amerikan, të cilin aeroplani të tanë e detyruan të ulej në tokën tonë. Kështu u veprua edhe me një aeroplane anglez.

Ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë. Në fakt edhe socializmin po e ndërtojmë, por edhe ushtrinë nuk e lëmë pas dore. Ne kemi një ushtri të fortë si malet tona, besnikë deri në fund të popullit. Ajo është ushtri e një tipi të ri, jo ushtri për t'u përdorur kundër popullit, siç ishte ajo e Ahmet Zogut, por një ushtri e përbërë nga bijtë e popullit, që dinë përse shërbijnë, përse e mësojnë artin ushtarak dhe përse i mbajnë armët, si, ku dhe kur duhet t'i përdorin ato. Ushtria

jonë është një shkollë e vërtetë për bijtë e popullit. Ne kemi edhe flotën ajrore dhe marinën tonë ushtarake, ku shërbejnë me besnikëri djemtë e popullit, të cilët tregohen jashtëzakonisht të zotë. E gjithë ushtria jonë, rojet e kufirit, policia popullore, arma e sigurimit të shtetit përbëhen nga djemtë më besnikë të popullit, që vigjilojnë ditë dhe natë për ruajtjen e interesave të popullit. Prandaj i duam ata me gjithë zemër se janë djemtë tanë, se ata, duke pasur mbështetje të fuqishme popullin, mbrojnë atdheun e fitoret e socializmit nga çdo rrezik në rast se ai do të vijë.

Pra, të dashur vëllezër, shokë dhe shoqe matjane, me bindje dhe besim t'i përvishemi punës dhe të korrim suksese sa më të mëdha në çdo fushë, në industri, në bujqësi, në arsim e në kulturë për ta bërë popullin tonë sa më të gjëzuar, për t'u siguruar fëmijëve tanë një jetë më të lumtur, për t'u siguruar atyre begatinë, rehatinë dhe gjumin e qetë, paqen e qëndrueshme.

Kjo varet nga ne, nga duart tona. Në këtë rrugë na mëson dhe na udhëheq Partia jonë.

Ne do t'i arrijmë objektivet tona sepse kemi Partinë tonë të çeliktë, besnikë deri në fund të marksizëm-leninizmit, e pamposhtur ndaj armiqve të popullit, e papajtueshme me revisionistët modernë, si ata të Beogradit, të cilët nuk janë veçse agjentë të imperializmit. Ne kemi pushtetin tonë popullor, qeverinë tonë popullore të dalë nga populli.

Prandaj të bashkuar, si asnijëherë, si një trup i vetëm rrëth Partisë, me besim dhe entuziazëm të shkojmë në punë për të realizuar detyrat tona që kanë përqëllim të vetëm rritjen e mirëqenies së popullit.

Të rrojë populli i krahinës së Matit, populli liri-dashës, besnik i Partisë dhe i pushtetit tonë popullor!

Të rrojë Partia jonë e lavdishme e Punës!

Të rrojë populli i lavdishëm dhe heroik shqiptar!

Të punojmë që të rrojnë të lumtur rinia dhe fëmi-jët tanë!

*Botohet për herë të parë me  
disa shkurtime sipas origji-  
nalit që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*

## **NJEREZIT DUHET TË MËSOHEN QË TË JENE TË DREJTE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**13 qershor 1960**

Mendimi im është se raportimi i shifrave joreale nuk është një punë e mirë komuniste nga ana juaj, shokë drejtues të Kukësit. Ju nuk keni zbatuar si duhet udhëzimet e Partisë në paraqitjen e rezultateve të vërteta. Pavarësisht se ç'kanë bërë agronomi ose shefi i bujqësisë, mendimi im dhe i shokëve të tjerë është se ju mbani përgjegjësi, sepse keni dashur që shifrat t'i fryni dhe t'i paraqiteni Komitetit Qendror dhe Qeverisë me plan gjoja të realizuar e të tejkaluar.

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua dhënia e disa shifrave jo të sakta në raportet e dërguara për Komitetin Qendror nga ana e Komitetit të Partisë dhe e Komitetit Ekzekutiv të Kukësit për vitin 1959.

Pse e keni bërë këtë? Në qoftë se ju nuk e njihni gjendjen si rreth, pse nuk merrni parasysh të dhënrat reale të bazës? Përse janë organizatat-bazë të Partisë, kryesitë e kooperativave dhe komiteti ekzekutiv i KP të rrëthit? Ata janë në korrent dhe përbëjnë mbësh-tetjen kryesore të komitetit të Partisë. Por duket qartë se ju jeni përpjekur t'i fryni shifrat për të fituar garën që keni shpallur me rrethin e Peshkopisë. Mund të pranojmë versionin që ju i keni kthyer shifrat për t'i parë edhe një herë, por disa kanë thënë: «Të pranojmë shifra që janë më të larta». Është faj i madh që ju keni shtrembëruar realitetin për të dalë fitues të garës, pa marrë parasysh të dhënrat e bazës. Ky faj i rëndë nuk duhet të përsëritet më nga ju.

Duke besuar në shifrat e raportuara nga ana juaj, Kemiteti Qendror dhe Qeveria ju dërguan një letër falenderimi. Meqenëse shifrat e raportuara s'janë reale, është i drejtë propozimi që kjo letër t'ju tërhiqet. Mund të bëhet një letër tjetër nga ana e Komitetit Qendror ku të thuhet se letra e falenderimit ju tërhiqet, për arsy se shifrat e rendimenteve të arritura janë rapor-tuar gabim me ndërgjegje. Gjithashtu të tërhiqet edhe fleta e lavdërimit që është dhënë nga ana e bashki-meve profesionale. Ndërsa për flamurin që keni marrë, nuk kemi çfarë të themi, sepse e keni fituar për grumbullimet, megjithëse edhe kjo është bërë në një mënyrë të tillë që kooperativat bujqësore janë lënë pa bukë. Si mund të veprohet kështu dhe të krijohet një situatë e tillë politike? Si mund të lësh popullin pa bukë për të qenë «në rregull» me Partinë e Qeverinë duke «realizuar» grumbullimet? Populli mund të thotë: Këto

veprime i kanë bërë njerëzit që janë në udhëheqje, atëherë pse i mbajnë në udhëheqje?

Ja, shokë, ç'pasoja ka kur s'raptorohet e vërteta. Ne nuk po marrim masa më të rënda për ju, sepse jeni shokë të vjetër dhe një gabim të tillë kolektiv e bëni për herë të parë. Mundet që Byroja Politike të mos jua hiqte teserën e Partisë, por t'ju bënte ushtarë të thjeshtë të Partisë, sepse nuk luhet me punën e djersën e popullit.

Lidhur me masat që propozohen, mendoj që byrosë së komitetit të Partisë të mos i heqim vërejtje si kolektiv, pse shokët besoj se e ndiejnë këtë përgjegjësi, por të mjaftohemi me tërheqjen e vëmendjes, që të kenë kujdes për herë të tjera dhe të kërkojnë si duhet llogari ndaj njerëzve përgjegjës. Përsa i përket ish-sekretarit të parë të komitetit të Partisë të rrëthit, sekretarit të dytë dhe kryetarit të komitetit ekzekutiv të KP të rrëthit, t'u hiqet vërejtje e rëndë me shënim në kartën e regjistrimit. Masat për njerëzit e tjerë janë në kompetencën e rrëthit. Ju, nga ana e byrosë, duhet të kishit marrë më parë masa për ta.

Njerëzit duhet të mësohen që të jenë të drejtë. Nuk është mirë që ndonjëri të firmosë pa lexuar aktin. Kur raporton osc flet, secili të jetë i matur dhe ta thotë fjalën shkoqur.

Ne jemi të bindur se nuk do të ngjasin më gabime të tillë, sepse Partia dhe shteti vihen në pozita të vësh-tira në lidhje me bilancin e drithërave. Duke u bazuar në të dhënrat që japid rrëthet, Qeveria bën llogaritë për importin dhe rezervat. Në qoftë se këto të dhëna fryhen, s'janë reale, atëherë jo vetëm rrëthi s'jep atë që

detyrohet, por kërkon t'i japë Qeveria. Si mund të ecet kështu? Prandaj shokë, mos bini më në këto gabime.

*Botohet për herë të parë me  
ndonjë shkurtim sipas tekstit  
të nxjerrë nga procesverbali i  
mbledhjes së Sekretariatit të  
KQ të PPSH që gjendet në AQP*

# **TEMA E AGJITACIONIT FIGURATIV TË JETË MË SHUMË PËR PRODHIMIN**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**13 qershor 1960**

Plakatat që bëhen të mos shpërndahen në mënyrë shabllone, por të shkojnë atje ku duhet, ku na shërbejnë, atje ku është prodhimi. Nuk duhet të ndodhë, për shembull, që plakatat për pambukun dhe për duhanin të shpërndahen në të gjitha kooperativat, edhe atje ku këto kultura nuk mbillen. Kooperativa bujqësore pret t'i dërgohet ajo plakatë, për të cilën ka nevojë, që nxit çuarjen përpëra të prodhimit. Prandaj kur projektohen plakata, të nisemi nga kritere e pikësynime të caktuara. Ne nuk bëjmë plakata për plakata, propagandë për propagandë.

Në agjACIONIN FIGURATIV kanë rëndësi përbajtja, forma, tematika dhe shfrytëzimi. Mendoj të mos mbe-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi gjendjen e agjACIONIT FIGURATIV dhe masat për përmirësimin e tij.

teni në disa parulla, që dihen nga të gjithë. Parullat duhet të jenë kurdoherë mobilizuese. Prandaj tekstet e parullave që afishohen të bëhen të menduara mirë.

Këtu u tha që shumë pak pllakata janë bërë për traditat patriotike të popullit tonë, natyrisht edhe këto duhen, por mendoj që në radhë të parë tema e agjitationit figurativ të jetë më shumë për prodhimin. Them kështu, sepse për traditat patriotike zhvillohen aktivitete të tjera. Për shembull, për të përkujtuar ditë-lindjen e një patrioti, s'ka kuptim një pllakatë, sepse zhvillohet konferencë, shkruhet në shtyp etj.

Nga ana tjetër, u duhet thënë komitetetë të Partisë që pllakatat të shpërndahen e të afishohen menjëherë dhe të mos lejohet asnjë rast që disa të shtrojnë me to tavolinat. Në këto raste të mbahet qëndrim. Tani nuk jemi si në ditët e para të pasçlirimit, kur pllakata e afishe përdoreshin edhe për deftere etj. Kjo ndodhte atëherë sepse s'kishim as letër.

Gjithashtu, në projektvendimin që na është paraqitur të mos thuhet se sa të rritet tirazhi i mjeteve të agjitationit figurativ në pesëvjeçarin e tretë. Këtë do ta shikojmë kur të na paraqitet për aprovim projekt-plani pesëvjeçar.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

# **EKSPERIENCA E MIRË NE PUNE — FAKTOR I RËNDËSISHËM PËR FORCIMIN E KOOPERATIVAVE BUJQËSORE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**14 qershor 1960**

Kjo analizë ka një rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të kooperativave bujqësore në vendin tonë. Me dërgimin e ekipeve është bërë një punë e mirë, e cila duhet të vazhdohet edhe në të ardhshmen duke e ngritur në një shkallë akoma më të lartë, sepse kooperativat bujqësore kanë nevojë për t'i ndihmuar që të ecin kurdoherë përparrë në rrugën e konsolidimit të tyre ideologjik, ekonomik, organizativ.

Mendoj se eksperienca e mirë e kooperativave bujqësore duhet të përpunohet më tej, sepse puna e deri-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua rrëth raportit «Mbi gjendjen ekonomiko-organizative të kooperativave bujqësore dhe punën e bërë nga ekipet e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë për forcimin e tyre».

tanishme në këtë fushë është e pamjaftueshme. Këtë e bazoj edhe në raportin e projektvendimin që na janë paraqitur, të cilët janë të njëanëshëm, sepse përbajnjë vetëm dobësitë që konstatohen. Këto dobësi ne nuk na trembin dhe as kemi ndër mend t'i fshehim, por në kooperativat bujqësore kemi edhe shumë anë pozitive, kemi përparime, eksperiencë të mirë, prandaj kooperativistët dhe kuadrot drejtues duhet të mësojnë si nga gabimet, ashtu dhe nga të mirat e tyre në punë. Eksperienca e mirë në punë është një faktor me rëndësi përfshirë forcimin e kooperativave bujqësore.

Lidhur me përhapjen e eksperiencës së përparuar nuk duhet të kritikojmë vetëm bazën, por edhe veten tonë. Kur zbulohen shembuj të mirë në punë, është e domosdoshme t'i rekomandohen bazës përfshirë eksperiencë dhe kjo të konsiderohet një direktivë e Komitetit Qendror të Partisë. Kjo ka rëndësi të madhe përfshirë ecur në gjurmët e më të mirëve. Mjaft nga kooperativat tonë kanë grumbulluar një eksperiencë të mirë, të cilën ne, si Komitet Qendror, duhet ta përgjithësojmë dhe të japim direktiva si të veprohet përfshirë zbatimin e saj.

Eksperienca e fituar duhet të përhapet gjithashtu nëpërmjet artikujve e shkrimeve të ndryshme të gazetës «Zëri i popullit». Këta artikuj të mos janë me karakter të përgjithshëm, por në ta të spikatë eksperienca e gjallë e punonjësve. Edhe herë të tjera kemi thënë se informacionet që botohen në gazetë janë të mira, por ato duhet të janë më të lidhura me direktivat e veçanta të Komitetit Qendror, më konkrete dhe pa frazeologji. Në një shkrim është e pamundur të trajtohen të gjitha

problemet që shتروhen në një konferencë apo mbledhje, prandaj në gazetë kërkohet që lexuesit të mund të gjejnë çështjet kryesore dhe këto në shkrime me tituj nxitës, pa dëmtuar brendinë. Të kihet gjithashtu para-sysh që të mos trajtohen të gjitha problemet e bujqësisë vetëm në një artikull, sepse ato janë të shumta. Çështja është që njerëzit të preokupohen për problemet e bujqësisë dhe t'u tregohen rrugët se si t'i zgjidhin detyrat duke u bazuar në eksperiencën e më të mirëve. Duke trajtuar një problem kyç të theksohen parimet dhe kjo të ilustrohet me praktikën e punës, me qëllim që njerëzit të mësojnë e të nxjerrin konkluzione për sektorët e tyre. Pra, ka mundësi që në faqet e gazetave tonë lexuesit të gjejnë edhe eksperiencën e mirë, nga e cila do të përfitojnë për të përmirësuar gjithnjë e më shumë punën e vet.

Kisha disa vërejtje në lidhje me kuadrin që pre-gatitet për bujqësinë. Ne luftojmë e do të luftojmë akoma më shumë edhe në të ardhshmen për sigurimin e kuadrit në këtë sektor. Në Kongresin III të Partisë u theksua që çështjen e kuadrove me profil bujqësor, veçanërisht pre-gatitjen e kryetarëve, të llogaritarëve e të brigadierëve të kooperativave bujqësore, duhet ta shtrojmë me një perspektivë të caktuar. Propozoj që në shkollat dhe në kurset ekzistuese të kalojnë më shumë nga këta kuadro, të cilët të pre-gatiten brenda një kohe të caktuar. Për këtë të studjohet më mirë problemi i afatit të tyre dhe i përbajtjes së lëndëve që do të zhvillohen me kategoritë e kuadrove. Më shumë kujdes t'i kushtohet drejtimi ekonomiko-financiar të kooperativave bujqësore në këto kurse dhe shkolla.

Pa pregititjen e kuadrove drejtues të kooperativave bujqësore nuk është e mundur të ecë si duhet përpara bujqësia.

Përsa i përket pregititjes së kryetarëve të kooperativave bujqësore duhen marrë masa për dërgimin e tyre në shkollë. E vërteta është se kooperativës nuk mund t'i imponosh se cilin të zgjedhë kryetar të saj, por ai që zgjidhet ka nevojë të pregititet; kur të kthehet nga shkolla, kooperativistët e shohin që është bërë më i aftë, prandaj dhe e rizgjedhin. Natyrisht në këtë proces mund të ketë edhe ndonjë rast që ai të mos zgjidhet përsëri në postin e kryetarit, por kjo të mos na bëjë të tërhiqemi nga puna për dërgimin në shkollë të kryetarëve.

Kryetarët e rinj duhet të zgjidhen me kritere të shëndosha, të jenë njerëz me perspektivë, të përshtatshëm edhe nga pjekuria, edhe nga mosha, që nesër kooperativa të mund t'i zgjedhë përsëri. Prandaj kjo punë duhet bërë në mënyrë të studjuar dhe me kujdes të madh. Nuk duhet të na ndodhë që ai, i cili kryen shkollën për kryetar, të mos jetë i aftë për të drejtuar kooperativën. Në qoftë se ngjasin raste të tillë, kjo do të thotë se kryetari i kooperativës nuk është zgjedhur me kujdes që në fillim. Ai që do të mësojë mirë dhe do të jetë më i zoti, mund të caktohet edhe kryetar, ose po që se nuk është i zoti për kryetar, sipas aftësive mund të vihet edhe në punë të tjera.

Partia duhet të ketë kujdes që kryetari të mos jetë «perëndia» e kooperativës bujqësore. Organi më i lartë i kooperativës është asambleja e saj, ndërsa forca udhëheqëse në kooperativë është organizata-bazë e Partisë.

Mund të ndodhë që në një kooperativë të kemi kryetar shumë të mirë, por është e dobët organizata e Partisë apo e kundërta. Sidoqoftë, një njeri partie që është organizator i mirë ndihmon edhe organizatën e Partisë, edhe asamblenë e kooperativës, por kurdoherë kryetari duhet të jetë nën kontrollin e organizatës-bazë. Ndryshe kryetarët nuk do të pyesin fare as organizatën e Partisë, as asamblenë, të cilën do ta nënveftësojnë, nuk do ta mbledhin në rregull, do të fillojnë të bëjnë favore etj. Kryetari duhet të jetë si një ushtar i disiplinuar dhe të mos e vërë veten mbi asamblenë. Atje ku organizata e Partisë do të jetë e fortë, edhe asambleja edhe kryetari i kooperativës do të jenë në rregull. Prandaj të kemi parasysh që kryetari të jetë me cilësi të mira morale, politike dhe organizative, t'i kërkojë vetes dhe të tjerëve disiplinë, të mbledhë në rregull asamblenë etj. Në qoftë se ndonjërit i rritet mendja, do të ndodhë e kundërta. Prandaj kjo frymë e Partisë të çohet në çdo kooperativë bujqësore.

Organizimi i punës në kooperativë është një nga çështjet kryesore. Është e domosdoshme që fshatarët t'i organizojmë mirë, që ata të punojnë në radhë të parë tokën e kooperativës, por edhe oborrin kooperativist. Fshatari duhet ta kuptojë se të ardhshmen e ka me kooperativën, prandaj ai duhet t'i përvishet punës sidomos në pronën e përbashkët, por kjo s'do të thotë që ai të mos lejohet të punojë në oborrin kooperativist. Po nuk u mbajt parasysh kjo, ka rrezik që fshatari të lërë fshatin, të shkojë në qytet e të punojë punëtor. Ne do të tërheqim krahë pune nga fshati për ndërtimet e pesëvjeçarëve tanë, por edhe tokat nuk do t'i lëmë pa

punuar. Prandaj kjo duhet bërë në mënyrë të organizuar. Ndryshe krijojmë vështirësi dhe pakënaqësi në kooperativat bujqësore. Ja, për shembull, ka shumë fshatarë nga malësitë e Sarandës që kanë ikur nga fshati dhe janë bërë punëtorë në qytet. Mirëpo gratë e tyre kanë nga 2-3 dynym tokë dhe disa rrënje ullinj. Disa shokë u thonë atyre: ose kthehuni në kooperativë, ose ne do t'jua marrim këto. Por këtë sipërfaqe toke ne nuk e duam, sepse nuk luan ndonjë rol me rëndësi, prandaj le ta punojnë gratë dhe fëmijët e tyre e të qëndrojnë në fshat. Fitimi që ka kooperativa është vetëm sepse këto familje punojnë tokën e tyre, diçka bëjnë edhe në kooperativë. Prandaj edhe në malësitë të bëjmë kujdes për këtë çështje. Në qoftë se ne nuk u lëmë këtyre familjeve qumësht, djathë, zarzavate, atëherë me çfarë do të rrojnë ato? Fshatari bën llogari: me drithin që merr plotëson nevojat për bukë, ndërsa nga oborri kooperativist do të plotësojë disa nevoja të tjera, për këtë arsy i jepet edhe ky oborr. Sigurisht do të vijë një kohë që oborrin kooperativist ta shkurtotojmë, por tanë akoma është shpejt.

Ka mjaft probleme që duhen zgjidhur, por kjo zgjidhje është e domosdoshme të bëhet në përputhje me vijën e Partisë. Të marrim çështjen e qumshtit, për të cilin ne kemi bërë një plan. Po si janë bërë llogaritë? Disa i kanë bërë këto llogari që fshatarëve t'u merret edhe qumshti i atyre tri-katër deleve që kanë. Dhe fshatarët e kësaj kategorie shkojnë e dorëzojnë qumshtin me shishe! Parimi është që fshatari ta dorëzojë qumshtin me dashje, po në praktikë nuk ndodh kudo e kurdoherë kështu, këtë ma thanë edhe kur isha

në Peshkopi. Ne do të bëjmë dhe duhet të bëjmë përpjekje për grumbullimin e qumshtit nga oborret koooperativiste, por të marrim qumësht nga ata fshatarë që kanë 10-15 dhen dhe jo nga ata që kanë 3 ose 4 kokë, qumshti i të cilëve nuk u mjafton as për vete. Është tjetër kur edhe këta fshatarë, për nevoja të tjera që mund të kenë, i shesin shtetit qumësht me dëshirën e tyre.

Kur flasim për përhapjen e eksperiencës së përparuar, e kemi fjalën për ato iniciativa që janë me të vërtetë frytdhënëse, që i shërbejnë interesit të përgjithshëm, por s'dëmtojnë interesat vetjake të njerëzve. Në këtë drejtim të ruhemi nga entuziazmi i tepruar, nga nxitimet. E them këtë sepse ka pasur ndonjë iniciativë pa vend, që s'duhet përkrahur. E tillë është iniciativa e Sarandës, sipas së cilës traktori i fal kooperativës stimulin e tij, që është vendosur me ligj. Kjo është një iniciativë e gabuar, e cila nuk mund të përhapet. Gjesti patriotik duhet kuptuar drejt. Njeriu mund të ndihmojë vullnetarisht, për shembull, në ndërtimin e një shkolle ose të një çesme, por jo të falë nga të ardhurat që i takojnë atij se «kështu ndihmohet kooperativa!» Fshatarët nuk mund të hanë në kurriz të traktoristit duke i shkurtuar atij rrrogën dhe kjo të na quhet një «iniciativë e mirë», një «eksperiencë e përparuar».

Po kështu është edhe «iniciativa» tjetër për të bërë investime pa të holla. Pashë se në Peshkopi kanë hapur tokë me punë vullnetare, pa marrë ditë-punë. Konkretilisht, në fshatin Dovalan kooperativistët kishin hapur shumë hektarë tokë për të cilat nuk paguheshin. A është e drejtë kjo? Mua më duket se jo. Kooperativisti duhet të marrë ditët që i takojnë për punën që bën.

Nuk përjashtohet që ndonjëherë të ndërmerren edhe aksione me kontribut vullnetar, por kjo nuk duhet të bëhet vijë. Puna e kooperativistit duhet të futet në llogari.

Një sektor me shumë rëndësi në kooperativën bujqësore është ai i financës. Është e domosdoshme që të marrim masa për ta forcuar këtë sektor. Edhe këtu ka eksperiencë të mirë, të cilën mund ta rekomandojmë për t'u përhapur e për t'u zbatuar nga të tjerët. Për shembull, si kanë vepruar kooperativat e mira bujqësore që u kanë dhënë kooperativistëve dy herë në muaj të holla? Ministria e Bujqësisë ta shikojë këtë eksperiencë që ta zbatojnë edhe kooperativat e tjera me kushte pak a shumë të barabarta. Prandaj Ministria e Bujqësisë t'i caktojë çdo rrathi se cilat kooperativa do të japid paradhënie një herë në muaj e cilat dy herë.

Punët në kooperativat bujqësore nuk mund të ecin në përgjithësi, nuk mund të drejtohen pa zbuluar e pa përhapur eksperiencën e mirë. Është fakt se disa kooperativa ecin shumë mirë, disa të tjera janë mesatare dhe disa mbeten prapa. Në rast se kënaqemi me këtë gjendje të çorganizuar, nuk do të kemi rezultatet e dëshiruara. Prandaj të nxitim interesin e fshatarësise për një pjesëmarrje sa më të gjerë në punë, të nxitim e të ndihmojmë punën organizuese të kooperativave bujqësore, ngritjen e nivclit ekonomik të tyre.

Një kujdes të veçantë duhet të tregojmë për kafshët. Aktualisht mund të themi se mungon interesimi i duhur për rritjen e kafshëve tërheqëse, kjo bëhet në mënyrë spontane, pa perspektivë. Si në fushë, ashtu dhe në malësi kafshë tërheqëse na duhen, prandaj të

studjohet edhe kjo çështje. Për shpërndarjen e qeve organet e grumbullimit duhet të bëjnë një politikë më të drejtë. Në radhë të parë qetë duhet t'u jepen rretheve malore ku nuk shkon traktori dhe jo zonave fushore për t'i përdorur për qerre. Është e nevojshme që më parë të sigurojmë bukën, pastaj forcën tërheqëse. Rrethit të Burrelit, për shembull, i duhen mbi 100 pendë qé, prandaj meqenëse jeni këtu, Ministria e Bujqësisë ta shikojë me kujdes këtë nevojë të Burrelit dhe të rretheve të tjera malore, të cilat i kemi lënë pa qé. Po kështu të shikohet krediti për rrethet malore.

Duke lexuar materialin që na është paraqitur, më bëri përshtypje një çështje: disa herë, më shumë rëndësi i kushtohet interesimit për stallën sesa për shkollën. Kjo do të thotë ta kuptosh keq politikisht problemin. Ne do të luftojmë të ndërtojmë si shkollën, ashtu edhe stallën. Shkolla të ndërtojmë medocemos, njeriu mbi të gjitha, kështu na mëson Partia. Këto gjëra duhet të shikohen mirë. Tani ka kooperativa që mund të ndërtojnë edhe shkollën, edhe stallën.

Për ujitjen dhe ekspericencën e fituar në këtë drejtim nuk flitet fare në raport. Mirëpo ujitja është një pasuri e madhe, të cilën nuk na lejohet ta lëmë pas dore. Eksperiencia e mirë në këtë fushë nuk na mungon, prandaj duhet të jepen udhëzime se si të punohet për shfrytëzimin e ujërave, për ujitjen, gjë e cila do të na shpjerë në rendimente më të larta të prodhimeve bujqësore.

Kooperativat bujqësore kanë nevojë për një ndihmë më të madhe dhe më efikase. Kjo kërkon që Ministria e Bujqësisë të çrrënjosë pikëpamjen e saj të gabuar,

sipas së cilës sektori kryesor është ai i ndërmarrjeve bujqësore. Këto te ne zënë 11 për qind të tokave, atëherë përsë na qenkan sektori kryesor? Ministria e Bujqësisë nuk është ministri e NB-ve, por është «Ministria e Bujqësisë» dhe ekonomia më e madhe bujqësore që drejton ajo është në kooperativat bujqësore dhe jo në NB-të. Përveç kësaj, ndërmarrjet bujqësore tani ecin plotësisht me kënbët e veta, atje kemi kuadro drejtues nga më të mirët, teknikë të lartë e të mesëm, mekanikë bujqësorë dhe punëtorë. Prandaj edhe Ministria e Bujqësisë duhet të tregojë më shumë interesim për kooperativat bujqësore. Kjo nuk do të thotë aspak që NB-të të lihen mënjanë dhe tani e tutje të mos tregohet kujdes për to.

Kooperativave bujqësore t'u jepet një ndihmë e vazhdueshme dhe e organizuar. Shokët e Ministrisë së Bujqësisë të shkojnë në bazë sipas një plani të caktuar. Po kështu të veprojë edhe aparati i Komitetit Qendror dhe ai i Kryeministrisë. Ky i fundit duhet të ndihmojë më mirë shokët e komiteteve ekzekutive të rretheve dhe të lokaliteteve, sidomos me instruktorët e kooperativave bujqësore, në mënyrë që të zbatohen si duhet direktivat e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë për forcimin e mëtejshëm të këtyre kooperativave.

Për të forcuar më tepër drejtimin në bazë ne mund të dërgojmë edhe kuadro nga aparatet qendrore, me të cilët të zëvendësohen instruktorët e paaftë të kooperativave bujqësore. Këta instruktorë është e domosdoshme që të shkojnë sidomos çështjen e funksionimit të kooperativave bujqësore, të bëhen organizatorë të mirë ashtu si instruktorët e komitetit të Partisë.

Eksperiencën e ekipeve që kontrolluan e ndihmuan kooperativat bujqësore mendoj që ta përgjithësojmë. Këto ekipe kanë dhënë një ndihmë shumë të madhe, prandaj një praktikë të tillë pune ta përsëritim çdo vit. Vendimi i kësaj mbledhjeje të jetë një vendim i pre-gatitur mirë, në të cilin të jepen direktiva se si duhet të punohet për zgjidhjen me sukses të problemeve shumë të rëndësishme që kanë përpara kooperativat tona bujqësore.

*Botohet për herë të parë sëpas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**LETRAT E POPULLIT TREGOJNE LIDIIJET E TIJ  
TË NGUSHTA E TË SINQERTA ME PARTINE.  
KUSH E FRENON NJË VEPRIMTARI TË TILLE,  
AI DUHET DENUAR RREPTË**

*Letër komiteteve të Partisë në rrrethe*

**30 qershor 1960**

Komiteti Qendror i Partisë i ka konsideruar letrat, ankesat dhe kërkesat e punonjësve si një nga format e lindhjes së Partisë dhe të pushtetit tonë popullor me masat punonjëse. Ai ka theksuar vazhdimisht se puna për shqyrtimin e tyre është një detyrë e rëndësishme e organeve të Partisë e të shtetit dhe e organizatave të tjera shoqërore, se zgjidhja e drejtë dhe e shpejtë e tyre kontribuon në zbatimin e vijës së Partisë, në zbulimin dhe në ndreqjen e të metave që mund të vërtetohen në praktikë, dhe në forcimin e ligjshmërisë socialiste.

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, ashtu si edhe herët e tjera, analizoi çështjen e letrave dhe të ankesave që i janë drejtuar Komitetit Qendror dhe komiteteve të Partisë të rrretheve gjatë vitit 1959. Fakti

që gjatë vitit të kaluar i janë drejtuar Komitetit Qendror më se 7 500 letra e ankesa dhe komiteteve të Partisë të rretheve rrëth 11 000 letra, pa përfshirë këtu ata që janë paraqitur personalisht, është një anë shumë pozitive që tregon besimin e madh që kanë masat te Partia jonë e Punës dhe te Komiteti i saj Qendror përzgjidhjen e çështjeve të tyre.

Nën shembullin e Komitetit Qendror të PPSH ka ardhur duke u rritur gjithnjë e më shumë kujdesi i organave të Partisë dhe të pushtetit, për shqyrtimin dhe përzgjidhjen drejt e shpejt të letrave dhe të ankesave të punonjësve. Disa byro të komiteteve të Partisë e kanë analizuar këtë problem në tërësi dhc, herë pas here, mjaft prej tyre shqyrtojnë çështje të veçanta dhe marrin masat e nevojshme. Gjithashtu ka edhe mjaft organizata-bazë që tregojnë kujdes përkëto çështje.

Por këtu duhet theksuar edhe ana tjetër, ana negative. Letrat dhe ankesat e shumta që i drejtohen Komitetit Qendror të PPSH, tregojnë se në punën e aparateve të Partisë, të pushtetit, të ekonomisë, të organizatave të masave dhe në organizatat-bazë të Partisë ka të meta dhe dobësi serioze.

Nga mjaft letra që i janë drejtuar Komitetit Qendror të PPSH, rezulton se një pjesë e punonjësve kanë shkuar më parë në zyrat përkatëse në rrëth, bile edhe në komitetin e Partisë, por meqenëse çështjet u janë zvarritur ose nuk u janë zgjidhur, atëherë janë detyruar t'i drejtohen Komitetit Qendror. Komitetit Qendror dhe komiteteve të Partisë të rretheve e të qyteteve u drejtohen letra edhe për çështje të vogla, të cilat, po të tregohet kujdes, mund dhe duhet të zgjidhen nga

organizatat-bazë të Partisë, nga bashkimet profesionale dhe nga drejtuesit e institucioneve shtetërore. Vihet re, gjithashtu, se disa punonjës i drejtohen Komitetit Qendror me letra, ose paraqiten personalisht edhe nga vendet më të largëta, pa iu drejtuar më parë organeve në bazë. Këto ngjasin sepse:

*E para.* Organet e Partisë e të pushtetit në rreth, nuk tregojnë kujdesin e duhur për shqyrtimin e letrave, të kërkesave dhe të ankesave që u drejtohen, sepse ato merren si çështje të thjeshta e nuk u jepet rëndësia e duhur. Disa drejtues dhe organizata-bazë të Partisë nuk interesohen sa duhet për njerëzit, për hallet dhe për nevojat e përditshme të punonjësve ashtu si na porosit Partia. Edhe atëherë kur ata janë në dijeni, nuk interesohen për zgjidhjen e tyre qoftë edhe në organet më të larta të Partisë e të pushtetit, por ndodh që bëjnë veshin e shurdhër në mënyrë që t'u shpëtojnë «telashive».

*E dyta.* Në disa qendra pune, komitete ekzekutive, bile edhe në disa komitete partie, nuk është organizuar mirë pritja e popullit. Ka drejtues ndërmarrjesh, sekretarë organizatash-bazë të Partisë, përgjegjës të organizatave profesionale, si dhe kryesi të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore dhe sekretarë të komiteteve të Partisë që nuk bëjnë gjithnjë pritje në ditot e caktuara, me pretekst se janë të zënë me punë të tjera. Çështja tjetër, që ka një rëndësi të dorës së parë, është se në takimet nuk u krijohet kurdoherë punonjësvé një ambient i ngrohtë e nuk dëgjohen me vëmendje, por ndodh që ata priten në këmbë sa për të kaluar radhën.

*E treta.* Me masat, veçanërisht me ato që drejtojnë letra dhe ankesa, nuk bëhet si duhet një punë e mirë sqaruuese dhe bindëse, jepen përgjigje burokratike pa i sqaruar njerëzit me durim dhe pa i bindur ata, sidomos kur pretendimet e tyre janë të padrejta, ose ngaqë nuk njojin mirë ligjet dhe urdhëresat në fuqi.

Nga letrat, ankesat dhe kërkesat që i janë drejtuar Komitetit Qendror të PPSH dhë komiteteve të Partisë të rretheve gjatë vitit 1959, rezulton se ato kanë pasur kryesish karakter personal, por ndër to ka që ngrenë edhe çështje me karakter të interesit të përgjithshëm. Një pjesë e mirë e tyre është zgjidhur në favor të të interesuarve, gjë që tregon se ata kanë pasur të drejtë. Kjo do të thotë se nga disa punonjës, bile edhe drejtues të institucioneve të ndryshme, bëhen hatëre e padrejtësi. Në disa raste mbi këto veprime të papëlqyeshme dhë të dënueshme, organizatat-bazë të Partisë dhë disa komitete partie nuk janë ndalur për të gjetur shkaqet dhe për të vënë para përgjegjësisë personat që i bëjnë ato.

Nga ankesat për pushime nga puna, 21 për qind e tyre janë zgjidhur në favor të të interesuarve. Ka shembuj që tregojnë se disa drejtues ndërmarrjesh mbrojnë në mënyrë të padrejtë, duke shkelur të drejtat e ligjshme të punonjësve. Kështu është rasti i një shitës-magazinieri në librarinë e qytetit të Vlorës, i cili u pushua nga puna prej përgjegjësit për arsy se e kishte denoncuar atë në organet e prokurorisë për abuzime. Disa të tjerë, pa u thelluar mirë, për gabime jo aq të rënda, marrin menjëherë masat më ekstreme duke i pushuar punonjësit nga puna. Përballë këtyre vepri-

meve organizatat e Partisë nuk kanë reaguar si duhet për të vënë para përgjegjësisë së Partisë ata që marrin masa të tilla të padrejta dhe arbitrarë ndaj punonjësve.

Nga ankesat për çështje të ndryshme të bujqësisë më se 16 për qind janë zgjidhur në mënyrë pozitive. Në disa raste vihet re se fshatarëve individualë u bëhet presion për t'u futur në kooperativë, duke u spostuar tokat nga një e dy herë, duke i ndaluar të kullosin bagëtinë në mushahet e fshatit, ose duke marrë masa të tjera. Për shembull në Lukovë të Sarandës, një fshatar e spostuan nga tokat e tij, që kishte jashtë bllokut të kooperativës dhe i dhanë brenda këtij blloku vetëm pér t'i bërë presion që të futej në kooperativë. Ka raste që nuk veprohet drejt në ndarjen e kullotave. Nuk shikohen mirë kërkesat e kooperativistëve që kanë nevojë të punojnë përkohësisht në ndërmarrjet shtetërore, pér dhënen e ndihmës nga fondi 2 pér qind atyre që janë të paaftë pér punë etj. Këto çështje, të cilat njihen dhe janë në kompetencën e organizatës-bazë të Partisë, të kryesisë së kooperativës bujqësore dhe të këshillit popullor, nuk shikohen dhe nuk zgjidhen drejt prej tyre. Kështu fshatarët detyrohen të drejtohen deri në organet më të larta të Partisë dhe të pushtetit.

Mjaft letra ka pér çështje pune dhe pensioni. S'ka dyshim se në kërkesat në këtë drejtim ka dhe mjaft gjëra jo të drejta, ka njerëz që kërkojnë punë të zgjedhur dhe në administratë, por ka edhe raste që tregojnë se nuk mbahen sa duhet parasysh vendimet dhe udhëzimet e Partisë e të Qeverisë, si pér shembull pér vendosjen në punë të invalidëve, caktimin e drejtë të pensioneve etj.

Nga letrat dhe deklarimet rezulton se disa komunistë dhe punonjës pa parti mbajnë qëndrime të padrejta në punë, në shoqëri dhe në familje. Këto çështje nuk bëhen kurdoherë problem e të dënohen nga organizata e Partisë dhe kolektivi punonjës. Për shembull organizata-bazë, ku bënte pjesë ish-drejtori i arkës së kursimit në Durrës, nuk mbajti asnjë qëndrim ndaj tij kur u shqyrtua letra e ish-bashkëshortes së tij, e cila e akuzonte për mashtrim dhe se ishte fejuar me dy-tri vajza të tjera. Vetëm pasi u rishqyrtua çështja, u morën masa deri në përjashtimin nga Partia dhe shkarkimin e tij nga funksioni që kishte.

Shumë qytetarë i drejtohen Komitetit Qendror të PPSH për çështje të strehimit dhe të pashaportizimit, ku theksojnë se kanë shumë vjet që kanë kërkuar strehim dhe nuk janë sistemuar, gjë që tregon se në ndarjen e banesave ka anomali të mëdha dhe hatërlleqe. Vihet re se ndarja e kontingjenteve të banesave për qendrat e punës nuk studjohet me kujdesin e duhur. Përveç kësaj, konstatohet se në disa qendra pune e prodhimi nuk ndiqet gjithnjë kriter i drejtë në ndarjen e banesave, të cilat t'u jepen në radhë të parë atyre punonjësve që kanë më tepër nevojë, që janë punonjës të dalluar, që banojnë në kushte të vështira dhe që kanë parashtruar kërkesa prej një kohe të gjatë. Kështu për shembull në kombinatin e tekstileve «Stalin», ku ka mjaft punonjës që kanë nevojë për strehim, i janë dhënë në mënyrë të padrejtë dy dhoma e një guzhinë një shoku i cili nuk është më punonjës i kombinatit por ka ardhur në Tiranë për të vazhduar studimet. Një punëtor në portin e Durrësit, i cili kishte kërkuar të

strehuhej qysh në vitin 1954, u sistemua vetëm pasi iu drejtua Komitetit Qendror të PPSH. Ndërmarrja e ndërtesave të Elbasanit kishte vendosur t'i jepte shtëpi një punonjësi megjithëse ai kishte shitur shtëpinë e tij mbi 120 000 lekë. Gjithashtu vërtetohen veprime të padrejta si në këmbimin e banesave dhe në zbatimin e vendimeve të gjyqit për lirimin e shtëpive të pronarëve.

Ka pasur raste që disa njerëz kanë siguruuar pashaportizimin në rrugë miqësore ose me matrapazllëqe e mashtrime.

Eshtë për të theksuar se komitetet e Partisë të rretheve e të qyteteve nuk respektojnë gjithnjë afatin e caktuar për shqyrtimin e letrave dhe të ankesave. Nganjëherë në këtë çështje vërehen vonesa të palejueshme. Nuk bëhet një punë e diferencuar për të ndjekur veçanërisht ato letra që kanë karakter urgjent dhe të veçantë. Nuk mbahet kurdoherë parasysh që letrat dhe ankesat të mos i dërgohen për shqyrtim atij kundër të cilit ankohet i interesuari. Disa byro të komiteteve të Partisë nuk zbatojnë udhëzimet e Komitetit Qendror që të paktën një herë në vit të marrin në shqyrtim punën me letrat dhe me ankesat.

Me qëllim që të zhduken të metat dhe dobësitë që vërtetohen dhe të përmirësohet puna në të ardhshmen për këtë çështje të rëndësishme, Komiteti Qendror i PPSH porosit:

1. — Organizatat-bazë të Partisë të rritin më shumë kujdesin e tyre për njerëzit. Të interesohen nga afër për jetën, për hallet dhe për nevojat e përditshme të punonjësve, duke e konsideruar këtë si një nga detyrat e rëndësishme të punës së Partisë. Të dëgjojnë me

vëmendje dhe të zgjidhin drejt e shpejt propozimet, kërkesat dhe ankesat e punonjësve që bëhen në mbledhjet e ndryshme dhe që u drejtohen organizatës-bazë, byrosë ose sekretarit të organizatës së Partisë. Edhe kur çështja nuk është në kompetencën e organizatës-bazë, sekretari i organizatës së Partisë të interesohet për zgjidhjen e saj në organet përkatëse të pushtetit dhe të Partisë. Kjo do të bëjë që të rritet edhe më tepër roli dhe autoriteti i organizatave-bazë të Partisë, të forcohen edhe më shumë lidhjet e Partisë me masat.

2. — Drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të organeve të tjera të pushtetit si dhe kryesitë e kooperativave, si komunistë dhe përfaqësues të pushtetit populor dhe si organe të zgjedhura, duhet të shqyrtojnë dhe të zgjidhin me kujdes, shpejt dhe drejt kërkesat dhe ankesat e punonjësve dhe të mos i përcjellin ato nga një zyrë në tjetrën. Organizatat-bazë të Partisë, herë pas here, të ushtrojnë kontroll dhe të thérresin në raport drejtuesit për të parë se si zgjidhen kërkesat dhe ankesat e punonjësve.

3. — Organizatat-bazë dhe komitetet e Partisë nuk duhet të lejojnë në asnje mënyrë shkeljen e të drejtave të qytetarëve. Njerëzit e pandërgjegjshëm dhe burokratë, që i pushojnë punonjësit pa të drejtë nga puna, që u bëjnë favore njerëzve të njohur duke vepruar jashtë rregullave të caktuara, të vihen përpara përgjegjësisë së Partisë. Të praktikohen më dendur gjyqet shoqërorë, të cilat ndihmojnë për të rritur ndërgjegjen e punonjësve në qëndrimin socialist ndaj punës dhe ndaj pronës socialiste. Kështu do të ndreqen ata që gabojnë dhe do të edukohen të tjerët.

4. — Të organizohet mirë pritja e popullit në ndërmarrjet dhe institucionet e ndryshme, në komitetet ekzekutive të lokaliteteve dhe të rretheve si dhe në komitetet e Partisë. Të afishohen ditët dhe orët e pritjes dhe të respektohen këto me rigorozitet nga drejtuesit. T'u krijohet punonjësve gjatë takimit një ambient i ngrohtë në mënyrë që aia të parashtronjë lirisht mendimet dhe kërkesat e tyre. Kur çështjet mund të zgjidhen aty për aty, të merren menjëherë masa, ndërsa për ato që duhen verifikuar, jo vetëm të mbahen shënime, por në fund t'i jepet përgjigje e plotë të interesuarit. Edhe kur kërkesat janë pa vend, personat duhet të sqarohen mirë dhe me durim në bazë të vendimeve të Partisë dhe të ligjeve të shtetit. Duhet pasur parasysh se puna sqaruese dhe edukative me punonjësit është e vështirë, por e domosdoshme dhe e vëtmja rrugë e drejtë për të bindur masat dhe për të rritur autoritetin e Partisë.

5. — Komitetet e Partisë të rretheve e të qyteteve t'i kushtojnë rëndësinë e duhur politike punës për shqyrtimin e letrave dhc të ankesave, dhe, ashtu sikurse porosit Komiteti Qendror, të mos konsiderohen ato si çështje të thjeshta, sepse çdo letër përfaqëson një njeri me nevojat dhe me kërkesat e tij. Byrotë e komiteteve të Partisë të paktën një herë në vit të analizojnë punën për shqyrtimin e letrave dhe të ankesave, të studjojnë shkaqet, të nxjerrin konkluzione dhe të marrin masat e duhura për përmirësimin e punës me letrat. Një gjë të tillë duhet të bëjnë herë pas here dhe organizatat-bazë të Partisë.

6. — Komitetet e Partisë në rrethe në bashkëpunim

me organet e pushtetit të studjojnë dhe të caktojnë vendet se ku mund të punojnë invalidët që fizikisht janë të paaftë për të bërë çdo lloj pune. Të tregohet më tepër kujdes për sistemin e tyre në punë.

7. — Ndarja e kontingjenteve për banesat të bëhet pasi të jenë studjuar mirë nevojat e çdo qendre pune, duke marrë parasysh numrin e kërkesave, radhën dhe gjendjen e strehimit të punonjësve. Për këtë nga komitetet e Partisë të ushtrohet më tepër kontroll mbi komitetet ekzekutive të rretheve.

Që të bëhet një ndarje e drejtë e banesave për punonjësit, në komisionet e qendrave të punës për shpérndarjen e banesave të bëjnë pjesë: sekretari i organizatës-bazë të Partisë, drejtuesi i qendrës së punës, kryetari i komitetit profesional dhe 3-4 punonjës nga më të mirët dhe që gëzojnë besimin e kolektivit. Ky komision, pasi të studjojë gjendjen e punonjësve që kanë kërkuar të strehohen, të shpallë qysh më parë listën mbi radhën e dhënes së banesave. Në rastet kur vërtetohet se bëhen padrejtësi, organizatat-bazë të Partisë të mbajnë qëndrim dhe ta bëjnë çështje këtë deri në komitetin e Partisë.

8. — Të merren masa për të organizuar më mirë punën në zyrat e punës dhe të pashaportizimit, në mënyrë që ato t'i kryejnë si duhet detyrat e tyre. Të dënohen rastet e marrjes në punë dhe të pashaportizimit në bazë të njohjes e të miqësisë dhe jashtë rregullave të caktuara.

9. — Për të ndihmuar aparatet e komiteteve të Partisë dhe me qëllim që të shqyrtohen sa më shpejt dhe në vend letrat e ankesat e punonjësve, të caktohen

pranë instruktorëve të komitetetëve të Partisë shokë të mirë, aktivistë dhe me aftësi, për verifikimin e letrave. Këta të pajisen me autorizim të posaçëm nga komiteti i Partisë për kryerjen e kësaj pune.

10. — Organizatat e Partisë të marrin masa për të organizuar herë pas here njohjen e ligjeve dhe të urdhëresave të pushtetit nga ana e punonjësve. Kjo duhet bërë vëcanërisht me kuadrot e Partisë e të pushtetit që janë të ngarkuar për zbatimin e ligjeve dhe të urdhëresave.

\* \* \*

Komiteti Qendror i PPSH ka besim se komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive dhe organizatat-bazë të Partisë, do të marrin të gjitha masat për të ndrequr të metat dhe dobësitë e deritanishme në shqyrtimin e letrave, të kërkesave e të ankesave të punonjësve dhe do ta konsiderojnë këtë punë si një detyrë të rëndësi-shme partie.

Në fryshtën e kësaj letre, çdo organizatë partie duhet të nxjerrë detyrat e saj për përmirësimin e punës në të ardhshmen.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*



## L E N D A

PARATHENIE PËR VËLLIMIN 18. .... V—IX

1960

VETËM ME NJË LUFTË TË VENDOSUR KUNDER  
TË GJITHA SHFAQJEVE BORGJEZE DHE MIKRO-  
BORGJEZE VIHEN NË JETË DREJT POROSITË E  
PARTISE PËR ZBATIMIN E PARIMIT SOCIALIST  
TË SHPËRNDARJES SIPAS PUNËS — Letër drejtuar  
komiteteve të Partisë në rrethe (6 janar 1960). ....

1—16

TE POPULLI SHQIPTAR POPULLI I IRAKUT DHE  
POPUJT E TJERE ARABË KANË NJË MIK BESNIK  
NË KOHË TË MIRA E NË KOHË TË VËSHTIRA —  
Nga biseda me drejtorin e Radiodifuzionit të Republikës  
së Irakut dhe kryeredaktor i gazetës «Al Insania»,  
Khadhim al Samavi (6 janar 1960) ....

17—28

POPULLI IRAKIAN BËRI COPË E THERRIME MAS-  
KËN E IMPERIALISTËVE PËR TË NDËRHYRË NË  
PUNËT E BRENDSHME TË VENDEVE ARABE — IN-  
tervistë dhënë zotit Khadhim al Samavi, drejtor i Ra-  
diodifuzionit të Republikës së Irakut dhe kryeredaktor  
i gazetës «Al Insania» (6 janar 1960) ....

29—41

MBI INISIATIVËN E KOOPERATIVISTËVE TË DALUAR TË RRETHIT TË GJIROKASTRËS PËR RRI-TJEN E PJESËMARRJES NË PUNË (15 janar 1960) .....	42—44
PARTIA JONË DO TË JETË KURDOHERË VIGJILENTE NË MBROJTJE TË MARKSIZËM-LENINIZMIT, TË INTERESAVE TË POPULLIT E TË ATDHEUT — Nga biseda në takimin me delegacionin e Partisë Komuniste të Indonezisë, të kryesuar nga D. N. Aidit, Sekretar i Përgjithshëm i kësaj partie (20 janar 1960)	45—86
NE DO TË MOBILIZOJMË TË GJITHA ENERGJITË DHE BURIMET E BRENDSHME PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË BUJQËSISË SOCIALISTE — Nga fjala në mbledhjen e Moskës të përsaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore të vendeve socialiste të Evropës për çështjet e zhvillimit të bujqësisë (2 shkurt 1960) .....	87—100
EDUKIMI I FËMIJËVE — DETYRË E TË GJITHËVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 shkurt 1960) .....	101—103
MË SHUMË INTERESIM PËR PRANIMET NË PARTI — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 shkurt 1960) .....	104—108
SA MË MIRE TË PUNOJNË E TË MËSOJNË GRATË, AQ MË SHPEJT DO TË LULËZOJË SHQIPËRIA — Fjala në takimin me një grup grash të dalluara të vendit tonë me rastin e 50-vjetorit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas (9 mars 1960) .....	107—128

TE EKONOMIZOJMË E TE SHFRYTEZOJMË MË MIRË MATERIALIN E IMPORTIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23 mars 1960) .....	129—136
LIDHJA E TEORISË ME PRAKTIKEN — DETY- RË ME RËNDËSI E SHKOLLËS SONË — Disku- tim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23-24 mars 1960) .....	137—141
TELEGRAM PËRSHËNDETJEJE DËRGUAR MBLE- DHJES SË KOMITETIT EKZEKUTIV TË FBRD (25 mars 1960) .....	142—143
ROLI UDHEHEQËS DHE DREJTUES I PARTISË DU- HET TË NDIHET KUDO — Fjala e mbajtur në aktivin e Partisë të ushtrisë (7 prill 1960) .....	144—167
T'U VIHET FRE SHFAQJEVE LIBERALE PËR TA SJELLË ÇDO GJË NGA IMPORTI — Letër komite- teve të Partisë në rrethe (13 prill 1960) .....	168—178
KUSH ECËN NË RRUGËN E PARTISË, AI DUHET TË LUFTOJË E TË FITOJË EDHE KUNDER VESH- TIREATIVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (16 prill 1960) .....	179—184
TE REALIZOJMË MIRË DETYRAT PËR ZHVILLI- MIN E AGRUMEVE — Diskutim në mbledhjen e By- rosë Politike të KQ të PPSH (16 prill 1960) .....	185—187

PARTIA ëSHTË E FORTË KUR ZHVILLON LUFTËN E KLASAVE DHE ZBATON VIJËN E MASAVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 prill 1960)	188—190
RENDIMENTET E LARTA NË BUJQËSI ARRIHEN ME LUFTË TË MADHE, ME ORGANIZIM TË MIRE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 prill 1960) .....	191—194
PA RININË BUJQËSIA NUK MUND TË ECË SI DU- HET — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 prill 1960) .....	195—197
KUR MERREN ZOTIME, TË MBAHET PËRGJEGJË- SI PËR REALIZIMIN E TYRE — Diskutim në mble- dhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 prill 1960) ..	198—201
REPARTET XHENIERE TË PUNËS TË PREGATITIN NJERËZ ME PROFESIONE TË NDRYSHME — Dis- kutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ, të PPSH (18 prill 1960) .....	202—203
ORGANIZATAT E PARTISË NË KUFI TË JENË TË FORTA, TË PASTRA, MONOLITE — Nga fjala e mbajtur në takimin me ushtarakët e forcave të kufirit (25 prill 1960) .....	204—226
NGRITJA E NIVELIT TË LEKSIONEVE, VARET NË RADHË TË PARË NGA VETË PEDAGOGËT — Dis- kutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (3 maj 1960) .....	227—228

PUNA PËR PRANIMET NË PARTI DUHET TË ZHVI-LLOHET MË ME PERSPEKTIVË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (4 maj 1960) .....	229—232
TË KUPTOHET DREJT NEVOJA DHE RËNDËSIA E INFORMIMIT TË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (4 maj 1960) .....	233—235
TELEGRAM URIMI DËRGUAR KQ TË PK TË INDOZEZISË ME RASTIN E 40-VJETORIT TË THEMELIMIT TË PK TË INDONEZISË (22 maj 1960) .....	236—238
NDËRTIMET KËRKOJNË NJË ORGANIZIM DHE DREJTIM MË TË PËRSOSUR — Fjala e mbylljes në Plenumin XVI të KQ të PPSH (26 maj 1960) .....	239—255
TË ECIM PËRPARA DUKE FORCUAR KURDOHERË UNITETIN, EKONOMINË, EDUKIMIN, VIGJILENCËN — Fjala në mitingun e organizuar në kooperativën e bashkuar bujqësore të Brezhdan-Zdojanit të rrethit të Peshkopisë (31 maj 1960) .....	256—274
VEPRAT QË NDËRTON DHE GËZON POPULLI YNË I MBRON ME VIGJILENCË — Fjala në mitingun e organizuar me punonjësit e Peshkopisë (1 qershor 1960)	275—294
PUNËT ECIN MIRË KUR KOMUNISTËT JANE NË BALLE TË LUFTËS ME VËSHTIRËSITË — Fjala në takimin me kuadrot e Partisë dhe të pushtetit të rrethit të Peshkopisë (1 qershor 1960) .....	295—319

ME VULLNET TË ÇELIKTË, MINATORET KAPËR- CEJNË ÇDO VËSHTIRESI — Fjala në mitingun e pu- nëtorëve të Minierës së Bulqizës në rrëthim e Peshkopi- së (2 qershor 1960) .....	320—330
PUNA NË KOOPERATIVËN BUJQËSORE SIGURON TË ARDHSHMEN E LUMTUR TË FSHATARIT TONË — Fjala në mitingun e organizuar në fushën e Vali- kardhës me fshatarët e lokalitcit të Zerqanit të rrëthit të Peshkopisë (2 qershor 1960) .....	331—339
PARTIA ËSHTË E BINDUR SE RRETHI I MATIT DO TË ECE KURDOHERË PËRPARA — Fjala me kua- drot e Partisë dhe të pushtetit të rrëthit të Burrelit (2 qershor 1960)	340—356
PUNA E ORGANIZUAR NË KOOPERATIVAT BUJ- QËSORE TË LODH MË PAK DHE TË JEP MË SHU- MË — Fjala në takimin me kooperativistët e koopera- tivës së bashkuar bujqësore Shoshaj-Zenisht të rrëthit të Burrelit (3 qershor 1960) .....	357—367
PUNA DHE DITURIA E ZBUKUROJNË JETËN E NJERIUT — Fjala në mitingun e organizuar nga pu- nonjësit e qytetit të Burrelit (3 qershor 1960) .....	368—383
NJERËZIT DUHET TË MESOHEN QË TË JENË TË DREJTË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (13 qershor 1960) .....	384—387
TEMA E AGJITACIONIT FIGURATIV TË JETË MË SHUMË PËR PRODHIMIN — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (13 qershor 1960) ....	388—389

---

EKSPERIENCA E MIRË NË PUNË — FAKTOR I RËNDËSISHËM PËR FORCIMIN E KOOPERATIVAVE BUJQËSORE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (14 qershor 1960) .....	390—400
LETTRAT E POPULLIT TREGOJNË LIDHJET E TIJ TË NGUSHITA E TË SINQERTA ME PARTINË. KUSH E FRENON NJË VEPRIMTARI TË TILLE, AI DUHET DËNUAR RREPTË — Letër komiteteve të Partisë në rrëthe (30 qershor 1960) .....	401—411